- Arkitektura e ndërtimeve edukative është një faktor i fortë në procesin e mësimit e se vendi ku nxënësit mësojnë është po aq i rëndësishëm sa dhe aspekte të tjera të edukimit.
- Ndërtesat edukative duhet të shihen si një koleksion mjedisesh, grumbullim hapësirash të cilat influencojnë mësimin, mësuesin, nxënësit, etj., dhe për këtë duhet të përmbushin parametrat minimale për zhvillimin e procesit.
- Arkitektura e shkollave në Shqipëri është derivat i modeleve të vjetra, të ngurta, jo-fleksible, dhe jashtë parametrave të komoditetit; modele të papërshtatshme me ndryshimet drastike në sektorin e edukimit, të teknologjisë, pedagogjisë, politikës e shoqërisë.

Filozofit e dizajnit të shkollave si "*fit for purpose*" (e përshtatshme për qëllimin) si dhe "*less is more*" (pak është më shumë) kanë gjetur në dizajnin arsimor fushë të gjerë veprimi (Bertman, 2012) dhe kanë detyruar ndërtimin në masë të shkollave nëpër botë por edhe në Shqipëri.

Për ndërtimin e shkollave ashtu si dhe në vende të ndryshme të botës janë mbajtur këto principe por edhe "forma duhet të ndjekë funksionin", dhe motoja e famshme " kursim, kursim, kudo e kurdo" që kanë sjellë që strukturat e shkollave në Shqipëri të kenë përjetuar të gjitha luftërat që ka kaluar vendi, ndryshimet politike, mungesën ekonomike dhe kanë qenë rrjedhojë e programeve, orëve të mësimit, numrit të nxënësve, kostove si dhe shtypjes së mendimit e lirisë së projektimit të arkitektit. Por duke qenë se ndryshimet që shoqëria jonë ka pësuar në 25 vitet e fundit kanë qenë drastike, se bashku me ndryshimet në teknologji, kurrikula, programe, struktura, numrin e nxënësve në rritje në qytetet e mëdha paralelisht më rënien e boshatisjen e klasave në zona rurale, e shumë kërkesave të tjera, kanë çuar në kthimin e këtyre ndërtesave në godina të mbingarkuara ose të boshatisura të ndërtuara jo në parametrat e duhur dhe jo të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor.

## c. Pyetjet e kërkimit

Duke hedhur një vështrim në shkollat në vendin tonë, mënyrën se si ato janë ndërtuar, hapësirat, procesin e mësimit, rëndësinë që arsimi ka për vendin, por edhe për vetë fëmijët, koston dhe ndryshimet që sektori i edukimit po kalon lindin disa pyetje kërkimi.

- Si ka evoluar ndërtimi i shkollave nëpër botë, e njëkohësisht në vendin tonë dhe cilat janë disa nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e arsimit Shqiptar të cilat kanë prekur dhe kanë modeluar arkitekturën e këtyre ndërtimeve, dhe si janë reflektuar këto ngjarje në formën dhe tipologjitë e ndërtesave të shkollave?
- Si janë zhvillimet e arkitekturës së shkollave në vendin tonë në 100 vjeçar-in e fundit duke u fokusuar kryesisht në periudhën e viteve '45-'90 , si periudha e 'Vrull-it' të madh të ndërtimeve arsimore?
- Cilat janë tipologjitë e shkollave në Shqipëri, zhvillimet morfologjike të tyre, modelet e dizajnit, hapësirat, format e tyre të shprehura nëpërmjet arkitekturës, dhe si reflektojnë

këto modele zhvillimet pedagogjike, kurrikulat, strukturat, standardet e nevojat që ka arsimi dhe vetë historinë e tyre?

Janë pikërisht këto pyetje kërkimi të cilat ngrenë edhe qëllimin kryesor të tezës së disertacionit si dhe nën-objektivat e saj.

## d. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i kërkimit është të eksplorojë historikun, arkitekturën e ambienteve të mësimit, normativat, standardet, zhvillimin, format arkitektonike më të përdorura, ndërtesat kryesore arsimore në Shqipëri duke u fokusuar në zhvillimet tipologjike e arkitekturën e ndërtesave të shkollave e në historikun e arsimit dhe dizajnit të tyre në shekullin e fundit e kryesisht në arkitekturën e viteve ’45-‘90, duke qenë se momentalisht kemi ende një numër të madh ndërtimesh ku kryhet mësim nga kjo periudhë specifike.

Gjithashtu objektiv kryesor është të paraqes problemet, faktorët, veçoritë, parametrat, modelet e aplikuara në këto ndërtesa dhe të japi një bazë konteksti mbi zhvillimin e historikut dhe të arkitekturës së shkollave në Shqipëri.

Ky kërkim tenton në të kuptuar pikërisht marrëdhënien që kanë zhvillimet historike me arkitekturën e ndërtesave shkollore, marrëdhënien mes përdorimit të shkollës dhe arkitekturës, marrëdhëniet e ndryshme të arkitekturës dhe edukimit, e nëse është e mundur të bëj përgjithësime mbi këto marrëdhënie ose mbi principet e dizajnit të shkollave ose në mënyrë më pak ambicioze, të nxirren , të evidentohen faktorët dhe elementët kryesorë që duhet të kihen parasysh në projektimin e shkollave.

Vlerësimi i ndërtesave të mëparshme mund të na sjellë disa të përbashkëta ose principe përgjithësuese, të cilat mund te jenë të dobishme te ata që merren me këtë fushë. Megjithëse mund të argumentohet se investigimi i këtyre ndërtesave nuk na jep një zgjidhje të vetme në dizajnin e shkollave, ka sugjerime te forta e aspekte të procesit te projektimit të ndërtimit e të përdorimit te tyre që mund të reflektojnë problemet, çështjet, variabëlit, influencat në arsim e të bëhen modele dizajni për të ardhmen e projektimit e shkollave.

Kjo temë disertacioni kërkon të provokojë debate rreth asaj që ka qenë, është dhe ndoshta e si duhet të jetë e ardhmja e ndërtesave të shkollave, duke ilustruar çështjet dhe temat nëpër të cilat ky grup i madh ndërtesash ka evoluar, faktorët e shumtë që kanë çuar në këto lloj ndërtimesh si dhe eksploron ndryshimet dhe efektet që kanë kaluar në sektorin e edukimit nëpër rrjedhën kronologjike të historisë. Ky hulumtim përcakton kontekstin për këtë sektor, trajton zhvillimet evolutive si dhe eksploron marrëdhëniet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në mjedisin e ndërtuar të shkollës. Përcakton kush janë problemet kryesore brenda këtij sektori si dhe identifikon disa nga çështjet që i kanë shkaktuar këto probleme në mënyrë të tillë që të merren masa për ndryshimet dhe projektimin e shkollave për të ardhmen në Shqipëri.

Kjo teme kërkimore bazohet në disa objektiva e nën-objektiva të lidhura pikërisht me pyetjet e kërkimit të ngritura më sipër.

1. Nën-objektivë e këtij kërkimi është shfaqja e rëndësisë së dizajnit të shkollës dhe gjithë efektet që ky projektim ka në procesin e marrjes e dhënies së mësimit, bazuar në literaturën botërore. Studimet e shumta të cilat reflektojnë efektet dhe rëndësinë

paraqiten si çështje themeltare së bashku me faktorët kryesorë që kihen parasysh në projektimin e shkollave.

2. Baza teorike dhe shembujt e zhvillimeve kryesore në botë të historisë dhe evoluimit të ndërtesave arsimore përbëjnë një pikë kyçe për temën e cila përdor rishikimin e literaturës si pikë referimi për ngritjen e supozimeve kohore si dhe përcaktimin e periudhave kryesore të zhvillimit të arsimit në Shqipëri.
3. Zhvillimet e ndryshme në arsim sjellin ndryshime në dizajnin e ndërtesave shkollore e si objektiv mjaft i rëndësishëm është edhe analiza e rasteve të ndryshme, e atyre objekteve të cilat kanë bërë historinë e arsimit Shqiptar dhe e shembujve të shkollave më të rëndësishme në vazhdën e historisë.
4. Si objektiv final është fokusimi në analizën e tipologjive, morfologjisë, hapësirave dhe elementëve më të rëndësishëm të dizajnit në shkollat e projektuara në vitet '45-'90 si periudha e ndërtimeve të numrit më të madh të modeleve tip në Shqipëri. Të studiohen e të analizohen parametrat dhe elementet fizikë e morfologjik të hapësirave të shkollave, klasave, laboratorëve, korridoreve, ambienteve të jashtme etj., si dhe dimensionet e hapësirave, format, madhësitë, orientimi, lartësitë, pajisjet dhe organizimi i tyre.

Mbi bazën e këtyre objektivave e pyetjeve kërkimore është strukturuar edhe përmbajtja e temës së disertacionit e cila fokusohet në katër kapituj kryesore.

## e. Metodologjia dhe metoda e kërkimit

Dy metodologjitë kryesore të zgjedhura për të kryer këtë kërkim janë të tipit përshkrimor dhe analitik. Është zgjedhur metoda përshkrimore duke qenë se "qëllimi kryesor i kësaj metode është të përshkruaje faktet, ngjarjet, statusin e të dhënave ashtu siç kanë qenë ose si janë në të tashmen." (Kumar, 2008, f. 6) Duke qenë se në thelb të këtij hulumtimi është raportimi i ngjarjeve historike, i zhvillimeve në arsim, i grumbullimit të të dhënave, i efekteve që projektimi ka në procesin e arsimit si dhe i faktorëve që ndikojnë kryesisht duke u bazuar edhe në rishikimin e literaturës botërore, por pa influencuar në këta variabël, e bëjnë këtë kërkim të tipit përshkrimor. Në kapitullin e katërt, por edhe në të tretin në të kundërt është përdorur "metoda analitike, ku të dhënat e grumbulluara, faktet, informacionet e mbledhura, analizohen duke bërë një vlerësim kritik të tyre." (Kumar, 2008, f. 7)

Ky studim është ndërdisiplinor me përmbajtën e tij që përfshin si historinë e edukimit, atë të dizajnit si dhe analiza e vlerësime kritike të ndërtimeve arsimore. Përdoren metodat e analizimit vizual ku si burime kryesore përdoren fotografitë, planimetritë e ndërtesave e gjithashtu publikimet, librat, revistat etj., nga historia e arsimit dhe ajo e projektimit për të identifikuar dhe kategorizuar gjuhën e dizajnit nën vazhdën e historisë.

Për përgatitjen e kapitullit të parë dhe të dytë metoda e kërkimit është bazuar kryesisht në grumbullimin e literaturës, studimeve, dhe të dhënave të kryera më herët, kështu që burimi i të dhënave kanë qenë të tipit sekondare ose edhe terciare, duke qenë se këta kapituj bazohen kryesisht në zhvillimet historike në Botë, në Shqipëri, faktorët kryesorë që ndikojnë projektimin e shkollave si dhe efektet ose rrjedhojat që këta faktorë sjellin në mësim.

Për realizimin e kapitujve të tretë e të katërt kërkimi është bazuar kryesisht në të dhëna primare ku janë grumbulluar nëpër Arkivin Qendror të Shtetit si dhe Arkivin Qendror Teknik të

Ndërtimit, planimetri të mbi 150 shkollave tip, ose edhe të shkollave të veçanta, fotografi të këtyre ndërtimeve nëpër vite, të dhëna të tjera, si fakte, dokumente, relacione, preventiva etj. Gjithashtu është punuar me literaturën, datat e të dhënat e grumbulluara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Biblioteka Kombëtare, Muzeu Historik Kombëtar, Bashkia Tiranë, si dhe një sërë intervistash të kryera me inxhinierë e arkitektë të cilët kanë ndihmuar në projektimin e këtyre shkollave. Gjithashtu janë kryer vëzhgime e fotografi në një pjesë të madhe shkollash në Shqipëri.

Planimetritë e rreth 100 shkollave tip të periudhës ’45-‘90 janë hedhur në programin Auto-CAD-Architecture, dhe janë përgatitur skeda për secilën shkollë me informacionet kryesore dhe zgjidhjen në plan të shkollës, në mënyrë për të grumbulluar të dhënat mbi sipërfaqet që ato kanë, hapësirat, organizimet, normativat, standardet etj. Të gjitha llogaritjet janë përpunuar në programin Excel për të kuptuar më qartë këto parametra të dizajnit.

Më poshtë në Figurën 1 jepet një shembull i skedës së formuar si dhe i të dhënave të marra për një shkollë të mesme.

| | | | Shkolla 11 vjecare | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Viti** | **1953** | | | | |
| | | **Nentipi** | **me 2 kate** | | | | |
| | | Emertimi | Nr. | M2 | M2/nx | Sip. Tot | **Totali** |
| | | **Nxenesit** | **40** | | **2.1** | **440** | |
| **Hapesira mesimi** | **Hap. Didaktike** | **Klasa** | 10 | 42 | 1.05 | 420 | 461.56 |
| | **Hap. Praktike** | **Laboratore** | 1 | 42 | 1.05 | 42 | |
| | | **Palestra** | | | 0 | 0 | |
| **Hapesira per aktivitete te lira** | | **Biblioteke** | 1 | 42 | 0.1 | 42 | 41.96 |
| | | **Salle Nxenesish** | | | | 0 | |
| | | **Mence** | | | | 0 | |
| **Hapesira shperndarese** | | **Holle** | 2 | 32 | 0.23 | 64 | 229.2 |
| | | **Korridore** | 2 | 72.6 | 0.52 | 145 | |
| | | **Shkalle** | 1 | 20 | 0.07 | 20 | |
| **Hapesira administrative** | **Administrata** | **Drejt/Sekr/mes** | 5 | 17.2 | | 85.9 | 85.9 |
| | **Mesuesi** | **Fjetje** | | | | 0 | |
| | | **Kabinete** | | | | 0 | |
| **Ambjente ndihmese** | **Ndihmese** | **Zhveshje/dushe** | | | 0 | 0 | 105.2 |
| | **W.C.** | **m2/Nxenes** | 4 | 12.1 | 0.17 | 48.2 | |
| | | **cope/Nxenes** | 8 | | 55 | | |
| | | **Mesuesi** | | | | 0 | |
| | **Depo** | **Depo** | 4 | 14.3 | | 57 | |
| | | | Nr./klase | Gjeresi | Lartesi | Raport | M2 Neto |
| **Ndricimi ne nje klase** | | | 3 | 1.2 | 1.8 | 0.15 | 923.82 |
| **Korridore** | | | | 2.4 | | | |
| **Shkalle** | | | | 1.6 | | | |




Figura 1. *Shembull i skedës së hartuar për një shkollë të mesme si dhe skema shpërndarëse e nukleve funksionalë.*

## f. Limitet e vështirësitë e studimit

Pavarësisht se numri i madh i shkollave të grumbulluara japin një bazë relativisht të plotë të dhënash nga ku mund të bëhen analizat dhe përgjithësimet kryesore, mendohet që jo të gjitha

planimetritë e shkollave të ndërtuara janë përfshirë në studim, kjo për shkak të mungesës së planimetrive nëpër arkiva. Ka gjithashtu një boshllëk të madh literature e shkrimesh të cilat analizojnë arkitekturën në përgjithësi në periudhën '45-'90 dhe gjithashtu është hasur vështirësi me të dhënat, statistikat e datat e gjetura në Ministrinë e Arsimit të cilat shpesh janë edhe jo të sakta ose kontradiktore mes tyre.

Gjithashtu është prekur shumë pak e trajtuar në mënyre sporadike, arkitektura e 25 vjeçar-it të fundit duke qenë se në këtë periudhë ka pasur më shumë rikonstruksione e ndërtime shkollash të reja por jo të llojit Tip. Duke qenë se ky numër prej 1600 rikonstruksionesh është bërë unik për secilën ndërtesë nuk mund të analizohen shkolla individuale pasi nuk përbëjnë përgjithësime, dhe për këtë nuk ka qenë pjesë e studimit arkitektura e shkollave e ndërtuar në këtë periudhë.

## g. Organizimi i Temës

Ky kërkim është konceptuar dhe ideuar në katër kapituj kryesorë ku kombinohet në gjithë shkrirjen e tij kriteri kronologjik me atë problemor. Pjesa vijuese e disertacionit është menduar e ndarë në pjesë të cilat trajtojnë çështje të rëndësishme për arsimin dhe arkitekturën që lidhet me ndërtesat arsimore. Hulumtimi i grupuar në katër kapituj kryesorë lidhet me katër tema thelbësore:

**Kapitulli 1: Arsimi dhe arkitektura,** ku trajtohen nën temat mbi bazën teorike dhe rishikimi i literaturës mbi historikun e zhvillimeve të ndërtimeve arsimore në botë, efektet që projektimi e dizajni i shkollave sjell në procesin e mësimit, si dhe faktorë të shumtë që merren parasysh në projektim e shkollave.

**Kapitulli 2: Vështrim historik i zhvillimeve arsimore në Shqipëri.** Ky kapitull fokusohet mbi ecurinë kronologjike të arsimit, gjuhës shqipe dhe të mjedisit fizik të edukimit ku ky proces ka ndodhur duke evidentuar ngjarjet kryesore në arsimin Shqiptar.

**Kapitulli 3: Arkitektura e ndërtesave arsimore në Shqipëri.** Ky kapitull i cili përbën një pjesë të madhe të hulumtimin përbëhet nga një analizë e ndërtesave kryesore të shkollave në Shqipëri duke trajtuar arkitekturën, organizimin, funksionimin e të dhëna të tjera të këtyre mjediseve kaq të rëndësishme të renditura në bazë kohore, prej fillimit deri në vitet 1944.

**Kapitulli 4: Analiza tipologjike e arkitekturore e ndërtimeve arsimore në vitet 1945-1990.** Zhvillimet e arkitekturës së ndërtimeve të periudhës 1945-1990 janë grupuar, janë analizuar duke ndarë tipat e shkollave të ndërtuara në Shqipëri, dhe duke i studiuar mbi parametrat, normativat e modelet e dizajnit kryesore të tyre.

Sinteza e 4 kapitujve vjen e diskutuar dhe e përmbledhur te përfundimet dhe diskutimet e cila është pjesa përmbyllëse e temës së disertacionit. (Figura 2)




Figura 2. *Skema e organizimit të strukturës së tezës*

Ledita Mezini

# KAPITULLI 1

# ARSIMI DHE ARKITEKTURA

## HYRJA

*"Dizajni i ndërtesave të shkollave është si një guaskë eksterieri dhe organizmi në interier, i hapësirave dhe i mobilimit, në një marrëdhënie simbioze, midis ideve mbi fëmijët, edukimit, dhe komunitetit."* (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Në këtë kapitull prezantohet një analizë e literaturës që lidhet me arkitekturën e shkollave. Analiza ekzaminon se si shkrimet dhe studimet rrotullohen rreth faktorëve që kanë impakt në dizajnin e shkollës, lidhjen midis kushteve të mjedisit edukativ dhe procesit të marrjes dhe dhënies së mësimit, si dhe elementëve kryesorë të projektimit të shkollës. Gjithashtu pjesë e rëndësishme e kapitullit është një vështrim në arkitekturën e ndërtesave arsimore në botë për të kuptuar stadet më kryesore të evoluimit të historisë dhe ndërtesat më të rëndësishme të arkitekturës edukative.

Kapitulli i parë fokusohet në tre pjesë të bazuara në rishikimin e literaturës e bazën teorike ku evidentohet shkolla dhe dizajni i tyre, çfarë përfaqëson, kush janë studimet kryesore në fushën e dizajnit të shkollave, elementet ose faktorët që kihen parasysh kryesisht për projektimin e ndërtesave shkollore, si dhe një vështrim i përgjithshëm zhvillimeve arsimore të ndërtesave në botë. Njohja me ndryshimet e vazhdueshme dhe ecurinë e dizajnit të shkollave është një hap i domosdoshëm pasi na reflekton dhe na mëson mbi gabimet, idetë, teoritë e mëparshme që nuk kanë funksionuar në ndërtimin e shkollave e gjithashtu na nxjerr një bazë teorike për të kuptuar, krahasuar e për të mbështetur arkitekturën e shkollave në Shqipëri në lidhje me shkollat në botë.

## 1.1 SHKOLLA DHE RËNDËSIA E PROJEKTIMIT TË TYRE

### 1.1.1 Shkolla dhe dizajni i tyre

Pyetja kryesore që lind është se çfarë përfaqëson shkolla e pse ka rëndësi projektimi i mirë i saj? Nëse e përshkruajmë me elementet e saj më të thjeshtë se çfarë ka qenë shkolla në shumë vende të botës dhe është akoma edhe sot e kësaj dite, "është thjesht një vend i vetëm takimi, një mësues, një rrjedhë mendimi, një formë e organizuar uljeje (zakonisht në rreshta), një qëllim i përbashkët, e sigurisht fëmijë." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

"Sigurisht shkollat kanë ekzistuar prej shekujsh, nga njëherë duke u kujdesur për të varfrit por kryesisht për të pasurit, shpesh duke u lidhur me qëllimet fetare, në një vend prodhimi (fabrikë ose zyrë), ose në një shtëpi a fermë." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008) "Klasa të mëdha me mbi 55 nxënës të ulur në rresht e që përsërisnin mësimin si papagall, dhoma të mbingarkuara, ventilim, ngrohje, ndriçim, higjiene skarso, karrige rigjide e të palëvizshme dhe mungesa e hapësirave të lojës" (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004), përfaqësonin ndërtesën e shkollës dhe arkitekturën e saj në shekullin e XIX.

Ledita Mezini

"Kërkesat e shkollës kanë ndryshuar me kalimin e kohës, nëpër principe të ndryshme nga nevoja për ajër të pastër, më pas të dëshira për të ndërtuar shpejt te kërkesa për të dhënë sipërfaqe të mëdha për mënyra të ndryshme të të mësuarit." (Baker, 2012)

Për sa i përket arkitekturës së shkollave ato "duhet të ishin ndërtesat më të bukura në fshat mbas ndërtesës së kishës." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)  I po këtij mendimi është edhe arkitekti Hertzberger i cili shkruan: "Ka pasur mjaft shkolla të admirueshme të dizenjuara në shekullin e 20-të nga arkitektë të ndryshëm, shkolla që dallonin për nga materialet, vetratat e me klasa të vendosura rresht një korridori." Arkitekti sqaron që këto me pamjen e tyre monumentale  në vitet 1930, vendoseshin në zona lagjesh të reja e me madhësinë e tyre binin dukshëm në sy në siluetën e qytetit. " ato shpesh u panë si "kishat" e këtyre lagjeve, në mënyrë kulturore ashtu edhe kontekstuale. Ndërtesat e shkollave u bënë një lloj ndërtimesh qartësisht të identifikueshme, e familjare në siluetën e qytetit, plotësisht të integruara, e të asimiluara në bllokun urban. (Hertzberger, 2008, p. 12)

Duhet të kihet parasysh se "edukimi publik është një nga qëllimet kryesore të shoqërisë demokratike, dhe ndërtesa ku edukimi zhvillohet e bën këtë qëllim të rëndësishëm, jo vetëm pasi i jep formë mënyrës se si mësohet, por edhe jep ikona dhe simbole për vlerat që quhen të përbashkëta si shoqëri." (Baker, 2012, f. 3)

> "Ndryshimet tipologjike dhe fizike në arkitekturën e shkollave kanë qenë të influencuara gjithmonë nga ndryshimet sociale-politike, ekonomike, dhe ideologjitë e arsimit të shoqërisë. Këto ndryshime i kanë dhënë formë konceptimit të zhvillimit të fëmijës, sjelljes rreth praktikës edukuese, dhe tipin e ndërtesave arsimore së bashku me formën fizike e sociale të tyre, që u zhvilluan si agjentë të socializimit. Në mënyrë për të kuptuar arritjet e strukturës e ambientit të shkollës kontemporane, roli i tyre si agjente socializimi , historia e mjedisit të shkollave duhet të studiohet duke e konsideruar zhvillimin e tyre social dhe fizik, nëpërmjet trashëgimisë së vlerave, sjelljeve, e formës fizike." (Pasalar, 2003)

Po nga se ndikohen shkollat ne dizajnin e tyre? Baker thekson se "shkollat influencohen nga lëvizjet politike dhe sociale, risitë dhe teknologjitë e reja, ndërgjegjësimi në rritje për ato që na bëjnë të mësojmë më mirë e kështu të gjitha nocionet tona mbi çfarë e bën një shkollë të mirë po ndryshojnë e po adaptohen në ide të reja. Megjithatë në akoma jemi të rrethuar nga shkolla që i përkojnë ideologjive të një shekulli më parë, kur bota dhe të kuptuarit tonë mbi edukimin ishte krejt ndryshe; godina ndriçohej nga dielli, ngrohja realizohej me soba të mëdha druri ose qymyri, dhe fëmijët vetëm shikoheshin dhe nuk dëgjoheshin." (Baker, 2012)

Ideja se shkollat e të shkuarës nuk ndryshojnë shumë nga shkollat e të tashmes e se elementë të veçantë ngelen po njësoj theksohet edhe nga një artikull i Frith dhe Whitehouse (2009). Me gjithë ndryshimet e shumta në pedagogji dhe fushatat promovuese që kërkojnë të bëjnë në godinat e shkollave, studimi reflekton se si historikisht shkollat të projektuara nga Modernistët e nga arkitektët e mëvonshëm manifestojnë dizajnë jo krejt të reja, e kanë një rrjedhshmëri mendimi. (Whitehouse, 2009)

Ndërsa sugjerimi i kompanisë *Shneider Elecric Building AB*, në raportin e tyre *"Building Intelligence"* rekomandojnë që në projektimin e shkollave duhet të kihen parasysh kurrikulat,

pedagogjia por njëkohësisht edhe vetë ambienti i mësimit. Raporti thekson se "shkollat e të ardhmes duhet të stimulojnë njohuritë, aftësitë e nxënësve por njëkohësisht duhet të jetë mbrojtëse të shëndetit dhe të ambientit që ata jetojnë." (Building Intelligence , 2009, f. 9) Sugjerimet për përmirësimin e ndërtesave të shkollave fokusohen në një numër të caktuar çështjesh siç janë shëndeti, ruajtja e energjive, rezultatet pedagogjike, impakti mjedisor dhe siguria.

Studimet e Stamps tregojnë që njerëzit mësojnë më mirë në ambiente pune 1 me 1 ose në grupe të vogla dhe që ambientet duhet të vizatohen që të marrin parasysh këtë fakt (Stamps, 1998) Ndërsa studimi i Copas (2000) rekomandon që shkollat të hapen drejt komunitetit: pjesëmarrja e familjarëve në nivelin e shkollës është një prioritet.

Ndërkaq Schank thekson rëndësinë e mjedisit te jashtëm dhe ndikimin e madh që ka teknologjia në dizajn. "Ambientet e mësimit- në qoftë se nxënësit kanë interes në mësim dhe ambientet e mësimit ekzistojnë si brenda dhe jashtë ndërtesës së shkollës, teknologjia do të jetë ngjitësi që do i mbajë të lidhur". (Schank, 1999)

"Interieri i shkollës është përdorur për të ndërtuar e për të dhënë formë eksperiencave dhe marrëdhënieve, ambienteve dhe atmosferës, rrjedhshmërisë dhe lëvizjes, nocioneve të kohës dhe vendit, dhe të grupojë identitetet nëpërmjet organizimit hapësinor, dizajnit të mobilieve, dhe përzgjedhjes, zgjedhjen e mobilimit e pajisjeve, përfshirja e teknologjisë, aksesi te mjetet e burimet, përdorimi i ngjyrës, teksturës, materialit të dritës si asaj natyrale e artificiale." (Whitehouse, 2009, f. 94)

Hertzberger në librin e tij *Space and Learning* përpiqet të tregojë se si arkitektura dhe edukimi influencojnë njëra tjetrën duke treguar se hapësira mund të jetë një stimul për të mësuar. Sipas tij, ndërtesa e shkollës është një nga të paktat fusha në arkitekturë ku projektuesit mund të përcaktojnë dhe influencojnë kushtet humane. Në opinionin e tij "ndërtesa e shkollës kërkon një balancë mes përdorimit, performancës dhe arkitekturës së informuar nga edukimi." (Hertzberger, 2008) "Principi kryesor i shkollave është: të mësosh si të mësosh" e sipas Hertzberger, "hapësira të ndihmon për të mësuar."

Ashtu siç argumenton Adrian Forty: "Dizajni është një metodë e prodhimit kulturor i cili përcakton idenë se cilët në jemi e se si duhet të sillemi në një formë tangenciale të përhershme." (Forty, Objects of Desire, 1986, str. 6) Dhe sipas Catherine Burke, Ian Grosvenor, "dizajni kontribuon që të ndërtojë kulturën materiale të edukimit." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

### 1.1.2 Pedagogjia dhe godina

"Procesi i mësimit është një aktivitet kompleks që teston motivimin e nxënësve dhe kushtet fizike. Mësuesit dhe kurrikulat luajnë një rol vital në edukimin e fëmijëve." (Lyons, 2001, f. 1) Por pyetja që ka nisur të bëhet gjerësisht është se çfarë ndodh me kushtet fizike dhe dizajnin e vetë ndërtesave të shkollave, dhe si ndikojnë ato në eksperiencat e mësimit.

Historikisht, shkollat u kanë ngjarë institucioneve në mënyrën e arkitekturës si dhe organizimit, në vend të tipologjive të vendeve që fëmijët i kanë më të njohura e të dashura siç janë shtëpia e tyre ose vendi i lojërave pranë lagjes. Studiues të ndryshëm kanë punuar për të gjetur gjurmët

e historisë së arkitekturës së shkollave si Dudek, Burke e Grosvenor etj., "por ajo që është me shumë interes në historinë e dizajnit të shkollave është besimi i vazhdueshëm në një lidhje mes influencës aktive e të vazhdueshme mes pedagogjisë dhe arritjeve të nxënësve" (Bertman, 2012)

Shumë studime theksojnë se ndërtesa e mësimit duhet të jetë e lidhur me vetë procesin e mësimit. Në studimin e përbashkët të *Committe on Developments in the Science of Learning, Commission on Behavorial and Social Sciences and Education,* dhe *National Research Council* shpjegohet qartë se mënyra e mësimit ka ndryshuar shumë në shekujt e fundit, prandaj kur mendojmë të projektojmë duhet të kemi parasysh mënyrën se si jepet mësimi, çfarë mësojmë, dhe si përvetësohet nga nxënësit. Ka katër perspektiva në dizajnin e ambienteve të mësimit- që janë të rëndësishme për këto ambiente- nxënësi në qendër-njohuria në qendër-praktika në qendër dhe komuniteti në qendër. (John D. Bransford, 1999)

Një tjetër artikull që mbështet teorinë se që të krijosh një ambient perfekt mësimi duhet të kuptosh se si janë teoritë e ndryshme të së mësuarit është "Ambienti i mësimit optimal-Teoritë e të mësuarit." (Akkinsanmi, 2008) Në artikullin e tij ai përshkruan ambientet e mësimit të ndërlidhura me secilën prej tre teorive të së mësuarit. Nëpërmjet një kalimi të shkurtër të historisë e të këtyre teorive autori mbështet idenë se duhen krijuar "vende për të mësuar e jo thjesht hapësira për të mësuar".

Në studimin e tij mbi pedagogjinë inventive dhe ndërtesave të shkollave autori thekson mbi rëndësinë se projektimi i shkollave të reja duhet të marrë parasysh metodat e reja në pedagogjinë dhënien dhe marrjen e mësimit dhe këto duhet të reflektohen në ndërtesë. (Washor, 2003) Studime të shumta mes drejtuesve, mësuesve dhe administratës së shkollave kanë treguar që 96 % mendojnë se një dizajn i mirë i shkollës është një pjesë e rëndësishme për të pasur një ambient të mirë mësimi (Schapiro, 1998) Ndërtesat e shkollave duhet të stimulojnë mësimin dhe format e këtyre ndërtesave duhet të lidhet me funksionin që ato kanë. Por si duhet të jenë këto ndërtesa të reja ku "forma ndjek funksionin" por funksioni i shkollës është në një lëvizje e transformim të vazhdueshëm. Industria e edukimit po zhvillon alternativa inventive ndaj sistemit sundues aktual të projektimit të shkollave, ku strukturat e shkollave ecin paralel me programin e fokusuar te lëndët, klasat, kurrikulat etj. (Nathan, 2001)

Duke qenë se modele të reja shkollash kanë dalë dhe bota po përkrah ide të reja në procesin e mësimit atëherë edhe objektet e shkollave duhet të përkrahin këto modele. Ndërtesat e reja për metodat pedagogjike të reja duhet të jenë shumë ndryshe nga ndërtesat e së shkuarës. Ndërtesat e shkollave të ndërtuara 100 vitet e fundit reflektojnë një model edukimi të tipit fabrikë. (Washor, 2003) Në këto ndërtesa, nxënësit ishin instruktuar dhe drejtuar të mblidhnin fakte sesa të përdornin mendjen e të zgjidhnin probleme që s'kishin përgjigje konkrete. Kështu që ishte e lehtë të krijojë hapësira që nuk ishin fleksible, dhe që përdoreshin për vetëm një qëllim: të jepje informacion nga mësuesi te nxënësi herë pas here (Copa, 2000)

Nocioni që dizajni i arsimit duhet të jetë fleksibël por gjithashtu të akomodojë programin e nxënësve, është një problem i ndërlikuar.

Ambienti i mësimit të modelit të Montessori (1966) e drejton te forma ndjek funksionin, dhe nxënësit, përdorin duart dhe mendjen në një varietet hapësirash të ndryshme brenda një

ambienti. Ndërsa Roger Schank (1999) tregon se shkolla ka nevojë për tre ambiente për të mësuar, të cilat janë : Mësim i fokusuar, punë kolaborative (Sociale) dhe punë me "Duar në projekt". Këto hapësira mund të jenë brenda ose jashtë shkollës.

Masat e performancës janë shpesh të lidhura me praktikat e vlerësimit nga vetë përdoruesit. Por në përgjithësi këto nuk fokusohen në aspektin teknik të ambientit të mësimit. Një rritje interesi mbi relacionin që ka pedagogjia me ambientin e mësimit është ilustruar nga tezat e shumta të doktoratës të cilat kanë bërë një kërkim sasior mbi këtë pyetje. Këto kërkime kanë rezultuar në masën e performancës në "bazë evidence" e cila lidh kushtet e ndërtesës me rezultatet në testime. Kështu përmirësimi në rezultatet e testimeve deri në 14 % bëhet duke përmirësuar kushtet e ndërtesës (Earthman, 1998) (Fischer, 2005)

Në artikullin e Kenn Fischer (2005) ekzaminohen më në detaj ambientet e mësimit dhe gjithë masat kërkimore cilësore dhe sasiore që janë përdorur për të parë efektivitetin e tyre. Eksploron disa nga pedagogjitë dhe performancat e ambientit dhe i shikon këto në kontekstin e kërkimit të nevojshëm dhe përpiqet të lidhë pedagogjinë (duke përfshirë nxënësit dhe sjelljet e mësuesve me hapësirën). Ekzaminon disa raste dhe fokusohet në strategjitë e reja sistemin DET- Victoria që lidh Pedagogji-Hapësirë.

Gjithashtu kërkime cilësore janë kryer duke pasur si fokus kërkimin me "bazë evidence". Në këto kërkime ka pasur përpjekje për të lidhur pedagogjinë me ambientin duke identifikuar disa matëse kyçe të performancës. Ka disa raste të këtyre shembujve duke përfshirë konspektet e *OECD PEB*, *Design Share Awards* dhe renditjen e klasës nga Sanoof (2001). Kriteret zgjedhëse për konspektet e OECD-PEB kanë 6 kategori nga të cilat dy bazohen në ambientin e mësimit. E para pyet se si dizajni stimulon fëmijët në eksperiencën e të mësuarit, ndërsa e dyta pyet të anketuarit të ilustrojnë se si ambienti i ndërtesës është adaptuar ndaj formave të reja të mësimit e të kërkimit e se si përdorimi i TIK-ut optimizonte planifikimin ose menaxhimin.

Ndërsa *Design Share Awards* ka 6 kategori nga të cilat vetëm njëra fokusohet te ambienti i mësimit- "Stimulon mësimdhënien dhe mësim marrjen dhe akomodon të gjithë nevojat e nxënësve." Kjo përfshin disa elemente si: të ndjekësh kërkimin në shkencën e mësimit; nxënësit duke bërë dhe jo vetëm duke marrë; të krijosh dhe jo vetëm të ri-krijosh; zgjidhja e problemeve të nxënësve; bashkëpunimi, projektet, ndërdisiplinor; theksimi i stileve të të mësuarit, inteligjencat e ndryshme dhe nevojat e veçanta të nxënësve; ndërtesat e shkollave janë mjete të rëndësishme mësimi; dhe në fund kërkimi mbi impaktin që ambienti fizik ka në arritjen e nxënësit.

Renditja e klasave nga Sanoof kishte të bënte me pyetjet e anketuesve drejt organizimit, formës së 6 tip klasash. Renditja bëhet në bazë të 11 kritereve të komentuara më pas edhe nga anketuesit. Ky model paraqet një fokus të fortë mbi vlerësimin e pyetjen e lidhjes pedagogjike me vlerësimin e dizajnin e ambientit të mësimit. (Sanoof, Pasalar, & Hashas, 2001)

Qartësisht burimi më efektiv dhe i konsoliduar në kërkimet mbi dizajnin e ambienteve të mësimit janë të ofruara nga Educational Research Clearinghouse (ERIC) dhe nga National Clearinghouse for Educational Facilities. Mbi dizajnin e shkollave përveç se projektit të madh te 'Shkollat e shekullit 21" (CABE/RIBA, 2004) nuk ka evidenca të ideve arkitektonike ose të dizajnit që prekin drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë radikale shkollat. Në çdo kohë, pjesa më e

madhe e shkollave do të strehohen në ndërtesa të vjetra që nuk do të mundin të përthithin e të marrin idetë e reja të dizajnit. Me gjithë publikimin e buletinit të fundit të ndërtesave të prodhuar nga DfES i cili promovon ndërtesa shkollash më krijuese, duket se përsëri shumë nga ndërtesat e reja të shkollave që mendohen të ndërtohen e të planifikohen do të jenë të ngjashme me ato që kanë qenë më parë. (Seaborne, 1971) tregon që megjithëse janë bërë ndryshime në arkitekturën e shkollave, shpesh këto ndryshime kanë qenë të avashta. Seabourne dhe Lowe përshkruan se si entuziazmi për 'planin e hapur' në shkollat fillore u zbeh aq shumë sa edhe shkollat e ndërtuara në masë në vitet 1960' janë më shumë të para si 'gjysmë te hapura'(1977). Ndërsa studimi i Jamieson (2000) argumenton që kjo ndodh për shkak se në procesin e dizajnit mungon pjesëmarrja e përdoruesve. Një nga studiuesit që insiston në përfshirjen e përdoruesve (nxënës dhe mësues) në përmirësimin e dizajnit është Dudek. (Dudek, 2000), (Jamieson&Taylor&Fisher&Trevitt&Gilding, 2000, fv. 2,19,221-236),

Ka një numër instrumentesh për të arritur në qëllimin që dizajni i shkollës të jetë inspirues e të sjellë ndryshim si për shembull The Construction Industry Council's Design Quality indicator. DQI për shkollat është një mjet që jep një kornizë mbi pikat kyçe në dizajnin e shkollave. Bazohet në tre kategori kryesore që janë: funksionaliteti, cilësia e ndërtesës dhe impakti, si dhe disa nënndarje të tjera si aksesi, hapësira, përdorimi, materialet, komuniteti etj.

Megjithëse Nuikkinen (2009) argumenton se dëshirat e përdoruesve dhe konceptet teorike mbi atë që është një shkollë e mirë nuk përputhen në praktikë, të gjithë studimet me pyetësorë në mes nxënësve dhe mësuesve kanë evidentuar probleme që vetë përdoruesit gjejnë në ndërtesën e shkollës. Një studim interesant i kryer në 6 shtete Evropianë u fokusua në dizajnin e ambientit të mësimit për të ardhmen, dhe u përpoq të krijonte një model fleksibël, të modifikueshëm, dhe të qëndrueshëm, e që njëkohësisht të mbështesë procesin e mësimdhënies e mësim marrjes. Gjetjet ishin të qarta : ambientet e mësimit kanë nevojë për ndryshime në mënyrë që të mbështesin kërkesat e përdoruesve, strukturat fizike dhe ato pedagogjike duhet të ecin në paralel në mënyrë që tu përgjigjen kërkesave në ndryshim të kulturës së shkollave. "Në mënyrë që një shkollë të zhvillojë një ambient mësimi fizik dinamik, nevojitet një ndryshim në lidhje me planifikimin dhe krijimin e zgjidhjeve hapësinorë. Dhe ky ndryshim nuk mund të ndodhë pa pyetur vetë përdoruesit (González, 2011)

### 1.1.3 Impakti i dizajnit të shkollës në procesin e marrjes, dhënies së mësimit.

"Në fushën e dizajnit edukativ dhe të ambientit të mësimit, ka pak kërkime e studime mbi efektin që dizajni i arsimit ka në mësim marrje e mësim dhënie." (Lawton, 1999)

Megjithëse, ka prova gjithmonë e më në rritje mbi korrelacionin ndërmjet fasiliteteve të shkollës dhe performancës dhe sjelljeve të nxënësve. Si evidenton Lyons "një numër studimesh paraqesin lidhjet mes kushteve të godinës dhe arritjeve të nxënësve. Që në vitin 1982 një raport me mbi 88 studime të publikuara tregoi se si shkollat e vjetra dhe ndërtesat jo tërësisht të këndshme kishin ndikime negative në procesin e mësimit ndërsa shkollat e sigurta, moderne dhe të kontrolluara e përmirësojnë atë." (Lyons, 2001, f. 6)

Gjithashtu katër studime të fundit kanë vlerësuar lidhjen mes gjendjes fizike të ndërtesës së shkollës dhe arritjeve të nxënësve në testet finale. Nxënësit që mësonin në kushte më të mira figuronin me rezultate më të larta sesa ata që studionin në ndërtesa me kushte nën-standarde.

Diferenca në rezultate shkon nga 5-17 %. "Kushtet e ndërtesës mund të kenë një efekt shumë të madh në performancën e nxënësit shpesh edhe më të madh se sa influenca e familjes, statusit ekonomiko-social, pjesëmarrjes në shkollë, apo sjelljes." (Earthman, 1998), (Morgan, 2000) (J.Lackney, 1999), (Moore, 1998)

Shumë studiues kanë tentuar të gjejnë këto faktorë dhe cilët janë problemet kryesore. Në kërkimin e tij, Lyons shpjegon se rreth 40 % e shkollave në Amerikë kanë kushte mjedisore jo të favorshme për procesin e mësimit. Diskutimi i tij fokusohet në ndikimin e kushteve të ndryshme të objektit mbi nxënësit, duke përfshirë moshën e ndërtimit, temperaturën, ventilimin, akustikën, ndriçimin, zhvillimin e kurrikulës, dhe madhësinë e shkollës. (Lyons, 2001)

Studimet provojnë se ka një kategori variacionesh të problemeve fizike te cilat kane impakt në shëndet, në sjelljet e në arritshmëritë e mësimit. Këto lloj studimesh janë të bazuara kryesisht në korrelacionet dhe aso-cimet por shpesh dështojnë të demonstrojnë një marrëdhënie jo të rastësishme midis ndërtesës e të mësuarit.

Ka në grup të madh kërkimesh e studimesh të cilat evidentojnë ndërlidhjen e ndërtesave 'të varfra' të shkollave me procesin e mësimit. Por duhet pasur kujdes në këtë lidhje pasi situata është shumë më komplekse, pasi në kompleksitetin e rrjetës së aspekteve shoqërore, kulturore, e fizike të shkollës, mjedisi i varfër mund te jetë rezultat edhe i shumë problemeve të tjera- "mund të jetë një efekt e jo një shkak." (Woolner, 2010, p. 15)

Nëse hedhim një vështrim të shkurtër evoluimit të shkollave e të ndërtesave të tyre në 100 vitet e fundit duhet të fokusohemi veçanërisht, ashtu si thotë edhe Baker (2012) "në sistemet që i bëjnë shkollat të jetueshme dhe të favorshme për mësim: ndriçimi, ngrohja, ftohja, ventilimi dhe akustika". Të gjitha këto lidhen edhe me efektet klimaterike që përjetohen brenda mjedisit të shkollës. Por një nga pyetjet e kërkimit është të njihemi me evoluimin e ndërtesave të shkollave në botë dhe cilët kanë qenë faktorët që kanë ndikuar në ndryshimet e vazhdueshme që shihen sot?

Është një kërkesë e qartë, të konsiderohen çështjet e momentit mbi dizajnin e ambienteve të mësimit, duke nisur që prej perspektivës se edukimit, duke iu drejtuar atyre qe e përdorin shkollën dhe atyre që duan te mendojnë më shumë se si hapësirat në to duhet të planifikohen për te ndihmuar procesin e dhënies e marrjes së mësimit. (Woolner, 2010)

## 1.2 FAKTORËT QË DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË PËR PROJEKTIMIN E SHKOLLËS

*" Ndërtesa e shkollës është një copëz e mozaikut te madh e të komplikuar që përbën arsimin e edukimin, por gjithmonë e më shumë po kuptojmë që është një copëz e rëndësishme."*

(Young, Green, Roehrich-Patrick, Joseph, & Gibson, 2003, f. 6)

Megjithëse studimet flasin për variabla të rëndësishme të lidhura me familjen si të ardhurat, raca, edukimi, kultura, okupimi, të cilët përbëjnë faktorët primarë në të shpjeguarit e përthithjes akademike të nxënësve, përsëri ka një grup të madh studimesh të cilët ndërlidhin faktorët e

dizajnit të ndërtesës. Problemi qëndron se shumica e faktorëve socialë nuk mund të ndryshohen kollaj, ndërsa "ndërtesa është një armë e fortë në dorën e edukuesve, drejtuesve politikë, arkitektëve e partnerëve të tjerë që mund të përmirësojnë efikasitetin e mësimit." (Young, Green, Roehrich-Patrick, Joseph, & Gibson, 2003).

> Planifikimi dhe ndërtimi i shkollave është i prekur nga një sërë faktorësh që duhet të merren në konsideratë gjatë dhe pas procesit të projektimit: disa variabël shoqërorë të përgjithshëm, disa influenca demografike dhe ekonomike, e disa faktorë specifikë të arkitekturës, të ndërtimit e të vetë edukimit. Këta faktorë, karakterizohen si influenca të drejtpërdrejta në periudha të ndryshme të ndërtimit të shkollave ose edhe si çështje më të vakëta që nuk e prekin direkt. Këta faktorë influencojnë jo vetëm hovet e shpërthimet e ndërtimit të shkollave në kohë por edhe mënyrën dhe stilin që rezulton prej tyre. Janë pikërisht këta faktorë që do të ndër veprojnë, dhe nga mënyra se si bashkëveprojnë varet fakti se si influencat e pavarura e individuale përbëjnë supozimet e përgjithshme shoqërore, idetë, e te kuptuarit e këtyre që lë një impakt në formimin e konceptimin e arkitekturës së edukimit. (Woolner, 2010, p. 2)

Një nga arsyet që është e vështirë ti përgjigjemi pyetjeve se cilët janë faktorët që ndikojnë mbi përmirësimin ose projektimin e shkollave është fakti se duhet të konsiderojmë nevojat dhe dëshirat e një grupi të madh përdoruesish. Siç mund të pritej, kërkimet tregojnë se ka një diferencë të madhe në opinionet e individëve. Për shembull, ka një variacion të madh në preferencat e ngjyrave, kështu që edhe kur arkitektët sugjerojnë një ngjyrë si me e përshtatshme për tu fokusuar te mësimi, ose si me te përshtatshme për një grup moshe, kjo ngjyrë nuk ka qenë te të preferuarat e atij grup nxënësish, te mësuesit ose madje as nga arkitektë të tjerë. Duket sikur ka diferenca sistematike ndërmjet grupeve të ndryshme të komunitetit të shkollës dhe mënyrës se si e perceptojnë ata shkollën e mjediset e saj.

Kështu që megjithëqë dëshirën për të bazuar projektimin e shkollave mbi studimet e shumta diferencat ne përgjigje e opinionet e ndryshme të komunitetit të shkollës na çojnë në përfundimin se nuk ka një dizajn të përcaktuar në mënyre universale, e kjo vlen për secilin parametër.

Duhet pasur parasysh në ndërtimin e shkollave nevoja e përfshirjes së shumë partnerëve. "Duke qenë se përfshirja e arkitektëve është e paevitueshme në planifikimin e ndërtesave të shkollave, nuk ka shumë dritë në nevojën e përfshirjes së përdoruesve të shkollës si në arkitekturë e në vendimet e qeverisjes në dizajnin e shkollave." (Woolner, 2010)

Nga analiza e literaturës evidentohen faktorët kryesorë që merren për tu studiuar si mosha e shkollës, madhësia e ndërtesës, madhësia, forma, ngjyrat, mobilimi i klasës, korridoret, qarkullimi etj., faktorë të dizajnit. Në tabelën më poshtë është krijuar një përmbledhje e faktorëve që përmenden gjerësisht nga literatura dhe merren në studim ato modele dizajni të studiueses Sheila Bosch, duke qenë se përfshin e i trajton këta element dizajni, më tepër. (Tabela 1). Ky studim do të përdoret si referencë për të analizuar këto modele të dizajnit në shkollat shqiptare në vitet 1945-1990.

Ledita Mezini

Tabela 1. *Tabela përmbledhëse e literaturës si dhe faktorët e dizajnit të shkollave*

| Autori | Robert Scott McGowen | SCRI- Research report | | | Design Council | | | Tennessee Advisory Commission on Intergovernmental Relations | John B. Lyons | | | Mutlaq M. Al-Enezi | Stephen L. Olson, Shana Kellum | James A. Dyer | Sheila Jones Bosch | Lindsay Baker | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tema | Impakti I ndertesave te shkollave ne arritjet e studenteve, pjesmarrjen, sjelljen, shkalla e konkurrences, ne shkollat e Teksasit | Hapesirat optimale te mesimit | | | Impakti i ambjentit te shkollave | | | A ndikojne ndertesat e shkollave 12 vjecare ne arritjet e nxenesve? | A ndikojne vertete ndertesat e shkollave ne edukimin e femijve? | | | Nje studim mbi lidhjen e kushteve te ndertesave te shkollave me arritjet e nxenesve ne provimin final | Impakti I Ndertesave te qendrueshme te shkollat 12 vjecare ne arsimim | Efekti I ambjentit te mesimit ne procesin e mesimit | Identifikimi I variablave te rendesishem per te kuptuar se si ndikon ndertesa e shkolles ne arritjet e mesimit | Impakti I ndertesave te shkolles ne shendetit e nxenesve dhe performancen e tyre | | |
| Faktoret | | Natyrale | Individuale | Stimulues | Godina | Klasa | Komunikimi | | Godine | Shoqeria | Pedagogjia | | | | Funksionaliteti, shoqeria, Komforti, shendeti dhe siguria, estetika dhe paraqitja, burimet | Dizajni I godines e karakteristikat e ndertimit | Kushtet e godines | Variabla te ndryshueshem |
| | Mosha e Nderteses | | | | | | | Mosha e Nderteses | | | | | | | Mosha e Nderteses | | | |
| | Madhesia e Nderteses | | Madhesia /shkalla | | Madhesia | | | | Madhesia e Nderteses | | | | | | Madhesia e Nderteses | | | |
| | Kushtet e nderteses/ Shendeti | | | | | | | Kushtet fizike te nderteses | Kushtet fizike te nderteses, Shendeti | | | Kushtet Fizike te nderteses, Struktura | Kushtet Fizike te nderteses, Struktura | | Kushtet Fizike te nderteses, Mirembajtia, Rinovimet | | Kushtet Fizike te nderteses, Mirembajtia, muret, tarraca, dritaret, | |
| | Ndricimi | Drita | | | Ndricimi | | | Vizuale/ Ndricimi | Ndricimi | | | | Ndricimi natyral, artificial | Ndricimi natyral artificial | Komforti Vizual | Ndricimi natyral | | |
| | | Zhurma | | | Zhurma | | | Zhurma | Zhurma/ Akustika | | | | Zhurma/ Akustika | Zhurma/ Akustika | Komforti Akustik | Dizajni akustik | | |
| | | Temperatura | | | Temperatura /Cilesia e ajrit | | | Vizuale/ Ndricimi | | | | | Faktoret termike | Faktoret termike | Komforti Termik | Komforti Termik | | |
| | | Cilesia e ajrit | | | | | | Cilesia e ajrit | | | | | Cilesia e ajrit, ventilimi natyral | Cilesia e ajrit, ventilimi natyral | Cilesia e ajrit, ventilimi natyral | Ventilimi natyral | | |
| | | | Fleksibilitetit | | | Fleksibilitetit | Brenda Shkolles-Nderlidhja, fleksibiliteti, shperndarja | | | | | | | Faktoret hapsinore, shperndarja, qarkullimi, format, | Fleksibiliteti | | | |
| | | | Nderlidhja | | | | | | | | | | | | Faktoret hapsinore, shperndarja, qarkullimi, format, ngarkesae klasave, programi etj | | | |
| | | | | Kompleksiteti | Tipi I nderteses/ Forma e | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | Ngjyrat | Ngjyrat | Ngjyrat | | Ngjyrat | | | | Kushtet estetike, ngjyrat, | | Atributet estetike, ngjyrat, pamja, materialet | Estetika dhe paraqitja | | | |
| | | | | Tekstura | | Tekstura, Materialet | | | | | | | Materialet e nderteses | | Materialet, ngjyrat, pamja e nderteses | | | |
| | | | | | | | Jashte Shkolles | | Siti urban, vendodhja, Hapsirat e jashtme, | | | | Siti urban, vendodhja, Hapsirat e jashtme, | | Hapsirat e jashtme | | | |
| | | | | | | Mobilimi/Pajisjet | | | | | | | | | Mobilimi/Pajisjet | | | Mobilimi/ Pajisjet, ndricimi, temperat |
| | | | | | | Arredimi | | | | | | | | | Arredimi | | | |
| | | | | | | TIK | | | | | | | | | TIK | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | Madhesia e klases | | | |

Pavarësisht se studimet e shumta përmendin disa faktorë ose elemente të dizajnit të cilat kihen parasysh në projektimin e shkollave, faktori i rëndësishëm këtu, është një proces bashkëpunimi

i projektimit mes arkitektëve dhe edukuesve që përfshin një vizion të qartë mbi zhvillimin, krijimtarinë, kërkimin e fëmijës që çon në identifikimin e një ambienti mësimi të prodhuar në mënyrë të përshtatshme.

### 1.2.1 Klasa

Klasa është zona më e rëndësishme në një shkollë. Brenda saj nxënësit kalojnë shumicën e kohës së tyre, duke shpresuar në një mjedis të favorshëm për të mësuar. "Të mësuarit në klasë kërkon një nivel të caktuar të përqendrimit, të dëgjuarit, të shkruarit, dhe leximit. Klasa individuale dhe objektet arsimore në tërësi duhet të vlerësohen, jo vetëm për mënyrën sesi ata përmbushin kërkesat arsimore, por edhe për mënyrën se si ata plotësojnë kërkesat mjedisore për shëndetin, sigurinë, dhe të sigurisë." (Lyons, 2001)

### 1.2.2 Madhësia e klasës dhe format.

Ashtu siç e tregon edhe zhvillimet e historisë edhe në një shkollë të shekullit të 20-të me një ndërtesë inovative nga arkitektura mund te shohim se në brendësi është klasa tipike e tradicionale. Duke e konsideruar si një hapësirë shpjegimi, një dhomë drejtkëndore është e përshtatshme për mësimin e gjithë klasës, pasi nuk ka cepa të fshehur e hapësira mund të adaptohet e të sistemohet me mobilim edhe për mësim më individual. Gjithashtu drejtkëndëshat përshtaten e përputhen mirë në dizajn me njeri-tjetrin duke e bërë planifikimin e shkollës më të thjeshtë. Ka shumë arkitektë të cilët mendojnë se është mirë përdorimi i formës së L-së (Dudek, 2000, str. 56,57)

Ka raste të veçanta te përdorimit të shkollës me forma hekzagonale dhe trekëndore por gjithashtu këto kanë treguar probleme me mobilimin. Për sa i takon madhësisë së klasës është një pikë thelbësore e dizajnit të shkollës të alternojë e të kombinojë madhësinë e hapësirave të klasave. Megjithëse kjo sjell diferenca në mobilime, është një qasje e mirë në nevojën për hapësira të ndryshme me përdorim të ndryshëm e sa më fleksible. Por më shumë se sa madhësia e hapësirës studiuesit ngulin këmbë te menaxhimi i këtyre hapësirave dhe se si njerëzit e përdorin vetë mjedisin fizik.

Përdorimi i pajisjeve elektronike si një hap inovativ e interaktiv tregoi se përdorimi i tyre nëpër klasa çon edhe në probleme e vështirësi teknike ose në mangësi serioze në aftësitë e mësuesit. (Smith) Megjithëse me teknologjitë e reja entuziazmi dhe kostoja e këtyre pajisjeve mund te mos jetë proporcionale me përdorimin e tyre aktual, është e rëndësishme për klasën e për mësuesin të përfshihet në këto zhvillime e të përdori mjedisin e klasës e teknologjitë e reja. Bazuar në studimet dhe anketimet e kryera, nxirret përfundim se nëse përdoruesit e kontrollojnë vetë ngrohjen e ftohjen në një mjedis, janë më të lumtur me ambientin fizik. (Dept. for Education and Skills, 2006)

### 1.2.3 Mobilimi

Klasat vazhdimisht projektohen nga arkitektët e studiuesit në forma të ndryshme mobilimi, duke i organizuar ato në hapësira sa më fleksible e të ndryshueshme me lehtësi. Për këtë kërkohet që më shumë se sa format e ndryshme të të ulurit te fokusohen të vetë mobiliet që të jenë sa më të lehta për tu lëvizur, e njëkohësisht praktike. Ka mjaft kërkime që tregojnë se mobilimi i klasave përmirëson ose pengon procesin e marrjes e dhënies së mësimit por

Ledita Mezini

gjithashtu ka edhe faktorë që e pengojnë këtë proces si: madhësia e numri i madh i mobilieve për tu lëvizur në një hapësirë relativisht të vogël për numrin e nxënësve, koha që kërkon rregullimi i këtyre hapësirave dhe vetë dëshira ose mënyra e vetë mësuesit për të shpjeguar në atë hapësirë të organizuar si ai ndihet më komfort.

Për sa i takon hapësirave praktike shpesh ato mobilohen si klasa tradicionale te pajisura me disa mjete e pajisje shtesë por duke qenë se klasat e praktikave nuk mund të jenë vetëm laboratorë eksperimentalë, ka shume vështirësi në elaboratin e këtyre hapësirave pasi kërkohet të jenë të përshtatshme jo vetëm për eksperimente e praktikë por edhe për aktivitete të tjera e duke qenë se këto mjedise kërkojnë kosto, duhet të kihen mirë parasysh nga arkitekti e partnerët e përfshirë ne fushën e arsimit se si do përdoren këto hapësira e se si duhet të projektohen ato.

### 1.2.4 Hapësira

Studimet nga pyetësorët e shumtë kanë treguar se hapësirat e mëdha janë të pëlqyeshme nga përdoruesit  por gjithashtu ato mund të sjellin ndriçim e ventilim jo të mirë, apo mbipopullim ose zbrazje të tyre. Hapësira në përdorim mund të ketë impakte direkt në marrëdhëniet sociale në sjelljet e nxënësve e për pasojë mund të çojnë edhe në ndikim në procesin e mësimit. Ashtu si hapësira e madhe edhe ato të voglat lidhen në shume studime me ndikimin e mësimit dhe densitetin e nxënësve. Por jo vetëm madhësia e hapësirës por edhe mënyra se si ajo hapësirë organizohet është një nga faktorët më të rëndësishëm në klasë. Organizimi dhe madhësia e hapësirës është një nga faktorët kryesore që merret në dizenjimin e ambienteve të mësimit. Duke pasur në mendje faktorin e hapësirës  e numrin e nxënësve që do të akomodohen në këtë ambient nis në përgjithësi projektimi i shkollave dhe i mjediseve të mësimit.

### 1.2.5 Organizimi dhe shpërndarja e hapësirave të mësimit.

Megjithëse shumë studiues mendojnë që në të shkuarën e në ditët e sotme ende, procesi i edukimit është kryesisht me banka të rreshtuara dhe një libër për të studiuar, Baker thekson se "duhet të fokusohemi te ambienti fizik i shkollës dhe te materialet e nevojshme për këtë tip ndryshimi, duke qenë se kurrikulat janë shtuar, metodat e të mësuarit janë më aktive, kërkesa për të punuar e për tu praktikuar janë më shumë se sa për të mësuar përmendsh librat." (Baker, 2012) Metodologjia e edukimit dhe marrjes së informacionit po ndryshon dita-ditës dhe së bashku me të shtohen dhe kërkesat për plotësimin e kushteve të nevojshme që të  inkurajohet aktiviteti midis nxënësve, që dikton mënyra të ndryshme organizimi të hapësirave.

Në pyetësorin që Woolner ka kryer në Angli mbi strukturën që duhet të ketë një shkollë janë ngritur këto diskutime: nëse shkolla duhet të jetë me blloqe të veçanta apo duhet të konsistojë në një bllok unik. Organizimi në blloqe të veçanta që i takojnë një disipline të veçantë, i japin karakter disa zonave të shkollës, dhe sugjerojnë ndarje te grup lëndëve. Por pavarësisht kësaj nxënësit dhe stafi preferojnë një ndërtesë unike duke dashur mos bëjnë shumë lëvizje nga një zonë e shkollës drejt hapësirave të tjera. Përdoruesit e shkollës dëshirojnë një shpërndarje e cila përfshin edhe ndërveprimin me sipërfaqet e jashtme dhe një lëvizje në mjediset e shkollës e cila çon në ndërveprim.

### 1.2.6 Hyrjet

Në shumë shkolla momenti i hyrjes konsiderohet nga arkitektet si një pikë kyçe në dizajnin e shkollës. Nga ana funksionale ajo shërben si akses për grupe të ndryshme nxënësish të moshave të ndryshme ose për të bërë të mundur hyrjen e komunitetit, por pavarësisht kësaj ato paraqiten shpesh shumë të mëdha e monumentale, duke u dalluar e spikatur nga pjesa tjetër e fasadës. Kjo sugjeron që hyrja është një element që të bën të rikujtosh shkollat si tempull të edukimit, e gjithashtu kërkon ti japi publikut një pamje impresionuese.

### 1.2.7 Qarkullimi

Organizimi i hapësirave të qarkullimit brenda mjediseve të shkollave mund të duket si një çështje qe s'ka rëndësi me procesin e mësimit por më shumë me lidhjen mes hapësirës sociale dhe marrëdhëniet mes përdoruesve të shkollës. Megjithëse në librin e tyre Daniel Muijs dhe David Reynolds shkruajnë për potencialin, nivelin e zhurmave nëpër korridore dhe ndikimin e tyre nëpër klasa, të quajtur 'klima e klasave'. (Saunders, 2012)

Në dizajnin e shkollave e në projektimin e tyre duhet në mënyrë të paevitueshme të llogaritet tensioni ndërmjet hapësirave të mësimit dhe atyre të përdorura për qarkullimin e lëvizje. Qarkullimi nëpër shkolla përbën një problem të qartë, i njohur si një prioritet mes partneriteteve të arsimit. Korridoret e ngushta përbëjnë një debat në lidhje me faktin se nuk lejojnë e pengojnë qarkullimin e kollajshëm nëpër mjediset e shkollës, por studimet kanë treguar që edhe shkollat me korridore shumë të gjëra kanë çuar në ndriçim të dobët nëpër mjediset e shkollës e humbje të nxehtësisë e probleme me ventilimin. Një zgjidhje që është aplikuar gjerësisht e zgjidh disa prej problemeve midis hapësirës së mësimit dhe asaj të qarkullimit është përfshirja në këto mjedise edhe e përdorimeve të tjera. Një zgjidhje e ngjashme me atriumin modern është edhe dizajni i hollit qendror mjaft i përhapur në Angli ne fund të shekullit të 19. Klasa të cilat hapen dhe dyfishohen duke u bashkuar me mjediset e qarkullimit dhe formojnë një ansambël për qarkullim ose për mësim.

Një mundësi për të kombinuar hapësirën e mësimit me atë të qarkullimit është nëpërmjet krijimit të hapësirave të përbashkëta midis disa klasave duke i ofruar hapësira që përmbajnë resurse të përbashkëta si materiale reference, kompjuter, pajisje speciale ose edhe thjesht mjedise për tu ulur e shplodhur, lexuar etj. Hapësira e përbashkët mund të përdoret si një hapësirë për aktivitete praktike.

### 1.2.8 Resurset e shkollës.

Hapësirat sportive të cilat mund te jenë të hapura edhe jashtë orarit të shkollës mund të grupohen e të veçohen nga hapësirat e tjera didaktike, por një zgjidhje e pranueshme është edhe të grupohen bashkë me mjedise të cilat janë të hapura për publikun. Kjo qasje ne shpërndarjen e shkollës mund të përshtatet edhe për bibliotekën, e cila mund të përdoret nga shkolla e gjithashtu edhe nga komuniteti. Whoolner deklaron se ka shumë avantazhe në përdorimin e bibliotekës së shkollës edhe si bibliotekë për komunitetin. Përdorimi i sallës se kompjuterëve, bibliotekës, një auditori ose edhe e mjediseve sportive nga komuniteti të implikojnë që dizajnin e shkollave ta organizosh si një lokacion qendror por me resurse të shpërndara në pozicione të ndryshme e gjithashtu një projekt të hapur me qarkullim e fluiditet lëvizjeje e shpërndarjeje hapësirash. (Woolner, 2010)

#### 1.2.9 Mirëmbajta dhe rinovimet

Një sugjerim mbi problemet e një mjedisi përgjithësisht të varfër, na jepet nga studimet e shumta te cilat korrelacionojnë masën e kualitetit të ambientit fizik të shkollave me rezultatet e testeve finale, me pjesëmarrjen ose me sjelljet e shumta. Duke qenë se shumica e këtyre studimeve janë të tipit korrelacionit, ndërlidhës ato nuk tregojnë shkakun ose pasojat e as nuk marrin parasysh faktin se mund të ketë edhe faktorë të tjerë që ndërfuten. Duke marrë në konsideratë se rinovimi i shkollave ka sjellë përmirësime në sjelljet e në rezultatet e nxënësve në mjaft shkolla, mund të themi se ka një lidhje të rëndësishme mes ambientit të mirëmbajtur, të bukur, e të pastër dhe rezultateve më të mira në procesin e marrjes dhe dhënies së mësimit. Mirëmbajtja fizike e shkollës renditet si një ndër faktorët parësorë që pasqyrojnë efektin e tyre në sjelljen humane.

#### 1.2.10 Komforti vizual - Ndriçimi

Arkitektët dhe projektuesit janë të bindur mbi rëndësinë që ka ndriçimi natyral e i plotë brenda në mjediset e shkollës. Ka disa prova qe vërtetojnë se ndriçimi ndikon në humorin e gjendjen emocionale si dhe në sjellje. Ka prova që ekzistojnë të cilat lidhin ndriçimin e keq me çështje që i takojnë shëndetit si dhimbja e kokës, lodhja e syve, dhe këputja fizike. Duke marrë parasysh studimet e shumta mbi ndriçimin natyral e artificial duhet pasur në konsiderate sasia e tipet e ndriçimit në pjesë të ndryshme të shkollës. Ashtu si edhe me temperaturën duhet pasur kujdes që ti lihet mundësia që përdoruesit të mund të kontrollojnë ndriçimin, vetë.

#### 1.2.11 Komforti termik - Temperatura

Kërkimet studimore kanë zbuluar se problemet e mësimit në temperatura jo komfortë lidhen me çështje si ventilimi dhe cilësia e ajrit. Gjithsesi ka një masë të madhe provash që sugjerojnë që probleme janë ndierë me temperaturat në shumicën e shkollave. Studimet e perceptimit të përdoruesve brenda mjedisit të punës kanë treguar që: " komforti termik është në krye të listës së ankimeve." (Leaman, A & Bordass, B, 2001)

Studimi dhe anketimi i tyre ka treguar se "është jetike që ti japësh kontrollin mbi ndërtesën atyre që e jetojnë atë si për të ndërhyrë e për të ndryshuar parametrat për ngrohjen, ftohjen, ventilimin, ndriçimin e zhurmat. (Leaman, A & Bordass, B, 2001, p. 133) Këtë gjë e ka treguar edhe anketimi i kryer se fundmi mbi efiçencën e energjisë në shkolla i cili nxori si përfundim që nëse përdoruesit e kontrollojnë vetë ngrohjen e ftohjen në një mjedis janë më të lumtur me ambientin fizik. (Dept. for Education and Skills, 2006)

#### 1.2.12 Komforti akustik - Zhurmat

Ka një literaturë shumë të gjerë e cila përcakton zhurmat dhe ndikimin që ato kanë si një nga faktorët kryesor në procesin e marrjes e dhënies së mësimit,. Kërkimet mbi ndikimin e zhurmave në mjediset e shkollës, e si një faktor i rëndësishëm mjedisor për komfortin në shkolla janë bërë si në laboratorë ashtu edhe ne studime jo eksperimentalë me studim literature ose pyetësorë.

Konkluzionet që mund të përcaktohen nga gjithë këto studime janë shumë të qarta por nuk na japin një përcaktim se si duhet të zgjidhim projektin e shkollës. Ka shumë prova qe shkolla ka



Ledita Mezini

një impakt direkt në disa procese e gjithashtu në mundësinë e mërzitjes e të shpërqendrimit si nga mësuesit edhe nga nxënësit. Kjo na çon në rëndësinë që duhet të merret parasysh vendndodhja e projektimit të shkollave, duke i evituar rrugët me shumë trafik e zhurma të tjera të mëdha. Në qoftë se shkolla është pranë një burimi të madh zhurmash është e nevojshme të maten ato e gjithashtu të vendosen elemente te bllokimit akustike në pika të caktuara, të cilat mund te ndryshojnë tipin e gjelbërimit, rrethimet e ndërtesës e gjithashtu përdorimin e materialeve absorbuese në ndërtesë.

Gjithashtu, përveç burimit të zhurmave nga jashtë ndërtesës, prezentë janë dhe zhurmat që shkaktohen në brendësi të saj, nëpër klasa e ambiente të tjera. Prandaj, një ndarje më e mirë akustike duhet të ndodhë midis klasave te cilat çojnë në përdorim të mureve më të trashë ose të ndarjeve me materialeve më absorbuese ndaj zhurmave.

### 1.2.13 Cilësia e ajrit të brendshëm

Ka gjithashtu prova të mjaftueshme të cilat japin impaktin që ka në shëndet e gjithashtu në mësim cilësia e ajrit. Studimet kanë treguar se cilësia e ajrit ndikon si në përqendrimin e vëmendje, probleme të cilat lidhen me cilësinë e pakët të ajrit në mjedisin e klasës. Ventilimi i mirë i mjediseve të mësimit është një cilësi e cila përmirëson pjesëmarrjen e pakësimin e sëmundjeve e gjithashtu është një pikë që ndikon në paraqitjen e ndërtesës. Përdorimi i dritareve të mëdha e të hapëshme ka qenë një faktor dominues në ndërtimet e viteve 1920-1930 ku për shkak të ventilimit të keq u përhapën e mjaft sëmundje, si tuberkulozi etj.

## 1.3 HISTORIA E DIZAJNIT TË SHKOLLAVE NË SHEKULLIN E XX-TË. ZHVILLIMET KRYESORE NË BOTË

## Hyrja

Nuk mund të analizohet e tashmja e historisë së arkitekturës së ndërtesave të shkollave ose të propozohet diçka e re, pa studiuar atë që është historiku i zhvillimit të godinave të shkollave nëpër botë e më pas në vendin tonë. Për të bërë një kategorizim të etapave të arkitekturës së shkollave nëpër botë mund të bazohemi të disa studiues. Duke qenë se shekulli i 20-të ishte një nga periudhat ku ndodhën ndryshimet më të mëdha në arkitekturën e shkollave, ky ka qenë shekulli që është studiuar e analizuar më së shumti. Megjithatë Hertzberger thekson se: "Ka shumë pak tipa ndërtesash që kanë evoluar aq pak sa shkolla në 100 vitet e fundit. Vetëm në dekadën e fundit të shekullit të 20-të që u panë deviacione nga tipi i standardizuar prej atij të fillimit." (Hertzberger, 2008)

Ndërkohë që studiues të tjerë shprehen se "ka pasur shumë ndryshime rrënjësore e kthesa të forta në sistemin edukues publik të Shteteve të Bashkuara duke filluar nga 1880 me Reformën e Shkollës Komune, duke vazhduar me lëvizjen në edukim të shkollën Progresive në fundin e shekullit të XIX-të e fillimin e shekullit të XX, duke u fokusuar te edukimi i hapur dhe shpërblyes. (Pasalar, 2003)

Baker e ndan në 5 grupe të mëdha ku përfshihen: arkitektura e ndërtesave të shkollave përpara viteve 1930, periudha Progresive (1930-1945), periudha e "*Boomit*" të pas luftës (1945-1960),



Ledia Mezini

periudha Impulsive (1960-1980), dhe rëniet e 1980 dhe lëvizjet e reja të 1990-2000. (Baker, 2012). Të ngjashëm në këtë kategorizim janë edhe studiuesit Ian Grosvenor dhe Catherine Burke të cilët në mënyrë të përgjithshme përmendin periudhën para 1920 që korrespondon me periudhën produktive të ndërtimit  në  masë të shkollave, e që e quajnë si "Periudha e fillimit të Edukimit", periudha progresive e Luftës së Parë Botërore që këta i përmendin si "Shkollat e të nesërmes", periudha e rikonstruksionit të shkollave pas Luftës së Dytë Botërore si dhe periudha e pas viteve 1960 si periudhë inovacioni e revolucioni në pedagogjinë e shkollave, që e klasifikojnë si periudha  "Shkollat në shpërthim e klasat në zgjerim." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Duke studiuar historinë e ndërtimit të shkollave në Evropë e në Amerikë mund të bëjmë një grupim në 5 etapa.

### 1.3.1 Arkitektura e ndërtesave të shkollave para 1930

Sipas studiueses Anne –Maire Chatelet (2004) "Shkollat publike në Evropë u zhvilluan shumë në shekullin e 19-të, pasi vendosja e demokracisë dhe e drejta e votës kërkoi që çdo person të dinte të lexonte dhe të shkruante." Në bazë të këtij motivi shumica e shteteve Evropiane u përkushtuan shumë në përpjekjen për të edukuar fillimisht popullsinë mashkullore e më pas atë femërore. "Edukimi shkoi paralel me procesin e kthimit të arsimit  laik, me mësues të profesionit në vend të atyre fetarë, dhe duke vendosur shkollat në godina të tjera e jo më në kisha."  Gjithsesi shpesh vihej re ndërtimi i shkollës me forma të ngjashme me kishat në këtë periudhë. Gjithashtu i këtij mendimi është edhe Gutman e cila shkruan: "Që nga fillimi i shek. XIX, fëmijët në Amerikë edukoheshin në disa varietete ndërtesash duke filluar nga bodrumet e kishave ose në shtëpi private." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004) Mësimi kryej në banesa e madje "shumë vajza të reja hapën shtëpitë e tyre për të mësuar vajzat në përgjithësi, në zonat rurale rreth viteve 1830 e këto u quajtën "shkollat e damave". (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Fillimisht arsimi për masën erdhi në gjithë format e mënyrat. Dëshira për tu mësuar Biblën masave, çoi në mësime në ditën e diel e më pas edhe në ditët e tjera. Këto u quajtën *Sunday School Building*  (Ndërtesa e shkollës të së dielës), të cilat ishin shkolla me 1 dhomë ku struktura me 1 ose 2 kate mbante deri në 1000 nxënës. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Më shumë se për t'u mësuar edukimin, shkollat e para "një dhomë-she" ishin më shumë për të mbledhur fëmijët e varfër e për t'i hequr nga rrugët e qyteteve. Shkollat organizoheshin nëpër kisha, kapela, banesa të konvertuara, hambarë, etj. Kushtet nëpër këto shkolla ishin shumë të këqija e ideja për të përhapur arsimin në fëmijët e varfër filloi në shtetet si Anglia, Skocia, Australia, etj. I të njëjtit mendim është edhe Baker e cila thekson se: "Fundi i shekullit të XVIII-njihet "shkolla-shtëpi-një-dhomë-she". Mbas Luftës Civile e me ardhjen e Periudhës së Industrializimit gjithmonë e më shumë shkolla duheshin për fëmijët e shpesh këto u quajtën "si fabrika të prodhimit të dijes" (Baker, 2012)

Diskutimet rreth arkitekturës së shkollave filluan shpejt të nxitura edhe nga metoda e re angleze e edukimit e njohur si "Arsimi i ndërsjellë". E projektuar për të përballuar numrin e madh të fëmijëve në qytetet industriale gjithmonë e më shumë në rritje – kjo metodë trajnonte studentet

më të avancuar të bëheshin tutorët, duke bërë kështu që një mësues të edukonte deri në qindra nxënës. Arsimi i ndërsjellë kërkonte rregullime specifike të hapësirave e të pajisjeve që Joseph Lancaster, një nga promovuesit e kësaj metode përshkruante në punën e tij. (Figura 3) (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Të parët që hodhën idenë e ndarjes së dhomës së madhe në disa dhoma katër këndore më të vogla ose një nënndarje të hapësirës për të lejuar "edukimin e përbashkët" ishin Dr. Andrew Bell dhe Joseph Lancaster. (Figura 4) Ishte një hapësirë e madhe me rreth 320 nxënës, shpesh edhe pa çati në mënyrë që të mos bllokoheshin zhurmat. Tualetet ndodheshin jashtë ndërtesës kryesore të shkollës. Një nga problemet e shkollës 1 katë-she ishte monitorimi dhe kontrolli i çdo nxënësi. Në shkollën Lancaster dyshemeja vinte me pak pjerrësi në mënyrë që të gjithë nxënësit të arrinin të shikonin dërrasën e gjithashtu të ishin të kontrolluar nga mësuesi.



Figura 3. *Plani i shkollës së propozuar nga Lancaster, 1874*

Fundi i shekullit të XIX-të shërbeu për shkollat në Angli si një pikënisje për civilizimin e komunitetit si dhe për t'i bërë ndërtesat publike më serioze. Duke qenë se edukimi u zhvillua më shumë se sa vetëm klasa të privilegjuara, me hyrjen e arsimit të detyrueshëm më 1870, "detajet arkitektonike dhe prezantimi i ndërtesës fizike të shkollës u projektua për të ngritur aspiratat e atyre që merrnin edukim." (Dudek, 2000)

Shumica e vendeve perëndimore e kthyen arsimin e detyruar në 1900, me përjashtim të Belgjikës që e ktheu në 1920. Shkollat e mesme filluan të lindnin në shekullin e 19-të si një vazhdim i "shkollës komune". Edhe në Evropë e në Amerikë, fundi i shekullit të 19-të ishte një periudhë produktive ku u ndërtuan shumë shkolla. Në vitin 1870 në Evropë numri i fëmijëve që ndiqnin shkollën u rrit nga 25 % e popullatës së fëmijëve në 75 % në 1900. (Baker, 2012)

Dy tip shkollash u zhvilluan: Shkollat rurale me vetëm një ose 2 klasa, të cilat japin një arkitekturë modeste dhe ekonomike dhe shkollat urbane shpesh të kritikuara si 'Shkolla pallat' për shkak të madhësisë dhe madhështisë. Shkollat urbane ishin në përgjithësi 2-3 kate. Korridore qendrore të gjata dhe klasa me lartësi të madhe në të dy krahët çonin në ndërtesë me thellësi më të madhe se 20 metër. Këto dimensione së bashku me aktivitetin që duhej të performohej në shkolla dhe rregullat e higjienës, u përcaktuan nga bashkia ose ligjet e shteteve të ndryshme rreth viteve 1860-1880. Shkolla ishte një konfirmim e idealit demokratik dhe forcimit të institucionit të ri. Shkollat ishin krenaria e qytetit të cilat shpesh projektoheshin nga vete arkitektët e bashkisë. Disa nga këta arkitekte të pasionuar nga subjekti, publikuan studime panoramike të arkitekturës së ndërtesave të shkollës si për shembull, Edward Robert

Robson(1835-1917) Felix Narjoux( 1867-1934, dhe austriaku Karl Hintrager (1859) (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)




Figura 4. *a- Majtas: Pamje të një shkolle në 1839. Një strukturë ndërtese e madhe mësonte shumë fëmijë, të moshave të ndryshme në të njëjtën kohë. b- Djathtas: "Arsimi i ndërsjellë" parashikonte që një fëmijë më i madh e i përparuar mësonte të tjerët, 1870*

Robson dha një situatë të detajuar të shkollave ekzistuese në botimin e tij, duke gërshetuar me idetë e dizajnit, dhe mendimet e tij mbi edukimin gjatë periudhës së ndryshimeve të mëdha sociale dhe politike, duke i lënë mundësi lexuesit për të reflektuar, kombinuar, e gjykuar. Në vitet 1860-1870 shkollat ishin të ndara për të dy sekset. Kishin në përgjithësi 12 klasa të cilat zhvilloheshin në mënyrë simetrike me 2 hyrje të veçanta e vend lojërash të ndarë. (Robson, 1972) (Figura 5)

Përveç shkollave 1 dhomë-she fëmijët vazhdonin të edukoheshin nëpër bodrumet e kishave e dhomat në shtëpi private. Arkitekti i parë i Bordit të shkollave në Angli, Robson e kritikonte shumë shkollën 1-dhomë-she e "sistemi i Prusisë" në opinionin e tij nuk ndryshonte shumë nga "ushtria e kontrolluar dhe ndërtesat e shkollave nuk ndryshonin shumë nga *regime* (regjimi)." (Robson, 1972)



Figura 5. *Shkolla Blackheath High School, Londër, ndërtuar 1897; arkitekt E. R. Robson*

"Nuk ka një shkollë dhomë në përgjithësi. Nuk ka një galeri të ngritur ku fëmija të mund të marri 'instruksione stimuluese'... Ka një seri klasash nga ku futesh prej një korridori të gjerë." (Robson, 1972, pp. 71-72)

Shkollat 1-dhomë-she njollosnin peizazhin zakonisht të vendosura në vende me kosto të ulët, të njohura si vende mbeturinash, në cep të komunitetit që rritej që shumë shpesh u ngjanin kutive me një hapësirë të ndërtuara thjesht me dru, tulla ose me kashtë. Plani ri-sjell dizajnin e kishave e famullive të vogla, me rreshta që drejtoheshin nga mësuesi i ngritur në platformë. (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Faza e standardizimit masiv që kapi periudhën 1890-1920, u quajt periudha "Lëvizja e shkollave komune". Një standardizim që erdhi si pasojë e rritjes së madhe të qyteteve, mbarimit të luftës Civile në Amerikë. Tipike për këtë periudhë ishte kërkesa për të futur sa më shumë nxënës. Skema që u përdor në këtë periudhë ishte ajo e krijuar nga Horace Mann, (Figura 6) i cili ishte një reformator në arsim, që vendosi përmasat e bankave në rreshta të rregullt e distanca të përcaktuara nga njëra tjetra dhe me dritare në dy anët. (Baker, 2012). Stili i shkollës Mann i cili u propagandua nga Barnard ishte një shkollë përsëri 1 dhomë-she por me 2 dritare në të dyja anët e hapësirës. Tavolina e mësuesit në mes me një platformë të ngritur dhe fëmijët të ulur në rreshta me tavolina individuale. [1]




Figura 6. *Plani i Horace Mann për Shkollën-shtëpi një dhomë-she, 1938, nga Weisser 2006, dhe plani i shkollës 1 dhomë-she në Amerikë, marrë nga Mills, 1910*

"Shkollat një dhomë-she" në fundin e shekullit të XVIII-të e XIX-të u zhdukën gati plotësisht pasi ose u adaptuan e u ndryshua forma e tyre fillestare për t'iu përshtatur kohës ose u shkatërruan plotësisht duke i lënë hapësirë ndryshimeve të vazhdueshme. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

[1]Barnard, Henry, School Architecture (New York, 1838), f. 23 cituar nga (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Në Anglinë e viteve 1870 shkollat shiheshin si "vende të civilizimit të masave". Ndërsa në Spanjë në 1903 si" Pallatet e Edukimit, ishin monumente të vërteta të ngritura për të nderuar kulturën nacionale". Në fundin e shekullit të XVIII-të e fillimi i shekullit të XIX-të arkitektët menduan të krijonin një kuptim të përbashkët, mbi një vend ku nxënësit merrnin informacion, e filluan të kuptonin frazën "hapësirë edukimi": një hapësirë që shihej si bashkëveprim mes fizikes e sociales. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Falë familjeve të mëdha në numër, veçanërisht emigrantë, shumë prindër kërkonin të dërgonin fëmijët në punë në vend të shkollës. Por mbas luftës Revolucionare, edukimi u bë i detyrueshëm dhe u futën në masë shkollat një dhomë-she me një mësues që drejtonte një grup prej 30-40 fëmijë të moshave e niveleve të ndryshme. Duke qenë se gjithmonë e më shumë fëmijë po merrnin pjesë në shkollë, mësimi në një klasë i fëmijëve të moshave të ndryshme e niveleve të ndryshme nuk ishte më i pranueshëm. Kështu u ndërtuan shumë shkolla të mirëfillta për herë të parë me klasa të ndryshme, mensë, si dhe palestër. Më pas lindi nevoja e ndarjes së shkollës në nivele për stadet e ndryshme që kishte fëmija e me rritjen e numrit të tyre shkollat u zmadhuan duke shkuar në godina me tre katër kate me 600 nxënës. Çdo klasë mbante deri në 55 nxënës. Tre katet e poshtme mbanin klasa që hapeshin drejt një korridori të përbashkët ndërsa kati i fundit i shërbente administratës si dhe një holli të madh. (Pasalar, 2003)

Ndërtesa e shkollës që arkitektet duhet të planifikonin duhej të ishte e prodhuar për të mbledhur fëmijë të moshave të ndryshme, madhësive të ndryshme, gjinive e studimeve të ndryshme. Shëndeti dhe suksesi në studim kërkonte ajër të pastër çdo ditë, ventilim të mirë, temperaturë te kontrolluar e tavolinat duhet të dizajnoheshin duke pasur parasysh komfortin si element bazë, në mënyrë që simetria e formës, kualiteti i shikimit të syrit, dhe gjithë sjelljet e fëmijëve do të ndikoheshin edhe nga situata, paraqitja, komforti i brendshëm e i jashtëm i shkollës. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Shumë u investua në Amerikë si dhe në Evropë për shkollat me 2-3 ose 4 kate ku ndërtesa përfaqësohej nga një godinë e rëndë dhe e stërmadhe, me qëllimin e imponimit, dhe e krijimit të ndjenjës së disiplinës e rëndësisë. (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Në pjesën më të madhe të godinave të shkollave të ndërtuara në këtë periudhë vihet re një stil tradicional me fasadë që reflektonte rrymat Beaux Arts, Gotike, Rilindjes Koloniale e të tjera neoklasike. Kjo vërtetohet duke parë fotot e mbi 130 shembujve të shkollave të paraqitura nga Mills mbi një sërë arkitektësh të asaj periudhe në librin "American School Building Standards".

Gjithashtu vihet re përdorimi i tullës si material kryesor dhe i dritareve Viktoriane në shumicën e rasteve. (Figura 7)

"Ato ishin të mëdha, imponuese, dhe shpesh me 3 ose më shumë kate. Ato dominonin territorin përreth" (Mills, 1915) I po këtij mendimi është edhe Gutman e cila deklaron "Nga shkollat 1 dhomë-she te ato komplekse shumë-katëshe, ndërtesat edukative paraqisnin potencë, imponim, rregull, disiplinë." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004) Në këtë periudhë ato filluan të braktisnin tendencën gotike dhe të shkonin në favor të stilit eklektik të Rilindjes Angleze. "Fasadat e tyre me maja çatish të zbukuruara, me tulla të përpunuara me ngjyra, dhe ornamente terrakote ishin me vërtetë godina të pashme ndërsa plani i tyre me klasa të mëdha prej nga

hyhej nga holli gjigand i përbashkët e me sheshe e hapësira të veçanta për djemtë dhe për vajzat do te ishte modeli ndikues për shkollat deri në fillim të shekullit të XX-të. (Figura 8)




Figura 7. *Plani i shkollës "Silas W. Gardner School", në New Orleans, 1900. Dallohet ndarja e shkollës në dy pjesë të veçanta për vajzat e për djemtë. (Mills, 1915)*

Lufta e Parë Botërore korrespondonte me ndryshime politike, normativa, mbi shëndetin dhe higjienën. Të kësaj periudhe ishin ndryshimet në nevojën për ndriçim dhe heqja e vëmendjes nga objekte monumentale në objekte funksionale, dhe njohja e shkallës në të cilën vepron fëmija. Pati dy rryma te forta filozofike ne shkollat alternative dhe në ato progresive. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Reforma e shkollës komune solli idenë e mundësive të njëllojta për të gjithë për t'u edukuar pavarësisht klasës e shtresës sociale, racës, gjendjes ekonomike etj. (Pasalar, 2003)

Ledita Mezini




Figura 8. *Plane dhe Foto të shkollave të ndërtuara në Amerikë gjatë periudhës së viteve 1900. Marrë nga (Mills, 1915)*

### 1.3.2 Periudha Progresive (1930-1945)

Shkolla ishte kryesisht e fokusuar te mësuesi e kjo gjë çoi që shkollat e mesme të cilat nuk ishin të detyrueshme të kishin një numër në rënie nxënësish. Shkolla në Amerikë ndryshoi rrënjësisht me teoritë e edukuesit John Dewey dhe te William James i cili sugjeronte që edukimi duhej te bazohej në një koncept më të gjerë e duke e bërë atë pjesë e integruar e procesit të jetës. Nxënësit do të mësonin duke punuar në praktikë e duke u integruar me njeri tjetrin. Madhësia e klasave filloi të zvogëlohej duke shkuar në 40-30 nxënës. Historianët dhe kritikët shprehen se në këtë fazë "klasa të reja si ajo e shkencës dhe e gjeografisë iu shtua kurrikulës, por megjithëse klasat përfshinin me shume aktivitete në grup përsëri kishin një dominim nga mësuesi." (Pasalar, 2003)

Reformatorja e arsimit Maria Montessori bëri një kritikë të ashpër për sistemin e tavolinave e karrigeve duke sugjeruar që përdorimi i tyre ishte një shenjë e pedagogjisë skllavëruese. E këtij mendimi ishte edhe Margaret Sanger e cila kritikoi interierët e dëmshme dhe të papërshtatshme të shkollave. Ralph Henry Clowley, mendonte se mënyra më e mirë për të zhvilluar progresin e shkollave për masat ishte duke parë praktikat që kishin bërë shtetet e tjera. Ai vizitoi shkollën Emerson dhe e paraqiti në librin e tij 'The Hygiene of School Life' si një mundësi e mirë për projektimin e "shkollave pa klasa" ku "asnjë ambient mësimi nuk i përkiste asnjë klase, dhe u jepej shumë rëndësi aktiviteteve në natyrë e të mësuarit e jetës praktike." Ideja ishte që fëmijët të mësonin në çdo cep të shkollës dhe çdo ambient të përdorej për mësim. "Shkolla konceptohej 'trup, mendje e ambient'." (Crowley, 1933)

Gjatë periudhës progresive, biznesi Amerikan dhe industria u zhvillua me shpejtësi. Kjo lëvizje influencoi edhe shkollat. Shkolla shihej në thelb si një vend pune (fabrikë) dhe mësimi i studenteve shikohej në termat e prodhimit. “Mësuesve u referohej si punëtorë fabrike dhe nxënësit si materiali bazë nga do merrej prodhimi, të cilët duhet të përmbushnin kërkesat dhe nevojat e shekullit të XX-të.” (Pasalar, 2003)

Të gjitha këto dëshira për të ndryshuar shkollën si në pamje ashtu edhe në mendim çuan në ‘shkollat e të nesërmes’. Studiues donin që shkollat e të nesërmes të ishin një qytet kopsht për fëmijët. Ndërsa Beatrice Ensor deklaron se “shkolla kishte braktisur ndërtesën e vjetër e të rëndë në favor të shkollave të lokalizuara në periferi, kaq të thjeshta në dizajn dhe me një pamje të përkohshme, që mund të shtoheshin e të ndryshoheshin lehtësisht kur ishte nevoja. Çfarë ishte më shumë e rëndësishme ishte “thjeshtësia, ngrohtësia, drita, ajri dhe sigurisht bukuria.” (Ensor, 1925)

Kështu që ambienti i shkollës iu atribuua pikëpamjeve të reja të procesit të edukimit që i takonte organizimit të hapësirave fleksible të klasave dhe numrit të laboratorëve ose të dhomave të projektimit, që mbështesnin aktivitetin e nxënësve. “Në përgjithësi ambienti i shkollës kërkonte të ofronte më shumë stimul te nxënësit  të cilët vepronin në një kornizë lirie dhe në një rrjet e marrëdhënie shoqërore më të balancuar. Qëllimi ishte të integronte rolet e ndryshme shoqërore duke i dhënë mundësi te barabarta çdo fëmije e duke promovuar zhvillimin e tyre psikologjik, shoqëror, e moral , d.m.th. personalitetin e tyre.” (Pasalar, 2003, p. 20)

Në fillim të shekullit të XX-të për shkak se shumë fëmijë u sëmurën filloi dëshira për të sjellë sa më shumë ajër e dritë në mjedisin e klasës e brenda në ambientet e shkollës. Në 1929-1930 nisën në Amsterdam, kryesisht nga arkitekti Johannes Duiker të aplikoheshin shkollat “Open Air” (e ajrosura). Shkolla nuk ishte më monumentale e mbyllur, me tulla qeramike dhe e rëndë por u kthye në shkollë me stil transparent, me dritare të mëdha, ku xhami zëvendësoi tullën dhe llacin. Së bashku me materialet ndryshuan edhe rrymat pedagogjike të cilat kërkonin më shumë lirshmëri, fleksibilitet dhe informalitet në edukim. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Në vitet 1920, kjo lloj rryme e re në arsim u quajt ‘periudha Progresive’. Në qendër ishte fëmija dhe edukimi e mësimi bëheshin nëpërmjet lojës, dhe zhvillimit të personalitetit dhe identitetit. Gjithashtu frika nga sëmundjet e ndryshme e kryesisht nga tuberkulozi bëri që shkolla “*open air*”  (e hapur ndaj ajrit) të gjente përkrahje të madhe “dëshira për të ajrosur ambientet e për të lënë diellin brenda çoi në një model dominues projektimi: holli qendror rreth të cilit ishin rrotulluar ambientet rreth e rrotull.” (Clay, 1902, f. 172) (Figura 9)

Ledia Mezini



Figura 9. *Shkolla "Open-air" në Amsterdam, 1929–30: arkitekt Johannes Duiker dhe Bernard Bijvoet.*

Arkitekti Giuseppe Terragni i inspiruar nga shkolla 'open air' e Duiker përdori idenë tradicionale të *cortile* (oborrit) për të projektuar shkollën Asilo Sant'Elia (Figura 10), që u quajt një "shtëpi xhami për të mësuar". Shkolla punonte si një dialog mes së brendshmes e së jashtmes, ndërmjet hapësirës së meditimit dhe elementeve të natyrës. Dritare të hapsh-me, tavane të larta, dhe oborre të cilat nxisnin e prodhonin ambiente me ajër, dritë, hije e gjelbërim. Ashtu si Terragni edhe arkitekti Kaj Gottlob projektoi shkollën ne Kopenhagen duke shfrytëzuar të njëjtat parime një atrium oval në lartësinë e ndërtesës ku drita dhe ajri qarkullonin duke krijuar një nga shkollat më vizionare të periudhës së vetë.



Figura 10. *Asilo Saint Elia, arkitekt Giuseppe Terragni. Shkolla përdori idenë e oborrit ku nxënësit kishin mundësi dalje direkte në territoret e jashtme.*

Ndërkohë në Amerikën e viteve 1918-1920 arkitektet William Lescaze dhe Richard Neutra hodhën idenë e shkollës eksperimentale që u bë manifest me 1935 me shkollën "Corona Avenue Elementary School," e cila ishte një ndërtesë një kat ku të gjitha klasat dilnin në

ambientin e jashtëm, e nxënësi "mësonte duke jetuar", e vetë klasa kthehej në një hapësirë lojërash. (Figura 11)



Figura 11. *Corona Avenue elementary School, viti 1935, arkitektë: William Lescaze dhe Richard Neutra*

Rreth viteve 1930 kultura e Britanisë u drejtua drejt modernizimit e kërkohej një arkitekturë që të ishte e një fryme të re e që i përgjigjej nevojave të njeriut e teknologjive të reja. Shumë arkitekte punuan në këtë periudhë për ndërtesat e shkollave e mes tyre mund të përmendim, Eero Goldfinger, Berthold Lubetkin, Erich Mendelsohn, por më i rëndësishmi i kësaj periudhe është Walter Gropius. Së bashku me Maxwell Fry ndërtuan Impington Village College, e cila u bë një nga shkollat pilot që bëri thirrje e manifestoi për ndryshimin në arsim sipas standardeve moderne por ngeli e vetme për një kohë të gjatë pasi shume të tjera në të njëjtën periudhë ngelën vetëm si projekte. "Kishte ende një stok të madh të ndërtesave të shkollave që ishin ndërtuar për të jetuar më shumë se për një shekull e të cilat nuk përshtateshin absolutisht me praktikat e reja të edukimit e asaj që u quajt rryma e "Learning by doing" (të mësosh duke e bërë)." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Por sipas Baker, rreth viteve 1930-1940 shumica e shkollave të ndërtuara vazhdonin duke përdorur principet dhe njësitë matëse të dizajnit të dekadave të mëparshme, megjithëse kishte një interesim të madh për modelet e reja të edukimit, me figura drejtuese si Maria Montessori në Itali dhe John Dewey në Sh.B.A. Këto mbështesnin idenë e nocionet e mësimit me qendër fëmijën dhe zhvillonin teoritë e arsimit që ekzistojnë deri më sot. (Hille, 2011) Shumë nga ndërtesat arsimore të kësaj periudhe ishin nga arkitektet inovativ si Eliel Saarinen me shkollën e Cranbrook Boys School (1925), Alvar Aalto me Tehtaanmaki school (1937) dhe Richard Neutra me shkollat e tij moderne të periudhës së viteve 1930. Këto shkolla që u quajtën lëvizja e "*open air school* "(shkolla e hapur me ajër) falë ngulmimit për ajër, dritë dhe ambiente të jashtme e qarkullim të lehtë nëpër godinë u quajtën edhe si "funksionaliste" sepse ato i jepnin rëndësi ajrit të freskët, aktiviteteve jashtë, shëndetit fizik, si jetike për shëndetin mendor. Një stil arkitektonik i tillë shihet edhe në ndërtesën e Walter Gropius e Maxwell Fry's, Impington

Village College e ndërtuar në 1936, ku falë dritareve nga dyshemeja në tavan mund të bëhej më mire lidhja me natyrën. (Baker, 2012) (Figura 12)



Figura 12. *Impington Village College e ndërtuar në Cambridgeshire, viti 1936, arkitektë Walter Gropius, Maxwell Fry*

Hertzberger shprehet për periudhën progresive si një nga fazat më të mira të krijimtarisë së shkollave:

> Shkolla "open-air" rrezatonte liri më shumë se çdo gjë tjetër, liri nga tullat e gurët e rëndë të ndërtesave të shkollave të zakonshme. Mure me xhama sillnin transparencë, pamje brenda e jashtë. Të dizenjuara nga arkitektet e lëvizjes Moderne mund të mos kenë ndryshuar mënyrën tradicionale të të bërit të mësimit por zëvendësuan ndërtesën e shkollës si një bastion i ashpërsisë e i rëndësisë me një imazh më të hapur, të lehtë dhe më të aksesueshëm duke paraqitur një shpirt të ri në edukim. "shkolla e re transparente dhe rrezatuese që u shfaq në 1920-1930 si një dëshmi e një bote më të mirë, vendosi një imazh të ri mbi higjienën, shëndetin, hapësirën, sipërfaqen, dritën, ajrin dhe pamjet." (Hertzberger, 2008, p. 19)

Vetëm në vitin 1934, mbas luftës në Francë filluan licetë, që u bënë shkollat për masën e jo vetëm për elitën. Ideologjia e shkollave të Reggio Emilias, me drejtues Loris Malaguzzin, në edukimin e fëmijëve njihte: fëmijën dhe të rriturin si të parët, mësuesin të dytin, si dhe ngrinin rolin e ndërtesës, interierit, teksturës, ngjyrave, etj., si të tretët. Ambiente edukuese që stimulonin fleksibilitet, të mësoje duke bërë, dhe pedagogji që ndihmonin mësimin me metoda vetjake. "Fëmija është njësia rreth të cilës shkolla rrotullohet", ishte motoja e pedagogjisë së re që kërkonin një "shkollë të kuptueshme". Këto shkolla në thelb të tyre kërkonin te ndihmonin komunitetin duke përfshirë edhe mësime sociale, e nisen një dinamike të re midis komunitetit, shkollës e shoqërisë. "ndërtesa që shkriheshin me ose shpërthenin në komunitet, mendoheshin për të gjithë ndërsa klasa fleksible dhe e zgjerueshme ishte motivi i ri." (Fielding, 2006, f. 350)

Në periudhën mes dy Luftërave Botërore, karakteristikat hapësinore të shkollave evoluuan në tre principe kryesore, gjetjet e reja pedagogjike, përparimi i Lëvizjes Moderne në arkitekturë, si dhe masat e marra për higjienë e evitimin e sëmundjeve. Të kësaj periudhe janë shkollat me

planimetri në formën e gishtave ku çdo klasë kishte dalje të ambientet e jashtme e iu kushtua shumë vëmendje ventilimit, ndriçimit, orientimit, dhe kontaktit direkt me natyrën. Për herë të parë klasat u lidhen me natyrën oborret, kopshtet, vendin e lojërave, duke e futur natyrën si një element të eksperiencës së mësimit. Megjithatë klasa ishte një faktor i madh përbërës i shkollës e cila shpesh organizohej përgjatë një korridori linear. (Pasalar, 2003)

Ishin pikërisht vitet 1930 ku lindi nevoja për një standardizim të menaxhimit të strukturave e të ndërtimit të shkollave në mënyrë të shpejtë. Vitet 1930 prodhuan gjithashtu interes te efektet psikologjike të ndërtesës së shkollës duke qenë se plani i shkollës së hapur ishte i fokusuar te dizajni dhe rëndësia që i kushtohej fëmijëve.

Duke qenë se gjatë periudhës së luftës shumë mësues kishin dhënë mësim edhe në kushte të papërshtatshme shumë mendonin se ambienti nuk kishte rëndësi, por metodat e mënyra e mësimdhënies. Mësuesit e rinj kërkonin ambiente që të ishin fleksible e të përshtatshme për teoritë e reja të të mësuarit. Në Amerikë u shpërbë shkolla monolite e kompakte në njësi të vogla me klasa në formën e L-së, të cilat dritaret e strehët shihnin nga gjelbërimi dhe oborret. "Oper air-class" (klasa e hapur me ajër) ishte një seri grupesh klasash rreth e rrotull një njësie administrative, bibliotekë, ose auditor.

Ndërtesat e reja të kësaj periudhe nuk ishin më të stilit klasik ose kolonial të Gjeorgjisë ose të Gotikut por ishin krejtësisht moderne, në përgjithësi me një kat me tarraca të sheshta, dritare në lartësinë e katit dhe me sisteme muresh të kombinuara me tulla ose beton. Ishte pikërisht gjatë kësaj periudhe që u zhvillua në masë plani i shkollës në forme gishtash ku dritaret me vetrata të mëdha e të hapëshme që kapnin gjithë fasadën bënin mundësi për dalje direkte në ambientin e jashtëm të çdo klase individuale. (Baker, 2012)

Periudha e Luftës së Dytë Botërore ishte një fazë e zezë në zhvillimin e arsimit dhe gjithashtu të shkollës e te ideve të reja por menjëherë pas saj kërkesa për rindërtim të shkollave e shtimi i të rejave ishte një hov në të gjithë Evropën. Standardizimi dhe kërkesa për të ndërtuar shkolla shpejt e lirë të krijonte përshtypjen e pamjes së fabrikës. Me 1940 Bradford Perkins dhe Philip Will së bashku me Eero & Eliel Saarinen ndërtuan Crow Island Elementary school , në Winnetka që u bë një shkollë ikonë e prototip i tendencave të reja. Kjo shkolle jo vetëm propagandonte shkollën "*Open Air School*" por edhe paraqiste tendencat e reja progresive të John Dewey në arsim, ku nxënësi ishte në qendër dhe shkolla duhet të kishte ajër të pastër, dritë natyrale, dollapë e karrige fleksible e të lëvizshme, dhe një hapësirë për komunitetin. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Për shumë studiues shkolla Crow Island School e Perkins & Will & Saarinen u bë simbol i arkitekturës së shkollave moderne në Shtetet e Bashkuara. Hapja e madhe e dritareve në këtë periudhë kishte të mirat e veta por sipas Baker ajo sillte edhe probleme siç ishte ndriçimi i tepërt në klasa, reflektimet, mbinxehje në stinën e verës dhe ftohje e humbje energjie gjatë dimrit. Në këtë periudhe filluan te rriteshin përgjegjësitë e inxhinierëve kundrejt komfortit termik i cili po behej një specialitet gjithmonë e më shumë në rritje teknike e kompleks i cili kërkonte temperaturë e lagështi të kontrolluar nëpër klasa. (Baker, 2012, p. 13)

Ledia Mezini




Figura 13. *Crow Island elementary School, Winnetka, viti: 1940, arkitektë: Bradford Perkins dhe Philip Will së bashku me Eero & Eliel Saarinen*

Crow Island e arkitektit Eero Saarinen & Perkins në 1967 u shpall si simbol i arkitekturës së shkollës e një nga ndërtesat më të rëndësishme të dizenjuara në shekullin e XX-të në Amerikë. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

### 1.3.3 "Bumi" i pas luftës (1945-1960)

Mbas luftës, lindi nevoja për të ri-konstruktuar e për të ndërtuar një numër të madh shkollash që ishin shkatërruar ose rrënuar nga bombardimet, e nisën të merreshin masa edhe për kushtet ambientale ku u vendosen rregulla si:

"Siti i shkollës, tipi i ndërtesës, aspekti, dekorimi, akomodimi, llojet e dollapëve, dusheve, lavamanëve, baseneve, mobilieve etj., temperatura dhe lagështia e atmosferës, ajri i freskët, diellzimi, heqja e pluhurit, kushtet e përgjithshme e të veçanta të punës në grup, lojës e të relaksimit si dhe standardet e higjienës dhe kulturës sociale." [2]

Arkitekti Stillman mendonte se duheshin shkolla me fleksible, metoda ndërtimi provizore e të shpejta, dhe se nevoja për ndryshim e kërkesa të reja nuk linte të ndërtoheshin gjërat jo fleksible. HORSA (*Hutting Operation for raising the School Leaving Age*), u quajt operacioni i ndërtimit të shtëpizave të vogla prej betoni të parafabrikuara të cilat u vendosën si blloqe klasash të përkohshme por përfunduan në shkolla te përhershme si për shembull në Wrothan School në Kent, më 1948. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008) (Figura 14)

[2] Birmingan Central Library, Archives Departement, Miscellaneous Education Files, Central Council for Health Education, 1947, cituar nga (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Ledita Mezini



Figura 14. *Shkollat e parafabrikuara sipas programit HORSA*

Baker e argumenton periudhën e standardizimit në bazë të shtimit të madh të popullsisë. “Popullata në Amerikë u rrit dhe gjithashtu u rrit shumë edhe numri i nxënësve që frekuentonin shkollat nga 2.3 milion studentë vetëm në një dekadë nga 1958-1968”. (Baker, 2012, f. 11) Kjo ishte një arsye se pse në vitet 1950 u përhapën gjerësisht planet dhe fasadat e standardizuara që kishin karakterizuar arkitekturën e asaj periudhe megjithëse duhet të pranojmë që pati lëvizje për një periudhë të re në arkitekturën e edukimit.

Puna e Tanner, Moorhouse e Eric Pearson hapi rrugën për lëvizjen e 1960, “*Open Plan”* (plani i hapur) ku në bashkëpunim edhe me prodhues hekuri lindën shkolla të parafabrikuara me dritare e parete shumë fleksible. “Shkollat po projektoheshin për funksione të reja e në një mënyrë shumë më të kuptueshme.” (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Hunstanton Secondary School në Norfolk,  (Figura 15) e cila u hap në 1954, u dizajnua nga arkitektët Alison dhe Peter Smithson. Kjo ishte një shkollë pa korridore, por me holle të mëdha lidhëse. Klasat me ndriçim nga të dy anët jug-veri, e me sipërfaqe të mëdha xhami e lirshmëri e fleksibilitet. Në revistat e kohës shumë kritike vlerësuan transparencën e madhe e zgjidhjen e mirë funksionale duke pasur parasysh që “funksioni duhet të ishte më parësor se sa estetikja.” (Education, 1954) Megjithatë shumë kritikë nuk e vlerësuan duke e quajtur si ‘brutalizmi i ri”. Materialet e vendosura ishin të ashpra: hekur, beton, e sipërfaqe të mëdha xhami. U kritikua si një ndërtesë jo e menduar për fëmijët por që gëzon vetëm arkitektin. Arkitekti Philip Johnson shkruan: “ Plani i shkollës jo vetëm që është shumë radikal po është shumë i ngjashëm më Mies Van der Rohe. Megjithëse arkitektët Smithson nuk e kanë parë kurrë veprën e Miesit, kjo shkollë ngjan si një vlerësim për veten e tyre si dhe për Mies Van der Rohe.” (Johnson, 2012)

Kidder Smith propozoi një zgjidhje të re për shkollën e madhe: krijimin e disa shkollave të vogla brenda një shkolle të madhe, klasa e ambientet e tyre ndihmëse të organizuara në dy kate rreth një oborri të madh që mblidhte funksionet e administrimit, bibliotekës, etj. Sipas Dudek kjo shkollë paraqiste “kremin e arkitekturës pas lufte në Evropë.” Ndërkohë që ndërtesat e shkollave janë të ftohta në dimër e të nxehta në vere e janë një tmerr për ata që rrinë aty,

ndërtesa e Smithi-it është një “ndërtesë shpirtërore” dhe u quajt si shembulli i parë i shkollës moderne ne Angli. (Dudek, 2000, fq 32)



Figura 15. *Shkolla “Hunstanton Secondary School në Norfolk” e arkitektëve Alison dhe Peter Smithson e cila u kritikua e njëkohësisht u vlerësua si “Brutalizmi i ri”.*

Shekulli i XX-të paraqiste tendenca të reja në dizajnin e shkollave por përsëri mësuesi nuk pyetej shumë e një pjesë e madhe e tyre kërkonin metodat e vjetra me të cilat ishin mësuar, me klasa tradicionale e mënyrën klasike të dhënies se mësimit.

Megjithatë Hertzberger i kritikon ashpër ato si objekte kuti: “Arredimi i tyre i brendshëm është gjithmonë njësoj: klasa si kuti opake përgjatë një korridori të gjatë për funksionin e thjeshtë të qarkullimit e për të varur palltot.” (Hertzberger, 2008)

Idetë e reja që kishin lindur mbi pavarësinë e lirinë e nxënësve hodhën dyshim për metodën tradicionale të të dhënit mësim, por përsëri u pa që në klasën e shekullit të 20-të shumë pak gjëra ndryshuan. “Arkitektet modern të shkollës ‘*open-air*’ shqetësoheshin ne përdorimin e vetratave të mëdha, transparencës dhe orientimit te bota jashtë por nuk sollën ndryshim te edukimi autoritar, te mënyra e uljes së nxënësve në rreshta përpara tabelës e as te oraret e caktuara e rregullat strikte të shkollës.” (Hertzberger, 2008)

Gjithashtu dëshira për të ndriçuar klasat me dritat fluoreshente, që ishin një mundësi e kohës po ndryshonte standardin e ndriçimit të klasës nga ai natyrali te artificiali në vitet 1940-1950. Ishte pikërisht edhe periudha ku filluan projeksionet si një mjet për të mësuar nëpër klasa kështu që lindi nevoja e pareteve ose perdeve për të errësuar klasën. Pikërisht për këtë shumë studiues ashtu si Baker mendonte që “ndryshimet që ndodhnin në standarde ishin më shumë të lidhura me përparimet teknologjike sesa me të kuptuarit e nevojave e komfortit human.” (Baker, 2012, f. 14)

Në vitet 1950 në Angli kryesisht e më pas edhe në Francë filloi ndërtimi i një numri të madh shkollash të lira, të shpejta, 1 katëshe me çelik struktural e gati të parafabrikuara. Por kjo metodë nuk mund të adoptohej për të gjitha shkollat në të gjithë vendet. Gjermania, Danimarka, Hollanda dhe Zvicra u mbështetën te sistemi i modelit të shtëpisë individuale (*individual home*

*model*), ku çdo klasë ishte si një nukël me vete, që grupohej në pavione, të organizuara ose me vete. Në ShBA. nisi rreth viteve 1960 dhe u quajt "*house plan*" ku shkolla ishte si një shtëpi e dhomat përfaqësonin klasat. (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)



Figura 16. *Shkolla Marl e Arkitektit Hans Scharoun, shkolla e quajtur " Qytet brenda qytetit". 1951*

Hans Scharoun propozoi një shkollë në Darmstadt më 1951, (Figura 16) që megjithëse nuk u ndërtua paraqiste një mendim të rëndësishëm për ndryshimin e projektimin e shkollave. Ndërtesa duhej të ishte e ngrohtë, me jetueshmëri, dhe emocionalisht një ambient ushqyes me njohuri dhe me krijimin e individit e komunitetit. Forma e klasës do te ishte ajo e 'klasës banesë', si një shtëpi e dytë për fëmijën ku dhe ambientet brenda e jashtë do të ndikonin në formimin social të tij. Klasat mobiloheshin ndryshe duke dhënë mundësi diskutimi dhe pjesëmarrje aktive. Në të njëjtën ide mendimi u ndërtua shkolla për vajza Lunen, North Rhine, Ëestphalia, me 1962 ku arkitekti Scharoun me dhomat hegzagonale krijoi shkollën si një 'qytet brenda qytetit', ku një rrugë në mes kapte gjithë klasat dhe lidhte në këtë mënyrë individin me komunitetin, klasën e me shkollën. Në opinionin e arkitektit kjo lloj shkolle e marrëdhënia mes hapësirës brenda e jashtë e hapjes dhe e mbylljes së njësisë, formonte esencën e shkollës. Në këtë mënyrë i jepej rëndësi mendimit dhe opinionit të fëmijës. [3]

[3] Heidemarie Kemnitz, Schulbau jenseit der Norm: Hans Scharouns Madchengymnasium in Lunen', Pedagogica Historica, XLI/4 (gusht 2005), fq 199-216, cituar nga (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Arsimi progresiv që nisi që me John Dewes me 1906 pati një boshllëk të madh, por më pas rreth 1950 mori një hov, ku shumë shkolla u bënë pioniere të arkitekturës të asociuara me pedagogjinë.

### 1.3.4 Periudha Impulsive (1960-1980)

Baker e quan këtë periudhë 'impulsive' dhe e këtaj periudhe është një mungese regjistrimi në masë nëpër shkolla gjë që çoi autoritetet të përballeshin me rishikimin e ri-mendimin e konfigurimit të hapësirave të shkollave ekzistuese. "Në këto vite studiuesit filluan të njohin lidhjen mes ambienteve të shkollës dhe procesit të mësimit por gjithashtu shikonin dy lëvizjet kontroverse në edukim që ishin "klasa edukimi të hapura" dhe "hapësira shkollash të hapura" të cilat kërkonin metoda të reja të përdorimit të hapësirës së klasës." (Baker, 2012)

Në vitin 1959 J. Lloyd Trumph përgatiti një raport duke theksuar nevojën për të përmirësuar kualitetin e shkollave dhe të ambientit të mësimit për të ardhmen. Ky raport i njohur si plani i Trumph-it influencoi zhvillimin e një numri të madh shkollash. Sipas tij, "shkollat nuk duhet të kishin më shumë se 25-35 nxënës që takoheshin 5 ditë në javë. Në termat e marrëdhënies së fëmijëve me mësuesin ai duhet të kishte më shume rolin e një konsultuesi se sa të një mbikëqyrësi."[4](Trumph, 1959) Duke qenë se nxënësit kanë stile të ndryshme të të mësuarit, plani sugjeronte studime të specializuara. Plani i Trumph-it e njihte influencën e drejtpërdrejtë që kishin karakteristikat fizike të ambientit të shkollës te fëmijët. Sipas Trumph-it hapësira brenda shkollës ndikonte te mënyra se si mësohej e se çfarë mësohej. Fleksibiliteti hapësinor ishte një nga variablat që duhej të konsiderohej. Planet e mëdha të klasave duhet të ishin mjaft fleksible e të lejonin ndarjen në hapësira më të vogla për punën në grup, dhoma seminaresh, e diskutimesh. (Pasalar, 2003)

Në vitet 1960 filluan tendencat të hapnin shkollën më shumë ndaj prindërve e ndaj komunitetit duke vendosur fëmijën në qendër të edukimit dhe duke i shtuar shkollës jo vetëm ambiente mësimi por edhe ambiente të tjera rekreative. "Në këtë periudhe u zhduk shkolla monumentale krejtësisht duke i hapur rrugë thjeshtësisë dhe çarjeve, në mënyrë që shkolla të jetë një vend për të jetuar fëmijët dhe një vend grumbullimi për komunitetin". (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Një shkollë me plan të hapur *"open plan"* është shkolla e projektuar nga Perkins & Will në 1960, shkolla e Disney School në Chicago. (Figura 17) Vazhdimisht kishte programe e projekte për të bërë parafabrikimin e shkollës e për të ndërtuar me teknikat e parafabrikateve. Pasi "kërkonin të aplikonin teknikat e standardizimit e analizës se sistemeve në mënyrë për të zhvilluar një godinë arsimore sa me ekonomike." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008) Duke qenë se periudha impulsive ishte një periudhë e cila u ndërtua pak, fokusi ishte në efikasitetin e energjisë e në rinovimin e shkollave ekzistuese. "Liria e madhe arkitektonike u shoqërua nga kriza e energjisë e cila ngriti pyetjen se a duhej të ishte klasa me dritare? Hapje e një hapësire të madhe klasash e ndarja shpesh me parete sillte në mungesën e dritës natyrale në thellësi të ambienteve si dhe në errësirë të plotë të disa prej tyre.

[4] J.L.Trumph, 1959, cituar nga (Pasalar, 2003)

Ledita Mezini



Figura 17. *Shkolla "Disney Magnet School", Chicago e arkitektëve Perkins & Will, të cilët projektuan shkollën 'me plan të hapur'. Viti 1960*

Finmere Infant School, në Oxfordshire, më 1960 nga arkitektja Mary Crowley (Medd) u bë e para shkollë me dy klasa mjaft fleksible, e parete të lëvizshme duke dhënë mundësi për krijimin e zonave të vogla të qeta, për punë individuale ose në grup. (Franklin, 2012) (Figura 18)



Figura 18. *Pamje nga shkollat 'open plan', të arkitektëve David dhe Mary Medd të cilët punuan për shkollat me fokus te fëmija rreth viteve 1944-1980. (Franklin, 2012)*

Dizajni '*Open Plan'* ofronte mundësi që shkolla të ishte kreative, aktive dhe me pjesëmarrësit aktiv në procesin e mësimit. "Shkolla duhej të ishte e qeshur, e ndriçuar, joformale, dhe e ngjashme me banesën, e lidhur ngushtë me jetën dhe punën e fëmijëve që jetonin në to." (Pearson, 1972, fv. 26-28)

Arkitektët në këtë periudhë filluan të merreshin shumë me teknologjitë e reja, materialet, teknikat në mënyrë që të promovonin gjithmonë e më shumë edukimin progresiv, e tendencat e arkitekturës '*open plan*', si një standard i ri që lejonte fleksibilitetin e mundësi për të qenë interaktiv me ambientin përreth. Këto lloj shkollash u përhapën gjerësisht më 1970 e dëshira që shkolla të ishte pjesë aktive e komunitetit bëri që Ministritë e Arsimit të caktonin që tashmë shkollat të ndërtoheshin në mes të komunitetit e të ishin për të gjithë, për qëllime të ndryshme, e të hapura mundësisht 24 orë. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Vitet 1960 e 1970 sollën zhvillime të reja në sistemin edukues e një analizë mbi zhvillimin e nevojat e fëmijëve. Ideja e dizajnit të hapur (*open plan)*, u shfaq duke sjellë ndryshime të mëdha në organizimin, strukturën e klasës si dhe në planin e ndërtesës në total. (Pasalar, 2003)

Lindjet e shumta të viteve 1960 së bashku me zhvillimin e periferive solli ndërtimin e shkollave të reja. Shkollat e reja kishin varietet arkitektonik e në program. Shkolla "*open space*" ( me hapësira te hapura) dhe edukimi informal u bënë pjesë e eksperimentimit. Shkollat '*open space'* lindën si nevojë për t'iu përgjigjur problemit të edukimit të fëmijëve e ndryshimeve në performancën e nivelin e tyre. Megjithatë shkollat "*open plan*" ishin më shumë një angazhim filozofik se sa një ndërtesë me efikasitet në kosto. Modeli i edukimit ofronte një mësim me qendër fëmijën, i cili nxiste një grupim e punë në grup të nxënësve, një mësim të individualizuar, një akses në materialet e mësimit, dhe përdorimi i hapësirave të shkollës si klasat, korridoret, dhe sipërfaqet e jashtme. Ideja ishte të jepte hapësira të cilat inkurajonin lëvizjen, komunikimin, interaksionin social, kooperimin, dhe projektet në grup, midis nxënësve. Ato ishin modeli i shkollës moderne dhe u adoptuan masivisht. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Sipas Wolfe dhe Rivlin megjithëse u futën këto tendenca të reja, kishte mësues që aplikonin metodat tradicionale të pamësuar me metodat e reja ku ata nuk kishin vëmendjen 100 % e gjithashtu kishte plot shkolla të ndërtuara me stilin e vjetër ku tentohej të futeshin pedagogji të reja. (Maxine Wolfe & Leanne G.Rivlin, 1987)

Shpesh filluan të përdoreshin e teknologjitë e reja e kompjuterët nëpër shkolla, por pavarësisht kësaj, këto ndërtesa mbetën ende në pamjen e tyre gati të pandryshuar, veçanërisht klasa. "Shumë arkitektë dhe edukues me interes në projektimin e ambienteve të mësimit efektivë dhe përfshirës ishin të shqetësuar me sfidën e organizimit, rregullimit të arkitekturës me edukimin". (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

Kështu që ideja filloi të dështonte duke qenë se nuk kishte përshtatshmëri mes aktivitetit mësimor dhe ndërtesës fizike të shkollës. Probleme si shpërqendrimi vizual, zhurma, si dhe nevoja për të pasur aktivitete të ndryshme e pajisje të ndryshme çoi në dështimin e shkollës "*open plan"* duke kthyer shumë nga shkollat në stilin tradicional të mësimit. (Sanooff, 2002)

Me gjithë dëshirën e fortë e risitë për inovacion e eksperimentim në shkollat e reja në dekadën e viteve '60-'70 pak ndryshime rrënjësore pati në arsim pasi pjesa më e madhe e mësuesve e drejtuesve kërkonin të kishin metodën tradicionale për të mësuar përpara një dërrase të zezë. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

### 1.3.5 Rëniet e viteve 1980 dhe lëvizja e re e 1990-2000.

Vitet 1980 ishte një periudhë rënieje dhe refleksioni për shkollat në Amerikë, e duke qenë se regjistrimet nëpër shumë qytete ishin gjithmonë e më të pakta, investimet në ndërtesat e shkollave ranë në mënyrë drastike dhe autoritetet u përqendruan vetëm te rikonstruksionet për t'i kthyer vetëm funksionale e të standardet bazë, stokun e ndërtesave të cilat po plakeshin. Gjithashtu vetëm në vitet 1980-1990, kombi Amerikan i vuri re problemet e klasave të përkohshme e të lëvizshme të cilat nuk ishin aspak më të përkohshme. Gjithashtu studimet e kohës treguan që ato nuk plotësonin kushtet e ajrimit të mirë duke treguar për prezencën edhe

elemente të ajrit të ndotur. Pikërisht në vitet 1990 lindi nevoja për ndërtesa shkollash e jo vetëm për to, që të ishin me performancë të lartë të energjisë, ose siç u quajtën *green building* (ndërtesat e blerta). Leed (*Leadership in Energy and Environmental Design*) në 1998 u bë një nga nismëtaret që influencoi në masë shkollën e gjelbër. "Standardet e tyre promovojnë përdorimin efikas të energjisë dhe gjithashtu të burimeve natyrore ndërkohë që japin kushte ambientale të shëndetshme brenda ambientit të jetueshëm." (Baker, 2012)

Një nga shkollat shembull të arkitekturës së kësaj periudhe e cila ri-sillte tendencat dhe rrymën e viteve 1970 së pedagogjisë 'studenti në qendër' është shkolla "*Bishop Park College*" në Angli e ndërtuar më 2005 nga arkitekti Lloyd Stratton i ACP Architects Copartnership. *Bishop park College* mund të konsiderohet si "shkolla brenda shkollës" ku aplikohen metodat inovative në kushte të reja, dhe çdo individ ka një program të specializuar. (Figura 19) Ndërtesa i përshtatet individit e "kjo lloj shkolle shkon me nevojat individuale dhe axhendën personale" e për këtë më 2005 fitoi cmimin RIBA. (Stratton, 2005)




Figura 19. *"Shkolla brenda Shkollës", Shkolla Bishop Park College, e arkitektit LLoyd Stratton, 2005 (Stratton, 2005)*

Në vitet 1989 u krijuan ambiente mësimi më të vogla që çuan te "shtëpitë akademike" ku jo më shumë se 200-300 nxënës e mësues organizoheshin në skuadra dhe kryenin aktivitete edukuese e shoqërore. (Pasalar, 2003) Njësoj mendojnë edhe Burke & Grosvenor (2008) të cilët shprehen "Tipologji të reja shkollash si 'Shkolla e specializuar', 'Akademia', 'Charter School', ishin të parat të cilat filluan të zëvendësonin shkollën publike në shumë vende të Evropës e të SHBA, të cilat sugjeronin ndryshime radikale dhe shpesh kërkonin ndërtime krejtësisht të reja".

Për fat të keq fondet për strukturat e mësimit patën buxhet të limituar dhe pati një lëvizje mbrapa te nevojat bazike hapësinore dhe një kthim te metodat tradicionale të cilat limitonin kostot dhe hapësirat e tepërta. Për këtë është e mundur të shikohen përqasje tradicionale në filozofi e në gjendjen fizike të shumicës së shkollave sot. (Pasalar, 2003)

Massimo Zini në Milano të Italisë ka organizuar një shkollë rreth asaj që duan fëmijët e vegjël "Shkolla ose qendra e mësimit është një ambient në ndryshim të vazhdueshëm ku dizajni, mobilimi, sistemet, ndërthuren dhe duhet të lejojnë aktivitete të ndryshme, në të njëjtin vend

në kohë të ndryshme të ditës, pa përcaktuar një program, por të bazuar në vendimet e bëra nga fëmijët e mësuesit e një momenti të caktuar." (Zini, 2005)

Një shembull ku arkitekti bashkëpunon ngushtë me fëmijët, i cili e sheh shkollën një "habitat i vetë projektuar dhe si një proces ndërthurje midis mësuesve, nxënësve, e prindërve, si një pjesë aktive e jetës për të gjithë ata që u përket" është, i cili dizajnoi një skemë ku përdori vizatimet e modelet e nxënësve, dhe argumentonte që "një koncept i ri për shkollën, një që ndryshon në kohë, demonstron ide të qëndrueshmërisë, dhe ka një formë të ndryshueshme, duke u bazuar ne kreativitetin e fëmijëve dhe mësuesve," dhe kjo është e nevojshme për shkollën e shekullit të XXI. (Hubner, 2005)

> "Klasat në dy anët e korridorit po tjetërsohen duke shkuar drejt asaj që quhet 'rruga e mësimit." (Figura 20) Është konsideruar të funksionojë jo vetëm si një mjet për të kaluar nga një vend në tjetrin por edhe si një katalizator i marrëdhënieve sociale, vend interaktiv, takimi, biseda, studimi, diskutimi, shplodhjeje. Ndryshe nga një korridor një 'rrugë mësimi' i ngjason një rruge qyteti, e cila përmban një varietet të madh hapësirash e vendesh ku ti mund të zgjedhësh aktivitetin që do të besh, hapësira ku produktet e materialeve të mësimit janë të ekspozuara si në market, vende ku nxënësit praktikojnë aftësitë e tyre duke iu ofruar shërbime komunitetit, dhe ku vendet e futura e të veçuara bëhen të favorshme për të ndihmuar interaksionin social. Një rrugë në vend të një korridori, shtëpi në vend të klasave, një holl qyteti, jo zyrash. Një fshat, në fakt me një teatër e me një hotel". (Hubner, 2005)

Peter Hubnere më këtë mendim në mendje projektoi shkollën "Evangelische Gesamtschule Gelsenkirchen" dhe po më këtë llogjikë edhe arkitekti Norman Foster me Capital City Academy, 2003 "një shtyllë kurrizore qendrore organizon gjithë ndërtesën, duke formuar një rrugë të bollshme të brendshme që kalon përgjatë gjithë shkollës që të lejojë ndërlidhje vizuale dhe interaksion në një ambient të brendshëm e të mbrojtur". (Foster, 2003) (Figura 20). Me këtë parim arkitekti Foster ka qenë për disa nga shkollat e tij të projektuara në vitet 2000-2005. I po këtij mendimi është edhe arkitekti Zvi Hecker i cili shprehet: "Shkolla është një qytet brenda qytetit. Rrugët e saj takohen nëpër sheshe, dhe sheshet bëhen oborre. Muret e shkollës gjithashtu ndërtojnë pasazhe, rrugë, rrugica qorre. Pjesa e jashtme e shkollës është gjithashtu pjesa e brendshme e qytetit, pasi shkolla është vetë qyteti… Dizajni hap petalet e tij për të formuar një qytezë për fëmijët". (Hecker, 2000)

Shumë studiues nuk e mbështesin këtë tip shkolle duke e krahasuar si një rikthim të "shkollës së vjetër", me korridore në mes. Fëmijës nuk i jepet fare privati dhe janë të shqetësuar për mungesën e rregullit, disiplinës dhe kontrollit të sigurisë në shkollë.

Një zhvillim të madh në fushën e komfortit termik dhe të ventilimit ishte kthimi në metodat tradicionale të ventilimit natyral, diellzimit natyral të kombinuara me sistemet moderne e standardet e komfortit. Dy dekadat e fundit u kanë dhënë shkollave ndriçim natyral por ende të pakontrolluar mirë për sa i përket sasisë së ndriçimit dhe komfortit te syrit. (Baker, 2012, f. 23)

Deri në vitet 1990 shkollat ngjanin njësoj në të gjithë vendin. Vetëm mbas 2000 filloi një lëvizje e lehte drejt dizajnit që njeh kulturën lokale, dhe trashëgiminë, dhe që përfshin

materialet dhe resurset e zonës në projektim. Ndërsa në vitet 2000 një princip bazë për shkollën u bë marrëdhënia mes shkollës, ekologjisë e ambientit. (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)



Figura 20. *Majtas: Shkolla Capitol City Academy" e arkitektit Norman Foster, (2000-2003), Londër, Djathtas: Shkolla" Evangelische Gesamtschule Gelsenkirchen" e Peter Hubnet, 1997-2004*

# PËRFUNDIME 1

Në kapitullin e parë studimi analizon arkitekturën e shkollave në botë, si dhe rëndësinë mjaft të madhe që ka kjo arkitekturë në edukimin e fëmijëve, shpesh i quajtur si mësuesi i tretë.

Kjo pjesë konsideron potencialin e transformimit të shkollës duke u bazuar te efektet e dizajnit të shkollës në procesin e marrjes dhe dhënies së mësimit. "Por ndryshimet duhet të shikohen jo vetëm nëpërmjet ndryshimit të një ndërtese por në tërësi nga politikat dhe axhenda e ndryshimeve në reformimin e edukimit, të cilat sugjerojnë se ndryshimet në një ndërtesë mund të jenë fragmentare e të variushme. Zhvillimi i një mjedisi shkolle konsiston në një ndërveprim dinamik midis vendit dhe praktikave të kryera në atë vend." (Woolner, 2010, p. 79)

Në kapitullin e parë u prezantua një analizë e literaturës që lidhet me arkitekturën e shkollave. Analiza ekzaminon se si shkrimet dhe studimet rrotullohen rreth faktorëve që kanë impakt në dizajnin e shkollës, lidhjen midis kushteve të mjedisit edukativ dhe procesit të marrjes dhe dhënies së mësimit, si dhe elementëve kryesorë që merren parasysh gjatë procesit të projektimit të shkollës. Gjithashtu në këtë kapitull bëhet një analizë e zhvillimeve historike nëpër botë në mënyrë që të kuptohet rrjedha kronologjike e grupimi i këtyre zhvillimeve në 100 vitet e fundit.

Në fund të kapitullit kërkimi hedh një vështrim të shkurtër historisë së evoluimit të shkollave e të ndërtesave të tyre në shekullin e fundit dhe fokusohet veçanërisht, në etapat kryesore të historisë së arsimit, në pedagogjinë e reformat e ndodhura në arsim e gjithashtu në disa prej ndërtesave kryesore që përbëjnë themelin e historisë se godinave arsimore. Njohja me ndryshimet e vazhdueshme dhe ecurinë e dizajnit të shkollave është një hap i domosdoshëm pasi na reflekton dhe na mëson mbi gabimet, idetë, teoritë e mëparshme që nuk kanë funksionuar në ndërtimin e shkollave. “Kërkesat e shkollës kanë ndryshuar me kalimin e kohës, nëpër principe të ndryshme nga nevoja për ajër të pastër, më pas të dëshira për të ndërtuar shpejt te kërkesa për të dhënë sipërfaqe të mëdha te mënyrat e ndryshme të të mësuarit.” (Baker, 2012)

Analiza dhe zhvillimet nëpër botë të trajtuara në kapitullin e parë janë thelbësore e të nevojshme për të kuptuar, analizuar, e vlerësuar evoluimin e shkollës Shqiptare e të ndërtesave arsimore në vazhdën e këtyre forcave të jashtme. Karakterizimi i arkitekturave nëpër botë na jep pikat referuese dhe etapat konkrete për të krijuar një elaborat të arkitekturës së ndërtesave arsimore në Shqipëri e për të krahasuar nëse këto dy arkitektura ndërlidhen, afrohen, ngjasojnë apo kundërshtojnë a nuk përkrahin absolutisht njëra tjetrën.

Nga analiza e literaturës evidentohen faktorët kryesorë që merren për tu studiuar si mosha e shkollës, madhësia e ndërtesës, madhësia, forma, ngjyrat, mobilimi i klasës, korridoret, qarkullimi etj., faktorë të dizajnit.

Ledita Mezini

# KAPITULLI 2

## VËSHTRIM HISTORIK I ZHVILLIMEVE ARSIMORE NË SHQIPËRI

### Hyrja

*"Historia e ndërtimit të shkollave është ajo e një kërkimi të kujdesshëm, e standardizimit si dhe e dizajnit të mirë llogaritur." (Baker, 2012)*

Duke qenë se nuk mund të studiosh arkitekturën e një grupi të madh godinash pa kaluar fillimisht një vështrim mbi historikun dhe zhvillimin e këtyre objekteve nëpër periudha të ndryshme kohore, qëllimi i këtij kapitulli është të kërkojë gjurmët e ndërtesave të para të arsimit në Shqipëri dhe të hedhë dritë mbi arsimin, arkitekturën e ecurinë e zhvillimit të kësaj tipologjie prej nisjes, duke vazhduar me shekullin e XX-të që korrespondon me kohën kur shkolla shqiptare mori një morfologji e karakter të mirëfilltë, për të përfunduar në situatën e këtyre ndërtesave në ditët e sotme.

Objektivi kryesor i kësaj pjesë është të evidentojë zhvillimet kronologjike, ngjarjet, e pikat kyçe të historisë së shkollës Shqiptare paralelisht në dy këndvështrime: formimi dhe përhapja e shkollës Shqipe në vazhdën e historisë në konceptin e gjuhës, si dhe shkolla Shqiptare si ndërtesë e si strukturë që mbarte arsimin Shqiptar.

Historiku i ndërtesave të arsimit në vendin tonë tregon se ato kanë një arkitekturë të lidhur ngushtë me luftërat që ka kaluar vendi, pushtimet e huaja, influencat, ndryshimet politike, sociale, kulturore etj., dhe pikërisht kjo pjesë kërkon te kuptojë se si ka nisur historia e këtyre ndërtesave e se si është zhvilluar, problematikat, çështjet, objektet kryesore si dhe luhatjet nëpër vite.

Studiuesi Hajrullah Koliqi në librin e tij "Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar", mendon se mund të ndahet në katër etapa kryesore: periudha e kohës së vjetër, periudha e kohës së mesme, periudha e kohës së re dhe periudha e kohës më të re. (Koliqi, 2002, f. 26). Ndërsa sipas studiuesit Neritan Ceka arsimi në Shqipëri mund të ndahet në dy periudha: atë parahistorike në rendin e bashkësisë primitive ku më shumë i kushtohej kujdes edukatës (mësimit të zanateve, veglave nga njëri te tjetri), më pas periudha e dytë kur edukata dhe arsimi kthehen në veprimtari të mirëfilltë, (Ceka, 2003, f. 13).

Të dy këta studiues e shohin këtë ndarje duke u fokusuar te arsimi por pa hedhur sytë konkretisht ndërtesave që e kanë mbartur atë. Arkitekti Maks Velo nga ana tjetër bën një ndarje mbi periudhat e ndërtimit në Shqipëri të cilat i grupon në pesë grupe:

1. Periudha e pushtimit Osman.
2. Periudha nga pavarësia deri në vitin 1939.
3. Periudha e pushtimit Fashist.
4. Periudha e komunizmit.
5. Periudha e demokracisë. (Velo, 2013, p. 56)

Ledita Mezini

Baballëku në temën e doktoratës krijon një ndarje tjetër të ndërtesave arsimore duke u nisur pikërisht nga normativat, nga teknikat, tipologjia e ndërtimit, etj. "Shtrirja në këto periudha ndikohet nga teknikat e ndryshme të ndërtimit, kodet e projektimit, ngjarje domethënëse historike e ekonomike. Referuar kohës së ndërtimit, dallojmë disa grupe të mëdha:

- Ndërtesa përpara vitit 1944 (përpara Luftës së Dytë Botërore);
- Ndërtesa në vitet 1945-1963;
- Ndërtesa në vitet 1964-1978;
- Ndërtesa në vitet 1979-1990;
- Ndërtesa pas vitit 1991. (Baballeku, 2014, f. 26)

Duhet pasur parasysh që fazat e ndërtimit nuk mund të jenë të prera dhe koncize pasi "si në çdo ndarje historike kufijtë janë artificiale dhe fazat e variueshme të ndryshimit, shfaqin elemente vazhdimësie." (Ian Grovenor, Catherine Burke, 2008) Pavarësisht kësaj në këtë kapitull ri-sillen ngjarjet më të rëndësishme të evoluimit të arsimit duke u fokusuar te ato momente historike që sollën ndryshime në dizajnin e ndërtesave edukative.

Megjithëse janë bërë ndarje të ndryshme nga studiues të shumtë zhvillimin ose zanafillën e tyre shkollat shqiptare e morën kryesisht në fillimin e shekullit të XX-të duke u formuar e marrë një karakter të plotë, në periudhën e pushtimit fashist për tu zhvilluar, tipizuar, e standardizuar në masivitet në periudhën e regjimit Komunist.

"Çdo periudhë ka pasur studimet e saj të veta mbi ndërtesat e shkollave dhe çdo periudhë ka pasur teknologjitë e saj të inovacionit, dhe çdo periudhë ka pasur si synim të projektojë shkolla më të mira për të mësuar për fëmijët... por është e rëndësishme të shikohet mbrapa te eksperiencat e shkuara në mënyrë që të nxirren mësimet e duhura për të ardhmen." (Baker, 2012, p. 25)

## 2.1 ZHVILLIMI I ARSIMIT PREJ FILLIMIT DERI NË SHPALLJEN E PAVARËSISË

Të dhënat arkeologjike dhe historike mbi arsimin në Shqipëri tregojnë se gjurmët e para të arsimit në Shqipëri datojnë që në periudhën parahistorike. Mbas mesit të shekullit të parë p.e.s. politika romanizuese futi në masë të gjerë në qendrat e krijuara, shkrimin, edukatën e kulturën latine. Në qendrat ilire janë gjetur mbetje të gjimnazeve[1] te cilat përgatisnin fëmijët nga ana e stërvitjes, e gjurmë të *stilos*[2]. (Ceka, 2003, f. 16)

Gjithsesi sipas studiuesve të shumtë, ilirët ashtu si dhe shqiptaret ndër vite nuk studionin nëpër shkolla duke mos dashur të mësonin nën vazhdën e të huajve gjuhën romake e helene, por merrnin edukatë e arsim në mënyrë popullore. Kjo veçori ka sjellë që përgjatë ecurisë së viteve, arsimi dhe shkollat shqiptare të lindin shumë vonë. "Me sa dimë gjer sot, në rendin e komunës primitive ilire, nuk ka pasur institucione autentike të posaçme arsimore, shkolla."- (Dedja, 2003, f. 38).

[1] Gjimnazet ishin institucione shtetërore në të cilat shkonin djemtë e familjeve të larta skllavopronare rreth moshës 15/16 vjeç.

[2] Lloj pene për të shkruar fëmijët e moshës 7-12 vjeç. (Ceka, 2003)

Dedja shprehet se “Lindja e institucioneve arsimore e shkollave është një dukuri e rendit skllavopronar që sipas të dhënave arkeologjike përkon me ngulmimet e kolonive helene. Prandaj në qytetet ilire bëhet fjalë për shkolla elementare private, palestra, *efebe*[3], dhe gjimnaze, të cilat nuk u huazuan mekanikisht por u krijuan nën ndikimin e sistemit të lashtë arsimor të Greqisë, që ishte më i përparuari për kohën , thuajse në të gjithë botën.” (Dedja, 2003, f. 39)



Figura 21. *Manastiri i Ardenicës*[4]*. Burimi: IMK*

Periudha e mesjetës i gjen shkollat dhe arsimin të lidhura ngushtë me kishën e krishterë, e më pas me atë të institucioneve fetare islame. (Figura 21) “Qytet shqiptare me karakter oriental u kthyen në struktura urbane kompakte, kaotike mesjetare shumë afër me skemat e qyteteve myslimane ku njësitë mbizotëruese janë ndërtesat 1-2 katesh private, ndërtesat publike fetare si xhami o ndonjë kishë ortodokse ose katolike dhe në rang të tretë ndonjë hapësirë publike tregtare e artizanale”. (Vokshi, 2014).

Ndërkohë që arsimi në Shqipëri ashtu si dhe në botë lindi nga vendi i kultit. Studiuesi Dedej shkruan “Arsimin vazhdon ta ketë në dorë kleri. Në këtë periudhë, në Shqipëri funksionojnë tre shkolla të ndryshme: Shkolla katolike në veri, ortodokse në jug, turke në tërë Shqipërinë.” (Dedej, 2003, f. 64). “... më 1745 në lagjen e vjetër të Tophanë funksiononte fshehtazi një shkollë shqipe me 30 nxënës me mësues Jakë Kolë Kamsi. Shkolla ishte nën ndikimin e klerit por mësimi ishte laik.” (Kazazi, 2014, f. 14) Me gjithë tendencën për të hapur shkolla Dedej mendon se politika arsimore që zbatuan për 500 vjet pushtuesit osmanlinj të cilët vinin fenë mbi gjithçka, ishte një goditje e rëndë për kulturën dhe shkollën tonë. “Kulturat e shkollave Shqiptare nuk njiheshin.” (Dedej, 2003, f. 45)

Evlija Celebi (1611-1684) udhëtar i huaj i përshkruan qytetet Shqiptare e jep të dhëna mbi karakteristikat e tyre kulturore e historike “me dhjetëra xhami dhe pranë çdo xhamie nga një medrese”. (Kazazi, 2014, f. 30) (Figura 22)

---

[3] Në moshën 18 vjeçare fillonte periudha e efebisë e zgjaste deri në 20 vjeç ku merreshin me edukim fizik e ushtarak, nëpër gjimnaze (Gymnasium) dhe në reparte ushtarake kufitare (peripole).
[4] Manastiri i Ardenicës është i tipit Bizantin –Ortodoks. Kompleksi ka një sipërfaqe rreth 2500 m2 dhe përbëhet nga kisha e Shën Mërisë, kapela e Shën Triadhës, konakët, mulliri vajit, furra, stalla, etj.



Figura 22. *Teqeja Helveti, Berat.* [5] *Burimi: IMK*

Perandoria Osmane në Shqipëri nuk pranonte që kishte Shqiptarë e pikërisht përkatësinë fetare e përdorte për të përcaktuar kombësinë, duke i ndarë shqiptarët si vijon: 1. Myslimanë, të cilët i quante turq e mund të mësonin në shkollat turke, mejtepe e medrese; 2. Ortodokse, të cilët i quante rum (d.m.th. grekë), të cilët mund të ndiqnin shkollat greke; 3. Katolikë të cilët i quante latinë e mund të arsimoheshin në shkollat e klerit katolik. (Figura 23), (Bakiu, 1998, f. 139) Gjithsesi Bakiu thekson se Perandoria Osmane nuk kishte arsim të organizuar nga shteti.



Figura 23. *Manastiri i "Shën Mërisë së Fjetur", Pojan, Apolloni, Shek. XII-XIV, Manastir Katolik. Burimi: IMK*

Koliqi se bashku me autorë të ndryshëm theksojnë se një nga shkollat për tu përmendur të kësaj periudhe është 'Akademia e Voskopojës' që fillimisht u hap si shkollë fillore e më pas më 1744 u kthye në shkollë të mesme. Kjo shkollë "Akademia e Re" e cila u bazua në modelin evropian ku mësohej letërsi greke, latine, filozofi, teologji etj., u shqua për futjen e metodave bashkëkohore në arsim dhe u njoh në rang ballkanik. (Koliqi, 2002, f. 114) Përveç shkollës së akademisë u shtuan edhe ndërtesa e shtypshkronjës, bibliotekës së pasur e ndërtesa të tjera të cilat dëshmojnë për rëndësinë dhe vlerat që dha në arsim kjo shkollë.[6]

Të kësaj periudhe mund të përmenden se në të tre pashallëqet Shqiptarë, atë të Shkodrës, Janinës dhe atë të Misirit kishte tendenca për hapjen e shkollave si: në pashallëkun e Shkodrës ishte "kompleksi arsimor kulturor" që ishte i lidhur me lulëzimin e pashallëkut të Bushatlinjëve. Ky kompleks rreth viteve 1760-1770 përfshinte medresenë, konviktin (internatin), bibliotekën. "Që në kohën e Bushatlijve u hap në Shkodër nga Mehmet Pashë Bushati (Plaku), rreth viteve 1760-70, Medreseja në Lagjen Qafë dhe më vonë pranë Xhamisë së Madhe në Pazar që iu vu emri Medreseja e Pazarit. (Figura 24) Më pas kemi mejtepin Ruzhdije Asqerije tek furra e Bejlikut." (Kazazi, 2014) "Kjo ndërtesë edhe pse ishte sipas

[5] Daton më 1492-1493. Sipas të dhënave ngjitur me të ka qenë biblioteka e cila lidhej me Mafilin e teqese. Ndërtesa e bibliotekës u dogj gjatë Luftës së Parë Botërore. Prania e bibliotekës ngjitur na tregon se ndërtesa ka qenë jo vetëm objekt kulti por edhe shkollë për të mësuar të rinjtë e fesë myslimane.

[6] Akademia, shtypshkronja, biblioteka etj. u dogjën në mënyrë të mistershme më 1767.

modelit të lindjes dhe e tipit oriental, edhe pse medreseja ishte fetare dhe mësimi zhvillohej në gjuhën turke, etj., ndikuan në ngritjen kulturore dhe arsimore jo vetëm të Shkodrës por dhe të trevave të tjera." (Osmani, 1994)



Figura 24. *Pamje e jashtme e Medresesë dhe bibliotekës së saj në Shkodër.*
*Burimi: AQSh*

Në pashallëkun e Janinës së Ali Pashës mund të përmendim shkollën e mesme eprore 'Kolegji Marruci' dhe medresenë e Janinës. (Koliqi, 2002)

Ndërsa për shumë studiues zhvillimi i arsimit nën ndikimin islam nuk përbën zhvillim pasi shkolla ishte nën influencën fetare, duhet të pranojmë se të gjitha faktet tregojnë qartë se këto "shkolla" ishin një hap përpara në zhvillimin e kulturës së arsimit dhe se këto ishin gjurmët e para të ndërtesave të shkollave në Shqipëri. "Në fund të shekullit XVI pushtuesit hapën shkollat e para turke, ndërsa në shekullin XVII numri i këtyre shkollave u rrit me shpejtësi. Nga mejtepet (shkolla fillore), më vonë hapen një numër i konsiderueshëm medresesh (në nivelin e shkollave të mesme)". (Dedej, 2003, f. 68) Pavarësisht se ne thelb "medresetë ishin institucione islame kishin për qëllim me veprue mbi të gjitha klasat njerëzore dhe me shpërnda dituritë..." (Kazazi, 2014, f. 36)

Pranë shumë ndërtimeve të kultit (myslimane ose katolike) janë gjetur mjedise bibliotekash dhe nuk mund të kuptohet jeta dhe veprimtaria e shkollave pa libra. "Shpesh kuptohet që ndërtesa ka funksionuar edhe si institucion arsimor pikërisht nga prezenca e bibliotekës shkollore." (Kazazi, 2014, f. 121)

Lidhur me arsimin dhe mendimin pedagogjik Albano- Shqiptar duke filluar që prej lashtësisë më pas atë të periudhës mesjetare e më vonë të humanisteve, Koliqi mendon se ishte pjesë integrale e arsimit dhe mendimit pedagogjik evropian, kryesisht në shkollat katolike dhe ortodokse. (Koliqi, 2002, f. 387)

Megjithëse shkollat, (kishat, xhami, medresetë, mejtepet manastiret e famullitë, etj.,) kishin karakter fetar dhe librat ishin të shkruara jo në gjuhën Shqipe, përsëri shumica e mësuesve ishin Shqiptarë e tentohej të flitej Shqip nëpër këto godina. Në mënyrë jozyrtare shkollat Shqipe kishin lindur që në periudhën e mesjetës dhe të gjitha këto ambiente laike ose jo mund të quhen si ndërtesat e para të shkollave Shqipe.

Pavarësisht se numrin më të madh të shkollave në Shqipëri e mbanin shkollat fetare myslimane pati edhe disa shkolla katolike të mbrojtura nga Protektorati i kultit Austriak mbi popullsinë katolike Shqiptare.[7]

Ndër urdhrat fetare Françeskane dhe Dominikane u ndërtuan mjaft shkolla në trevat shqiptare, ku mund të përmendet dhe Universiteti i Durrësit. Universiteti i Durrësit u hap në vitet 80 të shek. XIV, dhe ishte një ndër universitetet e para në Evropë.[8] (Koliqi, 2002, f. 53)

Disa prej shkollave katolike të shekullit të nëntëmbëdhjetë janë përmendur nga studiuesit Kazazi dhe Koliqi në krahinën e Shkodrës dhe zonën e veriut:

- Vitet 1854-1855 mund të quhen fillimi i shkollës Fretnore në Shkodër. “Kështu u përshtat një shtëpi me dy dhoma në mëhallën Gjuhadol, të falur prej njerëzve bamirës katolik”. (Kazazi, 2014) Më pas “Seminari Françeskan”, u bë një shkollë fillore mjaft e njohur dhe në vitin 1871 u fut gjuha Shqipe si lëndë e më pas në 1902 u kalua nën drejtimin e Gjergj Fishtës si shkollë tërësisht në gjuhën Shqipe. Mbi bazën e shkollës Fretnore u krijua në vitin 1921 Gjimnazi “Illyricum” në bazë të Urdhërit Franceskan. (Figura 25)
- Më 7 shkurt 1859- u hap “Kolegjia Papnore Shqiptare” që synonte të përgatiste klerikë katolikë. Drejtohej njësoj si Kolegji Saverian nga Urdhëri i Jezuitëve.

Ledita Mezini

---

[7] 1739- iu dha Hazburgërve një patentë e posaçme e trashëguar nga Venediku për mbrojtjen e katolikeve të Evropës.
[8] Në 1365, në Vjenë ishte hapur Universiteti i parë Gjerman.




Figura 25. *Pamje e Kolegjias Françeskane, Shkodër, Studio Marubi. Ndryshe është quajtur edhe shkolla fretnore. Burimi: AQSh*

- Më 1877 çelet në qytetin e Shkodrës 'Kolegja Saverjane e Jezuitëve' që në vitin 1888 pa frikë mund të quhej një gjimnaz i vërtetë. (Figura 26) Shkolla u quajt Kolegja e Shën Françeskan Saverit e deri ne 1888 u mbajt me fonde private me pas në kuadër e ndihmës ekonomike për katolikët në Shqipëri u akordua një fond nga Austria. Gjatë jetës së tij ka pasur profile të ndryshme reale, teknike, tregtare, normale, por gjithmonë në epiqendër kishte tiparet e gjimnazit klasik. (Kazazi, 2014)



Figura 26. *Kolegji Saverjan Jezuit , me rastin e 50 vjetorit të krijimit të tij. Foto Marubi. 1927. Burimi: AQSh*

- 1856- themelohet 'Shkolla e Parë Evropiane' (Koliqi, 2002, f. 148)

- Në vitin 1879 Motrat Stigmatine çelën të parën shkollë fillore për vajza. (Kazazi, 2014, f. 20), (Figura 27)



Figura 27. *Nxënëse të shkollës Selezjane në Shkodër, Shkollë fetare për vajzat nga Motrat Stigmatiane. 1923. Marrë nga AQSH.*

Sipas Studiuses Anne –Maire Chatelet "Shkollat publike në Evropë u zhvilluan shumë në shekullin e XIX-të, pasi vendosja e demokracisë dhe e drejta e votës kërkoi që cdo person të dinte të lexonte dhe të shkruante." Në bazë të këtij motivi shumica e shteteve europiane u përkushtuan shumë në perpjekjen për të edukuar fillimisht popullsine mashkullore e më pas atë femërore. "Edukimi në Europë e në Shqipëri shkoi paralel me procesin e kthimit të arsimit laik, me mësues të profesionit në vend të atyre fetar, dhe duke vendosur shkollat në godina të tjera e jo më në kisha." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Zhvillimet e arsimit lidhen gjithashtu me evoluimin e qyteteve të cilat kishin krijuar nevojën e mësimit praktik jo vetëm të gjuhës kombëtare, por edhe të gjuhëve të huaja në radhët e borgjezisë dhe të shtresave të pasura të qytetit që e shikonin këtë si rrugë për zhvillimin e tregtisë dhe të komunikimit me botën. (Kazazi, 2014, f. 15) Në Shqipëri vihen re të njëjtat paralelizma ku gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1830-1912) në vitet '30-'80 të shekullit XIX, u krijuan dy tip shkollash: ato te posaçme për bijtë e borgjezisë dhe të tjera për fëmijët e masave punonjëse. Ndërkohë që shkollat e fëmijëve të pasur paraqiten si komplekse ndërtimore shumë më të mira e me kushte të favorshme".... Shkollat fillore, ku mësonin fëmijët e masave punonjëse vazhduan të mbeten në një gjendje të mjerueshme, megjithëse borgjezia disa herë shpalli arsimin e detyruar fillor."- (Dedej, 2003, f. 91)

Përveç shkollave me karakter fetar në vitet 1800-1861 numëroheshin 12 shkolla (8 për djem dhe 4 për vajza) me karakter praktik- institucione arsimore që lidhen me aftësimin profesional (zejtar), siç quhet 'dhënia e zanatit' që nga koha e 'esnafeve', si për shembull shkolla e Gasper

Benusit.[9] (Kazazi, 2014, f. 114) Në periudhën e Rilindjes, shumë patriotë Shqiptarë tentuan të përhapnin arsimin nëpër vend e të ndryshonin disi shifrat alarmante të analfabetizmit në Shqipëri. “Në vitet 1840 rreth 98% e popullsisë ishte analfabete.” (Dedej, 2003, f. 90)

“Sipas të dhënave të fundit të shekullit XIX, në të katërt vilajetet e atëhershme: të Shkodrës, Kosovës, Manastirit, dhe të Janinës, në të cilat shqiptarët përbënin një tërësi kompakte dhe shumicën e popullsisë, kishte: 1187 shkolla në gjuhën turke, nga të cilat 1125 shkolla fillore, 57 plotore, dhe 5 të mesme, më shumë se 1000 shkolla në gjuhën greke dhe mbi 300 shkolla në gjuhën serbe, bullgare etj., pa përmendur shkollat në gjuhën italiane, që mbanin Austro-Hungaria dhe Italia.” (Myziri, 2003, p. 123). I po këtij mendimi është dhe Koliqi i cili deklaron: “Shkollat që mbizotëronin ishin shkolla fillore në gjuhën turke, greke, shkolla katolike në gjuhën italiane, bullgare, serbe, vllahe etj. (Koliqi, 2002, f. 140)

Të dhënat e vitit 1898 (1316) tregojnë se shkollat në gjuhën turke ishin [10]:

- Shkolla fillore (të para me 4 klasë, *iptidaije)* kishte në Janinë (128 cope), Manastir (451 copë), Shkodër (101 copë), Shkup (445 copë)
- Shkolla të dyta *(ruzhdije,* ose qytetëse me 3 klasë), kishte në Janinë (11 copë), Manastir (17 copë), Shkodër (5 copë), Shkup (24 copë). (Figura 28)



Figura 28. *Fotografi e nxënësve të shkollës (mejtebe) Ruzhdije në Shkodër,1876. Shkollë e dytë me tre klasë. Marrë nga AQSH.*

- Shkolla të mesme të larta me 4 klasë *(idaije)* kishte në Manastir, 2 copë dhe nga 1 në Janinë, Shkodër dhe Shkup. (Shkollat e mesme ishin te llojit gjimnaz civil, shkolla ushtarake, ose shkolla normale për përgatitjen e mësuesve).

[9] Gjergj e Gaspër Benusi me 1836 hapën një shkollë me sistem didaktik. Gaspri me vdekjen e të atit e vazhdoi shkollën edhe për 12 vjet në shtëpinë e tij. (Kazazi, 2014, f. 16)

[10] Ditërrëfenjësi kombiar, Sofie, Mot’ I katërt, 1900, fq 153-154. Cituar nga (Koliqi, 2002)

Ndërsa në gjuhën greke kishte mbi 1000 shkolla të cilat ndaheshin në: shkollat e shkallës së parë, shkollat e shkalles së dytë- (licetë) dhe shkollat e shkallës së tretë- universitetet [11], në gjuhën vllahe 40 shkolla, atë bullgare dhe serbe 20-30 shkolla në gjuhën shqipe kishte vetëm 2 shkolla në qytetin e Korçës. (Figura 29)




Figura 29. *Shkolla Greke në Durrës, Burimi: Arkiva Qendrore e Shtetit.*

Shkolla ku është mësuar gjuha shqipe dhe shkolla të hapura nga shqiptarët ka pasur edhe para vitit 1887 e janë të evidentuar nëpër dëshmi të ndryshme të historisë por për ekzistencën e shkollave shqipe nuk ka të dhëna konkrete përpara datës 7 mars 1887 ku u hap "mësonjëtorja e Korçës, e cila përfaqësonte të parën shkollë fillore Shqipe me fizionomi të plotë kombëtare, laike dhe demokratike." (Myziri, 2003, p. 133).[12] Kjo shkollë kishte për bazë shkencën dhe synimin për të nxënë sa më shumë dije. (Figura 30) Shkollat që u hapën në këtë periudhë ishin me vajza dhe djem së bashku, nxënës të moshave të ndryshme, shpesh edhe të rritur, të gjithë të grupuar në një klasë thjesht me dëshirën për të mësuar.

Periudha e Rilindjes e fundi i shekullit te XIX fillimi i shekullit XX korrespondon me atë që ishte shpërthimi i shkollave shqipe, shpesh duke marrë edhe godinat e shkollave të Austro-Hungarisë e të Italisë për të futur nxënës te gjitha feve e krahinave. "...më 1900 mësuesit e huaj u larguan nga shkolla." (Myziri, 2003, p. 161) Sipas Bedri Dedjas i cili është marrë me studime të mendimit pedagogjik të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, patrioti Babë Dudë Karbunara shënonte në "Ditarin" e tij: "Nuk do te presim të bëhen ndërtime shkollore , por do te punojmë që shkollat të funksionojnë në shtëpitë e qytetareve." (Dedja, 2003, f. 236)

[11] Historia e kombit grek, vellimi 5, Athinë, 1975 fq 52 – Cituar nga (Koliqi, 2002)
[12] Shkolla u vendos fillimisht në godinën e shtëpisë së zotit Diamandi Terpos i cili e dhuroi për shkollë.




Figura 30. *Mësonjëtorja shqipe e djemve në Korçë, 1899. Burimi: AQSH*

Për dhurimin e mjediseve për ndërtimin e shkollave na tregon edhe historiani Bakiu i cili përmend mësuesin Filip Ashikun i cili paguhej nga Austro-Hungaria. “Shkolla fillore u hap më 28 Nëntor 1898, në shtëpinë e Osman Elezit (ndërtesë e shembur, afërsisht aty ku gjendet hotel Miniri, në Tiranë.)” (Bakiu, 1998, f. 142) Provë për hapjen e shkollave nëpër shtëpitë e qytetarëve janë dokumentet të cilat tregojnë emra të ndryshëm të banorëve të Tiranës të cilët jepnin banesat për shkollë si; Refik Toptani i cili hapi shtëpinë e tij të pritjes për shkollë, kurse Murat Toptani vendosi shoqërinë ‘Bashkimi” në shtëpinë e tij. Gjithashtu u bënë përpjekje për të hapur shkollë e në shtëpitë e farmacistit Anton Hercek në 1909. (Bakiu, 1998, f. 143)

“Mësonjëtorja e vajzave në Korçë’ që u hap më tetor 1891 nga Gjerasim dhe Sevasti Qiriazi ishte një nga shkollat e para në gjuhën shqipe për vajza. Ajo u vendos fillimisht në një shtëpi private dhe më vonë u bë dhe një konvikt. “Shtëpia e Gjerasim Qiriazit e përshtatur në shkollë nuk i plotësonte kërkesat.” (Dishnica, 1997, fv. 36-37). Dy shkollat e Korçës ajo e djemve dhe ajo e vajzave (Qiriazi) ashtu si dhe shumë shkolla të tjera në këtë periudhe u shtuan në numër nxënësish dhe lindi kërkesa për hapësira e shtesa gjithmonë e më shumë. Në këtë periudhe shkollat kërkonin edhe konvikte për shkak se shpesh nxënësit vinin edhe nga larg. (Figura 31)

Fillimi i shekullit të XX korrespondon me çeljen e klubeve-(organizata të gjëra demokratike, si shoqëri patriotike) të cilat u morën gjerësisht me përhapjen e arsimit në Shqipëri. ‘Klubet u bënë nismëtare për çeljen e shkollave dhe të kurseve në gjuhën Shqipe. Ata kujdeseshin për sigurimin e fondeve të nevojshme për mbajtjen e tyre, për lokalet e personelit pedagogjik,...etj.” (Myziri, 2003, p. 175). Një element interesant ishte fakti se shkollat nuk punonin vetëm ditën për nxënësit por edhe gjatë natës për të mësuar shkrimin e leximin brezave më të rritur. Nocione si shkollë dite dhe shkollë nate u bënë jashtëzakonisht të përhapura në këtë periudhë e u

finalizuan me Kongresin e Manastirit të 1908, i cili- "kërkonte të shtoheshin shkollat në Shqipëri dhe të përhapej arsimi".(Myziri, 2003, p. 187). I rëndësishëm është edhe Kongresi Kombëtar Arsimor i Elbasanit më 25 mars 1919 ku mes pikave te ndryshme ishin: 1- Çelja e shkollave të reja shqipe, përcaktimi i numrit dhe i vendit, 2- Çelja e një shkolle normale, 3- Mënyra se si do mbaheshin shkollat, 4- Programi dhe struktura e shkollave Shqipe, etj. (Myziri, 2003, p. 197).



Figura 31. *Mësonjëtorja e vajzave në Korçë, motrat Qiriazi. 1891, Marrë nga AQSH*

Në këtë kongres u përcaktuan numri i klasave, ndarja për herë të parë në cikle; fillore, gjysmë të mesme dhe të mesme. U diskutua përsëri mbi baza teorike mbi krijimin e sistemit të arsimit të mesëm profesional, shkollave bujqësore, shkollave të zanateve. "Shkollat profesionale, bujqësore, tregtare, artizanale etj., duhet të lidheshin me praktikën e jetës për të përgatitur specialiste të fushave të ndryshme". (Dedja, 2003, f. 235)

Megjithëse nuk flitet fare nëpër shkrimet historike mbi arkitekturën e këtyre godinave është mjaft e rëndësishme të kuptojmë faktin se kërkesa për shkolla të reja, për mbarëvajtjen e tyre dhe në përputhje me programin dhe strukturën e shkollës ishin norma të spikatura që në këtë stad të arsimit Shqiptar.

Gjithsesi në këtë periudhë në Shqipëri u zhvilluan 3 tipa shkollash: Shkollat normale– të cilat përgatisnin mësues të rinj, shkolla fillore dhe disa shkolla profesionale. Përveç ambienteve të shkollës i kushtohej vëmendje dhe akomodimit të nxënësve dhe mësuesve prandaj shpesh në projektet e kësaj periudhe shkolla ishte një godinë ku zhvillohej mësim dhe fjetje.

Normalja e Elbasanit e hapur më 1 nëntor 1909 ishte e para shkollë e mesme kombëtare në vendin tonë dhe nisi me 50 nxënës nga gjithë vendet e Shqipërisë. (Figura 32) Nga të dhënat historike duke qenë se numri u shtua jashtëzakonisht shumë mësohet se shkolla nuk e përballonte dot ngarkesën e madhe të nxënësve: "Numri i nxënësve sot është aq i lartë"- shkruan konsulli austriak i Durrësit në maj 1910, "Sa në Elbasan nuk mund të gjenden as klasa mësimi aq të mëdha, por as vende për vendosjen e bursisteve." (Myziri, 2003, p. 205)



Figura 32. *Kongresi i Elbasanit në Shkollën Normale të Elbasanit. Burimi AQSh*

"Rilindësve u takon merita se hartuan të parët planet mësimore dhe programet e shkollave shqipe ..."- (Dedja, 2003, f. 239) Gjithashtu Rilindësit duke qenë se u edukuan në vende të ndryshme nëpër botë ishin të parët që tentuan të fusnin metodat e reja pedagogjike në të shpjeguarit të mësimit. "Rilindësit iu përmbajtën parimit të taktit të ngrohte pedagogjik me nxënësit, si dhe propaganduan metodat që lidhnin mësimin me natyrën, jetën dhe shoqërinë, si bazë për përgatitjen e brezit të ri .." (Jani Minga, citim) (Dedja, 2003, f. 240). I këtij mendimi është edhe studiuesi Koliqi i cili flet për metodat dhe pedagogjinë e Evropës Perëndimore, ku emra të rrymave pedagogjike ishin: Jan Amos Komenski, Xhon Luku, J.H. Pestalozzi etj. (Koliqi, 2002, fv. 388-389)

Rilindësit u përpoqën shumë për arsimin dhe ngritjen e shkollës shqiptare. Edukimi ose lëndët ndaheshin: edukimi fizik dhe shëndetësor, edukimi mendor, edukimi moral, edukimi kombëtar, edukimi religjioz, edukimi punues, dhe ai estetik. (Koliqi, 2002, f. 218)

Të gjitha këto të dhëna tregojnë qartazi se shkolla Shqipe, ashtu si dhe ndërtesat e shkollave nëpër botë, po niste hapat e saj si ide, si mendim dhe ende jo, si një arkitekturë a një ndërtesë e mirëfilltë mësimi.

## 2.2 ZHVILLIMI I ARSIMIT PREJ 1912-1925

Me krijimin e shtetit shqiptar më 28 Nëntor të 1912, arsimi trashëgoi tepër pak përvojë arsimore nga administrata e pushtimit turk. Për një kohë të gjatë deri vonë në Shqipëri funksionuan kryesisht shkolla të tipit të mejtepeve, të ngritura pranë xhamive..."shkolla Shqipe mbarte një histori të pasur, interesante, po aq dramatike dhe unikale." (Rama, 2005, f. 11)

Sipas studiuesit Kashari, "në vitin 1912, në Shqipëri kishte 250 shkolla fillore dhe disa dhjetëra plotore e numri i nxënësve që i vijonin ishte shumë i pakët. (Figura 33) Në çdo shkollë kishte

Ledia Merai

gati 20-30 nxënës. Në qytetet kryesore kishte nga një gjimnaz të vogël. Në ta mësonin gjithsej 200 nxënës." (Kashari, 2003, f. 265). Këto të dhëna informojnë qartë për numrin e vogël të nxënësve dhe të shkollave në Shqipërinë e pavarur e nënkuptohet që në këtë periudhë përparësi kishte përhapja e arsimit e jo një arkitekturë e menduar mbi këto ndërtesa.




Figura 33. *Shkolla Plotore në Lushnjë. Foto e vitit 1926. Burimi: AQSh.*

Ministri i parë i arsimit, Luigj Gurakuqi ishte një nismëtar i përhapjes së shkollave "krejt ndryshe në përmbajtje e formë nga shkollat e huaja, që kishin zotëruar gjatë pushtimit osman." (Kashari, 2003, f. 273), dhe gjithashtu një nismëtar i arsimit të detyruar për të gjithë. "Në vitin shkollor 1913-1914, u hapën dhe vepruan mbi 64 shkolla shqipe, nga të cilat afër 50 u takojnë fshatrave." (Kashari, 2003, f. 276) Në këtë periudhë iu kushtua vëmendje të veçantë hapjes së shkollave nëpër fshatra e pikërisht "në vitin 1913-1914 u hap edhe shkolla popullore e 'Rusit të vogël' e cila ishte shkolla e parë kombëtare në Shkodër pas luftërave ballkanike." (Koliqi, 2002, f. 322)

Shqipëria mbas një pushtimi gati 5 shekujsh kishte trashëguar një numër të madh shkollash fetare e kryesisht dy tip shkollash publike e laike: Shkollat fillore dhe shkollat Normale.

1- Shkollat fillore të cilat ishin me 3, 4 ose 5 vjet afat mësimi, ku shpesh 3 vite u takonin shkollave të fshatit ndërsa 4-5 qyteteve kryesore. Lëndët që zhvilloheshin në shkollat e fshatit ishin: Gjuhë shqipe, Këndimi, Aritmetikë, Këngë e Gjimnastikë, ndërsa në shkollat qytetëse lëndë të tjera ishin edhe Gjeometri, Gjeografi, Histori, Mësim sendesh, mësim qytetnor, Frëngjisht, Kaligrafi, e Vizatim. (Koliqi, 2002, f. 322)

Ledia Reziri



Figura 34. *Shkollë fillore në Durrës. Foto e vitit 1920. Burimi: AQSh.*

2- Një tip tjetër shkollash në vitet 1913-1914 ishin shkollat Normale ku përgatiteshin mësues të rinj. Të rëndësishme për kohën ishin Normalja e Elbasanit e Normalja e Beratit.

Lufta e Parë Botërore, korrespondon me një periudhë të vështirë për Shqipërinë e cila u gjend në mes shumë forcave të mëdha pushtuese. Tri kultura të ndryshme Euro-Perëndimore mbizotëruan në këtë kohë (Austro-Hungareze, Franceze dhe Italiane). Gjithashtu edhe Greqia duke e gjetur vendin në një situatë të vështirë kërkoi të kishte edhe ajo dominimin në territoret e saj.

Qeveria e Romës si dhe ajo Austro-Hungareze ishin të parat të cilat krijuan shkollat e huaja me frymë perëndimore në vendin tonë në këto vite. Megjithëse disa patriote shqiptare si Fan Noli e të tjerë nuk e mbështesnin idenë e shkollave të huaja, për shkak se gjuha Shqipe bëhej pak në këto shkolla, duhet pranuar se këta ndërtuan godinat e para të mirëfillta në funksion të mësimit e shpesh i kthyen edhe qendra të fshatrave të vegjël duke ofruar ambiente ndihmëse rreth saj, si ambulancë, dhoma pune, teatro shfaqjesh etj. Studiuesit mendojnë që shkollat e kësaj periudhe nëpër Evropë ashtu si edhe në Shqipëri, morën një pamje e fizionomi tjetër.

Nga të dhënat që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit në periudhën e viteve 1916-1918, (periudha e pushtimit Austro-Hungarez) kemi një numër të madh shkollash në gjithë vendin por kryesisht në qytet. Ndoshta fakti që arsimi fillor u bë i detyrueshëm për fëmijët 7-12 vjeç në fshat dhe 7-14 vjeç në qytet, solli hapjen e një numri të madh ndërtesash arsimore e kryesisht shkollash fillore. Ndërkohë në botë arsimi u bë i detyrueshëm rreth viteve 1900. (Baker, 2012)

Në vitin shkollor 1916-1917, vetëm në qytetin e Tiranës kishte 24 shkolla fillore. (Koliqi, 2002, f. 327) Ndërsa për sa i takon fshatit, shkrimet flasin për shumë banorë të cilët ofronin shtëpitë e tyre për ambiente shkollore. (Osmani, 2003, f. 329). (Figura 35)



Figura 35. *Në këtë ndërtesë më 19 gusht të 1921 bënin mësim rreth 39 djem. Burimi: (Muzeu Historik Kombetar, 2016)*

Pushtimi Austro-Hungarez kryesisht në zonat e Shkodrës, Elbasanit, Tiranës dhe Beratit, solli një unifikim të programeve mësimore në këto rrethe dhe të koncepteve të asaj që do ishte një shkollë e mirëfilltë, pasi jo vetëm u ndërtuan ndërtesa për mësim por edhe u futen hapësira për programe e mësime të ndryshme jashtë-shkollore e praktike. Shkollat që ishin nën influencën Austro-Hungareze përdorën metodat e pedagogjisë Herbartiane, "Artikulimi i mësimit sipas shkallëve formale të pedagogjisë Herbartiane ishin përgatitja, paraqitja, zhvillimi, përdorimi, ushtrimi" (Koliqi, 2002, f. 389)

Më 10 dhjetor të 1916, u shpall krahina autonome e Korçës e cila gjithashtu pati një ndikim të madh në arsimin Shqiptar. Nën influencën franceze më 25 tetor 1917 u hap një shkollë e mesme Liceu[13], e para shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm në vend. (Figura 36) Nga të dhënat historike rrjeti i shkollave në Korçë, ndonëse i pa konsoliduar përfaqësohej nga tri hallka kryesore arsimore: arsimin parashkollor (foshnjat), arsimi fillor (5-6 vjeçar për djem e vajza) si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm. (Osmani, 2003, f. 337)

[13] Liceu i Korçës ishte shkolla e parë e arsimit të mesëm të përgjithshëm në gjuhën Shqipe. Ishte shkollë me konvikt. Me 1921 u quajt Liceu Kombëtar, ndërsa sot Shkolla e përgjithshme 'Raqi Qirinxhi'. (Koliqi, 2002, fv. 328-329)

Ledia Mehaj



Figura 36. *Liceu i Korçës dhe nxënësit e tij në vitin shkollor 1922-1923. Burimi nga AQSH.*

Ndërsa në zonën e jugut influencën më të madhe e pati Italia. Gjatë vitit 1916-1917 rrjeti shkollor i krejt zonës së pushtuar nga Italia përfshinte 133 shkolla me 6123 nxënës. Në Vlorë dhe në Gjirokastër u ngrit edhe ndonjë shkollë gjysmë e mesme profesionale (agrare, zejtare, tregtare me gjuhë mësimi italishten.)

Pavarësisht vështirësive të shumta, gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) arsimi i mesëm në Shqipëri hodhi hapat e parë. Në vend punonin tre shkolla normale (Elbasan, Berat, Shkodër[14]), një lice (Korçë), një gjimnaz klasik (pranë Kolegjës Saveriane, Shkodër), dy shkolla tregtare (Gjirokastër dhe pranë Kolegjës Saveriane në Shkodër), dhe një shkollë qytetëse bujqësore (Vlorë). (Osmani, 2003, f. 358)

Një hap të rëndësishëm në arsimin Shqiptar, e dha Kongresi i Lushnjës[15] i cili përcaktoi programin e unifikuar e gjithashtu numrin e klasave. Në qytete, shkollat fillore do të ishin me 4 ose 5 klasë, ndërsa në fshat me 3 klasë. (Figura 37) Në qytete do të vepronin edhe shkollat 'qytetëse' me 3 klasë mbi filloren. Në disa rrethe do të vepronin edhe shkollat normale ose gjimnaze me 4 klasë. (Repishti, Kashari, & Osmani, 2003, f. 380) Pas Kongresit arsimor të Lushnjës, në gusht 1920, në Tiranë, është mbajtur një Kongres arsimor i organizuar nga ministri i arsimit Rexhep Mitrovica ku u miratuan tre tip shkollash: fillore, profesionale, të përgjithshme, dhe u vendos që shkolla të ishte laike, duke synuar ta shkëpuste atë nga feja. (Bakiu, 1998, f. 221)

---

[14] Normalja e Shkodrës u hap më 1917 (Kazazi, 2014, f. 83)

[15] Kongresi i Lushnjës kreu punimet në shtëpinë e patriotit lushnjar, Kaso Fuga, nga 21 deri në 31 Janar të vitit 1920 Koliqi, 2002 cit nga 'Shqipëria më 1957',vellimi 1, fq.164



Figura 37. *Shkolla fillore e Leskovikut, viti, 1922. Burimi: AQSH*

Kongresi arsimor i Lushnjës kërkoi të hapeshin edhe shkollat internate (konvikte) në qendrat kryesore të vendit ku të grumbulloheshin fëmijët për të ndjekur shkollën, si në Korçë, Tiranë, Berat, Elbasan dhe Shkodër. Kurse këto shkolla për zonat veriore e fëmijët e malësisë u quajtën 'shkolla përbujtëse'- që përfshinin fëmijët e një krahine. (Repishti, Kashari, & Osmani, 2003, f. 381). Në vitin shkollor 1920-1921, Shqipëria kishte 452 shkolla fillore dhe foshnjore dhe disa shkolla qytetëse 2-3 klasash. (Koliqi, 2002) "Vetëm mbas Kongresit të Lushnjës filloi të funksionojë shteti Shqiptar dhe u organizua sistemi unik arsimor kombëtar." (Bakiu, 1998, f. 140)

Pavarësisht nga përparimet në arsim për sa i takon numrit të nxënësve të cilit ndiqnin shkollën ky numër ishte akoma shumë i ulët dhe sidomos situata ishte dramatike për femrat që lejoheshin e kishin mundësi të arsimoheshin. Ndërkohë që nëpër Evropë përdoreshin hyrjet e veçanta për djem e vajza, një informacion që studiuesi Shefik Osmani jep mbi këtë periudhë është se në shkolla, mësimi bëhej ende i ndarë, veças për vajzat e veças për djem. Në shkollat e fshatrave mbizotëronin nxënësit meshkuj, ndërsa numri i vajzave që ndiqnin shkollat që i pandjeshëm. (Osmani, 2003, f. 323)

Ndërsa në vitin 1921-1922 kishte 572 shkolla (3 të mesme. 12 qytetëse[16], 519 shkolla fillore, 4 kopshte e 36 të minoritetit grek,[17] (Koliqi, 2002, f. 351) pati një nxitje e një shtytje të fortë nga domosdoshmëria e dëshira për të nxjerrë vendin nga prapambetja dhe përgatitjes së të

[16] Për shkollat qytetëse në Kongresin Arsimor të Tiranës në 1922, u vendos të kalohej në sistemin me 6 klasë dhe të përdorej eksperimenti në mësim. (Koliqi, 2002, f. 353)
[17] Xhevat Repishti, "Lëvizja sindikale e mësuesve Shqiptare në vitet 1921-1924") cituar nga (Koliqi, 2002, f. 351)

rinjve në fushat e ekonomisë, teknikës, arsimit etj. Kjo dëshirë çoi në nevojën për të hapur shkolla të mesme e gjithashtu për të mbyllur rrugën dërgimit të moshave të mitura për studime jashtë shtetit. Vetëm në vitet 1920- 1925 u hapën një numër i madh shkollash e kryesisht të arsimit të mesëm e atij profesional. (Repishti, Kashari, & Osmani, 2003, f. 401)

Më 21 korrik 1921, u hap ‘**Shkolla Teknike Amerikane’**, nga Kryqi i Kuq Amerikan, Në vitin 1922 drejtor u bë Harry. T. Fultz[18] i cili e drejtoi këtë shkollë profesionale për gati 12 vjet. (Bakiu, 1998, f. 222)

Në vitin 1921, mbi bazën e shkollës françeskane te hapur në vitin 1861 u hap në qytet nga Urdhri Françeskan ‘**Gjimnazi** ‘**llyricium**’, e cila ishte një shkollë e mesme me fizionomi të plotë. (Kazazi, 2014, fv. 62-63), (Figura 38).



Figura 38. *Godina dhe nxënësit e gjimnazit françeskan ne Shkodër në vitin 1930. Burimi: AQSH*

Më 2 tetor 1922, u hap në Tiranë shkolla e mesme femërore me emrin ‘**Instituti Kyrias**’ (Qiriazi, Dako). Protagoniste të hapjes së këtij instituti qenë pedagoget e shquara shqiptare, Parashqevi e Sevasti Qiriazi, që kishin mbajtur shkollën e vashave në Korçë, të cilat hapën këtë shkollë me pagesë. (Repishti, Kashari, & Osmani, 2003, f. 402), (Figura 39).

[18] Harry T. Fultz ishte i diplomuar në inxhinieri dhe profesor në Universitetin e Chicago-s.



Figura 39. *Pamje te nxënëseve të institutit Femëror Kyrias dhe të motrave Qiriazi. Burimi: AQSH*

Më 5 tetor 1922 u hap '**Gjimnazi i Shtetit të Shkodrës**'-Ndër gjimnazet shtetërore ishte më i madhi në vend dhe më jetëgjati e i qëndrueshëm.

**'Konvikti Naim Frashëri'** nuk ishte shkollë e mesme por një shkollë fillore private me program 6 vjeçar për nxënëse të moshës 6-14 vjeç. U hap me 1 korrik të 1922 e ne 1930 u çel pranë tij e një shkollë normale për vajza. (Bakiu, 1998, f. 227)

Ndërsa në vitin 1923 '**Gjimnazi i Gjirokastrës**' u bë e para shkollë e mesme mikse nga seksi dhe feja. (Figura 40)



Figura 40. *Ndërtesa vjetër e Gjimnazit të Gjirokastrës, ose Liceu, më 1923. Burimi: AQSH*

Në vitin 8 nëntor 1924 që ishte viti i krijimit të Qeverisë Demokratike të Fan Nolit u hap në vendin e quajtur Uji i Ftohtë në Vlorë, '**Shkolla e mesme Tregtare**' e cila më vonë u quajt 'Instituti Tregtar'.



Figura 41. *Instituti Tregtar i Ujit të Ftohtë në Vlorë, 1924, Foto e 1927; Burimi: AQSH*

‘**Gjimnazi i Beratit’**- u hap për herë të parë më 12 tetor 1925 e u mbyll më 1927/1928. Më pas vendin e tij e zuri shkolla profesionale industriale Italiane.

‘**Gjimnazi i Tiranës’** u hap në tetor të vitit 1924 me iniciativën dhe me paratë e komunitetit Tiranas ku secili nga prindërit e nxënësve do të jepnin një shumë mujore për qiranë e godinës. Fillimisht u quajt ‘Liceu privat i Tiranës’ e më pas në 3 nëntor të vitit 1925 u transformua në ‘Gjimnazin Shtetëror të Tiranës.’ (Bakiu, 1998, fv. 224-225)

“Pozitive nga pushtimi i tre fuqive të mëdha Evropiane...” ashtu edhe sipas Osmanit ishte fakti se “...tre shtetet pushtuese reflektonin tri përvoja të përparuara Evropiane, nga të cilat përfituan nxënësit, mësuesit dhe vetë godinat.” (Osmani, 2003, f. 355) Vendet pushtuese ndikuan jo vetëm në gjuhën, kulturën, historinë, traditën por edhe në programet mësimore. Planet mbi arsimin u gërshetuan me konceptet pedagogjike dhe kulturën e vendeve pushtuese. (Koliqi, 2002, f. 331)

## 2.3 HISTORIKU I ARSIMIT NË PERIUDHËN E 1925-1939

Ardhja e Ahmet Zogut, (21 Janar 1925) në pushtet solli ndryshime të mëdha në jetën politike dhe arsimore në Shqipëri. Në vitet ’20-’30 të shek. XX, në shkollat shqiptare filluan të depërtonin rryma dhe ide pedagogjike reformiste. “Ndër to ishte pedagogjia eksperimentale (funksionale) e Eduard Klaparedit, parimet reformatore të Hugo Gaudigut, shkolla aktive e Adolf Ferrierit, qendrat e Ovid Dekroliut etj.” (Koliqi, 2002, f. 390) (Figura 42)

“Deri në fund të vitit arsimor 1927/1928 shkolla fillore ishte 6 vjeçare. ...shkolla fillore u kristalizua në formën e saj përfundimtare si 5 vjeçare... ndërsa disa shkolla në fshat ngelën si 4 vjeçare por që e kryenin të plotë programin 5 vjeçar , ato u quajtën plotore.” (Gogaj, 2003, f. 459)

| Viti shkollor | Shkolla foshnjore | Institute të ndryshme | | | | | | | Personeli mësimor | | | Nxanës | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shkolla fillore e plotore | | | Internate | | | Shum = | Në fillore | | | Në fillore | | |
| | | M | F | GJ | M | F | GJ | | M | F | GJ | M | F | GJ |
| 1924/25 | 11 | 412 | 35 | 447 | 10 | 1 | 11 | 469 | 649 | 108 | 757 | 21163 | 4024 | 25187 |
| 1925/26 | 11 | 446 | 37 | 483 | 11 | 1 | 12 | 506 | 675 | 119 | 794 | 23480 | 4495 | 27975 |
| 1926/27 | 12 | 488 | 36 | 524 | 15 | - | 15 | 551 | 702 | 101 | 803 | 21520 | 5093 | 26613 |
| 1927/28 | 11 | 323 | 167 | 490 | 15 | 5 | 20 | 521 | 853 | 102 | 955 | 22251 | 5524 | 27775 |
| 1928/29 | 22 | - | - | 495 | 19 | 1 | 20 | 537 | 704 | 103 | 807 | 22971 | 5232 | 28203 |
| 1929/30 | 22 | 460 | 40 | 500 | 19 | 1 | 20 | 542 | 759 | 130 | 889 | 22971 | 5232 | 28203 |
| 1930/31 | 22 | 415 | 48 | 463 | 19 | 1 | 20 | 505 | 716 | 152 | 863 | 22971 | 5232 | 28203 |
| 1931/32 | 13 | 398 | 46 | 444 | 18 | 2 | 20 | 477 | 699 | 194 | 893 | 35255 | 13746 | 49001 |
| 1932/33 | 13 | 444 | 49 | 493 | 18 | 2 | 20 | 526 | 780 | 231 | 1011 | 35255 | 13746 | 49001 |
| 1933/34 | 13 | - | - | 532 | 18 | 2 | 20 | 565 | 842 | 217 | 1059 | 35255 | 13746 | 49001 |
| 1934/35 | 13 | - | - | 582 | 18 | 2 | 20 | 615 | 822 | 248 | 1070 | 37705 | 15317 | 53022 |
| 1935/36 | 15 | 467 | 114 | 581 | 18 | 1 | 19 | 615 | 828 | 263 | 1091 | 37329 | 15612 | 52941 |
| 1936/37 | 17 | 491 | 107 | 598 | 7 | 1 | 8 | 623 | 877 | 320 | 1097 | 36898 | 15586 | 52484 |
| 1937/38 | 18 | 507 | 102 | 609 | 7 | - | 7 | 634 | 918 | 282 | 1200 | 37858 | 17086 | 54944 |
| 1938/39 | 22 | 531 | 112 | 643 | 7 | 1 | 8 | 673 | 991 | 349 | 1340 | 38181 | 18751 | 56932 |
| 1939/40 | 16 | 557 | 106 | 663 | 6 | - | 6 | 685 | 1056 | 332 | 1388 | 36353 | 18505 | 54558 |

Figura 42. *Statistika të rritjes së numrit të shkollave 1924/1925-1939/1940. Marrë nga Historia e Arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, f. 464*

Në fillim gjimnazet ishin me 6 klasë, pastaj u bënë 7 klasë e më pas në vitin 1933, sipas reformës Ivanaj, ato u bënë 8 vjeçare. Gjimnazi kishte dy degë klasike dhe reale (shkencore). "Të kësaj periudhe janë çelja e disa shkollave të mesme dhe rimëkëmbja e disa të tjerave. Me rëndësi ishte çelja e disa shkollave fillore me konvikt për zonat malore." (Gogaj, 2003, f. 428)

Ne këtë kohë në pamundësi tjetër marrëdhëniesh ndërshtetërore, shteti shqiptar kishte lidhur disa marrëveshje me karakter ekonomik ushtarak, e politik me qeverinë italiane. Edhe në fushën e arsimit parashikoheshin marrëveshje me Italinë fqinje. Me 28 qershor të 1928 midis qeverisë Italiane dhe qeverisë Shqiptare, u lidh një marrëveshje për ngritjen në Shqipëri të shkollave profesionale italiane. Parashikoheshin të hapeshin 9 të tilla po përfundimisht u vendosen për 4 shkolla profesionale, të cilat u ngritën në Korçë, Shkodër, (Figura 43) Berat, dhe në Gjirokastër. (Gogaj, 2003, f. 429) [19]

Nën influencën e arkitekteve Italiane në Shqipërinë e viteve 1928-1939 u ndërtuan një sërë shkollash e godinash institucionale të cilat në shumicën e rasteve ishin më shumë profesionale sesa shkolla të përgjithshme.

Më 8 tetor 1928 Shqipëria u shpall Monarki Konstitucionale me mbretin Zog I, i cili pohoi botërisht se Shqipëria ishte shekuj të tërë mbrapa pjesës tjetër të Evropës së qytetëruar. Në reformat që kreu mbreti Zog në këtë periudhë ishte edhe fakti i përmirësimit të shkollave fillore "ku rreth 90 % e tyre ishin të papërshtatshme për punë të rregullt mësimore". (Gogaj, 2003, f. 437)

[19] Për drejtimin e tyre u vendos inxhinieri italian Plinio Luraschi.



Figura 43. *Shkolla profesionale e artit në Shkodër, Fotografi gjatë ndërtimit të saj, në vitin 1928. Burimi AQSH*

Tronditjen më të madhe e pësoi arsimi Shqiptar më 26 prill 1933 ku ministri Ivanaj i kërkoi parlamentit mbylljen e të gjithë shkollave private. "Sipas nenit 206 : Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë janë një e drejtë ekskluzive e shtetit. Arsimi fillor, për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyrueshëm dhe jepet falas. Shkollat private të çdo lloj kategorie qofshin, që kanë vepruar deri më sot, mbyllen." (Gogaj, 2003, fv. 443-444)

Ndër shkollat profesionale vendin më të rëndësishëm e zënë shkollat pedagogjike (normale) dhe degët pedagogjike të inkuadruara në disa shkolla të mesme të vendit. Përveç Normales së Elbasanit ishin edhe shkolla Normale Femërore në Korçë (1924-1933), dhe shkolla Normale në Gjirokastër (1930-1935).

Në "Arsimi në periudhën 1925-1939", (Figura 44) autori Gogaj përmend edhe *Dega Normale Femërore e Institutit Shqiptaro- Amerikan te Kavajës,* e cila u hap me 1926 pranë degës bujqësore të Institutit, por më 1931 u vendos në Malin e Robit, në ndërtesa të reja, moderne, e kushte shumë të mira. Nga të dhënat që autori përmend kuptohet që ndërtesa ofronte hapësira të bollshme ku vajzat merreshin me kopshtari, shpendari, këngë, valle, mësim instrumentesh, dhe ishte një shkollë që ofronte kushte për të qenë sa më afër praktikes jetësore duke ofruar konvikt, kuzhinë, oborr, kopshte, lulishte, terrene sportive etj. (Gogaj, 2003, p. 437)

Megjithëse në Shqipëri funksiononin një numër i madh shkollash të huaja shpesh edhe fetare, ose me fonde nga shtetet e tjera me reformën ministrit Ivanaj në periudhën e mbretit Zog, 1933-1934, arsimi niste punën për herë të parë në historinë e Shqipërisë vetëm me shkolla shtetërore. (Gogaj, 2003, f. 445) "Ligji i Mirash Ivanajt" i vitit 1933 goditi shumë shkollat teknike dhe profesionale të administruara kryesisht nga italianët në qytete të ndryshme të Shqipërisë. (Koliqi, 2002, f. 365) Gjithashtu sipas ligjit të Ivanaj; arsimi i mesëm nga 6 klasa me reformën e 1933 u bë 8 klasa me 2 cikle i ulët e i lartë, 2 degë klasike dhe reale. (Rama, 2005, f. 25)

Ledita Mezini



Figura 44. *Foto të shkollës e të sallës së Kinemasë së Institutit Shqiptaro-Amerikan të Kavajës, foto të vitit 1931/1934. Burimi (Muzeu Historik Kombëtar 2016)*

Sipas studiuesve të ndryshëm faktori kryesor që çoi në mbylljen dhe shkrirjen e mjaft shkollave profesionale, ishte qëndrimi ndaj politikave aktuale italiane për rritjen e ndikimit të saj ekonomik, politik, kulturor, e arsimor, në gjithë jetën e vendit, që po merrte formën e një protektorati dhe po rrezikonte vetë qeverisjen Zog-iste, që kishte filluar të shqetësohej me kohë për arrogancën në rritje të përfaqësuesve italianë në Shqipëri. (Rama, 2005, f. 20)

Sipas historianes Rama "rritja e shkollave fillore dhe profesionale italiane, me pavarësi të theksuar nga programet shtetërore, që shpërndanin gjithashtu një literaturë të shumtë italiane në gjithë vendin etj., ngjallën shqetësime dhe reaksion në rrethe të caktuara të Ministrisë së Arsimit, të mësuesve, të nxënësve dhe me tej. Ky ekspansion i vërtetë kulturor e arsimor u quajt një rrezik për shkollën dhe kulturën kombëtare." (Rama, 2005, f. 21)

Ivanaj kreu mjaft reforma të rëndësishme në arsimin Shqiptar. "ndonëse shteti Shqiptar rriti buxhetin e Ministrisë së Arsimit për ta mbështetur sa të mundej arsimin teknik shumë shpejt u bë e qartë se mbyllja e shkollave private kishte sjellë një rënie në fushën e arsimit." Megjithatë më vonë u pa rëndësia e shkollave profesionale dhe mbreti Zog u ndie i pafuqishëm përpara influencës dhe forcës Italiane e kështu kreu një reformë të dytë në vitin 1938 me në krye specialistin Italian Sestilio Montaneli i cili parashikonte kufizimin e shkollave të mesme të kulturës së përgjithshme dhe orientimin e shkollës së mesme drejt arsimit profesional. Shkollat qytetëse do të mbylleshin dhe në vend të tyre do të ngriheshin shkollat e punës në krye të cilave ishin drejtues Italianë. (Gogaj, 2003, f. 457)

## 2.4 HISTORIA E ARSIMIT NË VITET 1939-1944

Pushtimi fashist i vendit më 7 prill 1939 e futi shkollën në Shqipëri në një drejtim krejt tjetër me përmbajte sipas modelit të shkollave italiane. Italianet gjetën në Shqipëri rreth 660 shkolla fillore (6-11 vjeç), 19 shkolla të nivelit të dytë (11-13 vjeç), dhe ndër gjimnazet e arsimit të mesëm shkollat e tipit të liceut në Shkodër, Korçë, Liceu 'Naim Frashëri' në Tiranë, si dhe shkolla normale në Elbasan 'Luigj Gurakuqi'. Gjithashtu përmenden instituti Femëror 'Nana e Skënderbeut' (Figura 45) në Tiranë dhe Instituti Teknik Industrial "Karl Gega', Tiranë, e shumë shkolla të tjera profesionale e bujqësore. "Megjithatë gjatë okupacionit Italian sidomos gjatë viteve 1940-1941 institucionet arsimore filluan të shtoheshin shumë." (Spasse, 1997, f. 103)



Figura 45. *Instituti Femëror Nëna Mbretëreshë, dikur Shkolla teknike Amerikane e Harry Fultz. Burimi AQSH*

Duke qenë se kërkonin të përhapnin pushtimin e tyre nëpërmjet arsimit e gjuhës Italiane, pushtuesit hapën shumë shkolla në këtë periudhë për fëmijët e vegjël. Në vitet '40 u projektuan një numër i madh shkollash fillore nëpër rrethet e Shqipërisë ku tentohej të futeshin mjaft nxënës shpesh edhe pa ndarje moshe. Mësuesi mblidhte nxënës nga fshatra të ndryshëm e për këtë projektohej banesa e tij shpesh ngjitur me klasën e mësimit.

Periudha e pushtimit Fashist, përmbledh dy tip institucionesh arsimore: e para shkolla të rregullta atje ku kishte ndërtesa shkollash dhe një mësues të përhershëm, e tipi tjetër atje ku këto standarde mungonin përfshinte shkollat fillore me klasa kolektive të tipit të kurseve, me nxënës të moshave të ndryshme, pa orare e programe të rregullta. Mund të funksiononin edhe me mësues shëtitës për 3- 6 katunde me ditë ose me javë në çdo katund. Fëmijët e këtyre katundeve do te mblidheshin në kohë të mirë në sheshet e katundeve nëpër objektet e kultit a në ndonjë shtëpi fshatari. (Rama, 2005, f. 103), (Figura 46,47,48).

Ndërsa për sa i takon shkollave të mesme ato paraqiteshin më të strukturuara e ndër ato më kryesore të kësaj faze janë:

- Gjimnazi 'Iliricum' i klerit Françeskan, në Shkodër
- Kolegji Saverian i etërve Jezuitë, në Shkodër
- Gjimnazi i shtetit në Shkodër.
- Liceu Frëng në Korçë
- Liceu i Gjirokastrës
- Gjimnazi i Tiranës
- Shkolla Normale e Elbasanit
- Instituti femëror Nëna Mbretëreshë

- Shkolla Teknike Tiranës, etj. (Gogaj, 2003, fv. 471-482)




Figura 46. *Plani i katit përdhe dhe pamje te shkollës Malësi ku duket klasa 1-dhomëshe e mësimit si dhe ambienti i fjetjes se mësuesit. Viti 1940. Burimi AQTN.*[20]




Figura 47. *Plani dhe pamja e shkollës për fshat me dy klasë. Ndërtesa paraqitet e thjeshtë me simetri e ngjashme me ndërtesat e banimit. Burimi AQTN*

[20] Shkolla fillore me një klasë 9 metra me 6.40 metra funksiononte si shkollë fillore e mblidhte fëmijë të moshave të ndryshme nga fshatra përreth. Bashkangjitur ndërtohej dhoma e mësuesit.



Figura 48. *Shkollë fillore në Shosh. Viti 1939. Burimi: AQSH*

Me gjithë se Italianët sponsorizonin për bursa e për të arsimuar Shqiptaret në Itali në mënyrë që të propagandonin për Italinë Fashiste, shumë u kthyen kundër duke e braktisur shkollën ose duke propaganduar kundra Italisë. Historiania Fatmira Rama deklaron se "duhet pranuar se përsëri këta bënë që në një fare mënyre një pjesë e popullsisë të merrte arsim të lartë." (Rama, 2005)

Në vitet 1939, 1940, 1941 shkollat funksiononin më shumë si kurse dhe autoritetet pushtuese italiane nuk ishin më në gjendje të mbanin shkollat as financiarisht as për sa i takon vendosjes së rregullit e disiplinës. U mbyllën shumë shkolla konvikte e mjaft largime e braktisje. (Figura 49) Më 1943 Italia kapitulloi e administrata e re gjermane nën pushtimin gjerman nuk arriti të kishte autoritetin e duhur për të detyruar fëmijët të ndiqnin shkollat. (Rama, 2005, f. 77)



Figura 49. *Foto e një klase mësimi ku nxënësit kishin braktisur mësimin. Burimi: AQSH*

Pikërisht në etapën e fundit të luftës pati një braktisje masive nga shkollat, pasi shumica e popullsisë mendonte që po të shkonte në shkollë do të influencoheshin nga pushtuesit. "Shkolla..." –theksohet në një nga këto artikuj, "...ka qenë kallëpi ku i riu duhej të merrte formë sipas interesave të tjetërkujt.[21] Në vitet 1944- 1945 shqiptaret mendonin se po të shkoje në shkollë do të pushtonin mendjen e për këtë arsye braktisnin shkollat në masivitet nën parullën: "Ishte koha e luftës e jo e librit".

## 2.5 ZHVILLIMET E ARSIMIT NË VITET 1944-1990

Me çlirimin e vendit situata arsimore ashtu si në gjithë vendin ishte mjaft e rëndë. Një numër i madh shkollash ishin braktisur shkatërruar e rrënuar gati krejtësisht. (Rama, 2005, f. 127)

Pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri në nëntor të 1944 u vendos regjimi komunist. Shqipëria kishte një prapambetje të theksuar në shumë fusha e sidomos edhe në atë të arsimit. Një numër i madh fshatrash nuk kishin shkolla, ndërkohë që shkolla të mesme kishte vetëm në gjashtë qytete. Mbi 80 % e popullatës Shqiptare ishte analfabete dhe shkolla fillore mungonin në shumë fshatra.

Një problem i madh ishte se niveli profesional i arsimit ishte i ulët e kjo vihet re nga fakti se një mësues bënte mësimin për një grup të madh nxënësish të moshave të ndryshme e nga fshatra të ndryshëm. Ky tipar vihej re nga fakti se mbi 300 shkolla fillore ishin vetëm me një hapësirë mësimi "një-klasëshe pra të tipit ku mësimi u jepet disa rendeve (seksioneve) njëkohësisht, po prej një mësuesi." (Koliqi, 2002, f. 419) (Figura 50)



Figura 50. *Shkolla fillore e Kolonjës, Lushnjë. Burimi: AQSH*

[21] AQP, v1944 D 194, "Pishtari", Brig 8. Nr 2-3 vt 1 korrik gusht 1944, art 'Shkolla' cituar nga (Rama, 2005, f. 97)

Shqipëria në vitet '45-'90 që ishte periudha nën regjimin diktatorial komunist kaloi disa faza të cilat u influencuan gjithashtu nga faktorët e shumtë si politikë, ekonomikë, të metodave të ndërtimit etj.

Ndërkohë që sipas Koliqit arsimi në këtë periudhë kaloi në disa etapa:

- Etapa e parë e zhvillimit të arsimit zë fill që në vitet e Luftës dhe shtrihet deri në vitet e para të Çlirimit, në 1949-1950 ku për bazë ishte reformimi i arsimit. U vunë themelet dhe parimet bazë të sistemit të ri arsimor në Shqipëri. Ato ishin: arsimi falas, i përgjithshëm e i detyrueshëm, (fillor), arsimi unik (lidhje organike midis të gjitha shkallëve të shkollimit), arsimi i barabartë për meshkujt dhe femrat, arsimi laik në gjuhën amtare etj. (Koliqi, 2002, f. 440) . Në vitet e para të rindërtimit të vendit u bë një punë e madhe në ristrukturimin e shkollave të vjetra e në hapjen e shkollave të reja, ku synohej të kishte "ndërtesa shkollash në çdo cep të Shqipërisë"[22] e gjithashtu të zhdukej analfabetizmi.

- Etapa e dytë e zhvillimit të sistemit arsimor kap vitet 1950-1955, ku shkolla shqiptare mori fizionomi të plotë por pati një ndikim nga përvoja e shkollës dhe pedagogjisë sovjetike. Po në këtë periudhë u hapën edhe shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm dhe shkolla teknike profesionale të ulëta e të mesme, gjithashtu e liceu artistik, teknikumi i fizkulturës, si dhe teknikume të tjerë bujqësorë, tregtar, financiar, i ndërtimit, i naftës, mjekësor, i tekstileve etj. (Beqja, 1974, p. 15)

- Etapa e tretë e cila kapi një periudhë 10 vjeçare nga 1956-1965 kishte në qendër të shkollës e të veprimtarisë arsimore, boshtin ideologjik. Në vitin 1962-1963 Shqipëria kishte 636 shkolla 7 vjeçare, dhe 85 shkolla të mesme, të përgjithshme dhe profesionale ku gjendeshin edhe 9 shkolla pedagogjike. Me ligjin e 1963 'Mbi organizimin e sistemit arsimor ne RPSH' u sanksionua kalimi i arsimit të detyrueshëm 8 vjeçar dhe gjithashtu lidhjen e shkollës me jetën dhe punën në prodhim. (Koliqi, 2002, f. 443)

- Etapa e katërt filloi në vitet 1966 dhe kishte në thelb përsëri boshtin ideologjik marksist-leninist por reformat që pësoi kurrikula, programet dhe sistemi arsimor qenë shumë më të mëdha. Në thelb ishin parimet 'mësim-punë prodhuese- edukim fizik e ushtarak'. Ndërkohë arsimi pati një zhvillim të vrullshëm sasior. Deri në vitin 1970 në Shqipëri hapen 1374 shkolla tetëvjeçare, 53 shkolla të ulëta teknike- profesionale, 46 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm, 85 shkolla profesionale, industriale, bujqësore, pedagogjike etj., dhe 5 shkolla të larta. (Koliqi, 2002, f. 451)

- Etapa e pestë dhe e fundit e zhvillimit të arsimit në Shqipërinë Socialiste që filloi në vitet 1981-1982 e vazhdoi deri në 1991-1992 megjithëse kishte si parim 'ngritjen e arsimit e të cilësisë të punës mësimore edukative të shkollës' ishte një nga etapat ku arsimi kaloi një sërë vështirësish të ardhura edhe nga izolimi politik e ekonomik i Shqipërisë. Plani mësimor i shkollës së mesme të përgjithshme përfshinte këto lëndë: Njohuri të marksizëm-Leninizmit, Letërsi, Gjuhë Shqipe, Gjuhë e huaj, Histori,

[22] Enver Hoxha deklaroi që duhej të zhdukej analfabetizmi e të kishte shkolla fillore në çdo cep e skaj të Shqipërisë.

Gjeografi, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Bujqësi, Astronomi, Vizatim teknik, Dituri makinash, Elektroteknike, Edukim fizik, Edukim Ushtarak, Gjuhë e huaj e dytë (fakultative). (Koliqi, 2002). Në etapën e fundit ashtu si dhe në shumë fusha të tjera, arsimi u gjend mes parullës "Kursim, kursim, kudo e kurdo", gjë që çoi në shkatërrimin dhe rënien e arsimit në Shqipëri. Kjo rënie u pasqyrua në mungesën e ndërtimeve të reja por shtesa e përshtatje të ndërtesave ekzistuese arsimore.

## 2.6 HISTORIA E ARSIMIT PREJ 1990 E GJENDJA E NDËRTESAVE ARSIMORE SOT

"Shqipëria pësoi një zhvillim shumë më të ngadaltë se sa vendet e tjera të Ballkanit gjatë periudhës 45-vjeçare komuniste, doli më e varfër në vitin 1990 nga sa kishte qenë në vitin 1945." (Erebara, 2012) Arsimi në Shqipëri i ndodhur mes mungesës së madhe ekonomike dhe izolimit totalitar që po kalonte vendi u prek e u trondit jashtëzakonisht shumë me ngjarjet e vitit 1990-1991 ku tranzicioni, e rrëmujat prekën në masivitet shkollat, si ndërtesa e si institucione.

Vetë punonjës të Ministrisë së Arsimit janë shprehur se pas viteve '90 gjendja e ndërtesave arsimore ishte e mjeruar e është punuar për të rehabilituar kryesisht ato struktura ndërtimore të cilat ishin në rrezik shembjeje e përbën mbi 60 % të shkollave. (Tani, 2014) Ndërkaq të dhënat flasin se numri i shkollave në rrezik shembjeje është ulur duke shkuar në 77 ndërtesa në gjithë Shqipërinë e këto të pozicionuara kryesisht në zona rurale. (Figura 51)

Tabela 2. *Tabela e numrit të godinave arsimore dhe e gjendjes së tyre sipas MAS, në vitin 2011*




| | | |
|---|---|---|
| Nxënës | | 566,557 |
| Mësues | | 34,520 |
| Godina arsimore | | 3499 |
| Gjendja fizike e tyre | Rrezik shëmbjeje | 77 |
| | Të menjëhershme | 413 |
| | Amortizime | 1750 |




Figura 51. *Harta e shpërndarjes së gjendjes fizike të ndërtesave të shkollave në Shqipëri në vitin 2011 sipas secilit qark. Burimi (MAS, 2014)*

Dokumentacionet dhe shkrimet e kohës tregojnë se sektorët e ekonomisë ishin tërësisht drejt falimentimit dhe se problemet socio-politike ishin bërë shumë të mprehta. Vendi ndodhej në prag të kolapsit ekonomik. "Vetëm brenda pak ditëve nga data 6 deri në datën 8 mars u larguan nga vendi në drejtim në Italisë e gjetkë rreth 25 mijë qytetarë." (Zotaj, 2014, f. 100) Ndër të tjera, arsyet që i detyronin shqiptarët për tu larguar nga vendi vinin dhe si pasojë e destabilizimit dhe pasigurisë në rritje. Në arsim kjo situatë u pasqyrua me braktisje masive të shkollave, shkatërrim të ndërtesave, grabitje të materialeve të klasave, bankave, laboratorëve etj. Sipas Sofokli Meksit " Njerëzit filluan të shkatërronin gjithçka të vjetër që përfaqësonte tiranin", e kjo çoi në shkatërrimin e sendeve si dhe të vlerave. (Meksi, 2008, f. 7) (Figura 52)



Figura 52. *Majtas: Pamje e shkollës fillore të fshatit Kozarë, ndërtuar në vitin 1987, Djathtas: pamje e tualeteve të jashtme. Foto e vitit 2011.*

Një nga problemet kryesore që hasi arsimi në Shqipëri lidhet pikërisht me situatën ekonomike ku studiuesja Elda Zotaj shprehet: "Në fushën ekonomike trashëgimia komuniste ishte gati e mjerë. Vendi kishte trashëguar një industri të rëndë të falimentuar, një sektor bujqësor të prapambetur dhe një faturë të gjatë me borxhe. Shqipëria ishte vendi më i prapambetur dhe më i varfër i Evropës." (Zotaj, 2014, f. 110)

Ndërtesat e shkollave vuajtën mungesën ekonomike dhe kjo u duk në mos ndërtimin e strukturave të reja për më shumë se 10 vite. Sektori i arsimit në vitet 1990 e më pas, kreu një sërë rikonstruksionesh të cilat morën më shume hov në vitet e fundit falë dhe vëmendjes së SOROS-it i cili sponsorizoi për të rregulluar, përshtatur e për ti kthyer në gjendje mësimi shkollat fillore e ato 8-vjeçare, pasi u pa që shteti Shqiptar nuk po përgjigjej materialisht për më shumë se një dekadë. Periudha e rikonstruksioneve nisi kryesisht në vitet 1997-1998 dhe u fokusua në ndërtesat 9-vjecare të cilat janë edhe më shumë në numër.[23]

"Si për gjithë objektet e vjetra edhe për shkollat rikonstruksioni është rruga më efikase dhe më me pak shpenzime, kjo edhe për shkak se objektet e ndërtuara para 40-50 vjetësh vërtetë janë projektuar me ekonomi por nga struktura ndërtimore janë në gjendje perfekte." (Velo, 2004) Ndër investitorët dhe fondacionet të cilat janë marrë me rikonstruksionin e shkollave janë Banka Botërore, Komuniteti Evropian, Fondacioni SOROS dhe donatorë të tjerë. (MAS, 2014)

[23] Në vitin 1998 vetëm Fondacioni SOROS shpenzoi 880,000,000 Leke në ndërtimet e shkollave 9-vjecare kur buxheti i shtetit për arsimin e mesëm, 9-vjecar dhe atë fillor së bashku ishte 810.000.000 leke. (MAS, 2014)

Në tabelat Nr. 3 dhe 4 jepen fondet për investime në sektorin e arsimit prej nga vihet re që me fuqizimin e rritjen e buxhetit të Shtetit janë pakësuar fondet nga donatorët e tjerë. Gjithashtu këto investime janë fokusuar në rehabilitimin e ndërtimeve në rrezik shembjeje, ose shumë të amortizuara, dhe një fond i vogël është destinuar për ndërtimet e shkollave të reja. Të dhënat statistikore tregojnë se në vitet 2010-2012 fondet dhe buxheti për rikonstruksionin e shkollave kanë qenë gati minimale e të papërfillshme.

Tabela 3. *Realizimi i investimeve në fonde dhe objekte për vitin 1997-2004*

| Nr | Emertimi | Ndare ne vite NE 000/LEKE | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | Totali |
| | **1.Buxheti I Shtetit** | | | | | | | | | |
| | Arsimi Parashkollor | 12452 | 53768 | 109360 | 96319 | 144790 | 76800 | 77188 | 81490 | 652167 |
| | Arsimi 9 vjeçar | 292353 | 558323 | 1071135 | 707179 | 814810 | 700000 | 800000 | 1652610 | 6596410 |
| | Arsimi I mesem | 137151 | 198135 | 400010 | 215425 | 289005 | 187300 | 519750 | 750000 | 2696776 |
| | **Shuma** | **441956** | **810226** | **1580505** | **1018923** | **1248605** | **964100** | **1396938** | **2484100** | **9945353** |
| | | | | | | | | | | |
| | **2. Banka Boterore** | | | | | | | | | |
| | Arsimi 9 vjeçar | 119000 | 441000 | 96000 | | | | | | 656000 |
| | **Shuma** | **119000** | **441000** | **96000** | **0** | **0** | **0** | **0** | | **656000** |
| | **3. Komuniteti Europian** | | | | | | | | | |
| | Arsimi 9 vjeçar | 461698 | 126128 | | | | | | | 587826 |
| | **Shuma** | **461698** | **126128** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | | **587826** |
| | **4. Fondacioni SOROS** | | | | | | | | | |
| | Arsimi 9 vjeçar | 320000 | 880000 | 120000 | 35000 | 49000 | 112000 | 780000 | | 2296000 |
| | **Shuma** | **320000** | **880000** | **120000** | **35000** | **49000** | **112000** | **780000** | | **2296000** |
| | **Donatore te tjere** | | | | | | | | | |
| | Per te gjitha nivelet | 98000 | 123200 | 471200 | 185000 | | | | | 877400 |
| | **Shuma** | **98000** | **123200** | **471200** | **185000** | | | | | **877400** |
| | **TOTALI** | **1440654** | **2380554** | **2267705** | **1238923** | **1297605** | **1076100** | **2176938** | **2484100** | **14362579** |

Tabela 4. *Realizimi i investimeve në fonde dhe objekte për vitet 2005-2009*

| Nr | Emertimi | Ndare ne vite NE 000/LEKE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 201 |
| | **1.Buxheti I Shtetit** | | | | | | | | |
| | A.baze | 1889491 | 1561075 | 1478988 | 2891162 | 4195600 | | | |
| | A.mesem | 701382 | 523877 | 666373 | 701238 | 1312300 | | | |
| | A.prof | 555273 | 279006 | 382938 | 355763 | 511000 | | | |
| | **Shuma** | **3146146** | **2363958** | **2528299** | **3948163** | **6018900** | **0** | **0** | |
| | **FINANCIM I HUAJ** | | | | | | | | |
| | A.baze | 315000 | 60624 | 326000 | 5000 | 0 | | | |
| | A.mesem | 133000 | 20000 | 297400 | 0 | 0 | | | |
| | A.prof | 9500 | 56802 | 55000 | 5000 | 40000 | | | |
| | **Shuma** | **457500** | **137426** | **678400** | **10000** | **40000** | **0** | **0** | |
| | **TOTALI** | **3603646** | **2501384** | **3206699** | **3958163** | **6058900** | | | |

Në tabelën Nr. 5 jepen investimet e kryera në vitet 1997-2004 në arsim, të dhëna sipas qarqeve e numri i objekteve qe kanë përfituar kanë qenë afërsisht 1500. Më pas në vitet 2005 e më tej buxheti dhe fondet kanë shkuar për ndërtimin e shkollave të reja brenda parametrave e duke futur për herë të parë edhe standarde e normativa të reja në projektimin e strukturave arsimore.

Tabela 5. *Investimet e kryera në Vitet 1997-2004 sipas Qarqeve.*

| Nr | Emërtimi | Investime të kryera Viti 1997-2004 Buxheti+donator | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | i Qarkut | Investimet 1997 2004 Buxhet + Donator në 000/lekë | Numri i objekteve arsimore që kanë përfituar | Nuri i nxënësve që kanë përfituar | Investime për nxënës në 000/lekë | Investimet në rrethe në % |
| 1 | Q Berat | 1770838 | 115 | 24755 | 596.4 | 10.7 |
| 2 | Q.Diber | 1055986 | 148 | 27381 | 577 | 6.4 |
| 3 | Q.Durres | 1310906 | 102 | 34630 | 645.4 | 7.9 |
| 4 | Q.Elbasan | 1420574 | 180 | 44124 | 890 | 8.6 |
| 5 | Q.Fier | 1316785 | 151 | 45072 | 853 | 7.9 |
| 6 | Q.Gjirokaster | 824329 | 102 | 16993 | 511 | 5.0 |
| 7 | Q.Korce | 1037616 | 123 | 27069 | 840.4 | 6.3 |
| 8 | Q.Kukes | 1054797 | 119 | 19570 | 464.8 | 6.4 |
| 9 | Q.Lezhe | 696597 | 75 | 19436 | 805.6 | 4.2 |
| 10 | Q.Shkoder | 708777 | 164 | 35233 | 541 | 4.3 |
| 11 | Q.Tirane | 1800092 | 90 | 68262 | 758.5 | 10.9 |
| 12 | Q.Vlore | 1365282 | 107 | 29562 | 674 | 8.2 |
| | **TOTALI** | **14362579** | **1476** | **392087** | | |

Rikonstruksionin e shkollave arkitekti Velo e ndan në 4 kategori: në të parën mund të përfshihen ato shkolla ku janë bërë vetëm punime të reja zëvendësuese rifiniturash. Në të dytën ato shkolla ku janë bërë punime rifiniturash por edhe ndonjë shtesë e vogël e jashtme për një imazh tjetër. Në një kategori tjetër ai përmbledh rastin kur janë ndërruar rifinitura por edhe janë bërë shtesa volumesh. E në kategorinë e fundit janë ato shkolla (të pakta në numër) ku ndryshimet janë rrënjësore. (Velo, 2004)

Për sa u takon rikonstruksioneve të shkollave në Shqipëri shpesh u kryen edhe pa studime, në ishte më e vlefshme të kryej një rikonstruksion i pjesshëm apo një prishje e rindërtim shkolle nga e para. Shpesh rikonstruksionet u kryen me shpejtësi, në prag fushatash e pa cilësi duke përfunduar së kryeri rikonstruksione të ndërtesave të shkollave në mënyrë të herëpashershme. Në Figurën 53, 54, jepet plani dhe pamje të rikonstruksionit të kryer për shkollën Bajram Curri, Tiranë, i cili ishte një transformim total për ndërtesën duke shtuar volume për më shumë mjedise e hapësira të nevojshme. Të këtij tipi janë një numër i vogël ndërtesash arsimore të gjendura në zonat urbane e kryesisht në qytetin e Tiranës pasi pjesa më e madhe e rinovimeve arsimore u takon vetëm rifituarave, ose edhe strukturës së çatisë.




Figura 53. *Shkolla Bajram Curri, Tiranë, përpara dhe pas rikonstruksionit. Viti i Ndërtimit1970 dhe ai i rikonstruksionit 2003-2006. Ark: V.Islami, E.Kasimati, N.Theodhosi.*



Figura 54. *Plani i katit të parë të shkollës Bajram Curri, Tiranë e ri-konstruktuar në vitin 2003-2006. Pjesa e rrethuar me ngjyrë të kuqe është pjesa e vjetër e shkollës e ndërtuar në 1970 me projekt tip.*

Për sa u takon rikonstruksioneve, është për tu përmendur fakti se nuk pati vetëm nga ato të tipit të shtesave në shkolla, por edhe të heqjes e pakësimit të hapësirave. Ky veprim u ndërmor nga vendimmarrësit e Ministrisë, të cilët menduan se kushtonte më pak prishja e një hapësire se sa rikonstruksioni i gjithë shkollës. (Figura 55) Migrimet e shumta nga zonat rurale e periferike kanë bërë që shpesh të ketë shkolla me më pak se 10 nxënës. Nga të dhënat e Ministrisë së Arsimit, figuron se sot ka institucione arsimore të cilat janë me 2-10 nxënës e këto përbëjnë gati 9 % të shkollave. Kjo shifër e ulët ka çuar që shpesh shkolla të degradonte e të braktisej totalisht si nga nxënësit ashtu edhe nga instancat përkatëse. Momentalisht, gati 30 % e shkollave janë me më pak se 20 nxënës dhe po 30 % e tyre janë me mbi 100 nxënës. (Tabela 6)

Tabela 6. Përqindja e shkollave në lidhje me numrin e nxënësve për shkollë. (MAS, 2014)

| Numri i nxënësve | % e shkollave |
|---|---|
| <10 nxënës | 8.9% |
| 11-15 nxënës | 10.3% |
| 16-20 nxënës | 12.0% |
| 21-50 nxënës | 24.9% |
| 51-100 nxënës | 13.9% |
| 100+ | 30.0% |
| **Total** | **100%** |




Figura 55. *Plani i katit përdhe të shkollës fillore në Gegaj, komuna Tropojë, ku shkollës pas rikonstruksionit i prishen 2 klasa, e 2 hapësira ndihmëse. Studio Bilali, Sh.p.k.*

Në vitet 2005-2012 pati një sërë fondesh e projektesh të kryera nga donatorë e nga buxheti i shtetit në sektorin e arsimit të cilat sollën ndryshime të mëdha. Disa prej këtyre projekteve po

Ledita Mezini

përmenden më poshtë pasi prej tyre kanë derivuar disa prej shkollave të reja me një arkitekturë përparimtare e të qëndrueshme për Shqipërinë:

a- **Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim" (CBA)** i cili ka nisur të zbatohet në tetor 2006, është një projekt me një kosto prej 75 milion USD dhe që është zbatuar nga strukturat ekzistuese të MASH dhe institutet e varësisë, nëpërmjet programeve vjetore të reformës. (MAS, 2014)

   Projekti i cili ka qenë një nga më të rëndësishmit për arsimin shqiptar ka pasur një ndikim të madh në ndërtesat arsimore pasi ndryshoi frymën e arkitekturën e ndërtesave të shkollave. Projekti është financuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Botërore, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës dhe Banka Evropiane për Investime. Objektivi kryesor i projektit ishte përmirësimi i cilësisë së kushteve të të nxënit për të gjithë nxënësit dhe studentët, si edhe rritja e frekuentimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm, në veçanti për të varfrit. (Figura 56, 57)

   Në fushën e investimeve ky projekt u fokusua në ndërtimin e 15 shkollave të reja me një fond prej rreth 2.5 miliard leke dhe shtesën e 7 shkollave ekzistuese me një fond prej rreth 321 milion lekë për arritjen e objektivit të uljes së numrit të nxënësve për klasë. Shkollat u projektuan me 24 ose 30 nxënës për klasë me një sipërfaqe nga 45 deri ne 65 $m^2$. Shkollat e reja që përfituan nga projekti "CBA" paraqiten me një arkitekturë e tipologji të ndryshme nga më parë. Grupi i projektuesve ka konsultuar normativat Evropiane e sjell shkolla me atrium ose edhe me oborre të brendshme. Klasat paraqiten më të mëdha, me orientim të mirë, dhe i është kushtuar vëmendje edhe përkujdesje edhe vetë nxënësit duke projektuar shkolla të dizajnit universal, me panduse, ashensorë e tualete për Personat me Aftësi të Kufizuar.



Figura 56. *Render i shkollës 9-vjeçare, Sarandë. Ark. Edi Çomi, Studio Enval, ShPK. Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim"*




Figura 57. *Plani i sistemimit dhe pamje 3 dimensionale e shkollës së re të mesme në Dobraç, Komuna Rrethimë, Shkodër. Maj, 2011, ark. Klaud Manehasa*

**b- Projekti "Rehabilitimi i shkollave të Tiranës"**

Projekti për "Ndërtimin dhe Rehabilitimin e Shkollave të Tiranës" konsistonte në ndërtimin e 7 shkollave të reja dhe rikonstruksionin e 12 shkollave në Tiranë, në fazën e tij të parë. Ky projekt me ndihmën e Qeverisë vendore dhe asaj lokale u kristalizua duke ndërtuar rreth 6 objekte të reja në qytetin e Tiranës dhe rehabilituar 12 objekte ekzistuese me një fond prej 18,667,400 Euro. (Ristani, 2013) Për sa i përket rehabilitimit të shkollave ekzistuese u tentua drejt shtimit të ndonjë mjedisi ndihmës, si palestra, ndonjë ambient loje, rregullime, suvatime, e lyerje të fasadave e të rifiniturave të jashtme. Më poshtë janë imazhe të shkollës 9 vjeçare Niket Dardani, në Tiranë dhe imazhet e projektit te rehabilitimit të territoreve të jashtme. (Figura 58) Arkitekti Velo shprehet se: "Në shkollat e ri-konstruktuara janë bërë zëvendësime totalisht të çative të vjetra, heqja e suvasë së dekompozuar dhe ri-suvatimi brenda e jashtë, janë vënë shtresa të reja pllakash, janë zëvendësuar dyer dritare dhe janë bërë instalime të reja elektrike, dhe hidraulike, dhe së fundmi janë bërë edhe lyerje tërësore nga brenda e jashtë. (Velo, 2004). Pavarësisht kësaj ai shprehet se shpesh këto objekte nuk janë në harmoni me njëri tjetrin dhe "shpesh në këto rikonstruksione duket se objekti i ri me atë te vjetrin kanë një simbiozë të pakuptimtë." (Velo, 2004)



Figura 58. *Majtas-Sipër: Pamje e momentit të hyrjes në shkollën 9-vjecare Niket Dardani përpara rikonstruksionit. Djathtas sipër: foto të gjendjes ekzistuese së oborrit të shkollës. Poshtë: Imazhe të shkollës sipas projektit të rehabilitimit.*

c- **Projekti "IPA 2008"** në fushën e arsimit profesional.
Ky projekt konsistonte në ndërtimin e 4 shkollave të reja profesionale në Elbasan, Kamëz, Bushat (Shkodër) dhe qytet Shkodër si dhe zgjerimin e një shkolle profesionale në Durrës me një fond prej 5.133.848 Euro. (MAS, 2014) Projekti IPA 2008, pavarësisht se i përkiste arsimit profesional sillte risi në normativat e klasave, hapësirave e standardit të projektimit të ndërtesave arsimore. Më poshtë paraqitet Shkolla e mesme profesionale e Agrokulturës në Bushat, Shkodër. Të gjitha ndërtesat e shkollave të Projektit IPA 2008 u dizejnua nga studio Italiane e Francesco Martuschelli në bashkëpunim me arkitektët Shqiptar Sokol Imeraj. Këto paraqiten të ngjashme në skemë duke ndryshuar pak madhësinë e numrin e klasave. (Figura 59)



Figura 59. *Plani i katit përdhe dhe pamje 3-dimensionale e shkollës së mesme Profesionale të Agrokulturës, në Bushat, Shkodër. Projekti nga studio italiane e Francesco Martuschelli, në 2010 pjesë e projektit IPA 2008.*

d- Projekti Italian **"Informatizimi i 30 shkollave të mesme".** Në kuadrin e bashkëpunimit me qeverinë Italiane është implementuar projekti "Informatizimi i 30 shkollave të mesme" i cili përfshiu krijimin e kabineteve të informatikës dhe lidhjen e rrjetit të internetit për 1 vit në 30 shkolla me numër të konsiderueshëm nxënësish. Ky projekt ka përfunduar me një vlerë financimi prej 2 milion Euro. (MAS, 2014) Sajë këtij projekti gati të gjitha shkollat e mesme të Tiranës dhe disa prej atyre të qyteteve të mëdha janë pajisur me laboratorë kompjuterësh. (Figura 60)



Figura 60. *Foto nga inaugurimi i një salle kompjuteri, falë projektit Italian "Informatizimi i 30 shkollave të mesme".*

e- Projekti "**Mbështetje e Arsimit profesional në rajonin veri-lindor të Shqipërisë**" që u zhvillua nga kompania "PEM "dhe ka bërë ristrukturimin e katër shkollave profesionale në qytetet; Kukës, Peshkopi, Shkodër dhe Lezhë. Faza e I e projektit ishte janar 2008 - dhjetor 2009.



Figura 61. *Foto nga laboratori i fizikës dhe ai i kimisë nëpër shkolla, të fituara në bazë të projekteve të huaja për ngritjen e zhvillimin e arsimit profesional. Burimi MAS.*

f- **Projektet Zvicerane**. Programi Alb-VET i cili përbëhej nga projektet: "Përkrahja e shkollave profesionale" (SNV) dhe "Rritja e mundësive për zhvillimi e aftësive

profesionale“( RMZA) , e financuar nga një grant i Qeverisë Zvicerane me një shumë prej 4.435.000 CHF. (MAS, 2014)

Të gjitha këto projekte e të tjera nga Bashkimi Evropian kanë sjellë ndryshime jo vetëm në procesin e bërjes së mësimit por edhe vetë në ndërtesat arsimore, në kurrikula, në strukturimin dhe ngritjen e nivelit të mësuesve e të vetë nxënësve.

Në bazë të investimeve të kryera për ndërtesat arsimore në vitet 2005-2012 kanë përfituar rreth 850 objekte arsimore për arsimin para-universitar.

Tabela 7. *Realizimi i investimeve në objekte arsimore. (MAS, 2014)*

| | **Total objekte 2005-2009** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **2005** | **2006** | **2007** | **2008** | **2009** |
| Arsimi Bazë | 223 | 259 | 39 | 77 | 39 |
| Arsimi I mesëm | 46 | 71 | 5 | 19 | 14 |
| Arsimi profesional | 7 | 22 | 14 | 13 | 10 |
| **Arsimi parauniversitar** | **276** | **352** | **58** | **109** | **63** |

Në gjendjen aktuale të audituar sipas një projekti Evropian në bashkëpunim me MAS, e në bazë të të dhënave të “Sistemit të menaxhimit të Infrastrukturës Shkollore” në sistemin arsimor në Shqipëri në vitin 2012 funksionojnë 3388 godina shkollore, (MAS, 2014) të ndara si më poshtë:




Figura 62. *Grafiku i shpërndarjes së nxënësve në lidhje me numrin e klasave, viti 2011. (MAS, 2014)*

Siç vihet re nga grafiku ne Figurën 62 shumë shpesh kemi shkolla me klasa boshe ose në qytete e rrethe si Tirana, Durrësi e Elbasani kemi mbingarkesë të hapësirave me nxënës. Një hartë më e plotë e të dhënave është ndërtuar e paraqitur në Shtojcën D.

Tabela 8. *Tabela e tipit të ndërtimeve arsimore e shpërndarja e ndërtesave shkollore në rrethe*

| Nr | Emërtimi | Gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Godina | dhoma | nxënës |
| 1 | Kopshte | 1863 | 1857 | 40806 |
| a | Kopshte brenda shkollës | 1291 | | |
| b | Godina më vete | 572 | 1857 | 40806 |
| 2 | Shkolla Cikli i Ulët (1-6 klasë) | 871 | 2649 | 27379 |
| 3 | Shkolla 9 vjeçare | 1552 | 15271 | 371694 |
| 4 | Shkolla të mesme | 150 | 2613 | 79887 |
| 5 | Shkolla të mesme bashkuara | 185 | 2733 | 63841 |
| 6 | Shkolla profesionale | 58 | 1035 | 21330 |
| | **Shuma** | **3388** | **26158** | **604937** |




Përveç projekteve të shumta e fondeve të shpenzuara, në arsim kanë ndodhur edhe tre reforma thelbësore siç janë : Reforma e strukturës, ajo e Kurrikulës si dhe Reforma e menaxhimit dhe financimit të institucioneve.

**a- Reforma e strukturës së arsimit.**

Për sa i përket strukturës në arsim, e caktuar që në vitin 1963 që u aplikua për një kohë të gjatë e mbi të cilën u ndërtuan e u projektuan pjesa më e madhe e shkollave Shqiptare, pësoi ndryshime në vitin shkollor 2008-2009, ku arsimi i detyruar kalon nga 8 vjet në të paktën 9 vjet, dhe gjimnazi nga 4 vjeçar kthehet në 3 vjeçar. Këto ndryshime në strukturë nuk iu përshtatën mjediseve të shkollave të projektuara me strukturën e mëparshme.

Kjo strukture momentalisht përbëhet nga:

- Arsimi parashkollor;
- Arsimi bazë (Cikli fillor, Cikli i mesëm i ulët, Arsimi special);
- Arsimi i mesëm (Gjimnazi, Arsimi profesional, Arsimi social - kulturor);
- Arsimi i lartë;
- Arsimi i të rriturve.




Figura 63. *Struktura e organizimit të sistemit të arsimit Shqiptar në vitin 2009. (MASH, 2009)*

**b- Reforma e Kurrikulës.**

Gjithashtu një element e faktor dominues e i rëndësishëm i cili ndikon projektimin e ndërtesave arsimore është kurrikula e cila ka pësuar ndryshime kolosale të pa reflektuara në ndërtesat që mbartin këto programe mësimore. Kjo reformë përfshiu reformimin e programeve, teksteve, mësimdhënies, vlerësimit të arritjeve të nxënësve, si dhe kualifikim e mësuesve. (MASH, 2009) Karakteristika kryesore e kurrikulës së re për gjimnazin është se ajo bën pjesë në modelin anglo-sakson dhe ndahet në kurrikulë bërthamë, e cila është e detyrueshme për të gjithë nxënësit, dhe atë opsionale, duke theksuar kështu kurrikulën me bazë shkolle.

**c- Reforma e menaxhimit dhe financimit të institucioneve.**

Reformat, projektet e ndryshimet e shumta në arsim kanë tronditur themelet e muret e ndërtesave arsimore. Historia e këtij grupi të madh strukturash, pas viteve ‘90 dhe e arsimit na tregon se ajo ka qenë kryesisht një histori rehabilitimi dhe rikonstruksioni ku vendi përpiqet të krijojë modele të reja arsimore me shkollat profesionale e me projekte novatore por gjithashtu përpiqet të ruajë sa më shumë trashëgiminë e stokun e madh të ndërtimeve arsimore të gjendura kudo nëpër Shqipëri. Gjithashtu zhvillimet historike në 25 vitet e fundin kanë qenë të shumëllojshme dhe shkollat Shqiptare, kanë pësuar oscilacione të ndryshme, që nga grabitja, shkatërrimi, braktisja në zona rurale e mbipopullimi në zonat urbane, ndryshime e reforma në strukturën organizative, në kurrikulë, në menaxhimin dhe financimin e institucioneve e të fondeve, në drejtues, në mësues, në nxënës etj., ndryshime që nuk janë reflektuar e evidentuar e gati kanë ngelur po njëlloj në strukturat e në ndërtesat arsimore.

Ledita Mezini

## PËRFUNDIME 2

Objektivi kryesor i kësaj pjesë ishte të evidentonte zhvillimet kronologjike, ngjarjet, e pikat kyçe të historisë së shkollës Shqiptare paralelisht në dy këndvështrime: formimi dhe përhapja e shkollës Shqipe në vazhdën e historisë në konceptin e gjuhës, si dhe shkolla Shqiptare si ndërtesë e si strukturë që mbarte arsimin Shqiptar.

Historiku i ndërtesave të arsimit në vendin tonë tregon se ato kanë një arkitekturë të lidhur ngushtë me luftërat që ka kaluar vendi, pushtimet e huaja, influencat, ndryshimet politike, sociale, kulturore etj., dhe pikërisht kjo pjesë kërkon të kuptojë se si ka nisur historia e këtyre ndërtesave e se si është zhvilluar, problematikat, çështjet, ndërtesat kryesore si dhe luhatjet nëpër vite.

Ky kapitull evidenton etapat kryesore të zhvillimit të arsimit dhe arkitekturës së ndërtesave arsimore duke nxjerrë në pah influencat, faktorët e fortë të cilët kanë modeluar e kanë dhënë formë stokut të strukturave edukative. Nuk mund të kuptohet një arkitekturë e një grupi ndërtesash pa e analizuar atë në kontekstin e ngjarjeve historike, e zhvillimeve e forcave politike, ekonomike sociale e kulturore. Reformat, projektet e ndryshimet e shumta në arsim kanë tronditur themelet e muret e ndërtesave arsimore.

Studimi e ndan zhvillimin e shkollave në Shqipëri në 5 etapa kryesore, të cilat formohen nga faktorë të ndryshëm dhe karakterizohen nga tipare të veçanta.

### 1. Zhvillimi i arsimit prej fillimit deri në shpalljen e pavarësisë.

Nga Etapa e parë, kuptojmë që shkollat në Shqipëri i mbante feja, si ajo katolike me kishat, manastiret, famullitë, e ato myslimane me xhamitë, medresetë e mejtepet. Vetëm me Rilindjen filluan të lindnin shkollat e para Shqiptare që flisnin gjuhë shqip. Gjithashtu karakteristikë është se gjatë kësaj faze shkolla Shqiptare edhe pse me numër të vogël, shkon paralel me ideologjinë e shkollave nëpër botë ku arsimi drejtohej nga kleri ose edhe nga një pjesë e borgjezisë të cilët i sponsorizonin ato. Shkollat për të varfrit e për masën ishin sporadike nëpër banesa, haure, depo e mjedise të improvizuara. Në figurën 64 jepet skema e influencave kryesore në arsimin e shkollat prej fillimit deri në shpalljen e Pavarësisë.




Figura 64. *Skemë që tregon zhvillimet e arsimit në fazën e parë.*

## 2. Zhvillimi i arsimit prej 1912-1925

Etapa e dytë karakterizohet nga zhvillimet e vrullshme e luftërat që pësoi vendi të cilat nuk e lanë arsimin të përparonte e të merrte hovet e vendeve të zhvilluara. Shqipëria mbas një pushtimi gati 5 shekujsh kishte trashëguar një numër të madh shkollash fetare e kryesisht dy tip shkollash publike e laike: Shkollat fillore, dhe shkollat Normale. Lufta e Parë Botërore, korrespondon me një periudhë të vështirë për Shqipërinë e cila u gjend në mes shumë forcave të mëdha pushtuese. Etapa e dytë e zhvillimeve arsimore në Shqipëri karakterizohet pikërisht nga shkollat-shtëpi. Ndër faktorët më ndikues në arsimin dhe shkollat Shqiptare ishin varfëria e Shtetit Shqiptar mbas shpalljes së pavarësisë dhe ndikimit të vazhdueshëm e influencave të sulmeve të vendeve përreth. Në botë e Evropë u përhapën gjerësisht shkollat 1 dhomëshe, të cilat ishin hapësira për grumbullimin e fëmijëve. Pavarësisht qëllimit që ishte i ndryshëm kjo fazë përkon me hapjen e shkollave nëpër shtëpitë e banorëve thjesht me dëshirën për të mësuar gjuhën shqipe. Etapa e dytë karakterizohet nga banesat-shkolla, nga shkollat normale e shkollat e para të mesme publike.




Figura 65. *Skemë që tregon zhvillimet e arsimit në fazën e dytë.*

## 3. Historiku i arsimit në periudhën e viteve 1925-1939-1944

Faza e trete e arsimit e zhvillimeve kryesore historike që sollën ndryshime themeltare e që ndikuan në godinat arsimore përkon me ardhjen e Ahmet Zogut (21 Janar 1925) në pushtet i cili revolucionoi jetën politike dhe arsimore në Shqipëri. Ndër elementët e fortë që duhen përmendur të kësaj faze ishte rivaliteti mes Italianëve e Austro-Hungarisë të cilët i treguan përplasjet e tyre edhe në shkollat e tipologjitë që projektuan në territoret Shqiptare, dhe ndikimit të Amerikanëve me pedagogjinë e "shkollat e të nesërmes". Tronditjen më të madhe e pësoi arsimi Shqiptar më 26 prill 1933 ku ministri Ivanaj i kërkoi parlamentit mbylljen e të gjithë shkollave private, duke e kthyer prapa zhvillimin e arsimit shqiptar. Pushtimi fashist i vendit më 7 prill 1939 e futi shkollën në Shqipëri në një drejtim krejt tjetër me përmbajte sipas modelit të shkollave italiane. Italianet u interesuan në ndërtimin e shkollave profesionale, dhënien e zanateve e në përhapjen e gjuhës së tyre duke krijuar bazat e shkollat e para standarde e të mirëfillta për arsim.




Figura 66. *Skemë që tregon zhvillimet e arsimit në fazën e tretë.*

## 4. Zhvillimet e arsimit në vitet 1944-1990

Studimi evidenton fazën e katërt si periudha ku shkolla shqiptare mori fizionomi të plotë, filloi standardizimi e tipizimi në masë, dhe u krijuan normativat e plota mbi ndërtesat shkollore. Edhe brenda kësaj faze ka zhvillime e ndarje të etapave kohore të cilat përcaktojnë një tjetër tip karakteri për ndërtesat shkollore. Vetë periudha e viteve 1945-1990 ndahet në disa nën faza të cilat përkojnë me ndikimin nga Bashkimi Sovjetik, me frymëzimin e arkitektëve në funksionalizmin e pastërtinë e rrymës moderne e më pas në thjeshtësimin e ndërtimin në masë të shkollave me kosto sa më të ulët, nën regjimin diktatorial  e mangësisë së parave si agjentë kryesor ndikues.




Figura 67. *Skemë që tregon zhvillimet e arsimit në fazën e katërt, vitet 1945-1990.*

## 5. Zhvillimi i historisë së arsimit prej 1990 e gjendja e ndërtesave arsimore sot.

Etapa e peste e zhvillimeve arsimore në Shqipëri përkon me një nga periudhat kulmore e nga më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. Me rënien e regjimit komunist më 1990, arsimi në Shqipëri pësoi transformime të mëdha e gjendur mes tranzicionit, lëvizjeve politike, e qeverisëse, mes vrullit të madh të reformave në arsim, fondeve e investimeve të huaja, si dhe dëshirës për të futur teknologjinë, qëndrueshmërinë e risitë e reja në arsim. (Figura 68) Kjo etapë karakterizohet nga rikonstruksionet e shumta, nga një mbipopullim dhe mbingarkesë të strukturave arsimore në qytetet kryesore dhe braktisje, shkatërrim e degradim të strukturave nëpër periferi e zona rurale.

Edita Mezini




Figura 68. *Skemë që tregon zhvillimet e arsimit në fazën e pestë, prej tranzicionit deri me sot.*

Historia e këtij grupi të madh strukturash, pas viteve ‘90 dhe e arsimit na tregon se ajo ka qenë kryesisht një histori rehabilitimi dhe rikonstruksioni ku vendi përpiqet të krijojë modele të reja arsimore me shkollat profesionale e me projekte novatore por gjithashtu përpiqet të ruajë sa më shumë trashëgiminë e stokun e madh të ndërtimeve arsimore të gjendura kudo nëpër Shqipëri. Gjithashtu zhvillimet historike në 25 vitet e fundin kanë qenë të shumëllojshme e kaotike, dhe shkollat Shqiptare, kanë pësuar oscilacione të ndryshme, që nga grabitja, shkatërrimi, braktisja, mbipopullimi, ndryshime në reforma, në strukturën organizative, në kurrikula, në menaxhimin dhe financimin e institucioneve e të fondeve, në drejtues, në mësues, në nxënës etj., ndryshime që kanë tundur themelet, “lëvizur muret”, ndryshuar fasadat e strukturave të ndërtesave arsimore.

Ledita Mezini

# KAPITULLI 3

# ARKITEKTURA E NDËRTESAVE ARSIMORE NË SHQIPËRI

## Hyrja

*"Arkitektura është muzikë e gurosur. Ne duhet të bëjmë që në banesat tona, në shkollat, në fabrikat të ndjehet kjo poezi, të dëgjohet kjo muzikë."* [1]

Kapitulli i tretë i cili është një plotësim e vazhdim i historisë së arsimit, zhvillon një analizë kritike pikërisht të ndërtesave arsimore përgjatë atyre fazave të zhvillimeve historike, e ngjarjeve të trajtuara më parë në kapitullin e dytë. Duke hedhur sytë drejt ndërtesave të projektuara e të ndërtuara përgjatë këtyre etapave tentohet të kuptohet se si këto struktura edukative reflektojnë zhvillimet e kohës. Duke kaluar në mënyrë kronologjike trajtohen arkitekturat e periudhave të ndryshme dhe analizohen ngjashmëritë ose ndryshimet, me ndërtimet shkollore nëpër botë. Kjo pjesë grumbullon zhvillimet arkitekturore prej fillimit e deri në vitet 1944, si vit që përmbyll disa etapa, e nis fazën më prodhuese të shkollave në Shqipëri, atë të viteve 1945-1990, e cila trajtohet në kapitullin e katërt.

## 3.1 ARKITEKTURA E NDËRTESAVE TË ARSIMIT PREJ FILLIMIT DERI NË SHPALLJEN E PAVARËSISË

Ashtu si në shumë fusha të tjera, jeta e Ilirëve ishte e lidhur dhe e ngjashme me jetën e Romakeve dhe gjithashtu arkitektura e godinave të Gjimnazeve në periudhën ilire mendohet se ka qenë e ngjashme me atë Romake, ndërkohë që është zbuluar se në qendrat ilire zhvilloheshin tre lloj edukatash, edukata e punës, edukata fizike, e ajo ushtarake. (Ceka, 2003, p. 16)

Periudha e mesjetës i gjen shkollat dhe arsimin të lidhura ngushtë me kishën e krishterë, e më pas me atë të institucioneve fetare islame. Ndërtesa ku merreshin mësime ishte gjithmonë pranë sheshit afër kishës, ose xhamisë.

Duke qenë se në thelb të qytetit mesjetar ishte objekti i kultit, shkolla ose vendi ku mësohej ishte prapë ndërtesa e kultit, islame ose e krishtere. (Figura 69) Arkitektura e këtyre ndërtesave e hapur nëpërmjet portikëve ose arkadave ishte përfshirëse për publikun dhe të lirshme për të gjithë popullsinë. Siç përmend edhe Koliqi, "mësues ishin kleri ose hoxha, dhe mësimi i nxënësve bëhej pranë kishave, (katolike ose ortodokse) të quajtura manastire dhe më pas në medresetë e mejtepet që ishin shkollat e para islame." (Koliqi, 2002) Pranë Xhamive zakonisht osmanet themeluan mejtepet (shkolla fillestare islame), dhe medresetë (shkolla të mesme dhe të larta islame) si dhe bibliotekat.

Për sa i përket arkitekturës së qyteteve mesjetare e të këtyre ndërtesave që njëkohësisht funksiononin si objekte kulti por edhe si vende grumbullimi, takimi, mësimi etj., Vokshi mendon se: "Qytetet Shqiptare në fillim të 1900, sipas rregullave të vendosura nga otomanet e

[1] Gëte cituar nga Kolevica (Kolevica, Bisedë mbi arkitekturën, 1965)



Leita Nezni

nga besimi i tyre fetar prezantoheshin gati të pazhvilluara me art figurativ, skulpturor dhe pikturë ashtu siç kishin qenë kuptuar në antikitet". (Vokshi, 2014, p. 22)



Figura 69. *Xhamia e Beqareve, Berat. Ndërtuar më 1789. Burimi: IMK*[2]

"Edukimi shkoi paralel me procesin e kthimit të arsimit laik, me mësues të profesionit në vend të atyre fetar, dhe duke vendosur shkollat në godina të tjera e jo më në kisha." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004) Gjithsesi shpesh vihej re ndërtimi i shkollës me forma të ngjajshme me kishat ose me manastiret në këtë periudhë. Gjithashtu i këtij mendimi eshte edhe Gutman e cila shkruan" Që nga fillimi i shek 19, fëmijët edukoheshin në disa varietete ndërtesash duke filluar nga bodrumet e kishave e deri në shtëpi private." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Mbi ndërtesat e shkollave dhe arkitekturën e këtyre godinave gjatë periudhës nga shekulli i XVI deri në vitet 30' të shek. XIX, nuk kemi të dhëna pasi edhe mësimet kryheshin në vende të përshtatura, pranë famullive, pranë kishave, xhamive e shpesh fshehurazi nëpër godina të ndryshme. (Figura 70)

Ndër ndërtesat e para shkollore përmendet *Akademia e Voskopojës* e hapur fillimisht si shkollë fillore e më pas si e mesme më 1744. Kjo ndërtesë së bashku me shtypshkronjën e bibliotekën përbënin sipas historianëve një nga ndërtesat më të rëndësishme arsimore në Shqipëri. Koliqi shprehet se akademia "ishte një ndërtesë 3 kateshe me 40 salla dhe dhoma mësimi, pranë së cilës ishte dhe ndërtesa e jetimores.[3] (Koliqi, 2002, f. 114) Gjithashtu Velo e quan Akademinë e Voskopojës si "pararendëse të arsimit Shqiptar dhe si një godinë të paracaktuar për veprimtarinë shkollore". Sipas tij ndërtesa duhej të ishte e para historikisht e ngritur për një institucion arsimor. (Velo, 2004)

[2] Dokumentet tregojnë se kjo xhami në qendër të Berat e sheshi përballë saj ishte pikë grumbullimi, takimi, bisedash, e zhvillimi aktivitetesh të ndryshme përfshirë edhe arsimore.

[3] Orfanotrofi i ndërtuar më 1756 ishte dhe ndërtesa e parë për strehimin e fëmijëve jetim në gadishullin e Ballkanit.



Figura 70. *Shkolla Françeskane e Thethit. Shkolla ishte edhe famullia e Thethit. Ndërtesa u dogj në 1956. Burimi: AQSH.*

Në Shqipëri në vitet e Rilindjes Kombëtare (1830-1912) paralelisht si nëpër botë, u zhvilluan dy tip shkollash që ndaheshin në rurale (në përgjithësi për të varfrit) me vetëm një ose dy klasa, të cilat japin një arkitekture modeste dhe ekonomike dhe shkollat urbane shpesh të kritikuara si "Shkolla pallat" për shkak të madhësisë dhe madhështisë (për të pasurit). (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Dedej shkruan se dy tipat e shkollave në Shqipëri ishin ato për bijtë e Borgjezisë dhe ato për fëmijët e masave punonjëse: ".... Shkollat fillore, ku mësonin fëmijët e masave punonjëse vazhduan të mbeten në një gjendje të mjerueshme..."- (Dedej, 2003, p. 91) Në këtë periudhë kuptohet se edhe arkitekturës së shkollave fillore nuk u kushtohej vëmendje duke i lënë si godina në gjendje të mjerueshme, të ndërtuara shpejt pa kushtet përkatëse për zhvillimin e mësimit, e të higjienës. Ndërkohë që shkollat e borgjezisë e ato të sponsorizuara nga kisha ose xhamia paraqiten si ndërtesa më madhështore. "Për sa i përket arkitekturës së shkollave ato duhet të ishin ndërtesat më të bukura në fshat mbas ndërtesës se kultit." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004) (Figura 71)

Fizionomia e shkollave private ose ato të sponsorizuara nga kleri ose nga Austro-Hungaria kishin kushte mjaft të mira e ofronin mjedise të mëdha si për shembull shkolla e Shkodrës *"Kolegji Saverian i Jezuitëve"* (Figura 72) përmendet si një nga shkollat më të përparuara të kohës e gjithashtu e krahasueshme me shkollat nëpër Evropë. Faik Konica shkruan: "të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e përgjithësisht të Evropës mund të dëshmojnë se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë për t'u vënë në një me to." (Kazazi, 1997, f. 57) Shkolla kishte edhe 2 mjedise kabinetesh të pasura me mjete mësimore për fizikën dhe kiminë. (Koliqi, 2002, f. 45)



Figura 71. *Pamje e shkollës në Resmë, Niazi Beu gjatë ndërtimit të shkollës, foto e 1909. Burimi: AQSH.*



Figura 72. *Pamje me rastin e 50 vjetorit te Kolegjit Saverian "Jezuit", i hapur më 1877 në Shkodër. Burimi: AQSH*

Shkollat private duke qenë se kishin fonde të mëdha kishin mjedise të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve mësimore si salla praktike e gjithashtu mjedise për teatro ku mblidheshin jo vetëm nxënësit por edhe banorët përreth. Kazazi shkruan për jetën kulturore të qytetit të Shkodrës dhe përmend se ajo favorizohej pikërisht nga kushtet e volitshme që kishin krijuar shkollat; teatri i Kolegjas Saverjane ishte më i vjetri ndërtuar më 1890 me 450 vende, teatri i

Kolegjës Franceskane me 300 vende, teatri i shkollës Stigmatike me 300 vende, teatri i shkollës së Parrucës me 400 vende etj. (Kazazi, 1997, f. 117)

Mbi historikun e zhvillimit të arkitekturës së shkollave në Shqipëri ka shumë pak informacione dhe të analizosh këto godina është mjaft e vështirë e gati e pamundur. Arkitektura e ndërtesave të shkollave shkon përkrah me përhapjen e gjuhës Shqipe nëpër territore dhe zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Për përpjekjet e mësimit te gjuhës amtare, Sami Frashëri ka shkruar: "Shkronjat Shqipe u përhapën në të gjitha anët e Shqipërisë dhe të gjithë mësuam në pak kohë të shkruajmë e të këndojmë. Shqiptaret janë mësuar të nxënë shkronjat edhe pa shkollë, nëpër sheshe".[4]

Nënkuptohet se godina e ndërtesa të mirëfillta shkollash kishte shumë pak e gati fare. Gecaj nënvizon faktin se nën zgjedhën e Turqve kishte mjaft vështirësi në gjetjen e hapësirave të mësimit e shpesh zhvillimi i mësimit kryhej në shtëpitë e vetë mësuesve, a në vende të tjera të improvizuara "...mësuesi Refik Toptani u jepte nxënësve mësimin e Shqipes fshehurazi e më pas ai e ktheu shtëpinë e tij në shkollë. Ndërsa Mahmut Fortuzi u mësonte fëmijëve shqipen në dyqanin e tij. Në vitin arsimor 1911-1912 në Shëngjergj shkolla u hap në shtëpinë e një fshatari me mësues Ramiz Hatibin. (Gecaj, 2008, pp. 61-62). I këtij mendimi është edhe studiuesi Bakiu i cili përmend ndërtesën e shkollës që u hap në shtëpinë e Osman Elezit me mësues Filip Ashikun në 1889. " Ndërtesa ka qenë një shtëpi dykatëshe. Me shkallët që ishin nga mbrapa mund të ngjiteshe në katin e sipërm ku kishte dy dhoma të vogla e një sallë ku bëhej mësim. (Bakiu, 1998, f. 142) (Figura 73)



Figura 73. *Shkolla e Filip Ashikut, në të djathtë të Rrugës së Dibrës , sot Hotel Miniri, Tiranë. Foto e viteve 1920. Burimi: kartolinë koleksion privat.*

Të gjitha këto informacione e studime tregojnë qartë që zhvillimi i shkollave në Shqipëri ishte ende në hapat e saj të parë, dhe nuk pati një arkitekturë të mirëfilltë e të organizuar por

[4] Çaushi, A. "Fletë nga historiku i shkollës sonë", Tirane, 1963. Cituar nga (Dedja, 2003)

përshtatje të ndërtesave ekzistuese nga ambiente banimi në ambiente shkollash. "Mësimi këtu bëhej fshehurazi, nëpër shtëpi të ndryshme, në dyqane, e deri në burgje. Pak e nga pak qendrat mësimore nisën të luanin rolin e shkollave në gjuhën shqipe, megjithëse janë të kuptueshme vështirësitë që dilnin. Ato vepruan që nga Çamëria, Korça, Gjirokastra, Kolonja, Kavaja, Tirana, etj., në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë e Dibër." (Gecaj, 2008, p. 211) (Figura 74)



Figura 74. *Pamje e shkollës fillore të Opojës. Ish banesë e qytetareve të zonës e kthyer në shkollë. Burimi: AQSH*

Për sa i përket organizimit nëpër këto shkolla, në këtë periudhë mendohet se kishte vetëm ambiente klasash, kjo për shkak edhe të adaptimeve të banesave dhe mobilimit nga dhoma gjumi në klasa mësimi. Për këtë arsye këto shkolla ishin vetëm me 1- 2 ose tre klasa në maksimumin e tyre. Shumë shpejt me rritjen e numrit të nxënësve, shumë ndërtesa nuk i plotësonin më kërkesat në rritje të shkollave. Në këtë periudhë sipas të dhënave të ndryshme në qytete të Shqipërisë filluan të ndërtohen shkollat e para ku si për bazë kishin klasën e mësimit e disa ambiente të tjera ndihmëse. Siç përmend autori Gecaj në librin e tij "kryesorja ishin klasat për mësim, por u punuan edhe salla për punë dhe seminaret e ndryshme." (Gecaj, 2008, p. 166)

Ndërkohe nëpër botë ishte përhapur në masivitet shkollat "1 dhomë-she" të cilat sipas studiuesve, më shumë se për tu mësuar edukimin, shkollat e para "një dhomë-she" ishin për të mbledhur fëmijët e varfër e për ti hequr nga rrugët e qyteteve. "Shkollat organizoheshin nëpër kisha, kapela, banesa të konvertuara, hambarë, etj. Kushtet nëpër këto shkolla ishin shumë të këqija e ideja për të përhapur arsimin në fëmijët e varfër filloi në shumë shtete". (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Edhe kur shkollat ndërtoheshin me synimin e një ndërtese arsimore (si p.sh. rasti i shkollës së Tragjasit) përsëri arkitektura e saj nuk veçonte nga ndërtesat e tjera të fshatit e të zonës. (Figura 75)





Figura 75. *Majtas-Shkolla e Tragjasit*[5] *sipas kujtimeve të Xhemal Imerit (Imeri, 2003, p. 40). Djathtas- Pamje e shkollës në ditët e sotme.*

Duke qenë se shumica e këtyre shkollave ishin të pa legalizuara nga qeveria osmane shpesh ato u mbyllën duke u djegur, shkatërruar e bastisur. Nga numri i madh i shkollave që u hapën në fillim të shekullit të XX, kanë ngelur një numër i papërfillshëm dokumentesh që flasin për to, e gjurmë të pakta strukturash që i kanë rezistuar kohës, pasi ndërtimet e tyre kryesisht me materiale qerpiç e gurë i kanë bërë ato të pa rezistueshme.[6] (Figura 76)







Figura 76. *Shkolla e vajzave ne Korçë e motrave Qiriazi. Pamje nga jashtë e ndërtesës së shkollës si dhe nga brenda ku duket holli i veshur me dru. Burimi: (Muzeu Historik Kombetar, 2016)*

Arkitektura e tyre ngjasonte me ndërtimet e kohës pasi në shumicën e rasteve vinte nga një ndërtesë banimi e shpesh edhe për arsye monetare e kohe improvizohej duke i përshtatur nga ndërtesa banimi në ndërtesa arsimore. E tillë ishte edhe *'Normalja e Elbasanit'* e cila përfaqësohej nga një ndërtese kompakte me 2 kate e me çati, e ngjashme me ndërtesat dhe

[5] E ndërtuar më 6 Mars 1890 nga vajza e nipi i Ariz Ferhatit i cili ndihmoi me kapitalin e tij për ndërtimin e shkollës së fshatit. Mësimi me parë kryej në ndërtesën e xhamisë së fshatit. Në vitet 1912-1913 shkolla filloi të fliste në gjuhën shqipe. (Velaj, 2004) Në vitet 1914, bëri mësim Avni Rustemi. U dogj së bashku me fshatin në 1943. Edhe kjo shkollë e ndërtuar posaçërisht për ndërtesë arsimore paraqitet e ngjashme me ndërtesat e banimit.

[6] Kur u mbyllen nga turqit me 1910 shkolla e motrave Qiriazi ishte e vetmja qe u mbajt pasi gëzonte mbështetjen e amerikaneve prandaj ajo ndërroi emër e u quajt " Shkolla amerikane. Cit. Xhon Kuanrud, 'Besë, shpresë dhe dashuri, jeta e Gjerasim Qiriazit, fq 219.

arkitekturën e godina të banimit të Shqipërisë së mesme, pasi ndërtesa e shkollës u vendos fillimisht në një godinë banimi private e më pas një godine banimi tjetër u bë konvikti. Shkolla kishte 6 klasë ku 3 përgatitore me karakter të përgjithshëm dhe 3 me karakter profesional. (Koliqi, 2002, f. 206) (Figura 77)



Figura 77. *Ndërtesa ku u krye Kongresi i Elbasanit në Shkollën Normale të Elbasanit.*

## 3.2 ARKITEKTURA E NDËRTESAVE ARSIMORE NË VITET 1912-1925

Për shumë studiues okupimi turk mbas gati 5 shekujsh të rëndë dominimi të filluar që në 1400 kishte provokuar ndryshime të forta sociale, ekonomike dhe kulturore. "... duke i dhënë arkitekturës së qyteteve Shqiptare karakteristika të afërta me qytetet myslimane otomane". (Vokshi, 2014, f. 17).

Nga numri i vogël i nxënësve dhe i shkollave në Shqipërinë e pavarur e jashtëzakonisht të varfër e në vështirësi të mëdha nënkuptohet që në këtë periudhë përparësi kishte përhapja e arsimit e jo një arkitekturë e menduar mbi këto ndërtesa e institucione.

Dokumentet flasin për një kërkesë të madhe për arsim me gjithë mungesën e vendeve e hapësirave të mësimit, "shumica e lokaleve ishin të ftohtë dhe pa bazën e nevojshme materiale". Në kujtimet e një mësuesi të kohës shkruhet: "klasa ime e parë e zhvillonte mësimin në korridorin e shtëpisë. Për të hyrë në zyrën e tij, ministrit Luigj Gurakuqi i duhej të kalonte nga klasa ime..." (Kashari 2003, 280).

"Ndërtesat shkollore në përgjithësi ishin të vjetra dhe pa bazën e nevojshme materiale. Paraqiteshin më mirë vetëm shkollat qendrore në qytetet kryesore. Ndërsa në fshatra pa pritur

të ndërtoheshin godina të reja, mësimet filluan të zhvilloheshin nëpër shtëpi, kasolle, e haure, që u përshtatën në shkolla nga fshataret dhe mësuesit."- (Kashari 2003, 281) (Figura 78-79)



Figura 78. *Majtas: Pamje e shkollës fillore në Bradashesh, Elbasan; djathtas: Pamje e shkollës në fshatin Dragosh të Malësisë së Madhe. Ish banesa të kthyera në ndërtesa shkollash. Burimi: AQSh*

Nga dokumentacionet e kohës kuptohet që ndërtesat e godinat e shkollave fillore në këtë periudhë nuk u përgjigjeshin kërkesave të kohës, kjo për shkak edhe të fondeve të pakta që ato kishin në dispozicion. Siç shprehet edhe studiuesi Iliaz Gogaj i cili është marrë me studimin e ndërtesave të shkollave shqiptare "pjesa më e madhe e ndërtesave shkollore të rrënuara nga koha, nuk u përgjigjeshin as kërkesave higjienike." (Gogaj, 2003, p. 468) Gjithashtu një numër i mirë i mjediseve shkollore ishin vendosur në ndërtesa private.



Figura 79. *Majtas-Shkollë fillore ne Malësinë e madhe. Burimi AQSH. Djathtas-Ndërtesa e Gjimnazit te Parë të Tiranës*[7]*, fotografi e vitit 1930, Burimi: (Bakiu, 1998)*

Arkitektura e ndërtesave shkollore në vendin tonë i cili sapo kishte dalë nga lufta me Perandorinë Osmane ngjason me ndërtimet e banesave në krahina të ndryshme të Shqipërisë, kjo edhe sepse në shumicën e rasteve ishte një ish ndërtese banimi ose një ish kazerme, si në rastin e gjimnazit të Tiranës. (Figura 79) Ndërtesat shkollore paraqesin karakteristikat e ngjashme me ato të banesave me çardak, të tipit me qoshk, me hajat, me vatër zjarri ose e të tipit kullë si në rastet e shkollave të veriut. (Figura 80-81)

[7] Ndërtesa e marrë me qira funksionoi si gjimnaz e ishte në hyrje të Rrugës se Kavajës te 'Dhoma e tregtisë'. Në këtë ndërtesë bënin mësim edhe nxënësit e Shkollës Ushtarake të Tiranës në vitet 1928-1930.



Figura 80. *Nxënësit dhe shkolla e lagjes së Manalatit, Gjirokastër. Burimi: AQSH*



Figura 81. *Tipologjitë e banesave me karakter jo mbrojtës në Shqipëri. Nga e majta në të djathtë: Banesa me vatër zjarri, tipi me hajat, tipi me çardak, dhe tipi me qoshk. Burimi: Emin Riza dhe Pirro Thomo.*

Projektet e para të shkollave në Shqipëri janë të lidhura me influencat e huaja. Duke qenë se vendi ynë dilte nga një periudhë e gjatë pushtimi njohuritë mbi nevojat dhe kërkesat për ndërtimin e shkollave ishin të pakta. Gjithsesi vendet perëndimore si Austria, Franca, Italia e gjithashtu e Greqia duke dashur të përhapnin influencën e tyre nëpër territoret shqiptare menduan se një mënyrë ishte edhe nëpërmjet arsimit e gjuhës së huaj e për këtë ndërtuan një sërë institucionesh arsimore në vendin tonë.

Duhet pranuar se këta ‘pushtues të arsimit’ ndërtuan godinat e para të mirëfillta në funksion të mësimit e shpesh i kthyen edhe qendra të fshatrave të vegjël duke ofruar ambiente ndihmëse rreth saj, si ambulancë, dhoma pune, shfaqjesh etj. Studiues mendojnë që shkollat e kësaj periudhe nëpër Evropë ashtu si edhe në Shqipëri, morën një pamje e fizionomi tjetër.

Në disa prej ndërtesave të shkollave të ndërtuara në vitet 1912-1925, dallojmë elemente të reja në arkitekturën e këtyre ndërtesave, në volumet e transformuar, në funksionet e bashkangjitura, jo më si ndërtesa banimi, e jo vetëm klasa mësimi por edhe funksione si biblioteka, salla-teatro, salla laboratorësh etj.

- *Liceu Kombëtar i Korçës*

Liceu Kombëtar i Korçës (25 tetor 1917), ishte një shkollë e mesme e përgjithshme me 9 vite mësimi krejtësisht sipas modelit të shkollës Franceze. Shkrimet flasin se ndërtesa ishte e mirë dhe e përshtatshme për mësim. Ndërtesa e shkollës kishte një bibliotekë të madhe me mbi 1500 volume dhe në çdo klasë kishte rafte me mbi 600 libra mësimore. Pedagogët Francez e mësimet në gjuhën e huaj e gjithashtu programet e metodologjitë e bënë Liceun një shkollë të njohur në Shqipëri por jo vetëm. (Gogaj 2003, 480) Duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara , Gogaj shprehet se vetëm liceu i Korçës u vendos në ndërtesën moderne e cilësore me kërkesa pedagogjike e higjienike të realizuar me investime e donatore Shqiptare. (Gogaj, 2003, p. 469) (Figura 82)



Figura 82. *Pamje e Liceut Kombëtar të Korçës. Fotografi e viteve 1920. Burimi: AQSH*

- *Gjimnazi "Iliricium"-*

Më 1921 u hap gjimnazi i françeskanëve Iliricium mbi bazën e shkollës fretnore të vitit 1861. Gjimnazi "Iliricium"- i klerit françeskanë , Shkodër- ishte shkollë private e cila nga të dhënat e pakta që figurojnë kishte ambiente, mjete mësimore, pajisje, si dhe mjedise për veprimtari kulturore, artistike, e sportive mjaft të mira. Nga të dhënat vetëm salla e teatrit të gjimnazit ishte me mbi 300 vende. (Kashari 2003, 477)

Në këtë periudhë në Shqipëri pati influenca të shumta nga shumë shtete të huaja, jo vetëm politikisht por edhe me kulturën e tyre, traditat mësimore etj. Ndër to ishte edhe Amerika e cila hapi tek ne edhe institucione arsimore siç ishte "Instituti Teknik i Kryqit të Kuq të të rinjve Amerikane" [8] ( më vonë shkolla Harri Fulc-ose Shkolla e Mesme Teknike e cila i hapi dyert me vitin arsimor 1921-1922 dhe ishte shkollë teknike profesionale shumëdegëshe). (Gecaj, 2008, p. 183).

- *Shkolla e Mesme Teknike*

Për herë të parë në Shqipëri u ndërtua një shkollë që ishte me tepër se një vend mësimi, por edhe argëtimi, e grumbullimi etj. Shkolla e mesme teknike kishte edhe ambiente të tjera përreth për mësimin e aftësimin e nxënësve nga ana teknike. (Figura 83)



Figura 83. *Pamje anësore e Shkollës së Mesme Teknike, themeluar në 1921. Burimi: (Bakiu 1998)*

E themeluar në vitin 1921, dhe me drejtor Harry T. Fultz shkolla zë vendin qendror në shkollat profesionale teknike në vendin tonë. Praktikat mësimore më shumë se sa në laborator, u zhvilluan me sukses në fermat komplekse bujqësore e blegtorale të shkollës në ofiçinat e punishtet e saj, (Gogaj, 2003, p. 494). Kjo shkollë ishte si një fabrikë prodhuese ku shkolla jo vetëm prodhonte dije për nxënësit por edhe prodhime të ndryshme të cilat konkurronin në treg.

[8] Shkolla Teknike Shqiptare "The Albanian Vocational School' në Tiranë hapur më 21 korrik 1921 nga Kryqi i Kuq i Rinisë Amerikane kishte si bazë teorike dhe praktike të kësaj shkolle pedagogjinë pragmatiste amerikane, (instrumentalizimi, progresivizimi, aktivizimi, pedocentrizimi, rikonstruksionizmi). Duke u mbështetur në pedagogjine pragmatiste të John Dewey, sipas të cilit 'shkolla është bashkësi', 'edukata është jetë', veprimtaria e shkollës mbështetej në parimin themelor 'Mësojmë duke punuar'. (Koliqi, 2002, p. 392)

Në shkollën e Mesme Teknike vihet re parimet që po përhapeshin gjerësisht në Amerikë e cila kishte ndryshuar rrënjësisht arsimin, me teoritë e edukuesit John Dewey dhe të William James të cilët sugjeronin që edukimi duhej të bazohej në një koncept më të gjerë e duke e bërë atë pjesë e integruar e procesit të jetës. Nxënësit do të mësonin duke punuar në praktikë e duke u integruar me njeri tjetrin. (Pasalar, 2003)

Në praktiken bujqësore dhe blegtorale shkolla kishte fermën e Laprakës me 25 Ha, dhe atë të Yzberishtit me 10 ha. Me një sipërfaqe territori rreth 20,000 $m^2$ ofronte për praktiken industriale artizanale, ofiçinë metalike, punishte druri, central elektrik, fabrikë akulli, sektorë ndërtimtarie, tipografi, mulli bloje, furrë buke, qendër sinoptike, dyqan mallrash të ndryshme, shërbim postar dhe telegrafik, dhe bankë monetare. Të gjitha këto funksione e kishin kthyer këtë shkollë jo vetëm një ndërtesë mësimi po një qytet në miniaturë ku mësohej gjithçka në praktikë. “Ideja ishte që fëmijët të mësonin në çdo cep të shkollës dhe çdo ambient të përdorej për mësim. ‘Shkolla konceptohej ‘trup, mendje e ambient’.” (Crowley, 1933)



Figura 84. *Planvendosja e ndërtesës së shkollës së Mesme Teknike dhe të territoreve përreth.*[9] *Burimi: AQTN.*

Ashtu si dhe në Amerikë e në Evropë u investua për shkollat me 2-3 ose 4 kate ku ndërtesa duhej të përfaqësohej nga një godinë e rëndë dhe e stërmadhe, me qëllimin e imponimit, dhe e krijimit të ndjenjës së disiplinës e rëndësisë. (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

Planimetria e shkollës paraqitet me një simetri qendrore ku theksohet momenti i hyrjes dhe shpërndarja bëhet nëpërmjet një korridori të ngushtë. Kjo lloj skeme do të bëhet modeli i shumë shkollave të përhapura në Shqipëri më vonë.

Ndërtesa kryesore e shkollës dhe më pas më 1928 edhe ndërtesa e shkollës normale e konviktet paraqiten në tërësi si një nga komplekset më të mira në qytetin e Tiranës, për shkak të madhësisë që kishte, hapësirave e monumentalitetit të saj. Ajo kërkon të imponohet edhe nëpërmjet ngritjes në mbi 10 shkallë mbi kuotën e territorit. Dritaret e klasave kanë nga një kornizë të lehtë përreth dhe theksohen katet nëpërmjet kornizave të dala. Shkolla ka 3 hyrje ku

9 Ndërtesa e shkollës është me vijë të kuqe.

kemi hyrjen qendrore më të evidentuar si dhe dy hyrje anësore më të thjeshta. Shkolla paraqitet me simetri por me rikonstruksionin e 1938 u shtua një volum i ri anësor që ishte korpusi i shkallëve. (Figura 85)



Figura 85. *Plani i katit përdhe dhe të parë, i Shkollës së Mesme Teknike gjatë rikonstruksionit në vitin 1941, të kryer nga Italianët për pajisjen me nyje sanitare si dhe të një shkalle sekondare në pjesën anësore. Shkolla u quajt Instituti Teknik Nana Mbretëreshë. AQTN*




Figura 86. *Pamje e shkollës së Mesme Teknike , viti 1922, Marrë nga AQSH*

Kjo dukej edhe nga pamja e shkollës e cila tani më nuk përngjante më, me banesat por më tepër me ndërtesa monumentale e te rëndësishme të qytetit të Tiranës. Siç përmend Burke në librin

e saj *School*: "të kuptosh një shkollë në një siluetë urbane nuk është e vështirë. Megjithëse mund të ketë elemente arkitektonike të përbashkëta me ndërtesa publike e institucione të tjera, shkollat zënë vend shpejt në një hapësirë dhe rrallë ngatërrohen me ndërtesa të tjera"- (Ian Grovenor, Catherine Burke, 2008, p. 8)

"Më vitin 1927 u thirr arkitekti austriak Hans Koehler i cili se bashku me inxhinierë Shqiptarë si Skënder Frashëri u morën me planin rregullues të Tiranës (aksin Monumental)." (Vokshi, 2014). Arkitekti Koehler më 1927 projektoi ndërtesën e konvikteve e sallave të Shkollës së Mesme duke e plotësuar kompleksin arsimor e duke e kthyer në parimet e John Dewey-t "*learning by doing"*(të mësosh duke punuar). Ndërtesa do të ishte më shumë se një godinë mësimi, duke ofruar për herë të parë ambiente argëtimi, sallë ngrënie, teatri, kuzhinë, mensë, tualete, dushe, etj., ambiente që më parë në Shqipëri ishin të panjohura, për ndërtesat e shkollave.

Pas një periudhe të gjatë ku shkollat në Shqipëri përfaqësoheshin më tepër nga godina banimi, magazina, sheshe, e ambiente të tjera të papërshtatshme, godina e Shkollës se Mesme Amerikane përfaqësonte një risi e një ndryshim rrënjësor në imazhin dhe simbolikën e shkollës. Hapësirat të cilat ajo ofronte me sallën e madhe të teatrit me hapësirë 10*29 metra e me një lartësi 5 metër u kthye shpejt jo vetëm një ambient që shfrytëzohej nga shkolla por edhe nga komuniteti.




Figura 87. *Plani i katit të podrumit të konvikteve të shkollës së Mesme Teknike, ark. Koehler. 1927-1928*

"…U gjallërua e jeta kulturore. Shkolla gumëzhinte nga këngët atdhetare, recitimet, e veprimtari të tjera argëtuese, ku shkonin edhe prindërit." (Gecaj, 2008, p. 73)

Arkitekti tregon ndjeshmëri jo vetëm ndaj futjes së ambienteve të reja në brendësi të shkollës por edhe për fasadën e jashtme dhe elemente të ndryshëm arkitektonik.

Megjithëse ndërtesa kishte funksion primar konviktin, arkitekti austriak i frymëzuar nga parimet e arkitekturës progresive dhe asaj moderne duket se sjell arkitekturës elemente

moderne të shkollave. Ai kërkon të fusë një stil më të lehtë, me dritare të mëdha, të orientuara nga jugu, me kolona betoni të pastra e të larta dhe një pastërti e thjeshtësi nga frizat e monumentalit të shkollave të 1900. Ndërtesa duket se shkon përkrah me arkitekturën '*open air*' aq shumë të predikuar nga progresistët modern.




Figura 88. *Plani i katit të podrumit e plani i katit të sipërm të konvikteve të Shkollës Teknike amerikane. Ark. Kohler, 1927-1928. Burimi: AQTN*



Figura 89. *Pamje nga jugu i ndërtesës së konvikteve të Shkollës Teknike amerikane. Ark. Kohler, 1927-1928. Burimi: AQTN*

Në vitin 1933 shkolla ndërroi edhe ndërtesën (Në godinat që gjendet sot, në Rrugën Asim Vokshi) dhe në bazë të reformës Ivanaj, shkolla e vjetër, u shtetëzua duke u kthyer në "Instituti Teknik Femëror Nana Mbretëreshë". Instituti u hap me 2 tetor 1933. Në vitet 1937/1938 u bë më e madhja shkollë në Shqipëri, pasi ishte një nga shkollat e pakta që ofronte punë mësimore dhe punë praktike. [10] (Figura 90) (Gecaj, 2008)



Figure 90. *Pamje të shkollës "Politeknikumi 7 Nëntori" viti 1947– dikur ish Shkolla e Mesme Teknike, "Harry Fultz". Burimi: AQTN*

Në vitin 1938, rikonstruksioni i Institutit femëror Nëna Mbretëreshë iu la një inxhinieri ku objektit i shtuan edhe një kat duke e transformuar dhe e shkatërruar nga hijeshia dhe pamja e saj e dikurshme, dhe duke hedhur poshtë të gjitha parimet e arkitekturës moderne që arkitekti austriak kishte përdorur. (Figura 91)

[10] Më 1945 u hap si shkollë 'Politeknikumi 7 Nëntori' për djem dhe vajza bashkë.







Figura 91. *Sipër, Pamja nga jugu e ndërtesës së projektuar nga arkitekti austriak Koehler, më 1928, poshtë rikonstruksioni dhe shtesa e katit më 1938. AQTN*

- <u>*"Instituti Femëror Kyrias" Kamëz, Tiranë.*</u>

Amerikanët, me nocionet e "shkollës-fabrikë-qytet" dhe se nxënësi mësonte më mirë duke punuar, investuan nëpërmjet motrave Qiriazi edhe për shkollën e vajzave, që mori emrin "Instituti Femëror Kyrias". (Figura 92, 93) Kjo shkollë e mesme private e tipit të kolegjit Amerikan, u zhvillua në vitet 1925-1933. Motrat Qiriazi të frymëzuara nga shkollat dhe rrymat pedagogjike Evropiane e kthyen këtë shkollë në një institut shumë përparimtar për kohën. Një faktor me rëndësi që ndikonte në mbarëvajtjen e procesit mësimor ishte edhe mjedisi ku ishte vendosur shkolla. Shkolla fillimisht ishte vendosur në banesë me qira e më pas u transferua në Kamëz. "Jo pa qëllim zgjodhën shtëpinë e Kuseve, e cila ishte 10 minuta larg qendrës së qytetit. Kjo veç anës funksionale, që iu përshtat, plotësonte kërkesat dhe preferencat që ato kishin në radhë të parë për ta pasur sa më larg qendrës së banuar, dhe së dyti për ta pasur atë midis natyrës së bukur dhe tërheqëse, e cila luante një rol të rëndësishëm në edukimin e tyre". (Dishnica, 1997, p. 162)

Ledita Mezini



Figura 92. *Pamje e Institutit Femëror Kyrias, Burimi AQSH.*



Figura 93. *Pamje anësore të shkollës "Instituti Femëror Kyrias", Kamëz. Burimi (Muzeu Historik Kombëtar, 2016)*

Më 1927 u transferua në ndërtesën e re në kodrën e bukur të Kamzës. Falë kushteve të mira materiale, (shkollë, konvikt, dhe tërë pajisjeve të tjera përkatëse, së bashku me terrenet sportive", Instituti Kyrias u kthye në shkollë elite dhe mjaft e kërkuar nga të gjithë e shpesh e krahasuar me shkollat e vendeve perëndimore. Për sa i takon arkitekturës së ndërtesës nga fotot tregohet se ndërtesa vazhdon të mbajë nocione të shkollave eklektike dhe përdorte arkitekturën e rëndë e monumentale me kolona të stilit dorik, me korniza, friza e me muret me

veshje qeramike të shkollave të 1900, por si ide, e si parime për mbarëvajtjen e saj motrat Qiriazi krijuan një "shkollë për të nesërmen". "Shkollat e të nesërmes ishin një qytet kopsht për fëmijët, të vendosura nëpër periferi e ofronin gjithçka." (Ensor, 1925)

- *Gjimnazi i Shkodrës, e i Tiranës*

Ndryshe qëndronte çështja me bazën materiale të shkollave të mesme të përgjithshme. Ndërkohë që në shkollat private fondet ishin të mëdha shkollat e mesme publike paraqiten në gjendje të dëshpëruar. Mësimi kryhej në ish kazerma, ish spitale, e ish banesa... "Fillimisht , shkollat e mesme ishin vendosur në ndërtesa të pa-përshtatura për këtë qëllim, dhe në përgjithësi ato vuajtën nga ngushtica e sipërfaqeve. Gjimnazi i Shkodrës (Figura 94) dhe i Tiranës u përshtatën nga ish kazerma të ushtrisë turke."- (Gogaj, 2003, p. 469)



Figura 94. *Gjimnazi i Shkodrës i hapur më 1922, sot "Gjimnazi 28 Nëntori", Pamje në ditët e sotme.*

Ndërkohë edhe Gjimnazi i Tiranës, (Figura 91) shquhej për mungesë të hapësirave, ku deri në vitin 1928/1930 në të njëjtin ambient zhvillonin mësim edhe nxënësit e Gjimnazit Ushtarak të Tiranës.[11] Në vitet 1934/1935 gjimnazi i Tiranës u vendos në ambientet e ish Kazermës "Skënderbeg' të kryeqytetit. Gjimnazi i Parë në kryeqytet, sot quhet "Gjimnazi Qemal Stafa." (Gogaj, 2003, f. 469)

[11] Ndërtesa e marrë me qira që u përdor për Gjimnazin e Tiranës ndodhej në qendër aty ku është sot Ndërtesa e dhomës së Tregtisë.




Figura 95. *Prerje, plani i katit përdhe dhe i katit të parë të Gjimnazit të Shkodrës, sot i quajtur Gjimnazi 28 Nëntori. Pamje të palestrës e të një klase në ditët e sotme.*[12]



Figura 96. *Pamje e shtëpisë që funksionoi si Gjimnazi i Tiranës dhe foto e shkollës Ushtarake të Tiranës.*

[12] Ndërtesa e Gjimnazit të Shkodrës paraqitet me kushte të papërshtatshme për kryerjen e një mësimi normal duke qenë se është e adoptuar nga një ish kazermë ushtarake e ndërtuar nga ushtria Osmane.

Ledita Mezini

- "*Institutit Tregtar të Vlorës*"

Edhe ndërtesa e "Institutit Tregtar të Vlorës" u adaptua nga një ish spital i vogël i ndërtuar me shpejtësi dhe me idenë se do ishte provizor nga Italianët rreth viteve 1918-1920. Si shkollë nisi punën më 1924.



Figura 97. *Instituti Tregtar i Vlorës, foto e vitit 1927, Burimi: AQSH*

Vendet e huaja, Franca, Italia, Austro-Hungaria, Greqia po përpiqeshin të merrnin pushtetin e të mbizotëronin territoret duke përhapur gjuhën e tyre, arsimin, nëpërmjet edhe ndërtesave e arkitekturës e ideve të vendit që përfaqësonin. Vitet 1920 ishin vitet kur arkitektura e disa godinave të shkollave kishin një arkitekturë me influenca Austro-Hungareze. Sipas Vokshit "rivaliteti luhet i gjithi në tentativën për të vënë mbizotërimin nëpër territoret Shqiptare" ku Austro-Hungaria kërkonte të kishte kontroll në Adriatik e gjithashtu Italia filloi të tregonte se ishte e pranishme që në fundin e shekullit të XIX-të. (Vokshi, 2014, f. 15). Një projekt shkolle i kësaj periudhe është projekti i liceut dhe konviktit të vajzave në Tiranë.

- *Lice dhe konvikt (Internat) austriak për vajza*

Liceu, i vitit 1924, në Tiranë, është një ndërtesë dy katëshe ku arkitekti austro-hungarez, ri-sjell arkitekturën e shkollës me hollin qendror e dhomat e mësimit përreth. Pavarësisht se nuk kuptohet nëse shkolla ishte një projekt i ri apo një adaptim të një ndërtese ekzistuese, shkolla paraqet interes për bërthamën sociale që lidh gjithë funksionet. Nga planimetritë e katit përdhe dhe të katit të parë kemi ndarje funksionesh ku kati përdhe shërbente për salla leksionesh, paradhoma, ambiente gatimi e lavanderie, ndërsa kati i parë me ambiente banimi e fjetjeje. Holli është e vetmja pikë ku shkolla bashkohet dhe mund të bëhet kalimi nga një ambient në tjetrin. Shkolla paraqitet e ndryshme nga tipet e tjera pasi ajo zhvillohet me 4 hyrje në katin përdhe e dy hyrje në pjesën e sipërme, të cilat të nxjerrin direkt në anë të veçanta të oborreve.

Lëvizja me shkallë e me gjysmë kati bëhet ndoshta edhe për shkak të nivelit të terrenit. (Figura 98)




Figura 98. *Plani i katit përdhe dhe kati i parë i shkollës "Lice dhe konvikt austriak për vajza. 1924. Burimi AQTN*

- <u>*Shkollë fillore austriake e vitit 1922*</u>

Ndërkaq në shkollat tip fillore austriakët paraqesin një shkollë me 2 variante me 3 ose me 4 klasa mësimi. Shkolla fillore austriake paraqitet me 2 kate dhe ka 3 ose 4 klasa mësimi të cilat 2 ose 3 në katin e sipërm dhe 1 klasë së poshtmi. Në katin përdhe gjithashtu shkolla përmban një dhomë të vogël për drejtuesit në hyrjen e saj të parme si dhe nyje sanitare (3 copë), ambient gatimi, e depo në pjesën e hyrjes së pasme. Gjithashtu ne katin e poshtëm ka 2 ambiente dhomash që mund të kenë shërbyer për fjetje e për ngrënie. Klasat janë me përmasa 5.6 m x 8.3 m të mjaftueshme deri në 30 nxënës e që do të bëhen një standard për shumë shkolla deri në periudhën e regjimit komunist. Shkolla paraqitet me një simetri në fasadë e në volumet e saj ku holli është edhe qendra e ndërtesës.

Për sa i përket fasadës janë zhvilluar nga arkitekti dy tip fasadash me deviacione të vogla në të cilat theksohet momenti i hyrjes dhe ndarja e kateve nëpërmjet kornizave dekorative. Megjithëse pa shume ornamente ndërtesa paraqitet e ngjashme me arkitekturën austriake kjo edhe për shkak të dritareve të larta gati deri në tavan e aspak në lidhje me ato që ndërtoheshin më parë në Shqipëri rreth viteve 1920, si dhe të çatisë pak të tipit mansardë, ky jo një lloj mbulimi i përhapur në ndërtesat popullore Shqiptare. (Figura 99)

- <u>*"Shkolla me 7 klasë e tipit të ngushtë"*</u>.

Ndërkohë projektohet gjatë mbretërimit të Zogut edhe nga inxhinierë shqiptarë të cilët përdornin në shkolla një arkitekturë të rëndë monumentale e të stilit eklektik, ku bankat në rresht e nxënësit të ngjeshur shikojnë drejt mësuesit e dërrasës së zezë. E tillë paraqitet edhe *"Shkolla me 7 klasë e tipit të ngushtë"*.

Ledita Mezini




Figura 99. *Plani i shkollës me fjetje austriake e vitit 1924, me variantin me 3 klasa ose dhe me 4 klasa. Burimi: AQTN*

Nëse në Amerikë, shkollat e 1900 projektoheshin në të njëjtën godinë me hyrje të veçanta për vajzat ose djemtë e të ndara në dy pjesë të barabarta simetrike, në Shqipëri simetria ishte e përhapur në masë por jo në funksionimin e shkollës veçantë por thjesht në fasadë, pasi shkollat ishin të veçanta për djemtë e të veçanta për vajzat. Ky element kuptohet nga projekti i kësaj shkolle i cili paraqitet me dy variante, për pjesën e tualeteve, gjë që na bën të kuptojmë se

shkollat ishin ende të ndara për djemtë e për vajzat. Ndërtesa është me korridor në njërin krah dhe shpërndarja në klasa bëhet prej korridorit. Përgjithësisht këto shkolla me simetri në fasadë kanë simetri edhe në plan, por ky variant vendos palestrën në njërin cep dhe shkallën e nyje sanitare në anën tjetër duke e thyer pak simetrinë e volumeve në pjesën e pasme. Klasat me dimensione 6.20 x 7.50 metra janë të parashikuara sipas projektit për 48 nxënës. (Figura 100)



Figura 100. *Plani i katit përdhe të shkollës me 7 klasë , tip i ngushtë, Fasada ballore, si dhe plani i katit të parë. Burimi: AQN*

## 3.3 ARKITEKTURA E SHKOLLAVE NËN INFLUENCËN ITALIANE

Sipas marrëveshjes që lidhi më 28 qershor të 1928, qeveria shqiptare me atë Italiane do të hapeshin disa shkolla profesionale në Shqipëri dhe u investua nga fondi SVEA (*La Societa per lo Sviluppo Economico dell'Albania* – Shoqëria për zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë) në ndërtimin e 4 shkollave: në Shkodër, Gjirokastër, Korçë e Berat.

Studiuesit i përmendin këto shkolla për tipologjinë e ndërtesave, shkolla e Beratit, Gjirokastrës, më pas ajo industriale e Shkodrës etj., të cilat ishin të parat shkolla me kushte mjaft të mira e një risi në arkitekturën e shkollave në Shqipëri.

- *Shkolla profesionale e Gjirokastrës.*

Shkolla u hap me 3 janar të 1929, u quajt shkolla profesionale e Gjirokastrës dhe ishte një shkollë me program 4 vjeçar. (Figura 101) Drejtimi i shkollës profesionale të Gjirokastrës ashtu si dhe shkollat profesionale Italiane që u hapen më vonë ishte industrial- artizanal për teknikë, mekanikë (axhustator, elektricist, motorist, tornitor, farkëtar, e llamarinë-punues) dhe punim druri si (marangoz e gdhendës). (Gogaj, 2003, p. 500)



Figura 101. *Pamje e Liceut të vjetër të Gjirokastër përpara se të ri konstruktohej nga Italianët dhe foto e gjendjes ekzistuese.*

Në vitin 1940, Italianët propozuan disa ndryshime për ndërtesën e gjimnazit të Gjirokastrës ku u vendos të ndërtoheshin ngjitur edhe ofiçinat për punë profesionale.

Gjatë rikonstruksionit godina ekzistuese shtohet me shkallët e hyrjes dhe disa mure ndarës për mjediset e katit përdhe e atij të parë. Rregullime bëhen në fasadë duke i dhënë më monumentalit-et e rëndësi objektit. Gjithashtu shtohet edhe një kat i sipërm për të përmbushur nevojat për numrin e madh të nxënësve në rritje. Ndërtesa paraqitet me lëvizje volumesh si në pjesën ballore ashtu edhe atë të prapme. Megjithëse në plan shpërndarja bëhet nëpërmjet një korridori të gjerë që shkon mbi 4 metra kjo lëvizje ndërpritet në mes nga lëvizja vertikale e cila lidh edhe dy oborret e shkollës tej për tej. (Figura 102)




Figura 102. *Plani i katit përdhe dhe kati i parë i shkollës së Gjirokastrës me ndryshimet përkatëse, viti 1940. Burimi AQTN*

Ndërtesa e ofiçinave vendoset në krahun perëndimor të kompleksit dhe paraqitet me një arkitekturë tipike të objekteve industriale ku mbulesa e pjerrët hapet me ndriçim difuzë nga sipër nëpërmjet fanarëve të orientuar nga veriu. (Figura 103) Terreni i pjerrët e ndan objektin në dy volume paralele me disnivel mbi 1 metër. Arkitekti italian ka punuar mjaft mirë me territoret e pjerrëta përreth ndërtesës, sistemimet e jashtme e gjithashtu i ka kushtuar shumë vëmendje rritjes së pompozitetin e monumentalitetit në fasadë të përcaktuar nga arkitektura fashiste. (Figura 104)

Ledita Mezini




Figura 103. *Plani, fasada dhe prerja e ofiçinave të shkollës profesionale të Gjirokastrës. Viti 1940. Burimi: AQTN*




Figura 104. *Majtas: Plani i Vendosjes së Gjimnazit Profesional të Gjirokastrës si dhe të ofiçinave të tij. I. Ndërtesa ekzistuese e shkollës, II. Plani i vendosjes së ofiçinave. 1940 . Djathtas: Prerje e objektit të shkollës se Gjirokastrës. Burimi: AQTN*

Ndërtesa ekzistuese e shkollës shfaqet si 3 katesh-e në pjesën lindore e 2 katesh-e në pjesën perëndimore. Kjo ndërtesë megjithëse shumë më e madhe se shtëpitë Gjirokastrite paraqet mjaft elemente të përbashkët si përshtatja mjaft e mirë me terrenin, mbyllja e kateve te poshtme me dritare me hark e me të vogla dhe hapja në katet e sipërme me dritare më të mëdha e të larta, veshja me pllaka të mëdha guri në katin përdhe, dhe përdorimi i suvasë për pjesën e sipërme, si dhe stilizimi i elementeve të dalë të çatisë dhe i kornizave në ri sjellje të trarëve të nxjerrë të drurit në kullën gjirokastrite. (Figura 105)



Figura 105. *Pamje e projektit të perspektivës së rikonstruksionit të shkollës së Gjirokastrës. 1940*

- <u>*Shkolla industriale e Artit, Shkodër.*</u>

Shkolla u hap më 1 tetor të 1929. Arkitektit Florestano di Fausto iu dhanë të projektonte vepra të ndryshme administrative e publike ku mund të përmendim në 1929-1933 shkollën industriale të artit në Shkodër (sot spitali rajonal i Shkodrës). Viti i parë ashtu si në të katërt shkollat profesionale Italiane ishte përgatitor. Kjo shkollë më vonë u quajt edhe e artit të aplikuar ku u fut në program edhe reparti i plastikës me allçi dhe me baltë.



Figura 106. *Pamje të shkollës Industriale të artit nga mbrapa gjatë ndërtimit, 1929. Burimi:AQTN*

Ndërtesa e veshur me tulla në fasadën ballore vishet me ornamente në pjesën e sipërme, në atë të katit të poshtëm e të hyrjes kryesore e me korniza të rënda. Dritaret e larta në gjatësinë e katit, kornizat e trasha, dhe rrethimet e dritareve i japin kësaj godine një karakter të arkitekturës së ‘900-s. (Vokshi, 2014, p. 75) Ndërtesa paraqitet në plan në formën e një H-je. Vihet re një përpunim e trajtim shumë i madh në fasadën ballore e një thjeshtësi në dritare e korniza për sa i takon fasadave të tjera. Gjithashtu element i fortë dominues është momenti i hyrjes i cili

evidentohet dhe ngrihet monumental njësoj si në shkollën e Gjirokastrës. (Figura 106, 107, 108)



Figura 107. S*hkolla Industriale e Artit në Shkodër. Burimi: Armand Vokshi*



Figura 108. *Pamje gjatë ndërtimit të dy krahëve të godinës së Shkollës industriale të Artit në Shkodër dhe foto e gjendjes ekzistuese. Burimi: Armand Vokshi*

Mbi arkitekturën Italiane në Shqipëri janë shprehur shumë studiues dhe analiza e veprave të tyre është trajtuar gjerësisht. Marco Stigliano shprehet:

> Përdorimi i kornizave të rënda kat-shënuese, i kornizave dekorative në dritare, i dekorimeve të imta, i skulpturave, flasin një gjuhë plastike hijesh, dhe dritëhijesh, pjesësh të dala, dhe sprapsjesh të fillit të fasadës, një eksperiment i arrirë që sot duhet historizuar aq shumë, e që i japin karakter ndërtesave "në stilin e di Fausto-s'. Në rrafshin e sfondit të muraturës gdhenden kështu brezat e ndryshëm, që dalin në mënyrë progresive, që inkuadrojnë dritaret, zbukurimet që vënë në kornizë sipërfaqe katrore që mund të pasuroheshin edhe nga cikle piktoreske, kërcimet e përmbajtura të ballkoneve,

sergjenet me gurë çimentoje, dhëmbëzat dhe profilet e ndryshme të kornizave, por edhe gurët e latuar te pjesët bazamentale e kështu me radhë. (Stigliano, 2012)

Në thelb të qeverisë Italiane ishte ideja e krijimit të shkollave profesionale. Siç kemi përmendur , shkolla " Harry Fultz ose ndryshe Shkolla e Mesme Teknike e Tiranës kryente praktikat mësimore në mjedise që ishin më shumë se sa laboratorë, në ferma komplekse bujqësore e blegtorale të shkollës e në ofiçinat e punishtet e saj. Për praktiken bujqësore e para ishte ferma e Laprakës, me 25 ha. (Gogaj, 2003, p. 494)

- *<u>Shkolla bujqësore-blegtorale e shkollës Teknike.</u>*

Shkolla e përpunimit të bulmete-ve në Tiranë degë e institutit agrar të Shkollës së Mesme Teknike është një shembull i arkitekturës krejtësisht industriale e i shkollave të hapura nga Italianët me qëllim e zhvillimit të profesioneve në Shqipëri. Projekti i ardhur nga arkitektë Italianë përfshin 3 ndërtesa ku dy anësore për shkolla e një godinë qendrore ndihmëse e shërbimesh. Kjo shkollë na paraqitet me një strukturë të thjeshtë e funksionale ku njëkohësisht i kushtohej vëmendje mësimit dhe prodhimit. Në plan do të ndërtohej edhe një ndërtesë e trete e cila do të funksiononte për ambalazhime, kashta, shporta etj. (Figura 109)



Figura 109. *Plan vendosja e objekteve të shkollës bujqësore-blegtorale dhe pamje ndërtesës së shkollës se prodhimit të bulmetëve. Burimi AQTN*



Figura 110. *Perspektivë e shkollës se prodhimit të bulmetëve në Tiranë, projekt 1932. Marrë nga AQN.*

Ashtu siç vihet re edhe nga studimet e shumta e shkrimet e kësaj periudhe këto shkolla teknike nuk ishin vetëm vende mësimi por edhe prodhimi artikujsh të cilat konkurronin në treg duke futur idenë e ndërmarrjeve kapitaliste. Sot teoritë dhe studimet mbi shkollën vetë-prodhuese e për komunitetin po përhapen gjerësisht, duke këmbëngulur në faktin se “shkolla për të gjithë” do të jetë edhe shkolla e të ardhmes.

Duket se në këtë ndërtesë më shumë se të propozonin një arkitekturë të vecantë, projektuesit kërkonin një zgjidhje të pastër për funksionin e shkollës e të prodhimit, duke e propozuar atë si një volum katërtkëndorë me sipërfaqe rreth 137 m$^2$ (14 x 9.75) me dy kate. Të gjitha pajisjet dhe projekti i mobilimit erdhën nga Italia. (Figura 111)



Figura 111. *Plani i katit përdhe dhe i katit të parë i ndërtesës “Bulmetore dhe shkolla e Tiranës, pranë institutit Agrarë, Kamëz. 1932. Burimi AQN*

Për sa u takon shkollave fillore arkitektët Italian projektuan dhe ndërtuan edhe një numër të madh shkollash fillore të cilat fillimisht paraqiten si ndërtesa unike e më pas me përhapjen e influencës italiane nëpër shumë territore të Shqipërisë, si shkolla të tipizuara e standardizuara.

- *Shkolla fillore e Rrugës Bami.*

Shkolle fillore të kësaj periudhe kemi shkollën e ndërtuar në rrugën e Bamit, një ndërtesë 1 kateshe me 6 klasa mësimi. Nga plani i çatisë dallohet që kjo është një godinë me zgjidhje simetrike si në volum ashtu edhe nga brenda. Ambientet janë të vendosura me përmasa të njëllojta në dy anët e ndërtesës me aks simetrie qendror në momentin e hyrjes. Kjo shkollë e vitit 1929 e projektuar nga arkitekti Italian (*Pallovicino?*) është një ndërtesë që afron shumë nga elementet arkitektonike të përdorura në fasadë me disa nga godinat institucionale të projektuara nga Italianët në këtë periudhë. Vëmendje i është kushtuar detajeve të fasadës ku rreth e rrotull dritareve janë formuar korniza nëpërmjet suvatimit, që formojnë linja te kurbëzuara. E njëjta përkujdesje vihet re në momentin e hyrjes si dhe në elementet rrethues së oborrit të shkollës. Pavarësisht kësaj, godina paraqitet e thjeshtë në tërësi me një korridor qendror prej nga bëhet shpërndarja nëpër klasa. (Figura 112, 113, 114)



Figura 112. *Plani i çatisë se shkollës fillore të Varrit të Bamit- e vitit 1929, me arkitekt Italian Pallovicino dhe inxhinier Shqiptar Ismail Petrela.*



Figura 113. *Fasada Ballore e shkollës fillore të Varrit të Bamit- e vitit 1929, me arkitekt Italian Pallovicino dhe inxhinier Shqiptar Ismail Petrela.*



Figura 114. *Pamje e prerje e murit rrethues të shkollës Fillore në rrugën e Bamit.*

Në vitet 1932 Giulio Bertè (inxhinier e arkitekt shumë aktiv në Shqipëri mori pjesë në ndërtimin e planit rregullues të Burrelit e gjithashtu në ndërtimin e një numri të madh godinash e shkollash. (Vokshi, 2014)

- *Shkolla fillore për zonat malore.*

Nën rrymën e influencës Italiane kemi edhe godinën e shkollës fillore për zonat e malësisë. Arkitekti Italian Giulio Bertè ka projektuar një ndërtesë shkolle fillore me dy klasa. Në këtë godinë që afron me godinat e banesave të vendeve të ftohta ose të Alpeve të Evropës, vihen re për herë të parë disa elemente mjaft te rëndësishëm në projektimin e shkollave.

- Të dyja klasat janë të orientuara nga jugperëndimi. (Orientimi me i mirë është jugu-Juglindja ose jugu, për një ngrohje natyrale të ndërtesës.)
- Përmasat e klasave janë 6.50*5.50 metra e me një lartësi 3.8 m për maksimumin 42 nxënës. ( Sipërfaqja prej 36 metra katrore i jep një normë prej 0.85 $m^2$ për çdo nxënës.)
- Korridori është i gjerë 3.20 metër një distance e mjaftueshme për ndërveprim mes nxënësve e për gardërobë.
- Ndërtesa ofron edhe një dhomë të vogël për pajisjet e shkollës e gjithashtu një ambient të vogël për fjetjen e mësuesit. (Në këtë periudhë në Shqipëri mësuesit ishin të paktë në numër e detyroheshin të shkonin në këto vende për të dhënë mësim e të jetonin atje.) Një ambient fjetje për mësuesin së bashku me ambient gatimi e nyje sanitare do jetë një hapësirë që haset shpesh edhe në shkollat e mëvonshme të projektuara në vendin tonë. (Figura 117)
- Ka gjithsej 3 nyje sanitare që tregon një normë prej 1 nyje për çdo 28 nxënës. Në ndërtesë ka 3 hyrje. E para është hyrja kryesore nga rruga e mbuluar (Hajat), e dyta është hyrja nga oborri i brendshëm i shkollës, gjithashtu e mbuluar si dhe hyrja në ambientet e mësuesit.
- Klasat ndriçohen mjaft mirë në mënyrë natyrale nëpërmjet 3 dritareve të mëdha ku dy me përmasa 120 me 280 centimetër, dhe e mesit me përmasa 180*280 centimetër. Raporti 1/3 për sipërfaqen e ndriçuar me sipërfaqen e dyshemesë është një normë mjaft e mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. (Figura 115)

Megjithëse në pamje ndërtesa nuk lidhet si arkitekturë me ndërtesat tipike të malësisë, atë të tipit kullë, përsëri ofron elemente arkitektonike të ngjashëm si çatia e lartë 5 metër dhe veshja në pjesën e poshtme me gurë të zonës. Dritaret e klasave janë të larta e të mëdha, element që nuk afrohet me dritaret e vogla, të tipit frëngjive ose më të vogla e të mbyllura të ndërtimeve të malësisë.




Figura 115. *Pamje të shkollës Fillore Tip për vende malore i vitit 1936, Ark. G. Bertè. Burimi AQTN*

Ledita Mezini




Figura 116. *Pamje të shkollës Fillore Tip për vende malore e vitit 1936. Ark. G. Bertè, Burimi: AQTN*



Figura 117. *Plani i shkollës Fillore Tip 1 për vende malore i vitit 1936, Ark.G. Bertè. Burimi AQTN*

Në krahasim me ndërtesat e tipit kullë ose me shkollat që ekzistonin në ato zona, arkitekti përpiqet të sjelli një gjuhë të ngjajshme në perdorimin e gurit dhe të çatisë së pjerret por gjithmonë duke futur një linguazh të vetin e duke hapur dritare më të mëdha e të larta. (Figura 118)



Figura 118. *Pamje të kullave të veriut, dhe pamje e shkollës fillore të malësisë së Madhe në 1915, Marrë nga AQSH.*

E të njëjtit arkitekt është edhe ndërtesa e shkollës dhe konviktit “Naim Frashëri” në ish bulevardin Mussolini (sot Rruga e Kavajës) e cila është përdorur si godina e Muzeut të Shkencave të Natyrës.

- <u>*Shkolla Normale Femërore “ Naim Frashëri” në Tiranë*</u>

Normalja Femërore “Naim Frashëri” në Tiranë, u themelua në vitin 1930 në konviktin “Naim Frashëri”, të ngritur qysh në vitin 1922, nga Sadi Pejani dhe me fonde nga familjet Tiranase të vjetra ( Preza, Fortuzi, Llagani), e ishte një shkollë private e njohur me emrin “Liceu dhe Normalja ‘Naim Frashëri’.” (Bakiu, 1998, f. 227), (Gogaj, 2003, p. 491)

Konvikti “Naim Frashëri” u vendos në ndërtesën e projektuar nga arkitekti Giulio Bertè në rrugën e Kavajës. (Figura 119, 120)



Figura 119. *Pamje e ish. Shkollës “Naim Frashëri” në ditët e sotme si dhe pamje e ndërtesës në vitet 1940. (Bakiu, 1998)*




Figura 120. *Genplani i ndërtesës së shkollës dhe konviktit "Naim Frashëri" në Tiranë, projektuar nga ark. G. Bertè, 1939. Burimi: AQTN*

Sipas autorit Gecaj, "Historiku i ngritjes dhe funksionimit të shkollave Shqipe lidhet ngushtë dhe me atë të disa konvikteve. Ato shërbyen gjerësisht jo vetëm për jetesën e organizuar të nxënësve , por edhe si vatra atdhetare, drite, diturie për djemtë e vajzat e popullit tonë." (Gecaj, 2008, p. 191). "Megjithëse ndërtesës iu prish kati i sipërm dhe u ndryshua në kohën e pushtimit Italian për arsye të avionëve që kalonin në afërsi drejt fushës së vjetër të aviacionit," (Bakiu, 1998, f. 227) kjo mbeti si një ndërtesë kryesore për sa i përket rëndësisë jo vetëm në historikun e arsimit por edhe për pamjen e saj monumentale në bulevardin Musolini. (Rr. e Kavajës).




Figura 121. *Plani i katit përdhe të godinës 'Lice dhe konvikt- Shkolla Naim Frasheri Tirane, 1939, arkitekt Giuglio Bertè. Burimi: AQTN*




Figura 122. *Plani i katit të parë të godinës "Lice dhe konvikt- Shkolla Naim Frasheri", Tiranë, 1939, ark. Giuglio Bertè. Burimi: AQTN*

Edhe në këtë godinë ashtu si dhe në disa shkolla të tjera të kësaj periudhe vihet re elementi i simetrisë si në plan ashtu edhe në fasadë. Figuron në dy variante të propozuara nga arkitekti, ku njeri është me dhoma mësimi e tjetri me dhoma fjetjeje. Gjithashtu nga foto e vjetër e shkollës dallohet elementi i thjeshtë i kolonave që evidentohen midis mureve ndarëse të dritareve. (Figura 119)




Figura 123. *Plani i katit të dytë të godinës 'Lice dhe konvikt- Shkolla Naim Frasheri Tiranë, 1939, arkitekt Giuglio Bertè. Burimi AQTN.*

Orientimi i klasave është nga jugu dhe shkollës i ofrohet një sipërfaqe e madhe territori të gjelbër përreth. Dhomat e mësimit janë me sipërfaqe 33 deri në 34 metër katrore ( 4.95 me 6.75/6.80/6.85/7 metra) që sipas normativave të kohës duhet të kenë qenë përafërsisht për 40 nxënës në klasë. Konvikti është projektuar për rreth 60 nxënës në total. Ashtu si dhe në godina të tjera shkollash teknike, në shkollën Naim Frashëri në Tiranë janë futur edhe ambiente

Edita Mezini

ndihmese si sallë ngrënieje, gatim, roje, arkiva, magazina etj. Korridori i njëanshëm ka një gjerësi 2.30 m dhe orientohet nga veriu. (Figura 121,122,123)

Arkitekti Bertè projektoi edhe 2 shkolla të mesme në Korçë, të cilat paraqesin dy nga modelet më të mira në historinë e ndërtimit të arsimit Shqiptar.

- *<u>Shkolla e mesme  në Korçë</u>*

Projekti i ndërtesës së shkollës së mesme në Korçë artikulohet në një, tre dhe katër kate, ku volumi i sallës së gjimnastikës shfaqet më i dalë në katin përdhe. Kemi një zhvillim të njëjtë në katin e 2-të e të 3-të të planit dhe një ngritje në 4 kate të pjesës së hyrjes. Kjo zonë zhvillohet në formën e një kulle ku ndodhen laboratori i kimisë, lavamanë, depo për materialet e salla e auditorit të kimisë. “Ndërtesa është e orientuar sipas aksit lindje perëndim me një shtrirje të mirë nga jugu të klasave dhe në veri gjendet korridori i gjatë më në skaj e korpuset e shkallëve.” (Vokshi, 2014, p. 126)

Megjithëse në ndërtesë ka 3 hyrje, 1 në krahun jugor të klasave, 1 në krahun lindor dhe një hyrje e tretë nga ambientet e gjimnastikës, është për t’u theksuar se arkitekti i jep shumë rëndësi të treja-ve duke vendosur elementë të lartë kornizues në formën e koloncinave të cilat theksojnë vetratat.




Figura 124. *Plani i katit përdhe të shkollës së mesme në Korçë, ark. G. Bertè, 1936. Burimi: AQTN*

Ashtu edhe sipas Vokshit një nga elementet më dominues të ndërtesës është përdorimi i një dritareje treshe nëpër klasa i cili është një faktor plus për ndriçimin më të mirë të sallave të mësimit.

Ledita Mezini




Figura 125. *Plani i katit të parë të shkollës së mesme në Korçë, ark. Giulio Bertè, 1936. Burimi: AQTN*




Figura 126. *Plani i katit të dytë të shkollës së mesme në Korçë, ark. G. Bertè, 1936. Burimi: AQTN*



Figura 127. *Pamje nga jugu e shkollës së mesme në Korçë, ark. G. Bertè, 1936. Burimi: AQTN*

- <u>*Liceu "Turtulli" në Korçë*</u>

Arkitekti Bertè dhe arkitekti Waja i cili është marrë me interierin e ndërtesës së Liceut dhe me disa variante të fasadës, kanë projektuar një nga shkollat më të bukura në Korçë, në një zonë

Ledita Mezini

të gjelbëruar e kodrinore. (Figura 128) Megjithëse figurojnë disa variante për fasadat e ndërtesës, e gjithashtu edhe për planimetrinë, koncepti qendror ka mbetur i njëllojtë ku ndërtesa paraqitet monumentale, e rëndë e madhështore në fasadën perëndimore , atje ku është edhe momenti i hyrjes, e veshur me tulla të vogla qeramike, në formë lineare me një korridor të orientuar nga veriu e me klasa nga jugu. Në thelb të saj, kjo ndërtesë paraqitet e ngjashme me konceptin e arkitektit Giulio Bertè mbi atë që është një shkollë: parimet e tij janë të qarta e dalin në të gjitha shkollat që ai ka projektuar në Shqipëri:



Figura 128. *Variante të fasadës perëndimore të ndërtesës së liceut 'Turtulli' , Korçë. Burimi: AQTN*

Klasat në rresht vendosen të orientuara nga jugu, një korridor i gjatë nga veriu i cili mbyllet me dy korpuset e shkalleve, e nyje-t sanitare në pjesën fundore, një hyrje monumentale që ngrihet mbi shkallë mermeri, e streha të diferencuara, dritare të rrethuara nga korniza të trasha e të dala të cilat evidentojnë vetratat si dhe një element arkitektonik prej tre dritaresh që përsëriten në çdo klasë duke krijuar një ritëm në fasadën e jugut e ndriçim të bollshëm për gjithë ambientet. Fasada monumentale e jugut dhe ajo e perëndimit janë shumë në kontrast me atë të veriut (Figura 124) e cila paraqitet e thjeshtë pa elemente dhe e suvatuar. Ndoshta kjo neglizhencë e arkitektit ka ardhur si pasojë se në këtë krahë mendohej që shkolla do të zgjerohej në të ardhmen. Në variantin final shkolla përfundon me 9 salla mësimi ne katin përdhe nga te cilat 6 me dimensione 55 $m^2$ dhe 4 hyrje në ndërtesën e shkollës. (Figura 131, 132, 133)




Figura 129. *Variant i fasadës nga jugu i ndërtesës se liceut 'Turtulli' , Korçë. Burimi: AQTN*



Figura 130. *Variant i fasadës perëndimore e perspektivë e variantit final të ndërtesës së liceut 'Turtulli', Ark. Giulio Bertè, Korçë. Burimi AQTN*




Figura 131. *Fasada nga jugu e ndërtesës së liceut 'Turtulli' , Korçë. Burimi: AQTN*




Figura 132. *Variant i katit përdhe të ndërtesës së shkollës Turtulli, Korçë. Ark. G. Bertè. Burimi: AQTN*




Figura 133. *Plani i katit përdhe të ndërtesës së shkollës Turtulli në Korçë. Ark. G. Bertè. Burimi: AQTN*

Kërkesa për të përhapur arsimin fillor, të mesëm e profesional e kryesisht për të mësuar gjuhën Italiane gjerësisht fëmijëve e të rinjve, çoi në ndërtimin në masë të shkollave prej Italisë fashiste. Në këto vite vihet re për herë të parë tipizimi e standardizimi. Arkitektet Italianë në pamundësi për të projektuar shkolla në numër kaq të madh, në të gjithë Shqipërinë e për një kohë aq të shkurtër, filluan të projektonin tip-et e para të shkollave standarde që shpesh për shkak edhe të ndërtimit të shpejtë u bënë me materiale të çmontueshme e me panele të parafabrikuara.

- <u>*Shkolla fillore Tip me 7 klasë*</u>

Të po kësaj fryme, me një arkitekturë të pastër funksionale dhe me panele të parafabrikuara kemi edhe shkollën fillore të Bamit në rrugën Ciano e projektuar në vitin 1939. Shkolla ka gjithsej 7 klasa nga të cilat dy janë menduar për nxënësit e vegjël të fillores duke i veçuar pak nga pjesa tjetër edhe nëpërmjet një korridori të vogël e nyje sanitare të veçantë. Shkolla paraqet një simetri në plan ashtu dhe në fasadë, dhe ka një shtrirje gjatësore lindje-perëndim, duke orientuar klasat drejt jugut dhe korridorin gjatësor drejt veriut. Funksionet e ndërtesës përmblidhen në një godinë 1 katësh-e e cila ka klasa të mëdha nga 49 deri 58 m$^2$, 1 sekretari, roje, dhe dhomë mjeku. Godinave të shkollave po u jepej rëndësi jo vetëm në projekt por edhe në mobilim, pasi firma të njohura Italiane në fushën e mobilimit të shkollave ishin pjesëmarrëse në tenderët për mobilimin e klasave me banka e mjete mësimore.[13] (Figura 134)

Të kësaj periudhe janë dhe ish shkolla “Kosova” ose ndryshe e quajtur  “Maria Pia di Savoia” në rrugën e Elbasanit dhe shkolla “Lidhja e Prizrenit”, në Tiranë të cilat janë shkolla identike 7 vjeçare. Këto shkolla për shkak të ndërtimit në mënyrë të shpejtë me panele u përforcuan në vitin 1952 me mure me tulla me dimension 25 cm, por si planimetri e zgjidhje funksionale nuk u ndryshua asgjë nga projekti italian. Të dyja shkollat kanë 7 klasa mësimi, nga të cilat 6 janë të orientuara nga jugu, 1 hapësirë për mësuesin, 2 ambiente depoje dhe dy nyje sanitare.




Figura 134. *Shkolla fillore me 7 klasë me parete të çmontueshme në rrugën ‘Via Ciano”- Viti 1939.*
*Burimi:  AQTN*

[13] Firma ‘Giuseppe Pallini e figli’ ishte një nga firmat private që është marrë me arredimin e shkollave në Shqipëri. Bankat, dërrasat e dollapet projektoheshin, ndërtoheshin në Itali e silleshin direkt në mjediset e shkollave.

Ledita Mezini



Figura 135. *Plani i shkollës 'Kosova dhe i "Lidhjes së Prizrenit", viti 1939 viti i ndërtimit, 1952- viti i rikonstruksionit.*

Kjo shkollë u përdor si model e standard, jo vetëm nën periudhën e pushtimit Italian, por u ruajt si morfologji e kompozim edhe në vitet më pas me pak ndryshime të vogla në plan. Shkolla paraqitet me simetri të pastër e kompozuar në formën e U-së ku evidentohet momenti i hyrjes. Ky tip shkolle është hasur edhe në qytete të ndryshme të Shqipërisë me ndryshime të vogla. Nga dokumentet e shkruara e kërkesat për ndërtimin e këtyre shkollave rezulton se ato janë ndërtuar edhe me parë se viti 1939 në vende të tjera të Shqipërisë. Megjithëse ideja e Italisë në ndërtimin e këtyre shkollave ishte se këto do të shërbenin provizorisht e më pas do të ndërtoheshin të tjera projektet tregojnë që shkollat u përforcuan por mbetën për një kohë të gjatë, e u ngulën në memoriet e nxënësve me këtë fizionomi.



Figura 136. *Plani i shkollës fillore me 7 klasë në Vlorë. Tipi u përdor gjerësisht në gjithë Shqipërinë. 1940. Marrë nga AQTN.*

Ledita Mezini




Figura 137. *Foto e shkollës fillore me 7 klasë e ndërtuar me parete të çmontueshme. 1940*

Arkitektet italiane propozuan dy tip standarde shkollash, për zonat e fshatit me 4 klasë dhe për qytetet me 7 klasë.

- <u>*Shkolla e fshatit tip me 4 klasë, viti 1940*</u>

Në të dyja variantet si atë të shkollës së fshatit e atë të qytetit ambientet janë: klasa, dhomë mësuesi, ambient ndihmës për mjetet mësimore, dhe nyje sanitare.




Figura 138. *Plani i shkollës e pamje ballore Tip me 4 klasë. Viti 1940. Burimi AQTN*

Ndërtesa paraqitet si një korpus linear me korridor nga njëra anë e klasa të orientuara nga jugu. Simetria e ndërtesës theksohet nga dy volumet e futura në pjesët fundore si dhe momenti i hyrjes me strehë në qendër të ndërtesës.

- *<u>Shkolla e qytetit me 7 klasë.</u>*

Shkolla tip e 1940 është menduar për t'u ndërtuar në shumë fshatra të Shqipërisë. Në dy tipat e '40 shkolla është lineare me korridor nga njëri krah, dhe me vendosjen e njësisë së nyje-ve sanitare në mbarim të korridorit. Nëse shkolla e fshatit paraqet një simetri me hyrje qendrore e shtrirjen e klasave ne dy anët, ajo e qytetit zhvillohet me hyrje anësore e në zhvillim me dy kate. Tipike janë përmasat e klasave me gjerësi 5.5 metër e gjatësi 8 metër, përdorimi i dritares me tre pjesë e të kornizuara me fasha bordurash betoni, theksimi i momentit të hyrjes nëpërmjet strehës si dhe veshja e xokolit me gurë. Këto parime të qarta i pamë edhe në shkollat e projektuara nga arkitekti G. Bertè të cilat duket se kanë të bëjnë më shumë me normativat e shkollave e standardin Evropian që arkitektët Italianë sillnin në vendin tonë.




Figura 139. *Plani i katit përdhe të shkollës tip me 7 klasë. Viti 1940. Burimi AQTN*




Figura 140. *Plani i katit të parë të shkollës tip me 7 klasë. Viti 1940. Burimi AQTN*

Ledita Mezini



Figura 141. *Fasada anësore dhe prerje të ndërtesës së shkollës tip me 7 klasë. Viti 1940. Burimi AQTN*



Figura 142. *Fasada kryesore e ndërtesës së shkollës tip me 7 klasë. Viti 1940. Burimi AQTN*

Shkolla tip e 1940 është menduar për qytete të mëdha si në Tiranë, Berat, Kavajë, Shkodër, Elbasan, e Korçë. Në të dyja tipat e viteve 1940 vihet re një arkitekturë e pastër funksionaliste. Ndoshta kjo lloj paraqitjeje ishte rrjedhojë e influencave të arkitekturës moderne, të pastër e të thjeshtë për shkollat progresiste të përhapura rreth viteve ’30 nëpër Evropë ose edhe pasojë e racionalitetit që përfaqësonte arkitekturën fashiste, por mund të themi se ndërtesat e shkollave të viteve 1940 morën një fizionomi tjetër e u zhveshën nga ornamentet, duke përfaqësuar më së miri, moton e shkollave “Forma ndjek funksionin”.

Studiues argumentonin se shkolla në Evropë dhe sistemi arsimor po ndryshonte dhe duheshin ndërtesa të përshtatshme e fleksible për këtë sistem, por arkitektura e ndërtesave arsimore vazhdonte të ishte një arkitekturë statike. “Dritë më shumë se errësirë, një kalim nga dizajni memorial në hapësira funksionale dhe fleksible dhe detyra e arkitektit është të kuptojë politikat e edukimit modern.” (Stillman, 1949, fv. 28-38)

- Konvikti femëror[14]

Arkitekti Cesare Valle projektoi , rreth viteve 1940-1941, në kodrën e vendosur në jug të rrugës “Viale dell’Impero ”Konviktin Femëror” sot Fakulteti i Gjeologjisë, i cili sipas Vokshit “ka pikënisjen nga analiza funksionaliste duke bashkuar metodën e projektimit racionalist me sugjerimet e arkitekturës organike.” (Vokshi, 2014, f. 210) Volumi në projekt përbëhej nga katër korpuse, tre prej te cilave më të ulëta që kryqëzoheshin në volumin qendror të atriumit. Nga ky volum u ndërtua vetëm korpusi me hark i cili përfaqësonte zonën e studimit, i cili në

[14] Mbi arkitektet Italianë dhe ndërtesat kryesore të projektuara prej tyre në Shqipëri mund të referohemi te studimi i plotë i Prof. Asoc. Armand Vokshi. 2014

vitet 1949 u transformua në shkollën Marksiste-leniniste nga Partia Komuniste. Duke e pozicionuar godinën në pjesën më të lartë të kodrës e nëpërmjet kolonadës me hark në katin përdhe, arkitekti i jepte strukturës monumentalitetin e arkitekturës Fashiste e gjithashtu ndërthurte volumet perpendikulare e të thjeshta të modernistëve me harkun e madh kundrejt diellit, të arkitekturës organike.




Figura 143. *Plani i katit të podrumit, perspektivë (projekti) dhe foto të ndërtesës së Konviktit femëror në vitin 1941.Ark. Cesare Valle. Burimi: AQTN, (Vokshi, 2014)*

Një projekt shkolle (e pa-realizuar) mjaft interesant është edhe shkolla për zonën e Laprakës e projektuar përpara Çlirimit.

- *<u>Shkolla publike për fshatin Littorian, Laprakë.</u>*

Dy hyrjet e ndërtesës theksohen nëpërmjet arkadave tre-she (Element i arkitekturës romake) si dhe nëpërmjet ngritjes me shkallë. Fasada prej një kati qëndron e njëtrajtshme në lartësi por thyhet në volum nga hijet e thella të hyrjeve të cilat mbrojnë transparencën e xhamit të holleve. Shkolla zhvillohet në plan në formën e U-së ku oborri i brendshëm përfaqëson mbrojte e përkujdesje të hapësirës sociale të fëmijëve.

Kjo shkollë e ndryshme nga tipat e tjera të projektuara nga Italianët është ndoshta simbol i arkitekturës së shkollave '*open air*", për Shqipëri. Ndoshta e projektuar kryesisht për fëmijët Italianë të ushtarakeve të vendosur me banesa në zonën e Laprakës në Tiranë paraqitet si një kompleks në formën e U- së, ku dy korpuset e klasave janë të orientuara nga jugu dhe hapen me vetrata të mëdha në gjithë gjerësinë e lartësinë e klasës. Dy korpuset e klasave me nga katër njësi secila lidhen me njeri tjetrin me një pjesë të përbashkët të administratës e të një salle të madhe grumbullimi, mbledhjesh e aktivitetesh. Tre arkadat e momentit të hyrjes e ngritja e tyre mbi shkallë bëjnë një arkitekturë tipike Littoriane[15]. Gjithashtu përdorimi i veshjes me qeramike e vetratave të mëdha të klasave e bëjnë këtë një ndërtesë mjaft të veçantë si një arkitekturë ndërlidhëse ndërmjet të shkuarës dhe asaj moderne. Ndërkohë dritaret e holla të larta të ndërprera nga një fashë tulle në pjesën e sipërme është një karakteristikë e veçantë e ndërtesës e cila mundëson ndriçim maksimal edhe në thellësi të klasës por njëkohësisht hijezim gjatë stinës së verës.

Shkrimet e dokumentet tregojnë se pushtuesit Italianë gjetën në Shqipëri një varfëri, papastërti e mungesë higjiene të theksuar. Ashtu si në botë , shkolla '*open air*' lindi si pasojë e dëshirës për të evituar sëmundjet e futjen e sa më shumë drite e ajri në mjedisin e brendshëm, Dëshira për ti mësuar jo vetëm gjuhën, por edhe zakonet e traditat e vendeve perëndimore e gjithashtu influenca e tendenca për hapjen e dritareve në mënyrë që klasa të kishte më shumë ajër e dritë në mënyrë natyrale, bën që të lindte me këtë shkollë ashtu si dhe në Evropë "shkolla moderne". Këto parime shfaqen në shkollën Littoriane publike.

> "Parimet edhe të Le Corbusier për 'një shpirt të ri', për më shumë "dritë e ajër" bënë që dritaret të zmadhoheshit e të ktheheshin në dyer të rrëshqitshme që të çonin drejt oborreve me gjelbërim e ajër. Korridoret u ngushtuan dhe klasat u kthyen vetëm nga një anë (kryesisht nga jugu) në mënyrë që të kishin sa më shumë ajër e ventilim natyral. Dëshira për dritë, higjienë, ajër e gjelbërim, në vitet 1900-1930 çoi që shkollat të uleshin në një kat në mënyrë që secila të kishte akses me pjesën e jashtme, kjo kryesisht në shkollat e fshatit. Në Evropë ashtu edhe në Amerikën e veriut lindi "*Open Air School*" (Shkolla e hapur me ajër)." (Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman, 2004)

[15] Arkitektura Littoriane u quajt arkitektura e vonshme Fashiste e cila mbështetej te elemente të arkitekturës Romake.




Figura 144. *Plani e pamje e shkollës së Fshatit të Littorios, Laprakë, përpara Clirimit.*

# PËRFUNDIME 3

Kapitulli i tretë i cili është një plotësim i kapitullit të dytë zhvillon një analizë kritike pikërisht të ndërtesave arsimore përgjatë atyre fazave të zhvillimeve historike, e ngjarjeve të trajtuara më parë. Duke hedhur sytë drejt ndërtesave të projektuara e të ndërtuara në këtë fazë tentohet të kuptohet se si këto struktura edukative reflektojnë zhvillimet e kohës. Duke kaluar në mënyrë kronologjike trajtohen arkitekturat e periudhave të ndryshme dhe analizohen ngjashmëritë ose ndryshimet, me ndërtimet shkollore nëpër botë. Kjo pjesë grumbullon zhvillimet arkitekturore prej fillimit e deri në vitet 1944, si vit që përmbyll disa etapa, e nis fazën më prodhuese të shkollave në Shqipëri, atë të viteve 1945-1990, e cila trajtohet në kapitullin e katërt.

Fillimisht, arkitektura e ndërtesave arsimore lidhet paralelisht me përhapjen e gjuhës Shqipe nëpër territoret e tokat Shqiptare dhe zhvillimin e arsimit në Shqipëri.

Megjithëqë ndikimin e madh që pati feja e ndërtimi i shkollave të para shqiptare korrespondon me një arkitekturë të lidhur ngushtë me besimet fetare, si nëpër manastire ose nëpër medrese e famulli përsëri mund të pohojmë se kjo arkitekturë shkon paralel me zhvillimet nëpër botë deri në shekullin e XIX të këtyre infrastrukturave.

Pavarësisht vështirësive të mëdha që kaloi Shqipëria nën pushtimin e Turqisë për gati pesë shekujsh në periudhën e Rilindjes pati një zhvendosje të vëmendjes drejt normativave, rregullave, ligjeve të standardeve që duhet të ishin në arsim, e në ndërtesat shkollore. Megjithatë e ndodhur më pas nën luftërat e vazhdueshme e sundimet e njëpasnjëshme, arkitektura e ndërtesave arsimore nuk ishte një arkitekturë e mirëfilltë për mësim, por një mjedis për tu mbledhur për të diskutuar e për të mësuar, e kjo vihet re nga fakti se shkollat e para ku u mësua gjuha Shqipe ishin banesat e dhuruara nga njerëzit e ndryshëm ose shtëpitë e mësuesve.

Shumica e ndërtesave të para shkollore ishin shtëpi të thjeshta, depo, hambarë, etj., kryesisht ato në të cilat flitej shqip e që ishin për fëmijët e varfër. Vihet re një ndërtim më i kompletuar në strukturat e sponsorizuara nga kleri katolik, nga kisha Ortodokse, nga Perandoria Osmane si dhe nga fondet e Austro-Hungarisë ose vendeve të tjera si Italia, Franca e Amerika. Vetëm pas pushtimit Austro-Hungarez e më pas atij Italian mund te themi se nisi të kuptohej se çfarë përfaqësonte "Shkolla", si një vend për të mësuar e për t'u informuar e gjithashtu si një ndërtesë e mirëfilltë.

Pikërisht rreth kësaj periudhe 1912-1925 u dalluan në ndërtesat shkollore përkrahja nga vendet perëndimore dhe tendenca për të futur parimet e shkollave Amerikane e teoritë e John Dewey-t "learning by doing", (të mësosh duke e bërë). Ndërtesa do të ishte më shumë se një godinë mësimi, duke ofruar për herë të parë ambiente pune, prodhimi, argëtimi, teatri, sallë ngrënie, kuzhine, tualete, dushe, etj., hapësira pune, si brenda e jashtë, ambiente që më parë në Shqipëri ishin të panjohura, për ndërtesat e shkollave. Përveç arkitektëve të huaj pati edhe ndërtues e inxhinierë shqiptarë të cilët e shikonin shkollën ende si një banesë e projektuan këtë përsëritje në imazhin e shkollave fillore.

Pavarësisht kësaj, pas një periudhe të gjatë ku shkollat në Shqipëri përfaqësoheshin më tepër nga godina banimi, magazina, sheshe, e ambiente të tjera të papërshtatshme, godinat si Shkolla

e Mesme Teknike e Kryqit të Kuq Amerikan, Instituti Kyrias, liceu Francez i Korçës, normalja Naim Frashëri, etj., përfaqësonin një risi e një ndryshim rrënjësor në imazhin dhe simbolikën e shkollës. Ato përkrahnin pedagogji të reja dhe po përpiqeshin të kapnin me hapa të vogla e të ngadalta "arkitekturën e shkollave të së nesërmes."

Por e gjendur mes luftërave të vazhdueshme, arkitektura e ndërtesave shkollore u përfshi nën influencën italiane e cila në vitet 1925- 1939 që përkon me periudhën e mbretërimit të Ahmet Zogut e më pas në vitet 1939-1944, me pushtimin italian, është një krijim total i arkitekteve Italianë të cilët të ardhur në Shqipëri patën mundësi të projektonin e të krijonin duke u bazuar te arkitektura racionale fashiste por duke futur edhe elemente të arkitekturës tradicionale Shqiptare.

Megjithëse në vitet e para vihet re një monumentalit-et i madh i shprehur në disa lice e shkolla profesionale të ngjashme me karakterin e rëndë të ndërtesave të '900, vitet e fundit ky monumentalit-et ra në mënyrë totale për shkak ndoshta edhe të mungesës së fondeve e nevojës imediate të krijimit të shkollave në mënyrë të shpejtë. Me sa kuptohet nga literatura e nga shkrimet historike, italianët nuk preferonin të përhapnin arsim të përgjithshëm, por të jepnin një arsim profesional me shkolla të tipit teknike. Kjo ka bërë që ndërtesat e shkollave të mos jenë aspak të tipizuara e të ngjashme por të paraqiten të ndryshme në volumetri e në planimetri duke iu përshtatur më së miri shprehjes "forma ndjek funksionin". Këto ndërtesa të projektuara për qëllime të ndryshme paraqiten me variacione në të gjitha qytetet Shqiptare që u ndërtuan. Megjithëse të ndryshme në funksione e në laboratorët të cilat përmbanin, këto ndërtesa shfaqin disa elemente arkitektonike të përbashkëta si për shembull:

- Përdorimi i një aksi simetrie të përdorur gjerësisht në fasadën ballore, duke e ndarë shpesh volumin në dy pjesë.
- Diferencimi i kateve nëpërmjet kornizave e elementeve të dalë duke i theksuar ato' ku në ndërtesat e shkollave të arsimit profesional të 1928 paraqitet edhe më i evidentuar ky element në pjesën e çatisë.
- Theksimi dhe konturimi i dritareve me një fashë suvaje në të gjitha shkollat si ato të mesme e ato fillore duke nxjerrë në pah lartësinë e tyre.
- Evidentimi i momentit të hyrjes nëpërmjet një ngritje me shkallë si dhe krijimi i një strehe të vogël ne pjesën qendrore të ndërtesës që thekson monumentalitetin si dhe aksin e simetrisë.
- Organizimi dhe forma e shkollës zgjidhej me orientimin e klasave nga jugu dhe shkolla kryesisht e tipit bllok lineare.

Për sa i përket shkollave të periudhës së viteve 1939-1944 kemi një arkitekturë shumë të ndryshme në formë e tipologji e të karakterizuar nga variacione të ndërtesave të shkollave në plan me format simetrike ose lineare ashtu edhe në fasadë me simetrinë e monumentali-tetin e arkitekturës të '900, ose me racionalizmin e shpesh edhe thjeshtësinë e ndërtimeve të shpejta me panele. Ky diapazon i madh variacionesh që nis i ngjashëm me arkitekturën e monumentali tetin e '900, vazhdon me arkitekturën fashiste, e merr elemente e të arkitekturës së banesave Shqiptare, e gjithashtu përqafon parime moderne të arkitekturës së shkollave 'open air', bën që

strukturat edukative të kësaj periudhe të përbëjnë një shumëllojshmëri arkitekturash e stilesh. Arkitektet italiane patën mundësinë te eksploronin, te kërkonin veten e tyre në fushën e arkitekturës duke provuar të rikthenin elemente të arkitekturës italiane në një kontekst tjetër jashtë vendit të tyre e të fusnin një identitet e arkitekturë moderne. “rrënjët e arkitekturës italiane studiohen në mundësinë për të rimarrë një gjuhë ku matrica është të kërkojë në një të shkuar që nuk duhet të shihet me nostalgji por që është gjallë e që mund të merret si model ku mund të frymëzohet për arkitekturën e ardhshme (Vokshi, 2014, p. 297)

Për sa i takon arkitekturës italiane arkitekti Maks Velo shkruan: “Më duket se sado godina të tjera të ndërtohen në Shqipëri në epoka e stile të ndryshme, nuk bëjnë gjë tjetër veçse nxjerrin në pah aftësitë organizative stilistike, estetike, e etike të objekteve e komplekseve që së pari i dhanë një fizionomi të re qytetit.” (Velo, 2013, p. 18)

Ndërkohë për pushtimin Italian shprehet edhe Kolevica:

“Pushtimi fashist Italian, ndonëse i shkurtër e në gjendje lufte, për interesat e veta e për synime koloniale, bëri ndërtime deri atëherë, të panjohura në Shqipëri. Megjithëse ndihej fryma e stilit të arkitekturës fashiste te Piaçentinit, në përgjithësi u bënë ndërtime të bukura me arkitekturë moderne me materiale veshëse e punime të cilësisë se lartë. Gjithashtu në vitet e para të pushtimit, kur u zhvillua, tregtia shumë njerëz shkuan në Itali e vende të tjera, panë ndërtimet e reja te atjeshme gjë që forcoi edhe më shumë shijen e popullit pro arkitekturës moderne. Kështu viti 1945 e gjeti popullsinë qytetare shqiptare, veçanërisht atë të shkolluar me një shije të formuar pro arkitekturës moderne, racionale, funksionale.” (Kolevica, 2004)

Megjithëse kjo periudhë karakterizohet nga fasada e volume ‘pa stil të përcaktuar e shumë të variushme’, në varësi edhe të arkitektëve të rinj të huaj që provonin në territoret Shqiptare, mund të themi se pushtimi Italian hodhi gjurmët e para të ndërtimeve arsimore, vendosi disa kritere specifike në normativat e shkollave siç ishte orientimi i klasave nga jugu, organizimi me zona didaktike e zona administrative ose shërbimesh, vetratat më të mëdha në mjediset e klasave si dhe korridore e holle të mëdha që shërbenin e si ambiente grumbullimi. Ndërtesat e shkollave të projektuara nga arkitektet Italiane mbeten edhe sot disa prej ndërtimeve më të mira në Shqipëri. Ato përfaqësojnë ato që më pas u bënë baza e normativat kryesore në projektimin e ndërtesave shkollore.

Ledita Mezini

# KAPITULLI 4

## ANALIZA TIPOLOGJIKE E ARKITEKTURORE E NDËRTESAVE ARSIMORE NË VITET 1945-1990

### Hyrje

*"Shkollat janë ndër objektet shoqërore kryesore në formimin urbanistik dhe arkitektonik të qyteteve moderne"*

*(Velo, 2004)*

Sipas iniciativës së përbashkët nga organizatat CABE dhe RIBA mbi "*21st century schools*" (Shkollat e shekullit 21) politikat edukuese, politikat sociale, e gjithashtu ato urbane dhe të banimit kanë një impakt të fortë e të drejtpërdrejtë në shkollë. (Building Futures, 2004) Gjithashtu zhvillimet e shumta në politikat qeverisëse mbi fondet e investuara në institucionet arsimore, strukturën e arsimit, kurrikulat, reformat, menaxhimi i shkollës, pedagogjia dhe cilësia e mësuesve, ndikojnë drejtpërsëdrejti në projektimin e shkollave, në arkitekturën dhe vetë zgjedhjen e projektuesit, zhvillimin e mësimit, organizimin e strukturave arsimore, mbipopullimin ose braktisjen e klasave e deri te gjendja morale e stafit, dhe e nxënësve.

Ky kapitull analizon pikërisht ndryshimet kryesore dhe çështjet të cilat kanë influencuar ose jo drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte ndërtesat arsimore të projektuara në vitet 1945-1990 si periudha ku u ndërtua numri më i madh i ndërtimeve arsimore në Shqipëri. Analiza bëhet duke parë tipologjitë kryesore të ndërtimeve arsimore, ndryshimet që kanë hasur gjatë vazhdës së historisë e kush kanë qenë disa prej këtyre influencave të cilat kanë modeluar ndërtesat edukative dhe problemet që kanë sjellë e që mbartin deri në ditët tona.

Kapitulli i katërt i cili është thelbësor për temën studion arkitekturën, tipologjitë e ndërtesave arsimore në vitet 1945-1990 duke i studiuar në vlera sasiore e gjithashtu cilësore. Studiohet arkitektura e ndërtesave dhe ngjarjet kryesore, faktorë të fortë imponues që gdhendën këto struktura e gjithashtu shikohen elementet e dizajnit e normativat përkatëse, parametrat, sipërfaqet për të krijuar gjithashtu një kategorizim e grupim për këtë sektor ndërtimi. Ky kapitull ndahet ne 3 tema kryesore të cilat trajtojnë arkitekturën nën influencën e fortë politike, më pas normativat e në fund tipologjitë më të përdorura në shkollat Shqiptare.

Principet e dizajnit ose modelet e dizajnit[1] që duhet të kihen parasysh në projektimin e shkollave janë të shumtë dhe literatura na tregon se janë të lidhur me faktorë që ndikojnë direkt ose në mënyrë të tërthortë në projektim e ndërtesave arsimore e që sjellin efekte pozitive ose negative në procesin e marrjes e dhënies së mësimit. Analiza dhe sintetizimi i këtyre principeve të dizajnit në shkollat e ndërtuara në vitet 1945-1990, krijon një ballafaqim të çështjeve kryesore që lidhen me shkollat, shfaq një bazë të gjerë konteksti dhe njohjeje me këtë grup

[1] Modelet e dizajnit- I referohen komponentëve arkitekturore të strukturës, të lëvizshëm dhe atyre natyrorë. (Alexander, Ishakawa, Silverstein, 1977) Modelet e dizajnit japin një gjuhë komunikimi, një hartë bazë për planifikimin dhe dizajnin e të lejojnë zgjedhje të nevojshme për të arritur qëllimet e projektit.

strukturash si dhe evidenton gjendjen e këtij grupi të madh ndërtimesh duke dhënë mundësi reflektimi për atë që ka qenë, është e do të jetë e ardhmja e ndërtimeve arsimore në Shqipëri.

Modeli mbi të cilin zhvillohet analiza është gjuha e përdorur nga disa studiues si Tanner, Bosch, Hughes, Alexander, Ishakawa, (1977) etj.

## 4.1. ARKITEKTURA E SHKOLLAVE NËN INFLUENCËN POLITIKE

### 4.1.1. Periudha e fillimit të krijimit të arsimit bazë në Shqipëri (1945-1955)

*" U imponua një model politik mono-partiak i dhunshëm në qeverisje me zhvillim ekonomik të mbyllur ndaj botës dhe me tendenca autarkike, sipas teorive të modelit sovjetik Stalinist."*

*(Bego, 2009, f. 5)*

Siç kemi përmendur në kapitullin e dytë, mbas 1945, Shqipëria u gjend në një situatë shumë të vështirë politike si dhe ekonomike e kjo situatë ndikoi drejtpërdrejtë arsimin dhe sektorin e edukimit. Me ardhjen e Partisë Komuniste në pushtet mbas vitit 1945, "stereotipat në arkitekturë e klasicizmit arkaik që mbizotëruan në Bashkimin Sovjetik (B.S.) u imponuan edhe në vendin tonë." (Bego, 2009, f. 5) Studiuesit e pakët të kësaj faze të zhvillimeve arkitektonike si Velo, Faja, Kolevica, Bego, etj., theksojnë se "Imponimi kishte ardhur pa hasur as rezistencë kulturale nga mungesa e një përvoje arkitektonike të afirmuar".

Influenca sovjetike ishte absolute dhe deri në vitet 1947-1948 ishim edhe nën influencën jugosllave, e cila së paku nuk ndiqte verbërisht kanunet e realizmit socialist të Bashkimit Sovjetik. (Bego, 2009) Arkitektët shqiptarë që rronin të kërcënuar nga influenca e B.S. më 1945 ishin fare të pakët në numër. E ky numër arkitektësh e inxhinierësh, ose edhe teknikë të thjeshtë që kishin punuar nën udhëzimet e Italianëve, kishin detyrën e vështirë të projektonin një numër të madh shkollash, kryesisht rurale, e fillore. Pikërisht në këtë trysni e duke u bazuar në ndikimin Sovjetik dhe absolutisht jo, te influencat ose normativat Italiane të cilat konsideroheshin fashiste, e që ishin shembuj që s'duheshin ndjekur absolutisht, u projektuan shkollat e para të periudhës Komuniste.

Në shkollat e kësaj periudhe vihet re se ndërtesat kanë përsëri ri-sjellje të elementë të arkitekturës së banesave, kishave, xhamive, me arkada, kolona e dekorime, ose edhe dritareve e të kanateve të grilave, me arkitekturën e medreseve e mejtepeve e të banesave tipike popullore. (Figura 145)

Nga viti 1951-1952 përfunduan studimet dhe filluan punë në Ministri ose edhe Institutet e Projektimit, arkitektët e parë të pasluftës që studiuan në B.S. e pak më vonë edhe në vendet e demokracisë popullore të Evropës Lindore, satelite të B.S. Ashtu si arkitekti Faja edhe Bego shprehen se këta arkitektë sollën ndikimet e shkollave e frymën e vendeve që kishin studiuar. (Bego, 2009) (Faja, 2008) (Figura 146)

Leida Mezini



Figura 145. *Sipër: Pamje e shkollës fillore me 1 klasë, viti 1945. Majtas: Pamje e shkollës fillore me 2 klasë, viti 1945, Djathtas: Pamje e shkollës fillore me 3 klasë. Viti 1945. AQTN*

Ndërkohë që Kolevica mbi arkitektët që vepronin në këtë periudhë shkruan: "Ishin edhe dy arkitektë më të vjetër të dy të shkollës austriake, Skënder Luarasi, dhe Anton Lufi. Skënder Luarasi i përkiste asaj shtrese të intelektualëve që pushteti nuk i donte por i shfrytëzonte. Projektet arkitektonike i ngarkoheshin Luarasit dhe një tekniku me përvojë Vangjel Russi." (Kolevica, 2004, f. 74)



Figura 146. *Variant për fasadën e Gjimnazit Tip për qytete, Projekt i vitit 1953, ark. Valentina Pistoli. AQTN*

"Këta ishin në ide më afër arkitekturës bashkëkohore, kjo falë një tradite të rrënjosur në këto vende që para lufte." (Bego, 2009, f. 8) Shkollimi me frymën mbizotëruese të asaj kohe solli si pasojë, projekte që ndiqnin me rreptësi shembuj sovjetikë. Çdo devijim demaskohej si anti-Sovjetik, dhe dënohej.

"Erdhi propaganda e atëhershme e Bashkimit Sovjetik e cila u shtri e u materializua edhe në arkitekturë. Në fillim të viteve '50 erdhën disa arkitektë që kishin studiuar ne B.S. e bashkë me

ta u zyrtarizua arkitektura butaforike sovjetike, që polli e mbolli në gjithë Evropën Lindore, mostra ndërtesash të shëmtuara.” (Kolevica, 2004, fv. 42-43)

Në objektet e ndërtuara në Shqipëri si ato të banimit ashtu edhe ato shoqërore, e kryesisht në shkollat 11-vjecare u reflektuan gjatë këtij 10 vjeçari të parë, arkitektura e fryrë e rëndë eklektike me elementë dekorues të panevojshëm në fasadat e shkollave. (Figura 147)




Figura 147. *Shkolla 7-vjecare dy kate-Tip, frontale. Viti i Projekit 1954. Arkitekt Vangjel Russi. AQTN*

Arkitektura e këtyre ndërtime ishte plotësisht jo në kohezion me ndërtimet arsimore në vendet e tjera Evropiane ku me kohë e kishin lënë pas arkitekturën e ‘900. Sipas Herzberger shkolla monumentale e 900-ës “...binte ndesh me mendimin se shkollat duhet të ishin të thjeshta e zgjidhje të lira”. Ndërsa Arkitektura Progresiste po lirohej nga gurët e rëndë në fasada, dekorimet, monumentaliteti e po shkonte gjithmonë e më shumë drejt lirisë, dritareve të mëdha me xhama e lehtësisë së konstruksioneve të çelikut, shkollat Shqiptare kishin përkrahur një arkitekturë të vjetër e të ngurtë. Fatmirësisht kjo periudhë nuk zgjati shumë për disa arsye: Së pari duke qenë se numri i gjimnazeve të ndërtuara ishte i ulët, përdorimi i kësaj arkitekture ishte i kufizuar. Së dyti edhe për shkak të anës ekonomike e cila kërkonte një kosto edhe më të madhe në basamakë, korimano, mermer, basorelieve, kolona e korniza kjo arkitekturë nuk gjeti shumë përhapje te shkollat. Dëshira për të ndërtuar si influenca e B.S. ekzistonte po mungesa e fondeve sillte thjeshtime te projekteve ne fasadat anësore, e variante të fasadës kryesore të njëpasnjëshme në mënyrë që të gjenin atë që do të ishte më e lira po njëkohësisht e ngjashme me si të simotrave Ruse. (Figura 148)

“Kjo gjendje vazhdoi deri në vitin 1955-1956 ku në B.S. në Kongresin e XIX të Partisë Komuniste u bë kthesa që revizionoi historinë zyrtare të deriatëhershme.” (Bego, 2009, f. 8) Në thelb të këtij kongresi qëndronte rehabilitimi i arkitekturës bashkëkohore dhe u kritikua rreptë rryma mbizotëruese e ndjekur deri në atë kohë si regresive dhe arkaike.




Figura 148. *Fasada e Gjimnazit tip. Variantet e projekt Idesë, dhe projekti final, Shkollë 11 vjeçare frontale. Viti 1953. Arkitekt Kostaq Sahatciu. AQTN*

E në vendin tonë si refleks i asaj që ndodhi në B.S. e që përvetësohej në vendin tonë si përvojë e re, u kritikua eksperienca 10- vjeçare e kaluar e sipas Begos "kritikat u përqendruan te dekorativizmi i tepruar e i pakuptimtë, ndërsa thelbi mbetej i paprekur... Me heqjen e ornamenteve fare të panevojshme por me ndërtimet me materiale jo cilësore, që disponoheshin, e shumica e ndërtimeve me mungesë edhe të suvatimeve të jashtme i bënë këto godina të mjera." (Bego, 2009)

"Po perëndonte një periudhë dhjetëvjeçare projektimi të gabuar." (Kolevica, 2004, p. 74) Në këto kohë arkitektura e objekteve shoqërore u shkëput nga eklektizmi dhe pseudoklasicizmi. Ajo mori trajta të reja mbështetur në shkollën e funksionalizmit dhe racionalitetit evropian. (Faja, 2008, f. 15)

Gjithashtu për tu përmendur janë edhe shkollat profesionale të cilat u ndërtuan gjatë kësaj faze. "U hapën edhe shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm dhe shkolla teknike profesionale të ulëta e të mesme, gjithashtu e liceu artistik, teknikumi i fizkulturës, si dhe teknikume të tjerë

bujqësorë, tregtar, financiar, i ndërtimit, i naftës, mjekësor, i tekstileve etj. (Beqja, 1974, p. 15) (Figura 149)



Figura 149. *Teknikumi financiar. Sot shkolla "Qemal Stafa". Viti i projektit 1948. Arkitekti Moz. AQTN*

Pavarësisht, influencës butaforike e monumentalitet në fasadë ndërtimet e shkollave të periudhës '45-'55 nuk e reflektojnë madhështinë edhe në planimetri pasi shkollat janë të vogla, me një skemë te tipit simetrike, me dimensione klasash te 40-45 m$^2$, të planifikuara për 40 nxënës në një klasë. Korridoret e ngushta, ndriçimi i pakët në klasë e hapësira, si dhe një mungesë totale e sipërfaqeve e mjediseve për aktivitete të lira, të bëjnë të kuptosh që pedagogjia që zhvillohej brenda këtyre mjediseve ishte ajo e tipit të ngurtë, ku nxënësi kthen sytë nga dërrasa e te mësuesi dhe përsërit mësimin si papagall.

Kjo tipologji shkolle ishte një regres i strukturave arsimore të aplikuara e të propozuara nga italianët, normativat e tyre, e madje një regres edhe nga arkitektura e mëparshme e ndërtimeve

arsimore e viteve ’20-’40, që kishte influenca nga austriakët, ose dhe pedagogjitë e risitë e shkollave amerikane.

### 4.1.2 Arkitektura e ndërtimeve shkollore në vitet 1955-1963

Nga përshkrimet e arkitektit Kolevica mbi mënyrën se si projektohej në këtë periudhë, kuptojmë që Instituti jepte tipin që do përdorej dhe me pas arkitektit i lihej të punonte pak me fasadën e me pjesën e katit përdhe të shkollës, me hyrjen e sistemimet. “ isha i detyruar të përdorja seksionet tip por u bëra disa përshtatje që me ndihmonin në përmirësimin e funksionit të ambienteve dhe të linjës arkitektonike.” (Kolevica, 2004, p. 108)

Mbas vrullit të madh të ndërtimeve të shkollave fillore gati në çdo cep të Shqipërisë, filluan të kërkoheshin ndërtimet e shkollave 7 vjeçare e më pas të atyre 11 vjeçare. “Herë pas here kërkohej ndërtimi i ndonjë shkolle të re nëpër qytete të ndryshme, gjë që sipas orientimit të përgjithshëm, zgjidhej, duke dhënë për zbatim projektin tip, në rastin më të mirë, duke i bërë ndonjë ndryshim të vogël në fasadë me ngjyrosje, korniza dritaresh apo artific tjetër.” (Kolevica, 2004, p. 115)

Në këtë fazë, zhvillimet e planimetrisë flasin për një shkollë me skemë simetrike qendrore. (Figura 150, 151) U zhvilluan disa variante të cilat ndryshonin shumë pak nga njëra tjetra si variacione në lidhje me pozicionin e hyrjes si dhe variante për qytete të mëdha ose shkolla më të reduktuara por në thelb paraqitet po e njëjta tipologji: Shkolla kompakte me zhvillim linear. Një nga arkitektët e kësaj periudhe e që u morr gjerësisht me projektimin e shkollave është Sokrat Mosko e në kujtimet e Kolevicës mbi shkollat e ndërtuara në vend gjatë periudhës së viteve 1958-1959 shkruan:

> “Për shumë vite me radhë, shkollat te ne u ndërtuan sipas projekteve tip të njëllojta për çdo qytet të vogël apo të madh e për cilindo klimë, bregdetare të butë, apo malore të ashpër e me dëborë. Në vitin 1958, mbaroi studimet në Moskë dhe erdhi në Ndërmarrjen Projekti arkitekti Sokrat Mosko, i cili ndër projektet e para u mor me rishikimin e projekteve tip të shkollave të cilave u bëri disa ndryshime e plotësime, duke u shtuar punishte e palestra strehë të mbuluara për pushimin e nxënësve me zgjidhje planimetrike simetrike dhe asimetrike. Kjo punë ishte një hap përpara në krahasim me tipet e mëparshme.” (Kolevica, 2004, f. 115)




Figura 150. *Shkolla 11 vjeçare simetrike tip (Varianti i Madh), kati përdhe, viti 1958-1959. Arkitekti Sokrat Mosko.*




Figura 151. *Shkolla 11 vjeçare simetrike tip (Varianti i reduktuar), viti 1959. Arkitekti: Sokrat Mosko.*

Zhvillime tip, të njëllojta kudo e kurdo, derivime të të njëjtës tipologji me mangësi të mëdha në origjinalitet e në krijimtari, është arkitektura e kësaj periudhe. (Figura 152)

> "Sistemi edukativ dhe trendi arkitektonik në përgjithësi përfshinte tendencën e fabrikës, bazuar në ndërtimin e shpejtë dhe ekonomik të shkollave pa pasur parasysh unikalitetin, dhe përshtatjen me procesin e mësimit. Aspektet kulturore, gjeografike, shoqërore, dhe ideologjike nuk ishin prioritet të krahasuara me interesin për të krijuan një unifikim. Falë mungesës së buxhetit ekonomik për ndërtimin e shkollave, interesi dhe fokusi në infrastrukturën e shkollave ishte i pakët në fushën e pedagogjisë, organizimit shoqëror, hapësirës së brendshme, dhe elementeve të tjerë fizikë." (Pasalar, 2003)

Zhvillime të ngjashme të planimetrisë së shkollës 11 vjeçare me atë 7 vjeçare vërehen në shkollat e projektuara nga Sokrat Mosko në vitet 1958-1959-1960. (Figura 154)

**Skema shperndarese e katit perdhe, Shk. 1: 500**




Figura 152. *Skemë e shkollës 11 vjeçare simetrike, e vitit 1963. arkitekt Ibrahim Prushi.*[2]

---

[2] Ibrahim Prushi- "inxhinieri ndoshta më punëtor e më modest në Ndërmarrjen Projekti. Kishte bërë shkollën teknike të H.Fulcit e pastaj akademinë Ushtarake të Torinos, si oficer xhenios, por në Ndërmarrjen Projekti e më vonë në ISP bëri një nga punët më të vlefshme në studimin e banesave. Seksionet e banesave që nga viti 1958-1980 janë frute të punës së tij këmbëngulëse. (Kolevica, Arkitektura dhe diktatura, 2004, p. 65)



Figura 153. *Shkolla 11 vjeçare simetrike, e vitit 1963. arkitekt Ibrahim Prushi.*

Pavarësisht se kryheshin nga arkitektë të ndryshëm në periudha të ndryshme kohore kuptohet nga leximi i planimetrive që shkolla është gati e njëjtë pa shumë variacione e ndryshime të detyruar nga kostoja minimale të ndërtimeve si dhe nga kushtëzimi se nuk duhej të kishin derivime nga tipi. Kjo duket qartë nga varianti për shkollë të propozuar nga Valentina Pistoli që është një përsëritje e variantit të Sokrat Moskos, por pak më i vogël në sipërfaqe. (Figura 155) “Arkitektët ishin në kushte të paracaktuara e mundësitë e kërkimit të së resë ishin minimalisht të kufizuara. Ndërtimet në Shqipëri mbetën vetëm me ato tradicionale dhe të cilësisë së ulët e që zbatoheshin në vepër në mënyra primitive.” (Bego, 2009, f. 8)




Figura 154. *Skema e shpërndarjes së katit përdhe në dy variante i shkollës 7- vjeçare Tip, e vitit 1960. Arkitekti Sokrat Mosko. Ndryshimi te hyrja në katin përdhe. Kolonadat nga klasat ose nga shkallët.*




Figura 155. *Shkolla 7 vjeçare Tip, e vitit 1963. Arkitekte Valentina Pistoli*

“Me projektimin e shkollave gjatë periudhës komuniste u ndërtuan shumë shkolla në fshatra e në qytete si për arsimin fillor ashtu edhe për atë të mesëm e u morën gati gjithë arkitektët projektues në atë kohë. Si në të gjithë projektet edhe këto projektoheshin nën një regjim të rreptë kursimi, ishin shumë pak objekte në të cilat u arritën parametrat e pëlqyeshme dhe që mund të krahasohen me normat e shkollave Evropiane.” (Velo, 2004)

Arkitektura e pas luftës, zhvillimi e etja e madhe për arsim e shkolla të ndërtuara shpejt në Shqipëri korrespondon me fazën e industrializimit nëpër botë e me gjendjen e rëndë të dy Luftërave Botërore. “Shkollat e ndërtuara ndërmjet 1944-1960 treguan më pak vëmendje formës së re në arkitekturë për shkak të buxhetit të pakët të pas luftës.” (Hertzberger, 2008)

Ndërkohë Pasalar mbështet këtë mendim : “Gjatë periudhës së industrializimit (1945-1960) së bashku me idenë e prodhimit në masë u krijuan ndërtesa prototip shkollash duke dhënë një përqasje minimale drejt arkitekturës së hapësirave të edukimit-standarde koncize, dhe rregulla institucionale e ekonomike.” (Pasalar, 2003) (Figura 156)



Figura 156. *Shkolla 11 vjeçare simetrike tip (Varianti i reduktuar), viti 1959. Arkitekti: Sokrat Mosko.*

“Arti i Realizmit Socialist u dallua për mungesën e origjinalitetit dhe varfërisë të shprehjes artistike”.  (Velo, 2013) Kjo shprehje na ballafaqon më së miri me situatën e krijuar ndoshta edhe prej imponimit të regjimit i cili nuk linte të dilje nga tipi, ose edhe nga mungesa e madhe ekonomike por në shkollat e kësaj periudhe vihet re, një varfëri mendimi në projektimin e shkollave. (Figura 157)



Figura 157. *Variante fasade të shkollës 7-vjecare tip asimetrike, viti 1961. Ark. Valentina Pistoli, Rexhep Faja.*

Banesat tip, njësoj si shkollat ose ndërtesat e tjera tip të projektuara rreth kësaj periudhe “të fshehura nën variantet e fasadave, që jeta i provoi se nuk ishin variante, u ndërtuan jo vetëm në të gjithë qytetet, por edhe në qendrat e vogla bujqësore. Pak ndryshueshmëri nga ndërtesa në ndërtesë. Nga ndërtimet në një rrugë te ndërtimet në një rrugë tjetër, nga ndërtesat e një qyteti te tjetri.” (Kolevica, Një vështrim kritik ndërtimeve tona, 1966)

Në vitin 1963 ndryshoi struktura e shkollës dhe u kryen një sërë reformash në arsim të cilat ndryshuan edhe tipet e shkollave të projektuara.

### 4.1.3 Arkitektura e shkollave gjatë hovit të ndërtimeve 1963-1975

Numri më i madh i shkollave në Shqipëri korrespondon me periudhën e viteve 1965-1979 ku parimi "Arsimi publik, falas, për të gjithë, i barabartë, i përgjithshëm" çoi në rritjen në masë të numrit të shkollave e një zhvillim të vrullshëm sasior. Në vitin 1962-1963 Shqipëria kishte 636 shkolla 7 vjeçare, dhe 85 shkolla të mesme, të përgjithshme dhe profesionale ku gjendeshin edhe 9 shkolla pedagogjike. (Koliqi, 2002, f. 443)

Deri në vitin 1970 në Shqipëri u hapën 1374 shkolla tetëvjeçare, 53 shkolla të ulëta teknike-profesionale, 46 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm, 85 shkolla profesionale, industriale, bujqësore, pedagogjike etj., dhe 5 shkolla të larta. (Koliqi, 2002, f. 451)

Gjatë kësaj periudhe si dhe prishja zyrtare me Bashkimin Sovjetik solli ndryshime në jetën e shkollave. "Me shkrirjen e akullit të komunizmit në Evropë me prishjen e marrëdhënieve të miqësisë midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, rreth viteve '60-75, në jetët e shqiptarëve, në kulturë, arkitekturë, e art, sikur u krijuan kushtet për një krijimtari të lirë, të pavarur, pa diktat, pa dhunë, presione e pa censurë." (Faja, 2008, f. 14)

Në ndryshim nga seria e tipeve të përsëritura kudo njësoj, në çdo qytet të Shqipërisë , filluan të dalin tendenca për të përmirësuar fasadën e shkollës, nga arkitektë të ndryshëm të cilët krijuan variacione si dhe nxorën variantin e dytë të shkollës: atë jo simetrike , për herë të parë te shkolla 7-vjecare e 1961.

Shumë arkitektë ishin njëkohësisht kundërshtarë të tipizimit dhe standardizimit total në arkitekturë e urbanistikë, sepse "industrializimi parafabrikat i skajshëm solli në qytetet tona monotoninë fatale dhe ndrydhi lirinë e çdo krijuesi, për një arkitekturë, ndonëse jo të kushtueshme, të larmishme." (Faja, 2004)

Një variant ndryshe për fasadën na e propozon arkitekti Aleksandër Bregasi në vitin 1964 për shkollën 7/8 vjeçare asimetrike. (Figura 158)

Në këtë variant, pavarësisht planimetrisë të detyruar, arkitekti Aleksandër Bregasi[3] propozon një fasadë mjaft interesante duke luajtur me materialet e suvasë si dhe me fugat e objektit. "Dallimi nga Tipi konsiston në hapësirat e dritareve me kollonatat konstruktive" (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)

Godina përshkohet në gjatësi dhe gjerësi nga një fashë e gjerë kornize 50 cm, e cila del nga faqja e fasadës rreth 12 cm. e vishet me një granil të çukitur prej 4 cm. Me kornizat e betonit që përdoren si streha, pensilinën e madhe e të nxjerrë që mbulon dy hyrjet, balloren dhe anësoren njëkohësisht, kolonat e ndryshme nga Tipi, të momentit të hyrjes, dritaret më të mëdha e horizontale, lëvizja e materialeve në fasadë me muraturën e punuar, fuga dhe në çdo dy rreshta me tulla të parapërgatitura beton/armeje i japin kësaj ndërtese arsimore karakteristikat e një arkitekture moderne. (Figura 159)

"Arkitektura moderne hyri në Shqipëri në mënyrë të natyrshme dhe qetësisht pa zhurmë, e deklarata dhe aprovime Plenumesh, Mbledhjesh, Kryesisht, e Forumesh. Ajo nuk u thirr kurrë

[3] Arkitekti u largua nga Instituti i Projektimit menjëherë pas këtij projekti, rreth vitit 1965, për arsye të paditura. Kolegë të punës së tij në Institut shprehen se i gjetën "një njollë në biografi". (Pasko, 2016)

më emrin e CIAM-it,[4] i cili nuk u njoh kurrë zyrtarisht nga shteti ynë. Megjithatë arkitektura moderne gjeti hapësirë dhe njerëz në Shqipëri, ajo që u arrit në këtë periudhë është fryt i përpjekjeve në mes të thirrjes së arkitektëve dhe censurës e shtypjes komuniste. (Faja, 2008, f. 17)




Figura 158. *Varianti i fasadës, Shkolla 8 vjeçare Tip asimetrike, viti 1964. Ark. Aleksandër Bregasi.*

[4] *Congrès internationaux d'architecture moderne* (*CIAM*), ose Kongresi Ndërkombëtar i Arkitekturës Moderne, (1928)




Figura 159. *Detaj i dritares. Shkolla 8-vjeçare asimetrike Tip, viti 1964. Ark. Aleksandër Bregasi.*

Enver Faja në analizën e ndërtimeve të periudhës së Komunizmit shprehet: “Për sa i takon arkitekturës së disa arkitektëve si Petraq Kolevica etj., nuk përkrahën metodën e realizmit socialist si metodë politiko ideologjike-për t’iu kundërvënë “ndikimeve të huaja”, por “ai u bë përkrahës i arkitekturës moderne në Shqipëri, sepse tek ajo gjeti karakterin e fortë human, si stil që u përgjigjet idealeve të një shoqërie të re me forma të reja racionale dhe ekonomike.” (Faja, 2004)

Kolevicës iu dha detyra të projektonte një shkollë tip në Korçë por ai as nuk e morri parasysh dhe zhvilloi një projekt shkolle që ishte risi për disa faktorë: Përdorimi i palestrës në katin e dytë të ndërtesës, organizimi i klasave (në formë katrore) dhe laboratorëve në dy blloqe të veçanta, hapja me vetrata e dritare të mëdha si dhe pastërtia, thjeshtësia e funksionaliteti i japin kësaj shkolle një tendence drejt arkitekturës moderne. (Figura 160)

> “Tek ai projekt vura në zbatim për herë të parë te ne, klasat me përmasa afër katrorit të orientuara në Lindje dhe në Jug. Ndava bllokun e laboratorëve nga klasat, vura palestrën në katin e dytë e brenda trupit të ndërtesës, si dhe sallën e pushimit të nxënësve krejtësisht të mbyllur, gjëra këto të domosdoshme për klimën e ashpër të Korçës. Përveçse këtyre rrita disi edhe sipërfaqen e klasave, ndërsa ndriçimin natyral gati e dyfishova dhe u përkujdesa t’i jap ndërtesës një zgjidhje arkitektonike të veçantë e moderne. Kjo shkollë e cila u pëlqye shumë edhe nga mësuesit e nxënësit u zbatua edhe në Lushnje.” (Kolevica, Arkitektura dhe diktatura, 2004, p. 116)

Për sa i takon fasadës nga jugu arkitekti për herë të parë propozon një dritare sa gjatësia e klasës duke evidentuar në fasadë kolonat konstruktive që ngrihen e formojnë një fashë edhe në pjesën e sipërme si përmbyllje të volumit. Faja shkruan : “Vëllimi elegant dhe i lehtë i shkollës, plasticiteti i fasadës kryesore, ngjyra e bardhë, funksioni i pastër dhe i qartë janë disa veçori moderne të arkitekturës.” (Faja, 2008, f. 18) (Figura 161)




Figura 160. Sipër: *Fasada nga Lindja e Shkollës 11- vjeçare individuale. Poshtë:  Plani i katit përdhe Viti 1963-1964. Ark. Petraq Kolevica. AQTN*

Ledita Mezini




Figura 161. *Sipër: Plani i katit të Parë të Shkollës 11- vjeçare individuale. Poshtë: Fasada Nga Jugu. Viti 1963-1964. Ark. Petraq Kolevica. (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)*

Leila Mezini



Figura 162. *Foto të shkollës së mesme "Themistokli Gërmenji", Korçë. Shkolla e projektuar nga Ark. Kolevica*

Në këtë ndërtesë u arrit të bëhej në fasadën e hyrjes një basoreliev me motive nga jeta e shkollës. Për këtë, në gazetën "Zëri i Popullit" (8 qershor 1969) skulptori Thoma Thomai ka shkruar: "Sa shkolla janë ndërtuar por vetëm në njërën nga këto nga ana e arkitektit u bënë përpjekje për një bashkëpunim artistik ... dhe mbas saj nuk pati raste të tjera më." (Kolevica, Arkitektura dhe diktatura, 2004, p. 116) (Figura 163)



Figura 163. *Foto të Shkollës Themistokli Gërmenji, në ditët e sotme. Shkollë jo Tip. Projektuar nga ark. P. Kolevica.*

"Arkitektura e kësaj periudhe është e ngritur në shtratin e një varfërie ekonomike, teknologjie të prapambetur, dhe të trysnisë politike komuniste, e gjithsesi gëzon vlera të krahasueshme me arkitekturën e simotrave të vendeve të tjera, përkrahëse të këtij stili." (Faja, 2004) Përveç

shembullit sporadik te Kolevicës e Bregasit, a ndonjë arkitekti tjetër, i cili kërkonte tendencat moderne, në ndërtesat e shkollave të kësaj periudhe nuk dolën më në pah elemente të arkitekturës moderne duke i projektuar shkollat me shabllone në mënyrë të shpejtë e të njësojtë.

Në thelb të boshtit ideologjik që sundoi arsimin Shqiptar ishin parimet 'mësim-punë prodhuese- edukim fizik e ushtarak'. (Koliqi, 2002) Kjo karakteristike u shpreh me zvogëlimin e sipërfaqeve të klasave si dhe një rritje e numrit të 'pseudo laboratorëve'. Ato ishin gjithashtu klasa me sipërfaqe rreth 40-55 $m^2$, po të projektuara njësoj, ku thjesht u ndërrua emri për të qenë brenda parimit "mësim-punë". Më poshtë jepet grafiku i shkollave të mesme e sipërfaqeve përkatëse të tyre të klasave, laboratorëve e mjediseve të tjera ku vihet re që rreth viteve 1961-1971 u zvogëlua numri e raporti i sipërfaqes së klasave e u shtua numri i laboratorëve, pavarësisht se sipërfaqja e shkollës e numri i nxënësve ne total ngeli po i njëllojtë. (Figura 164)







Figura 164. *Grafiku i raporteve të sipërfaqeve të mjediseve të shkollës së mesme, periudha 1953-1979.*

Rritja e numrit të laboratorëve në periudhën 1961-1978, sidomos në shkollat e mesme korrespondon dhe me krijimin e ambienteve të mensës, e të sallës së nxënësve, që shpesh ishte si një mjedis afër bibliotekës e përdorej për lexim, ose edhe për diskutime të nxënësve mes tyre. Gjithashtu vihet re një ulje të sipërfaqes së bibliotekës e një zvogëlim i sipërfaqeve të mësimit. Të gjitha këto janë pasojë e ndërtimeve e tipizimit, ekonomizimit e standardizimit.




Figura 165. *Grafiku i sipërfaqeve të mjediseve të shkollës së mesme, periudha 1953-1979.*

### 4.1.4 Arkitektura e ndërtimeve shkollore në vitet e varfërisë ekonomike (1975-1990)

Krahas ndërtimit në masë të shkollave u has fenomeni i standardizimit, i cili solli monotoninë në qytetet e fshatrat e vendit. Dy tipet kryesore të shkollave : simetrike dhe asimetrike, shkuan drejt varfërisë, lënien pas të sipërfaqeve e zbrazjes së saj nga çdo hapësirë e lirë e kreative.

Parulla që ia zuri frymën ekonomisë së vendit e sidomos ndërtimit: “Kursim, kursim dhe vetëm kursim, kudo dhe në çdo gjë, aq shpesh të përsëritur me klithma të shfrenuara” preku edhe sektorin edukativ duke i dhënë morfologjinë e fytyrën ndërtesave arsimore. (Kolevica, 2004, p. 154)

“Nga fundi i viteve ’75, si pasojë e tipizimit, standardizimit, dhe ekonomizimit të skajshëm, kjo arkitekturë filloi të humbasë ngjyrën e saj, të bëhet e mërzitshme, me hapësira e peizazhe urbane monotone, standarde dhe aspak interesante. Këtyre të metave , tipike të arkitekturës moderne në Shqipëri i mungoi cilësia, materiali, i mungoi liria.” (Faja, 2004) (Figura 166)

“Periudha e 1973-1974 ishe periudha e gjuetisë së shtrigave ku kërkoheshin shembuj për të konkretizuar direktivat e freskëta të Pleniumit të IV të Komitetit Qendror i cili trajtonte luftën kundër ndikimeve të huaja.” (Bego, 2009) Arkitektët të frikësuar nga kjo “gjueti” e thjeshtuan në maksimum ndërtesën shkollore. Sipas Begos vlerësoheshin ata arkitekte të cilët arrinin të nxirrnin koston deri në 25 % më pak se parashikimi. “Preventivat përfundimtarë duhet të rezultonin deri në 75 % të asaj të planifikuar. (Treguesi për metër katror dhe metër kub i shkollës 8 vjeçare tip shkonte në 1.6 milione lekë të atëhershme)”. (Bego, 2009, f. 29)

Pavarësisht luhatjeve të lehta në plan, fasada e volumi ngeli problematik në këtë periudhë i karakterizuar nga thjeshtësia, mungesa e detajeve, e varfëria e materialeve e elementeve arkitektonik.

Izolimi politik e ekonomik i Shqipërisë, gjendja e rëndë ekonomike, së bashku me parullat për kursim si dhe luftës kundër influencave të huaja, çuan në zbrazjen totale të shkollës nga elementët arkitektonik, në rritjen e numrit të kateve për të kursyer maksimalisht, në shtimin e klasave por të asnjë parametri tjetër normativ, në zvogëlimin e dritareve e dyerve të cilat duhet

të ishin me madhësinë që ndërtonte uzina të parafabrikuara e në krijimin e shkollave uniforme, monotone e të njëllojta në të gjithë vendin.




Figura 166. *Shkolla e mesme e përgjithshme tip. Viarianti me 16, 24, 28 klasa. Viti 1979. Ark. Pavllo (Fredi) Luarasi*

Mbas projektimit të tipeve të vitit 1978/ 1979 për shkollat e mesme të përgjithshme si dhe për shkollat 8 vjeçare e atyre fillore, arsimi u gjend përballë një mangësie të madhe në fonde. Tipet e planifikuara për tu ndërtuar vetëm për një pesëvjeçar, domethënë deri në vitet 1983-1984 u përdorën në masivitet edhe më tej pasi rezultuan mjaft të mira nga ana e kostos së ndërtimit, nga Instituti i Projektimit nuk u planifikuan më projekte të reja tip. (Figura 167, 168)

Situata e ndërtesave shkollore paraqitej e rëndë, pasi ajo nuk përfaqësonte më objektin kryesor të fshatit, qendrës së banuar ose edhe të vetë qytetit por humbiste mes monotonisë, thjeshtësisë, e ngjyrës se rëndomtë gri a bezhë të zonave përreth saj.

Ledita Mezini



Figura 167. *Fasadat e shkollës 8-vjecare Tip 79.1 me 24 klasë. Viti 1979. Arkitekt. Afërdita Gjini*




Figura 168. *Fasadë : Shkolla e mesme e përgjithshme Tip 78/ Seria 1 , me 16/ 24/ 28 klasa. Arkitekt: Ark. Pavllo (Fredi) Luarasi*

"Shkollat në qytete janë si bërthamat më të rënda dhe prioritete të densitetit urban dhe kjo jo vetëm për numrin e madh të unitetit njerëzor për metër katror por edhe për moshën më të re të pjesëmarrësve. Ato ishin dhe janë ndër objektet më të rëndësishme që i japin edhe fytyrën vetë lagjeve sepse në shumicën e tyre nuk ka objekte të tjera shoqërore përveç shkollave. Pastaj duhet pasur parasysh që me shkollat janë të lidhur

edhe prindërit. Nuk ka asnjë objekt civil me të cilin të jenë të lidhur e gjithë shoqëria që të krahasohet me shkollat." (Velo, Rikonstruksioni i shkollave në Tiranë, 2004)

Shkollat të thjeshtuara në maksimum filluan të përngjanin me magazinat, depot, hambarët, objekte të industrisë së lehtë e nuk shfaqnin asgjë të veçantë nga ana arkitektonike, morfologjia a volumi i tyre. (Figura 169)

Vendi, në vitet 1980-1990 përkonte me periudhën e industrializimit në botë, ku filloi përdorimi gjithmonë e më në masë i materialeve të parafabrikuara. "Duke përdorur çelik, kolona betoni, parete, dyer, dritare të prodhuara në fabrika e të standardizuar u përpoqën të ndërtonin një numër të madh shkollash në mënyrë të shpejtë e të lirë. Këto konstruksione të standardizuara e të parafabrikuara çuan në forma katër këndore e drejtkëndore të rregullta duke shfaqur materialet dukshëm nëpër klasa, beton, çelik, xham e duke i dhënë klasës një karakter industrial." (Hertzberger, 2008)




Figura 169. *Shkollë fillore me 6 klasë, Tip. 79/1. Arkitekte Afërdita Gjini*

Duke qenë se shkollat nga ana konstruktive paraqiteshin në gjendje të mirë pas viteve 1983-1984, me fondet e qeverisë, Instituti filloi të kryente rikonstruksione, të cilat konsistonin kryesisht në shtimin e shkollës me një kat më shumë, me shtimin e ndonjë volumi anësore me blloqe klasash ose palestre e të mjediseve qe haseshin të nevojshme. Periudha e rikonstruksionit kapi shumë shkolla , kryesisht në qytet të mëdha, ku në përgjithësi u shtua edhe një kat më shumë për të përmbushur normativat. (Figura 170, 171)

Ledita Mezini



Figura 170. *Fasada e shkollës 11- vjeçare , "20 Vjetori i Çlirimit",*[5] *ne Bllokun 50 Vjetori "Shallvare". Sot Shkolla Dora d'Distria. Viti i projektit 1967. Ark. për fasadën Ibrahim Prushi.*



Figura 171. *Fasada e rikonstruksionit e Shkollës 11 vjeçare në bllokun e Shallvareve. Shkolla 20-Vjetori ose sot Shkolla Dora d' Istrja  Projekti i rikonstruksionit, viti 1989. Arkitekte Vera Kavaja.*

Shkollat në Shqipëri ashtu si dhe nëpër botë, rreth viteve 1980 u gjenden në vrullin e rikonstruksioneve, duke qenë se ishin struktura relativisht të reja. "Vitet 1980 ishte një periudhë rënieje dhe refleksioni për shkollat në Amerikë, e në Evropë e duke qenë se regjistrimet nëpër shumë qytete ishin gjithmonë e me të pakta, investimet në ndërtesat e shkollave ranë në mënyrë drastike dhe autoritetet u përqendruan vetëm te rikonstruksionet për ti kthyer vetëm funksionale e te standardet bazë stokun e ndërtesave të cilat po plakeshin."  (Baker, 2012)

Historia e arkitekturës së ndërtesave shkollore rreth viteve 1945-1990 është një histori e trazuar plot luhatje, ngritjeje e uljeje ndërtimesh të karakterizuara nga kursimi dhe ekonomizimi i cili çoi drejt tipizimit dhe standardizimit në masë. Historia e zhvillimet e shkollave, "në fjalë të tjera, dizajni i shkollave është pjesë e një ndërthurjeje komplekse midis individit, komunitetit, kulturës, brenda një konteksti global." (Catherine Burke & Ian Grosvenor, 2008)

## 4.2 NORMATIVAT E DIZAJNIT NË SHKOLLAT TIP

Mbi normativat e dizajnit dhe rregullat e parametrat mbi të cilat projektoheshin shkollat në periudhën e viteve 1945-1990 na tregojnë më shumë shkresat e dokumentet e vendimeve të marra nga Këshilli Teknik i Ministrisë së Ndërtimit.

Normativat e para që figurojnë të shkollave janë ato të vitit 1958, të cilat pavarësisht se rezultojnë se i ndajnë shkollat në dy grupe: shkollat 7 vjeçare qyteti dhe shkollat 7 vjeçare fshati përsëri kanë të njëjtat parametra. (Figura 173)

[5] Kjo shkollë nuk arriti të ri konstruktohet për shkak të trazirave dhe rënies së Komunizmit ne vitet 1990.

Shkollat shqiptare paraqesin varfëri në program e gjithashtu në mjedise. Shumica e shkollave e kryesisht ato fillore, pra shkollat rurale shfaqen vetëm me mjediset bazë që kërkon një mjedis mësimi, shpesh edhe vetëm me një klasë si në Figurën 172-B. Ndërkaq mjediset kryesore në shkollat shqiptare mund të grupohen në:

- Mjedise didaktike: klasa, laboratorë, palestra, salla pune.
- Hapësira për aktivitete të lira si: bibliotekë, sallë nxënësish, mensë.
- Hapësira shpërndarëse: holl, korridore, shkallë.
- Hapësira administrative: Drejtori, sekretari, sallë mësuesish, kabinete, fjetje mësuesi.
- Hapësira ndihmëse: nyje sanitare, depo, e mjedise të tjera ndihmëse.

Koeficienti i cili llogaritet në shkollat e të gjitha tipave është raporti i sipërfaqes së klasës me numrin e nxënësve i cili ka qenë një normativë që merrte për llogaritje klasën e mësimit me 40 nxënës. Ky koeficient paraqitet i njëllojtë e duhet të ishte 1 $m^2$/ nxënës duke shkuar deri në 1.05 $m^2$/ nxënës në shkollat e mesme. ( normativë që figuron deri në vitin 1974) (Figura 172, A)




Figura 172. *A-Plani i klasës tip për 40 nxënës. Sipërfaqe Neto 42 m2 (5.40X 7.80) Raporti i klasës 1.05 m2/nxënës. B-Plane shkollash me një klasë.*

Normativat e shkollave Shqiptare në vitet 1958 jepen në Tabelën e mëposhtme. (Tabela 9 )

### 4.2.1 Shkollat Fillore.

Një nga koeficientet kryesorë në dizajnin e shkollave është raporti i sipërfaqes së klasës me numrin e nxënësve për klasë. Pavarësisht kushteve normativë ky parametër ka pasur uljet e ngritjet e tij. Në shkollat fillore kur fillimisht kërkohej vetëm të projektohej, e nuk kishte ende standarde, ndoshta edhe prej faktit të mungesës së njohurive ose edhe të normativave të ngelura nga Italianët, shkollat paraqiten me raportin e sipërfaqes së klasës /numrin e nxënësve me 1.87 $m^2$/ nxënës, (në vitin 1945). Pëson ulje drastike në vitet ’52, ’54 e arrijnë përsëri vlera te 1.7 $m^2$/ nxënës në vitin 1959. Në grafikun e mëposhtëm jepet ky raport për shkollat fillore deri në vitin 1959, vit kur u vendosën normativa të reja. (Figura 173)

Ledita Mezini

Tabela 9. *Normativat e shkollave të miratuara nga Këshilli Teknik i Ministrisë së Ndërtimit deri në vitin 1958.*

| Nr. | Të dhënat Kryesore | Tipi i Shkollës | | Literatura Jonë |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Normat e vjetra 1958 |
| 1 | Numri i klasave | 8-Vjecare Qyteti | | 1 deri ne 7 klasa |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 1 deri ne 7 klasa |
| 2 | Madhësia e Parcelës | 8-Vjecare Qyteti | 16 klasa | |
| | | | 24 klasa | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha |
| | | Te mesme te pergjithshme | 16 klasa | |
| | | | 24 klasa | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 8 klasa | |
| | | | 12 klasa | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha |
| 3 | Sipërfaqe klase M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 7 vjecare, 1 m2 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 7 vjecare, 1 m2 |
| 4 | Sipërfaqe laborator M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 |
| 5 | Sipërfaqe rekreacioni (jashtë korridorit)M2/ | 8-Vjecare Qyteti | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | |
| 6 | Gjerësi Korridori në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 2.2 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 2.2 |
| 7 | Lartësia e katit në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 3.3 dysheme/dysheme |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 3.3 dysheme/dysheme |
| 8 | Salla e gjimnastikës | 8-Vjecare Qyteti | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | | |
| 9 | Raporti I Ndricimit | Per klasat e laboratoret | | 7 vjecare, 1:0-1:8 |
| | | Per fshat ose klime te ftohte | | |
| | | Per ambjentet e tjera | | 7 vjecare, 1:7-1:9 |
| 10 | Nyjet sanitare | Per gjithe tipat | | 1 W.C. dhe Pisuar per 40 djem |
| | | | | 1 W.C. per 30 vajza |
| | | | | 1 lavaman per 1 W.C. |




Figura 173. *Grafiku i raportit të sipërfaqes së klasës me numrin e nxënësve për shkollat fillore me 30/ 40 nxënës nga viti 1945 deri në vitin 1959.*

Sipërfaqja e klasave përkatëse sipas viteve paraqitet në grafikun më poshtë.




Figura 174. *Grafiku i sipërfaqes së klasës për shkollat fillore me 30/ 40 nxënës nga viti 1945 deri në vitin 1959.*

Shkollat fillore me 1 klasë (me 40 nxënës) paraqiten të varfra nga mjediset ku vihet re që kanë ose thjesht klasën dhe një mjedis administrativ, dhe rrallë edhe ndonjë mjedis ndihmës, (nyje sanitare). (Figura 172) Shkollat e fshatit (rurale) dhe hapësirat e tyre përkatëse jepen në grafikun e mëposhtëm prej nga kuptojnë se atyre u mungojnë krejtësisht sipërfaqet rekreative, laboratorët e mjedise të tjera. Shkollat me 1 klasë nuk u projektuan më pas vitit 1959.




Figura 175. *Shpërndarja e hapësirave në shkollat e fshatit me 1 klasë.*

Normativa e projektimit të raportit të sipërfaqes totale të shkollës në $m^2$ me numrin e nxënësve del si e dhënë kryesore dhe e vetme, në normativat e vitit 1974, në botimin e Ministrisë së Ndërtimit. Për shkollat e ciklit të ulët deri në 4 klasë kjo normë është 1.61 m2/ nxënës. (Figura 176)


**II. Shkolla 8 vjeçare:**

**B. Me banga dyvendëshe**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Shkollë e ciklit të ulët (deri 4 klasë) | m²/nxënës | 1,61 |
| 2. Shkollë 8 vjeçare + cikli i ulët | | |
| a) Me 8 klasë | » | 2,60 |
| b) Me 16 klasë | » | 2,60 |
| c) Me 24 klasë | » | 2,08 |

Figura 176. *Fletë nga botimi i Aparatit të Këshillit të ministrave, mars 1977. Mbi normativat e projektimit.*

Nëse e krahasojmë këtë normativë të projektimit të shkollave të ciklit të ulët për shkollat me 60-80 nxënës d.m.th. me 2 klasë do të vëmë re se vetëm tipi i vitit ’51, ’52, e ’59 me dy klasë janë brenda normativës së lejuar. (Grafiku në figurën 177). E njëjta situatë paraqitet edhe për shkollat me 120 nxënës (3 klasë mësimi ) e ato me 160 nxënës (4 klasë mësimi) ku vetëm në vitin 1952 e në vitin 1959 në shkollën me 4 klasa mësimi, për 120 nxënës, normativa e sipërfaqes Neto të shkollës me numrin e nxënësve kalon mbi 1.61 $m^2$/ nxënës, si në figurën 178. Shkollat e ciklit të ulët me 5 klasë ose me 6 klasë të vitit 1959 e deri në 1978 e kanë këtë normativë të kënaqshme nga 2.4 m2/ nxënës në 1.7 m2/ nxënës si në figurën 179.

Leila Mezini




Figura 177. *Raporti i sipërfaqes totale Neto me numrin e nxënësve për shkollat fillore me 60-80 nxënës nga viti 1945 deri në vitin 1959.*




Figura 178. *Raporti i sipërfaqes totale Neto me numrin e nxënësve për shkollat fillore me 120-160 nxënës nga viti 1945 deri në vitin 1976.*




Figura 179. *Raporti i sipërfaqes totale Neto me numrin e nxënësve për shkollat fillore me 120-160 nxënës nga viti 1955 deri në vitin 1979.*

Sic duket edhe nga figurat 177, 178, 179, ky raport ka qenë i kënaqshëm vetëm në vitin 1959. Vit në të cilin pati shumë ndryshime në normativat e shkollave të ardhura si rrjedhojë edhe e influencës nga Bashkimi Sovjetik, dhe reformave qe kreu në gjithë projektet drejtori Sokrat

Ledita Mezini

Mosko. *(Kolevica, Arkitektura dhe diktatura, 2004)*. Shumë e ulët është kjo normativë 1.1 m2/ nxënës, në vitin 1979 ku në një shkollë me 715 m2 sipërfaqe ndërtimi kryenin mësim 640 nxënës. Për sa i takon shkollave të ciklit të ulët ato nuk kanë mjedise rekreative e paraqiten kryesisht vetëm me klasa, ambiente fjetje për mësuesin, zyrë drejtori, ambient ndihmës, e hapësira shpërndarëse. Vetëm në vitin 1979 kjo shkollë ka dhe një mjedis të vogël biblioteke. (Figura 180)




Figura 180. *Grafiku i shpërndarjes së hapësirave në mjediset e shkollës fillore me 5, 6 dhe 8 klasa mësimi.*

Në grafikun e mëposhtëm jepen 4 variantet e shkollës për ciklin e ulët të vitit 1955 ku dallohen treguesit në m$^2$ për çdo hapësirë. Hapësira didaktike përbën pjesën më të madhe të shkollës duke treguar që shkollat fillore vuanin nga mungesa e sipërfaqeve të tjera. (Figura 181)




Figura 181. *Plani i shkollës së fshatit me dy klasa e vitit 1955, Varianti i I e varianti i II. Ark. M. Cano*




| | Pa fjetje me 80 nx. | Me fjetje me 80 nx. | Varianti 1 | Varianti 2 |
|---|---|---|---|---|
| Ambjente ndihmese | 0 | 19.44 | 0 | 0 |
| Hapesira administrative | 12.33 | 22.88 | 9.89 | 9.35 |
| Hapesira shperndarese | 7.92 | 45.9 | 0 | 14.5 |
| Hapesira per aktivitete te lira | 0 | 16.8 | 0 | 0 |
| Hapesira mesimi | 67.2 | 72 | 72.5 | 72.5 |

Figura 182. *Grafiku i treguesit në m$^2$ për çdo hapësirë funksionale për shkollat tip, të projektuara me dy klasë për 80 nxënës.*

Ndërkaq planimetritë e shkollës me dy klasë të vitit 1955 Varianti 1 e 2, nga arkitekt M. Cano, si dhe ai me fjetje e pa fjetje të projektuara nga V. Russi më 1952 jepen në figurat 181 e 183.




Figura 183. *Plani i shkollës së fshatit me dy klasa e vitit 1952, Varianti me fjetje e pa fjetje. Ark. V. Russi*

Leila Neziri

Vetëm në shkollën fillore të vitit 1959, të projektuar nga arkitekti Sokrat Mosko, shkolla është e projektuar edhe me dy mjedise laboratorike me raport sipërfaqeje/ nxënës me 1.1 $m^2$. Kjo shkollë me 5 klasë dhe 2 laboratorë përdorej edhe si shkollë e ciklit të ulët ose edhe si shkollë 7 vjeçare për zonat rurale. (Figura 184)




Figura 184. *Shkolla fillore e ciklit të ulët, me 5 klasë. Viti 1959. Ark. Sokrat Mosko.*

### 4.2.2 Shkollat 7 e 8 Vjeçare

Një punë më e madhe mbi normativat është kryer për shkollat 8 vjeçare të cilat pavarësisht se si raport të sipërfaqes së klasës me numrin e nxënësve vazhdon të jetë nga 0.9 deri në 1.2 $m^2$/ nxënës, dhe në pjesën më të madhe është te 1 $m^2$/ nxënës, raporti i Sipërfaqes Neto/ me numrin total të nxënësve paraqitet i variueshëm nga 1.4 $m^2$/ nxënës në 3.6 $m^2$/ nxënës kjo e llogaritur për shkollat 8-vjeçare me 280 nxënës. (Figura 185)

Më i madh paraqitet ky raport me shkollat me 480 nxënës kryesisht ato të vitit 1960, 1973/ e 1977, i cili është rrotull 2.2 m2/ nxënës, dhe arrin në 2.4 m2/ nxënës në shkollat 8-vjecare të 1964 simetrike 3 katëshe të projektuara për 640 nxënës.

Normativat e vendosura për shkollat 7/8 vjeçare pësuan ndryshime në vitin 1959, ndryshime që ngelën deri në vitin 1973. Këto normativa jepen në Tabelën 10 ku nga krahasimi me normat e 1958/1959 shihet se nuk kanë ndryshime thelbësore. Pësuan ndryshime në mbledhjet e kryera nga një grup arkitektësh dhe inxhinierësh si Andon Lufi, Kostaq Sahatciu, Ziha Ftera, Koco Miho, Valentina Pistoli, Sokrat Mosko etj., të cilët ri-shqyrtuan me vendimin Nr. 26 të datës 28.08.1961 (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015) ku u vendos si projekt Tip, projekti i arkitektes Valentina Pistoli. (Figura 187) Në këto mbledhje u pranua nga arkitektët e projektuesit që normativat Shqiptare për shkollat linin për të dëshiruar. (Figura 186)




Figura 185. *Sipër: Grafiku i raportit të Sipërfaqes Neto /numrin e nxënësve për shkollat 7-8 vjeçare me 480 nxënës. Në Qendër: Grafiku i raportit të Sipërfaqes Neto /numrin e nxënësve për shkollat 7-8 vjeçare me 480 nxënës. Poshtë: Grafiku i raportit të Sipërfaqes Neto /numrin e nxënësve për shkollat 7-8 vjeçare me 520-560-640-960 nxënës.*

Tabela 10. *Normativat e shkollave të miratuara nga Këshilli Teknik i Ministrisë së Ndërtimit deri në vitin 1973.*

| Nr. | Të dhënat Kryesore | Tipi i Shkollës | | Literatura Jonë | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Normat e vjetra 1958 | Normat 1959-1973 |
| 1 | Numri i klasave | 8-Vjecare Qyteti | | 1 deri ne 7 klasa | 16 klasa |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 15-16 klasa (Për 12 vjecaret) |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 1 deri ne 7 klasa | 7 klasa (Për 7 vjecaret) |
| 2 | Madhësia e Parcelës | 8-Vjecare Qyteti | 16 klasa | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | |
| | | | 24 klasa | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | 16 klasa | | |
| | | | 24 klasa | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 8 klasa | | |
| | | | 12 klasa | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | |
| 3 | Sipërfaqe klase M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 7 vjecare, 1 m2 | 1 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 1 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 7 vjecare, 1 m2 | 1 |
| 4 | Sipërfaqe laborator M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 1.3-1.9 (53-67 M2) |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | 1.06 |
| 5 | Sipërfaqe rekreacioni (jashtë korridorit)M2/ | 8-Vjecare Qyteti | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 0.21-0.3 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | | |
| 6 | Gjerësi Korridori në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 2.2 | 2.14 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 2.14 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 2.2 | 2.2 I dyanshëm/ 2.2 I njëanshëm |
| 7 | Lartësia e katit në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 3.3 dysheme/dysheme | 3.4 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 3.4 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 3.3 dysheme/dysheme | |
| 8 | Salla e gjimnastikës | 8-Vjecare Qyteti | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | | 8.6*17.6*4.3 h neto/8.5*19.4.3 h neto |
| | | 8-Vjecare Fshati | | | |
| 9 | Raporti I Ndricimit | Per klasat e laboratoret | | 7 vjecare, 1:0-1:8 | 1:5-1:6 |
| | | Per fshat ose klime te ftohte | | | 1:5-1:6 |
| | | Per ambjentet e tjera | | 7 vjecare, 1:7-1:9 | 1:08 |
| 10 | Nyjet sanitare | Per gjithe tipat | | 1 W.C. dhe Pisuar per 40 djem | 1 W.C. per 30-52 nxenws |
| | | | | 1 W.C. per 30 vajza | |
| | | | | 1 lavaman per 1 W.C. | 1 lavaman per 80 nxenes |


Rreth 22% e popullsisë së vëndit janë në moshë shkollore. Kjo shifër e madhe dhe fakti që arësimi tek né u bë masiv,kërkon ndërtime shkollash të shumta.Shpenzimet për ndërtimin e administrimin e tyre,shpërndarja në për qytete,krijimi i shkollës 8 dhe 12 vjeçare në vend të asajë me 7 dhe 11 klasë etj.probleme të tilla,kërkojnë studim të imtë.

Deri tani,këto probleme nuk ka qenë e mundur të studjohen e për pasojë shkollat që kemi ndërtuar lënë për të dëshëruar.

Figura 186. *Shkresë Vendimi Nr. 93 i datës 3/11/1964 nga Mbledhja e Këshillit teknik të Ministrisë së Ndërtimit, për projektimin e shkollave.*

| | | Viti | 1961-1964 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nentipi | Tip asimetrike 3 kat | | | | |
| | | Emertimi | Nr. | m2 | M2/nx | Tot nx. | Totali |
| | | Nxenesit | 40 | 1307.35 | 2.334553 | 560 | |
| Hapesira mesimi | Hap. Didaktike | Klasa | 14 | 39.1 | 0.98 | 547 | 729.52 |
| | Hap. Praktike | Laboratore | 4 | 45.7 | 0.33 | 183 | |
| | | Palestra | | | 0 | 0 | |
| Hapesira per aktivitete te lira | | Biblioteke | 1 | 39.1 | 0.07 | 39.1 | 39.06 |
| | | Salle Nxenesish | | | | | |
| | | Mence | | | | | |
| Hapesira shperndarese | | Holle | 3 | 45.3 | 0.24 | 136 | 373.06 |
| | | Korridore | 3 | 68.3 | 0.37 | 205 | |
| | | Shkalle | 1 | 32.4 | 0.06 | 32.4 | |
| Hapesira administrative | Administrata | Drejt/Sekr/mes | 3 | 17.1 | | 51.3 | 102.7 |
| | Mesuesi | Fjetje | | | | | |
| | | Kabinete | 4 | 12.9 | | 51.4 | |
| Ambjente ndihmese | Ndihmese | Zhveshje/dushe | | | 0.00 | 0 | 63.01 |
| | W.C. | m2/Nxenes | 4 | 12.5 | 0.09 | 50.2 | |
| | | cope/Nxenes | 12 | | 46.7 | | |
| | | Mesuesi | | | | | |
| | Depo | Depo | 1 | 12.9 | | 12.9 | |
| | | | Nr./klase | Gjeresi | Lartesi | Raport | 1307.35 |
| Ndricimi ne nje klase | | | 3 | 1.45 | | | |
| Korridore | | | | 2.26 | | | |
| Shkalle | | | | 1.7 | | | |




Figura 187. *Tabela e programit dhe plani i shkollës Tip 7/ 8 vjecare të projektuar e të ndërtuar në vitet 1961-1964. Arkitekte Valentina Pistoli*

Gjithashtu në vitin 1964 në vërejtjet për projektin tip të shkollës 8-vjecare të propozuar nga arkitektja Valentina Pistoli, recenti Kostaq Sahatciu shprehet: “Si element ku fëmija, krahas familjes, merr nocionet e para mbi jetën, shkolla është e një rëndësie të jashtëzakonshme dhe roli edukativ i arkitekturës në këtë mes është shumë i madh. Prandaj është e domosdoshme që projektet tip të shkollave të hartohen me seriozitet më të madh për të plotësuar mirë funksionin e tyre të gjithanshëm edukativ.” (Sahatçiu, 1964)

Pikërisht mbas vitit 1964 shkollat 8 vjeçare figurojnë pak më të mëdha për sa u takon hapësirave ku nga 560 nxënës maksimumi u kalua në 640 nxënës dhe gjithashtu filluan të futen

mjedise të tjera si salla leximi, salla nxënësish, biblioteka e shpesh edhe mensa. Hapësirat për aktivitet e lira edhe pse minimale në krahasim me sipërfaqet e tjera të shkollës filluan të shfaqen. (Figura 188)




Figura 188. *Sipërfaqet përkatëse për shkollat 8 vjeçare me 520, 560, e 640 nxënës.*




Figura 189. *Sipërfaqet përkatëse të shkollave 7-8 vjeçare për 480 nxënës.*

Pavarësisht rritjes së lehtë të sipërfaqeve, pjesën më të madhe të hapësirës së shkollës ë zënë mjediset didaktike me klasat e laboratorët, që zënë volumin kryesor të shkollës. (Figura 189)

### 4.2.3 Shkollat e Mesme

Shkollat e mesme të cilat filluan të ndërtohen më vonë në Shqipëri kanë normativa më të mira e të përafërta me vendet e lindjes nga të cilat ishin referuar. Nga grafiket vihet re se sipërfaqet e tyre janë relativisht të vogla në vitet 1953-1957, periudhë ku shkolla 11–vjeçare paraqitet gati e njëjtë me skemën e shkollës 7 vjeçare. (Figura 190)




Figura 190. *Majtas: Planet e shkollës 7 vjeçare të vitit 1955, ark. Valentina Pistoli dhe plani i shkollës 11 vjeçare Tip, viti 1953, ark. Kostaq Sahatciu*




Figura 191. *Raporti i sipërfaqeve të hapësirave të shkollës se mesme të përgjithshme.*

Përveç se në Gjimnazin Tip të vitit 1953, ku numri i nxënësve dhe numri i klasave e mjediseve janë të pakta në shkollat e mesme që pasuan sipërfaqet u rritën kryesisht në drejtim të mjediseve të tjera si hapësira administrimi, hapësira ndihmëse, hapësira për aktivitete të lira e për pasojë edhe hapësira shpërndarëse. (Figura 191)

Në periudhën e viteve 1961 ku motoja e shkollës u bë "Mësim +Punë Prodhuese" shikohet një kthim drejt sallave të laboratorëve ku shkolla ngelet me 6 klasa të mirëfillta dhe me 12 laboratorë e punishte. Ky kthim i shkollës me mjedise drejt laboratorëve çoi edhe në krijimin e një mjedisi te vogël ndihmës për nxënësit ku mund të ushqeheshin. Megjithëse në sipërfaqe të vogël ky mjedis u zhduk përsëri në shkollat e 1974 e atyre të 1979. Në shkollat e mesme të përgjithshme raporti i klasës mbetet 1 $m^2$/ nxënës kurse ai i laboratorit lëviz nga 1.05-1.4 m2/ nxënës. Ky raport nuk është në rregull as me normativën e vitit 1958 ku për laboratorët kjo normativë ishte vetëm 1.37-1.43 $m^2$/nxënës, e as me atë ekzistuese deri në vitin 1973 ku

normativa ishte 1.3-1.9 $m^2$/nxënës. Siç shihet nga figura shumë pak shkolla arrijnë ta kapin këtë normativë duke qenë pak më poshtë se kufiri. (Figura 192)




Figura 192. *Grafiku që paraqet normativën e raportit te sipërfaqes së klasës me numrin e nxënësve dhe raportit të sipërfaqes së laboratorit me numrin e nxënësve , dhënë në $m^2$/ nxënës.*

Ndërkaq raporti për sipërfaqen totale me numrin e nxënësve për shkollat e mesme jepet si në figurën marrë nga Normativat e projektimit të vitit 1977, ku shkollat ishin të planifikuara për 16 klasa, 24 klasa dhe 28 klasa, dhe 6 laboratorë respektivisht me 640, 960, 1120 nxënës. Këto raporte janë 2.9 $m^2$/ nxënës në shkollat me 16 klasa, 2.34 $m^2$/ nxënës për shkollën me 24 klasa, e 2.15 $m^2$/ nxënës në shkollën 28 klasash. (Figura 193)

Krahasimi i normativave ekzistuese me atë që ishte ndërtuar në shkolla na tregojnë se shkollat përmbushnin pjesërisht kërkesat e kohës. Pavarësisht kësaj në tabelën 11 dhe tabelën 12 mund të bëhet më mirë krahasimi e të kuptohen këto parametra:



**III. Shkolla të mesme**

**B. Me banga dyvendëshe**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Shkollë e mesme e përgjithshme me 16 klasa | $m^2$/nxënës | 2,90 |
| 2. Shkollë e mesme e përgjithshme me 24 klasa | » | 2,34 |
| 3. Shkollë e mesme e përgjithshme me 28 klasa | » | 2,15 |
| 4. Shkollë e mesme profesionale me 16 klasa | » | 4,10 |
| 5. Shkollë e mesme profesionale me 24 klasa | » | 3,30 |
| 6. Shkollë e mesme profesionale me 28 klasa | » | 3,00 |

Figura 193. *Fletë nga botimi i aparatit të Këshillit të ministrave, mars 1977. Mbi normativat e projektimit.*

Tabela 11. *Tabela e të dhënave të shkollave me 16/24/28 klasa në vitin 1979 dhe hapësirat përkatëse të tyre.*

| | | | Shkolla 12 vjecare | | | | | Shkolla 12 vjecare | | | | | Shkolla 12 vjecare | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Viti** | **1979** | | | | | **1979** | | | | | **1979** | | | | |
| | | **Nentipi** | **Tipi 1 me 16 klasa** | | | | | **Tipi 2 me 24 klasa** | | | | | **Tipi 3 me 28 klasa** | | | | |
| | | Emertimi | Nr. | m2 | M2/nx | Sip. Tot | **Totali** | Nr. | m2 | M2/nx | Sip. Tot | **Totali** | Nr. | m2 | M2/nx | Sip. Tot | **Totali** |
| | | **Nxenesit** | **40** | | **2.884** | **640** | | **40** | | **2.3197** | **960** | | **40** | | **2.2135** | **1120** | |
| **Hapesira mesimi** | **Hap. Didaktike** | **Klasa** | 16 | 36.4 | 0.91 | 582 | 1105.64 | 24 | 37.8 | 0.94 | 906 | 1423.68 | 28 | 38.9 | 0.97 | 1088.2 | 1605.57 |
| | **Hap. Praktike** | **Laboratore** | 6 | 54 | 1.35 | 324 | | 6 | 52.9 | 1.32 | 318 | | 6 | 52.9 | 1.32 | 317.4 | |
| | | **Palestra** | 1 | 200 | 0.31 | 200 | | 1 | 200 | 0.21 | 200 | | 1 | 200 | 0.18 | 200 | |
| **Hapesira per aktivitete te lira** | | **Biblioteke** | 1 | 42.9 | 0.07 | 42.9 | 42.88 | 1 | 42.9 | 0.04 | 42.9 | 42.88 | 1 | 42.9 | 0.04 | 42.88 | 42.88 |
| | | **Salle Nxenesish** | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | **Mence** | | | | | | | | | | | | | | | |
| **Hapesira shperndarese** | | **Holle** | 4 | 23.4 | 0.15 | 93.4 | 422.03 | 4 | 23.4 | 0.10 | 93.4 | 485.11 | 4 | 23.4 | 0.08 | 93.6 | 554.6 |
| | | **Korridore** | 8 | 35.7 | 0.45 | 286 | | 8 | 43.6 | 0.36 | 349 | | 8 | 52.3 | 0.37 | 418.4 | |
| | | **Shkalle** | 3 | 14.2 | | 42.6 | | 3 | 14.2 | | 42.6 | | 3 | 14.2 | | 42.6 | |
| **Hapesira administrative** | **Administrata** | **Drejt/Sekr/mes** | 3 | 26.2 | | 78.5 | 122.77 | 3 | 26.2 | | 78.5 | 122.77 | 3 | 26.2 | | 78.6 | 123.4 |
| | **Mesuesi** | **Fjetje** | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | **Kabinete** | 4 | 11.1 | | 44.3 | | 4 | 11.1 | | 44.3 | | 4 | 11.2 | | 44.8 | |
| **Ambjente ndihmese** | **Ndihmese** | **Zhveshje/dushe** | 2 | 11.5 | 0.04 | 23 | 152.46 | 2 | 11.5 | 0.02 | 23 | 152.46 | 2 | 11.5 | 0.02 | 23 | 152.67 |
| | **W.C.** | **m2/Nxenes** | 8 | 11.8 | 0.15 | 94.2 | | 8 | 11.8 | 0.1 | 94.2 | | 8 | 11.8 | 0.08 | 94.4 | |
| | | **cope/Nxenes** | 24 | | 26.7 | | | 24 | | 40 | | | 24 | | 46.7 | | |
| | | **Mesuesi** | | | | 0 | | | | | 0 | | | | | 0 | |
| | **Depo** | **Depo** | 3 | 11.8 | 0.06 | 35.3 | | 3 | 11.8 | 0.04 | 35.3 | | 3 | 11.8 | 0.03 | 35.27 | |
| | | | Nr./klase | Gjeresi | Lartesi | Raport | | Nr./klase | Gjeresi | Lartesi | Raport | | Nr./klase | Gjeresi | Lartesi | Raport | |
| **Ndricimi ne nje klase** | | | 3 | 1.33 | 1.61 | 0.18 | 1845.78 | 3 | 1.33 | 1.61 | 0.17 | 2226.9 | 3 | 1.33 | 1.61 | 0.1653 | 2479.12 |
| **Korridore** | | | | 2.14 | | | | | 2.14 | | | | | 2.14 | | | |
| **Shkalle** | | | | 1.5 | | | | | 1.5 | | | | | 1.5 | | | |

Tabela 12. *Tabela e normativave ekzistuese të miratuara*

| Nr. | Të dhënat Kryesore | Tipi i Shkollës | | Literatura Jonë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Normat e reja 1974 | Normat e vjetra 1958 | Normat 1959-1973 |
| 1 | Numri i klasave | 8-Vjecare Qyteti | | 16 dhe 24 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 16 klasa |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 16 dhe 24 klasa | | 15-16 klasa (Për 12 vjecaret) |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 8 dhe 12 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 7 klasa (Për 7 vjecaret) |
| 2 | Madhësia e Parcelës | 8-Vjecare Qyteti | 16 klasa | 0.75 Ha 11.7 m2/nxënës | | |
| | | | 24 klasa | 1 Ha 10.4 m2/nxënës | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | |
| | | Te mesme te pergjithshme | 16 klasa | 0.75 Ha 11.7 m2/nxënës | | |
| | | | 24 klasa | 1 Ha 10.4 m2/nxënës | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 8 klasa | 0.5 Ha 15.6 Ha/nxënës | | |
| | | | 12 klasa | 0.75 Ha 15 m2/nxënës | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | |
| 3 | Sipërfaqe klase M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 1 | 7 vjecare, 1 m2 | 1 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 1.05 | | 1 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 1 | 7 vjecare, 1 m2 | 1 |
| 4 | Sipërfaqe laborator M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | | 1.37 | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 1.5 | | 1.3-1.9 (53-67 M2) |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 1.37 | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | 1.06 |
| 5 | Sipërfaqe rekreacioni (jashtë korridorit)M2/ | 8-Vjecare Qyteti | | 0.2-0.3 | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 0.2-0.3 | | 0.21-0.3 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 0.16-0.25 | | |
| 6 | Gjerësi Korridori në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 2.20 l dyanshëm | 2.2 | 2.14 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 1.80 l njëanshëm | | 2.14 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 1.8-2.0 l dyanshëm/1.6-1.8 l njëanshëm | 2.2 | 2.2 l dyanshëm/ 2.2 l njëanshëm |
| 7 | Lartësia e katit në ml | 8-Vjecare Qyteti | | 3.3 dysheme/dysheme | 3.3 dysheme/dysheme | 3.4 |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 3.3 dysheme/dysheme | | 3.4 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | 3.15 dysheme/dysheme | 3.3 dysheme/dysheme | |
| 8 | Salla e gjimnastikës | 8-Vjecare Qyteti | | 9*18*4.5 h neto | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | | 10*20*5 h neto | | 8.6*17.6*4.3 h neto/8.5*19.4.3 h neto |
| | | 8-Vjecare Fshati | | | | |
| 9 | Raporti I Ndricimit | Per klasat e laboratoret | | 1:5-1:7 | 7 vjecare, 1:0-1:8 | 1:5-1:6 |
| | | Per fshat ose klime te ftohte | | 1:7-1:9 | | 1:5-1:6 |
| | | Per ambjentet e tjera | | 1:6-1:9 | 7 vjecare, 1:7-1:9 | 1:08 |
| 10 | Nyjet sanitare | Per gjithe tipat | | 1 W.C. dhe 0.4 Pisuar per 40 djem | 1 W.C. dhe Pisuar per 40 djem | 1 W.C. per 30-52 nxenws |
| | | | | 1 W.C. per 30 vajza | 1 W.C. per 30 vajza | |
| | | | | 1 lavaman per 60 nxenes | 1 lavaman per 1 W.C. | 1 lavaman per 80 nxenes |

- Klasa për shkollat e mesme të përgjithshme e ka normën 1.05 $m^2$/ nxënës ( Normativat e vitit 1974) ndërsa në shkollat e 1979 figuron: 0.91 $m^2$/nxënës, për shkollën me 16 klasa, 0.94 $m^2$/nxënës, për shkollën me 24 klasa, 0.97 $m^2$/nxënës, për shkollën me 28 klasa. (vija me të kuqe në tabelën 11)
- Laboratori për shkollat e mesme të përgjithshme e ka normën 1.5 $m^2$/ nxënës ( Normativat e vitit 1974) ndërsa në shkollat e 1979 figuron 1.35 $m^2$/ nxënës. (vija me blu në tabelën 11)
- Korridori me gjerësi 2.2 m, shfaqet pak më i ngushtë në shkollën e mesme me gjerësi 2.14 m

- Zbatohet raporti i ndriçimit që është 1/5 deri 1/7 dhe përmasat e palestrës 10/ 20/ 5 metra.
- Ndërkaq shkolla plotëson normativën e sipërfaqes neto/ numrin total të nxënësve, ku për shkollën e mesme me 16 klasa është 2.9 $m^2$/ nxënës (Vija me jeshile në tabelën 11), Është 2.32 $m^2$/nxënës në shkollën me 24 klasa nga normativa e cila tregon 2.34 $m^2$/ nxënës. Dhe është pak më e lartë me 2.21 $m^2$/ nxënës në shkollat me 28 klasë ku normativa është 2.15 $m^2$/ nxënës.




Figura 194. *Plani i katit përdhe të shkollës së mesme Tip 1, seria 2 me 16 klasë, viti 1979. Ark. P. Luarasi*

Normativat shqiptare afronin më shumë me ato kineze duke qenë se në këtë periudhë vendi kishte influenca dhe marrëdhënie bashkëpunimi me Shtetin Kinez. (Shtojca A)

## 4.3 TIPOLOGJITË E NDËRTESAVE ARSIMORE

### 4.3.1 Tipologjitë e ndërtesave arsimore në bazë të strukturës

Tipologjitë e ndërtesave arsimore janë të lidhura ngushtë me strukturën e sistemit arsimor në Shqipëri i cili përgjatë historisë së tij ka njohur ndryshime të herëpashershme. Struktura e vitit 1947-1948 parashikonte arsimin parashkollor, arsimi fillor, shkollat shtatë-vjeçare, arsimi i mesëm 11 vjeçar, dhe arsimi për të rritur e profesional. (Koliqi, 2002, f. 439)

Reforma kryesore e arsimit ajo e vitit 1946 pësoi ndryshime të mëdha në 1963 me ligjin “Mbi riorganizimin e sistemit arsimor në RPSSH”, ku arsimi bazë kaloi nga sistemi shtatë-vjeçar në atë tetë-vjeçar të detyruar e të përgjithshëm, për fëmijët e moshës 6-14 vjeç, arsimi fillor pa shkëputje nga puna dhe shkolla speciale, (Hoxha, 1968) dhe u intensifikua më shumë me 20 shkurt 1970, ku Këshilli i Ministrave miratoi vendimin “mbi sistemin e ri arsimor”, me të cilin krijohet sistemi i ri arsimor i plotë e i larmishëm. Kjo reformë preku gjithashtu edhe arsimin e mesëm i cili nga njëmbëdhjetëvjeçar kaloi në arsim të mesëm 12 vjeçar, ku kryesisht shkollat

e mesme të përgjithshme 4 vjeçare u ndanë më vete. (Koliqi, 2002, f. 451). Kjo strukturë ishte struktura që u aplikua për një kohë të gjatë e mbi të cilën u ndërtuan e u projektuan shkollat Shqiptare.

Momentalisht në Shqipëri kjo lloj strukture e shpërndarë nëpër institucionet arsimore shfaqet si në grafikun e mëposhtëm në shkollat si institucione. (Figura 195)




Figura 195. *Grafiku i llojeve të shkollave krahasuar me numrin e nxënësve përkatës dhënë si % e totalit të institucioneve shkollore, dhe % e numrit të nxënësve.*

- Nga Figura 195, kuptojmë se rreth 40% e Institucioneve Shkollore janë Kopshte por i shërbejnë vetëm 13% të popullatës së nxënësve.
- 52.% e Institucioneve Shkollore janë Shkolla 9-vjeçare dhe i shërbejnë rreth 68% të popullatës totale të nxënësve. Siç duket, rreth 18.5% e të gjithë institucioneve janë shkolla Fillore (klasa 1-5) dhe i shërbejnë 4% të gjithë nxënësve. Shumica e këtyre shkollave gjenden më së shumti në zonat **rurale** dhe janë relativisht të vogla.
- Rreth 8% e Shkollave të Mesme u shërbejnë rreth 19% të gjithë nxënësve të sistemit para-universitar. *(MASH, 2009)*

Pavarësisht se ndryshimi i strukturës është themeltar në përcaktimin e zhvillimin e projektit të ndërtesës, plani i shkollës 7 vjeçare të vitit 1963 me atë të shkollës 8 vjeçare të vitit 1964 ka shumë pak ndryshime në madhësi, numër klasash, skemë, e në organizim morfologjik të ndërtesës. Më poshtë jepen të dhënat mbi tipin e shkollës 7 vjeçare, simetrike me tre kate të vitit 1963 dhe tipit të shkollës 8 vjeçar simetrike me tre kate të vitit 1964, të projektuara nga arkitekte Valentina Pistoli. (Tabela 13)

Botime Pegi

*Tabela 13. Parametrat e dizajnit të projektimit të shkollës 7 vjeçare ( viti 1963) dhe 8 vjeçare (1964)*

| | | Viti | 1963 | | | | | 1964 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nentipi | Tip simetrike 3 kat | | | | | Tip simetrike 3 kat | | | | |
| | | Emertimi | Nr. | m2 | M2/nx | Sip. Tot | Totali | Nr. | m2 | M2/nx | Sip. Tot | Totali |
| | | Nxenesit | 40 | 1346 | 2.4 | 560 | | 40 | 1599 | 2.5 | 640 | |
| Hapesira mesimi | Hap. Didaktike | Klasa | 14 | 39.1 | 0.98 | 547 | 664.65 | 16 | 39.1 | 0.98 | 625 | 877.33 |
| | Hap. Praktike | Laboratore | 3 | 39.3 | 0.21 | 118 | | 5 | 50.5 | 0.39 | 252 | |
| | | Palestra | | | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | |
| Hapesira per aktivitete te lira | | Biblioteke | 1 | 39.1 | 0.07 | 39.1 | 65.33 | 1 | 25.3 | 0.04 | 25.3 | 38.75 |
| | | Salle Nxenesish | | | | 0 | | 1 | 13.5 | 0.02 | 13.5 | |
| | | Mence | 1 | 26.3 | 0.67 | 26.3 | | | | 0 | 0 | |
| Hapesira shperndarese | | Holle | 3 | 51.2 | 0.27 | 154 | 413.04 | 3 | 51.2 | 0.24 | 154 | 453.12 |
| | | Korridore | 3 | 71.6 | 0.39 | 215 | | 3 | 81.4 | 0.39 | 244 | |
| | | Shkalle | 2 | 22.3 | 0.08 | 44.5 | | 1 | 55.3 | 0.09 | 55.3 | |
| Hapesira administrative | Administrata | Drejt/Sekr/mes | 2 | 19.2 | | 38.5 | 77.15 | 2 | 20 | | 40 | 87.91 |
| | Mesuesi | Fjetje | | | | | | | | | | |
| | | Kabinete | 3 | 12.9 | | 38.7 | | 4 | 12 | | 47.9 | |
| Ambjente ndihmese | Ndihmese | Zhveshje/dushe | | | 0.00 | 0 | 126.21 | | | 0.00 | 0 | 142 |
| | W.C. | m2/Nxenes | 6 | 13.1 | 0.14 | 78.3 | | 2 | 26.9 | 0.08 | 53.8 | |
| | | cope/Nxenes | 18 | | 31.1 | | | 12 | | 53.3 | | |
| | | Mesuesi | | | | | | 2 | 7.71 | | 15.4 | |
| | Depo | Depo | 6 | 7.98 | | 47.9 | | 6 | 12.1 | | 72.8 | |

Megjithëse shkolla ndryshoi totalisht strukturën organizative vihet re që ndryshimet për shtimin e një viti akademik më shumë brenda në mjediset e ndërtesës, pasqyrohen vetëm me shtimin e dy klasave (nga 14 në 16) dhe të 2 laboratorëve ( 3 copë në 5). Kjo sjell edhe një rritje të lehtë të sipërfaqes së shkollës nga 1346 m2 në 1599 m2 e cila shpërndahet midis hapësirave të mësimit (me 110 m2), hapësirave ndihmëse (rreth 20 m2) si dhe atyre shpërndarëse (40 m2). Ndërkohë që rriten numri i mjediset minimale të klasave, laboratorëve e ambienteve ndihmëse vihet re një pakësim në sipërfaqet për aktivitete të lira e sociale mes nxënësve, si heqje e sallës së mensës dhe zvogëlim i sipërfaqes së bibliotekës. Ndërkohë krijohet një dhomë e vogël për nxënësit me arsyetimin për diskutime e mbledhje mes tyre. Ky mjedis do të jetë gjithmonë minimal dhe i vendosur më shumë për arsye të përhapjes së propagandës së punës në grup. (Tabela 13)




Figura 196. *Majtas: Planimetri të katit Përdhe , të parë e të dytë në shkollën 7-vjecare Tip. Simetrike me 3 kate të vitit 1963, dhe djathtas: Planimetri të katit Përdhe , të parë e të dytë në shkollën 8-vjecare Tip. Simetrike me 3 kate të vitit 1964*

Nga ana e organizimit të planimetrisë shkolla e vitit 1963 me atë të vitit 1964, ku shkolla kaloi nga 7 në 8 vjeçare ngelet e tipit kompakt e lineare, ku korridori qendror e i ngushtë bën shpërndarjen në dy krahët e klasave e laboratorëve. Hyrja për në mjediset e shkollës mbetet përsëri me një hyrje qendrore më monumentale me strehë dhe dy anësore shumë më modeste. Nga dy korpuse shkallësh në dy anët e hyrjes kalohet në një korpus qendror përballë momentit të hyrjes për në shkollë. (Figura 196)

Ndryshimi në strukturën organizative të shkollës nuk është reflektuar plotësisht me ndryshime në dizajnin e shkollave por thjesht me rritje të sipërfaqes së shkollës. Kjo karakteristikë ishte pozitive në krahasim me ndryshimet në reformën e strukturës së shkollave të vitit 2009 ku të njëjtat ndërtesa të projektuara për sistemin 7 vjeçar, më pas atë 8 vjeçar u përdorën për futjen e një sistemi 9 vjeçar. Tipat e shkollave sipas strukturës organizative në vitet 1945-1990 ishin:

A- Shkolla Fillore: 5 vite (1946-1963), 4 vite (1964-2009)

B- Shkolla shtatë-vjeçare: (1946-1963) në tetë-vjeçare (1964-2009).

C- Shkolla 11-vjeçare (1946-1963) në 12-vjeçare (1964-2009). (Figura 197)




Figura 197. *Skeme e ndryshimeve të strukturës së organizimit të sistemit arsimor përgjatë viteve.*

Më poshtë paraqitet struktura organizative e shkollave, ku kryesisht ndaheshin në tre tipe Kryesore. (Figura 198)

1. Shkolla 7 ose 8 vjeçare qyteti
2. Shkolla 7 ose 8 vjeçare fshati ( Shkollat fillore)
3. Shkolla te mesme




Figura 198. *Skema e tipologjive të ndërtesave të arsimit sipas Organizimit të strukturës.*

### 4.3.2 Tipologjitë e ndërtesave në bazë të vend-ndodhjes e pozitës gjeografike

- *VEND-NDODHJA E NDËRTESËS.*

Një karakteristikë tjetër e cila përcaktonte tipologjinë e shkollave e ndikonte në dizajnin e tyre është vendndodhja e ndërtesës si shkollë fshati (rurale) ose shkollë qyteti (urbane). Në vitin 1944 me mbarimin edhe të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria e gjeti veten në gjendje të mjeruar ku "Mbi 80 % e popullatës Shqiptare ishte analfabete dhe shkolla fillore mungonin në shumë fshatra." (Koliqi, 2002). Urdhri i Enver Hoxhës për përhapjen e arsimit dhe ndërtimin e shkollave fillore në çdo cep të Shqipërisë çoi në hapjen e shkollave rurale, të ndërtuara shpejt, deri në skajet më të largëta të vendit. Gjithashtu një faktor i rëndësishëm i përhapjes së shkollave në fshat ose qytet ishte ndikimi nga Bashkimi Sovjetik, ku të frymëzuar nga

normativat e tyre, parashikonin "urbanistikën e vendit me 1 zhvillim industrial-agrar me 70 % të popullatës të ndrydhur në fshat." (Bego, 2009, f. 29)

Nga studimi i projekteve, dallimi në se shkolla do i takonte zonave rurale apo atyre urbane bëhej në faktin se shkolla e fshatit pajisej edhe me një mjedis të vogël fjetjeje për mësuesin, dhe kjo vihet re kryesisht në shkollat fillore me 1-5 klasë mësimi. Pajisja me ambiente banimi për mësuesin vazhdon deri në vitet 1959. Ky element i cili ishte i përhapur gjerësisht mbas lufte ndërlidhet me numrin e vogël të mësuesve, numrin e shkollave rurale të cilat u ndërtuan me shpejtësi në çdo cep të Shqipërisë për të ulur shifrën alarmante të analfabetizmit. Këta mësues shkonin në një zonë, vendoseshin për një fare kohe e jepnin mësim një grupi nxënësish nga fshatrat përreth. (Figura 199)




Figura 199. *Plane të shkollës fillore me 1 , 2, 3 klase me ambientin e fjetjes së mësuesit. Viti 1945.*




Figura 200. *Majtas: Grafiku i institucioneve Shkollore të vendosura në zonat urbane e në ato rurale. Djathtas: Grafiku i Ndërtesave Shkollore të vendosura në zonat urbane dhe në ato rurale.*

Nga të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kanë rezultuar se gati 22% e Ndërtesave të Shkollave dhe 19% e Institucioneve Shkollore janë të vendosura në zonat urbane. (Figura 200)




Figura 201. *Shpërndarja në % e institucioneve arsimore shkollore.*

Shpërndarja e institucioneve shkollore shkon më shumë se gjysma (53 %) në arsimin e detyruar 9- vjeçar dhe vetëm 8 % në arsimin e mesëm ku gjithmonë shkollat rurale përbëjnë numrin më të madh, respektivisht 86 % e shkollave 9-vjecare dhe 57 % e shkollave të mesme janë në zonat rurale. (Figura 201)

Duke qenë se shkollat fillore kryesisht janë gjithashtu edhe shkolla fshati ose ndryshe rurale, e për këtë pajisen me ambiente shtesë për mësuesin, në shkollat shtatë-vjeçare faktori ndikues ne dizajnin e vendosjes së shkollës, në ishte shkollë qyteti a fshati, ndikonte te normativa e madhësisë së shkollës, e në numrin e kateve. Normativat e vitit 1958 rezulton që shkollat fillore si shkollat e fshatit edhe ato të qytetit llogariten me 1-7 klasa mësimi. (Figura 202)

Ambientet e fjetjes se mësuesve janë kryesisht të përbëra nga dhomë gjumi, ambient gatimi e një nyje sanitare. Hyrja e mësuesit bëhet kryesisht nga një derë e veçantë, dhe ka lidhje mes korridorit me ambientet e mësimit. Shkollat fillore, të pozicionuara kryesisht në fshatra të Shqipërisë, paraqiten me një arkitekture mjaft të varfër, ku mbizotërojnë linjat e drejta e të thjeshta në formulimin e ndërtesës. (Figura 203)

Ledita Mezini




Figura 202. *Plane të shkollave në fshat me një klasë mësimi. Viti 1952, Ark. V.Russi, A. Luffi*



Figura 203. *Fasada të shkollave në fshat me një klasë mësimi. Viti 1952, Ark. V.Russi, A. Luffi*

Ndërkohë që shkollat 7 vjeçare e më vonë, ato 8 vjeçare, paraqiten në arkitekturë me një volum gjithashtu të thjeshtë e kompakt por më të përpunuara në fasadë. Më poshtë jepet dy tipe të shkollës 7 vjeçare me 5 dhe me 7 klasa. (Figura 204)




Figura 204. *Majtas: Shkolla 7 vjeçare me 7 klasë, Viti 1953, Ark. Vangjel Russi. Djathtas: Shkolla 7 vjeçare me 5 klasë, Viti 1953, Ark. Vangjel Russi.*

Normativat i ndajnë shkollat në shkolla 7 ose 8 vjeçare fshati, ose 7-8 vjeçare qyteti, dhe te mesme të përgjithshme, pasi dihej që të mesmet ndërtoheshin vetëm në qytete. Nga studimi i projekteve e i tipeve ky grupim mund të jetë si më poshtë vijon. (Figura 205)




Figura 205. *Skema e tipologjive të ndërtesave të arsimit sipas Vend-ndodhjes së Shkollës.*

- POZICIONI GJEOGRAFIK

Pozicioni gjeografik i ndërtimit të shkollës është një element i rëndësishëm jo vetëm për konstruksionin e ndërtesës, por edhe për arkitekturën e tij. Shkollat në zonat e ftohta malore janë kryesisht me konstruksion vertikal mbajtës me mure guri 50 cm, të cilat vinin kryesisht edhe për thjeshtësinë e gjetjes si materiale të zonës e koston e ndërtimit. (Figura 207) Në arkitekturë dallohen ndërtesat e malësisë për shkak të përdorimit të çative të pjerrëta. (Figura 206) Ndërkohë që në zonat me klimë më të butë, ndërtesat e shkollave janë me muraturë tulle me gjerësi 38 cm ose 25 cm. Në bazë të shkresave të gjetura në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, shkollat që ndodheshin në kuotën mbi 500 metra mbi nivelin e detit, konsideroheshin shkolla për vende Malore e propozohej ndërtimi me muraturë tulle 38 cm ose me gurë 50 cm, nëse ky material ishte në afërsi.



Figura 206. *Pamja e shkollës 8- vjeçare simetrike, ark. Valentina Pistoli, 1964*

Leila Mezini



Figura 207. *Plani i shkollës fillore me mure guri (50 cm) dhe me mure tulle (25 cm). Viti 1957, Ark. Miço Pepa*

> "Ndërtesat arsimore në Republikën e Shqipërisë janë të konceptuara dhe të zbatuara kryesisht me teknikën e muraturës, si një nga teknikat më ekonomike dhe më e përhapur për kohën. Struktura mbajtëse e këtyre ndërtesave është e lidhur ngushtë me: materialet e gjendura apo të prodhuara në vend; me aspekte të funksionit të ndërtesës (numri i kateve, shpërndarja e mjediseve të brendshme, hapjet njëtrajtësisht të shpërndara, etj.); me klimën, si edhe me njohuritë teknike e praktike të grumbulluara në kohën e ndërtimit. Përparësia ekonomike e përdorimit të muraturës si material-element parësor ndërtimi ka qenë e lidhur edhe me mungesën apo koston e lartë të çelikut si material importi." (Baballeku, 2014)

Normativat nuk kanë asnjë parametër të përmendur mbi shkollat në vendet malore ose fushore përveç faktit se në shënimet teknike përmenden:

- "Nëse shkolla të ndërtohet në kuotën mbi 500 metra lartësi të përdoren mure tulle 38 cm, ose mure guri 50 cm, nëse ndodhen në afërsi.
- Ne vendet shumë malore dritaret të bëhen më të ngushta e me dy kanate, e dublet." (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)

Tipologjitë e shkollave sipas pozicionit gjeografik mund të grupohen në dy grupe: shkolla për vende malore, shkolla për vende fushore. (Figura 208)




Figura 208. *Skema e tipologjive të ndërtesave të arsimit sipas pozitës gjeografike të Shkollës.*

### 4.3.3 Tipologjitë e ndërtesave në bazë të madhësisë

Duke qenë se pjesa më e madhe e ndërtimeve shkollore janë shkolla 7/8 vjeçare fshati ose edhe shkolla për zonat rurale, madhësia e tyre është relativisht e vogël duke nisur nga shkolla me 1 dhomë mësimi e deri në shkollat me 30 klasa në shkollat 8 vjeçare të tipit të ‘79. Analiza e tipologjive tregon se si karakteristikë kryesore në ndarjen e shkollës sipas madhësisë është pikërisht numri i klasave.

Për shkollat fillore (të fshatit, ose edhe qyteteve të vogla ) ose ndryshe shkollat e ciklit të ulët, ky numër ndryshon nga 1 deri në 7 klasa. Kjo tipologji shkolle figuron e projektuar gjerësisht deri në vitin 1959. Në grafiku i mëposhtëm janë vendosur gjithë tipet e gjetura të shkollave fillore sipas viteve të projektit si dhe numrit të klasave. (Figura 209)

Nga të dhënat vihet re: Shkolla fillore me 1,2,3,4,5 klasë mësimi janë projektuar kryesisht në vitet ‘45, e ’51 deri ’59. Shkollë me 7 klasa figuron shkolla e vitit 1959. Vetëm rreth viteve 1978/ 1979 shkolla projektohet me 6 ose dhe 8 klasë e quhet shkollë për cikël të ulët.

Ndërkaq situata e shkollave 7 vjeçare si dhe e shkollave 8 vjeçare paraqitet më komplekse, pasi ato variojnë shumë si nga numri i klasave dhe më pas në shkresat e dokumenteve figurojnë të ndara edhe me numër katesh.

Ledita Mezini




Figura 209. *Skemat e shkollave fillore të shpërndara në vite si dhe me numrin e klasave.*

Nga figura e mëposhtme dhe në bazë të kategorizimit të shkollave kemi këto normativa mbi numrin e klasave: Shkollat 7 vjeçare të projektuara kryesisht deri në 1959 figurojnë me 5, 8, 9 klasa mësimi. (Figura 210) Ndërkaq shkollat 8 vjeçare të qytetit janë me 16 dhe 24 klasa mësimi.[6] Shkollat 8 vjeçare të fshatit janë me 8 dhe 12 klasa mësimi e shkollat e mesme me 16, 24 klasa mësimi. (Tabela 14)

*Tabela 14. Tabela me të dhënat e shkollës , marrë nga Shkresat e Këshillit Teknik të Ndërtimit. (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)*

| Nr. | Të dhënat Kryesore | Tipi i Shkollës | Literatura Jonë | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Normat e reja 1974 | Normat e vjetra 1958 | Normat 1973 |
| 1 | Numri i klasave | 8-Vjecare Qyteti | 16 dhe 24 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 16 klasa |
| | | Te mesme te pergjithshme | 16 dhe 24 klasa | | 15-16 klasa (Për 12 vjecaret) |
| | | 8-Vjecare Fshati | 8 dhe 12 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 7 klasa (Për 7 vjecaret) |

[6] Klasat e mësimit në normativat e shkollave përfshijnë klasat e thjeshta si dhe laboratoret.

Ledia Meziri




Figura 210. *Skema e shpërndarjes në vite të shkollave 7 dhe 8 vjeçare sipas madhësisë, numrit të klasave*.




Figura 211. *Skema e shpërndarjes në vite të shkollave të mesme sipas madhësisë, numrit të klasave.*

Pavarësisht se në shkresat figurojnë se në mbledhjet e organizuar mbi normativat e shkollave, arkitektët e inxhinierëve u kërkohet vazhdimisht të shikojnë mundësinë për projektimin e shkollave më të mëdha në numër katesh ku shkollat e mesme të shkonin deri në 4 kate madje edhe ato 8 vjeçare, vetëm në normativat e nxjerra në vitin 1979 u arrit të projektohet një shkollë 8 vjeçare me 4 kate. Ndërkaq shkollat e mesme me 2 e 3 kate figurojnë deri në vitin 1978. Në 1978 e 1979 u projektuan shkollat me 16, 24, 28 klasa, përkatësisht me 21, 33, 35 mjedise didaktike (klasa + laboratorë). (Figura 211)  Shkolla më e vogël e mesme figuron varianti frontal i vitit 1953, i cili ka 10 klasa mësimi e 1 laborator. Kjo shkollë e mesme ishte projektuar për 400 nxënës. ( Figura 212)




Figura 212. *Shkolla e mesme e përgjithshme, Viti 1953. Shkollë e mesme për 400 nxënës. Ark. Kostaq Sahatciu.*

Të dhënat mbi numrin e kateve të shkollave janë të pakta e të pasakta për të marrë njohuritë e duhura. Inxhinieri Markel Baballëku në temën e disertacionit të tij ka ngritur një tabelë me këto të dhëna, ku vërehen se shkollat e projektuara në Shqipëri janë kryesisht me 2 e 3 kate. Ai nuk përfshin ndërtesat 1 katëshe të cilat mendohen që gjithashtu përbëjnë një numër të madh strukturash. Nga grafiku vihet re që shkollat në Shqipëri janë kryesisht të ulta me 2 kate dhe vetëm ato te mesme e rralle e 8- vjeçare janë me 3 ose 4 kate.




Figura 213. *Ndarja e stokut të ndërtesave sipas numrit të kateve në grup-vite. Burimi: (Baballeku, 2014)*

Pra sipas madhësisë shkollat mund të grupohen në bazë të numrit të klasave si dhe numrit të kateve ( kryesisht në shkollat 8 vjeçare dhe të mesme). (Figura 214)

A- Me numër klasash/ B- Me numër katesh




Figura 214. *Skema e tipologjive të ndërtesave të arsimit sipas madhësisë së Shkollës*

### 4.3.4 Tipologjitë e ndërtesave në bazë të zhvillimit morfologjik.

Në këtë pjesë paraqiten tipologjitë kryesore të projektimit të ndërtesave të shkollave bazuar në analizën morfologjike dhe shpërndarjen e hapësirave.

Ledita Mezini

Gjatë viteve 1945-1990 që është periudha e komunizmit korrespondon me një llojshmëri ndërtimesh arsimore të cilat ilustrohen nga përdorimi i morfologjisë dhe modeleve hapësinore që ndjekin në përgjithësi tipa tradicionale ndërsa të tjera ndryshojnë prej njëra tjetrës. "Disa prej këtyre formave vijnë si pasojë e karakteristikave specifike të shkollës, nga niveli i edukimit, dhe nga numri i nxënësve. Por gjithashtu varen nga kushtet klimaterike, vendosja rajonale, (shkollë qyteti ose fshati), e nga tipi e filozofia pedagogjike." (Rigolon 2010)

Përcaktimi i tipologjive të projektimit ka si pikë nisje modelet e dizajnit në ndërtesat e edukimit, "të cilat fokusohen kryesisht te faktorët që ndikojnë në fushën e hapësirës së edukimit si dhe të hapësirave të shoqërizimit." (Rigolon 2010) Mund të themi se ndarja mes tipologjive në lidhje me formën e shpërndarjen e hapësirave bëhet nga organizimi i hapësirave didaktike (klasave e laboratorëve) me ato të shpërndarjes, (korridore, holle, shkalle), dhe marrëdhënia që kanë këto hapësira me ambientet e jashtme të shkollës. (Figura 215)

Organizimi:

- Hapësirave didaktike (klasa e laboratorë)
- Hapësira shpërndarëse, (korridore, holle, shkallë),
- Ambientet e jashtme të shkollës.




Figura 215. *Modelet e dizajnit që kihen parasysh në zhvillimin morfologjik.*

Pavarësisht se shkollat Shqiptare nuk paraqesin një larmishmëri në zhvillimet morfologjike hapësinore përsëri nga normativat figurojnë të ndara në dy grupe kryesore:

Shkollat frontale (Simetrike) dhe shkollat Asimetrike. Ndarja kryhet në plan e gjithashtu në fasadë. Simetria e shkollës nis nga vendosja e hollit kryesor e shkallës, nëse janë në qendër, te hyrja apo janë të pozicionuara në cep të ndërtesës. Mbi tipet 8 vjeçare, simetrike dhe asimetrike arkitekti Kostaq Sahatçiu në 1964 shprehet:

"Shkollat paraqiten me shtrirje gjatësore me korridor të ndërtuar nga njëra anë me klasat dhe nga ana tjetër me laboratorët , kabinetet etj. Shkalla vendoset në mes ose anash dhe kjo jep tipin simetrik ose asimetrik, por që në fakt në volum s'kanë ndonjë ndryshim mes tyre. Tipi simetrik mund të kthehet fare lehtë në tipin asimetrik dhe e kundërta pasi secila në vetvete nuk është e lidhur organikisht me zgjidhjen e saj." (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)

- SHKOLLAT SIMETRIKE

Shkollat simetrike janë gjerësisht të përhapur në territorin tonë e kjo ndoshta e lidhur me shumë arsye:

Shkollat simetrike të ndërtuara në vitet '45-'90 janë një rrjedhojë e shkollave simetrike të ndërtuara në Shqipëri prej vitesh e si pasojë e një trashëgimie të rrënjosur në memorien e arkitektëve.

Së pari, duke qenë se shkollat simetrike kanë një hyrje qendrore e holli shpërndarës nis në qendër të strukturës, kalimi nëpër mjediset didaktike kryet më shpejt dhe ka mundësi arritjeje më të thjeshtë. (Figura 216)

Shkollat simetrike gjithashtu nga preventivat dhe relacionet përshkrimore, paraqiten pak më të lira në kosto ndërtimi, faktor mjaft i rëndësishëm në zgjedhjen për projektimin e tyre.

Simetria e këtyre ndërtesave paraqitet edhe në fasadë ku theksohet momenti i hyrjes qendror në ndërtesë.




Figura 216. *Skemat kryesore të shkollave simetrike dhe fasada shkollash simetrike.*

- SHKOLLAT ASIMETRIKE

Varianti i parë i shkollës asimetrike u paraqit në Tipin e shkollës se mesme të vitit 1961 e ato 8-vjecare të 1961, (Figura 217) të propozuara nga arkitekte Valentina Pistoli, e më pas u përhap edhe në shkollat fillore (1976-1979). Këto variante të ripunuara më shumë në 1964 u përhapën gjerësisht në shkollat e mesme, ndërsa filloret dhe 8 vjeçare ngelën kryesisht simetrike.

Ledita Mezini




Figura 217. *Skema e shpërndarjes së Shkollës 7 vjeçare asimetrike e vitit 1961. Ark. V. Pistoli*

Skemat asimetrike dhe nën variantet e tyre gjetën më shumë përhapje në shkollat e mesme. Nga të dhënat tekniko-ekonomike të paraqitura në vitin 1974 mbi normativat e shkollave dhe 9 tipologjitë e përdorura në fshatra ose qytete te vogla del që shkolla asimetrike ka një kosto ndërtimi më të vogël, gjë që u reflektua me tendencën drejt projekteve asimetrike por gjithsesi kompakte. Shkolla me 480 nxënës me 12 klasë simetrike 2 katëshe ( numri 6 në Figurën 218) kishte një kosto 480.000 lekë ndërkaq që shkollat asimetrike paraqiten me kosto më të ulët.



TE DHENA TEKNIKE - EKONOMIKE

SHKOLLA 8 VJEÇARE (ME 8 DHE 12 KLASE) PE QENDRA FSHATI TE BASHKUARA E.N.A.

| TIPI | | SKEMA | KAPACITETI NXENES | [illegible] NXENE N° | [illegible] | [illegible] NXENES M² | [illegible] NXENES M² | [illegible] NXENES M³ | VOLUMI NDERTIM M³ | KOSTO LEKE | KOSTO NXENES LEKE | [illegible] M² | [illegible] NXENES M² |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8 KLASE 1 KAT | | 320 | 1 | 1/6 | 1.37 | 3.2 | 9.7 | 3100 | 311.000 | 970 | 65 | 0.20 |
| 2 | 8 KLASE 2 KAT | | 320 | 1 | 1/6 | 1.37 | 3.1 | 11.8 | 3780 | 378.000 | 1180 | 105 | 0.32 |
| 3 | 8 KLASE 2 KAT | | 320 | 1 | 1/6 | 1.37 | 3.2 | 11.8 | 3840 | 380000 | 1180 | 98 | 0.28 |
| 4 | 8 KLASE 2 KAT | | 320 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.8 | 10.4 | 3340 | 330000 | 1040 | 96 | 0.30 |
| 5 | 12 KLASE 2 KAT | | 480 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.6 | 9.7 | 4658 | 460000 | 970 | 96 | 0.20 |
| 6 | 12 KLASE 2 KAT | | 480 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.8 | 10.0 | 4844 | 480000 | 1000 | 96 | 0.20 |
| 7 | 12 KLASE 2 KAT | | 480 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.7 | 9.8 | 4696 | 460000 | 980 | 96 | 0.20 |
| 8 | 12 KLASE 3 KAT | | 480 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.8 | 10.0 | 4813 | 475000 | 1000 | 132 | 0.27 |
| 9 | 12 KLASE 3 KAT | | 480 | 1 | 1/6 | 1.37 | 2.7 | 9.6 | 4630 | 459000 | 960 | 120 | 0.26 |

Figura 218. *Të dhënat tekniko-ekonomike për shkollat 8 vjeçare me 8 dhe 12 klasë. (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)*

Disa prej skemave më të përdorura te shkollat e mesme asimetrike janë paraqitur më poshtë në figurën 219.

Pavarësisht ndryshimeve të lehta në plan shkollat paraqiten gati njësoj në volume e në fasadë. "Në thelb shkollat simetrike nga ato asimetrike ndryshojnë vetëm nga ritmi i dritareve pasi volumet ngelen po të njëllojta." (Kostaq Sahatçiu, 1964) (Figura 220)



Figura 219. *Skemat e shkollave asimetrike, dhe foto e shkollës së mesme, asimetrike "Sami Frashëri", Tiranë.*



Figura 220. *Fasadat e projektit Tip për shkollën 12 vjeçare asimetrike dhe simetrike në vitin 1971, Ministria e Ndërtimit, Instituti Shtetëror i Projektimit, Drejtoria e Projektimit të Ndërtimeve Qytetare. (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015).*



Figura 221. *Foto e shkollës asimetrike, Tiranë, viti 1964. Burimi (Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, 2015)*

Në Evropë studiuesit duke u bazuar në modelet e dizajnit kanë identifikuar katër tipa kryesore dizajni si : tipi me oborr, tipi bllok, tipi me grupime, ose tipi 'qytet' (i përbërë ose kompleks). (Figura 222)




Figura 222. *Tipologjitë e dizajnit të shkollave në Evropë. (Rigolon, 2010)*

Në Shqipëri projektet e ndërtesave arsimore, janë shprehje e kostove ekonomike dhe drejtohen prej tyre duke zgjedhur variantin më të lirë. Prej kësaj arsyeje arkitektët nuk kanë pasur mundësi të dalin nga tipi duke marrë variantin e miratuar e duke u përpjekur me ndonjë ndryshim të vogël në fasadë ose në momentin e hyrjes. Prej kësaj zhvillimet morfologjike janë të pakta e shkollat sipas modeleve të dizajnit të gjetura e në botë mund të ndahen në dy tipe kryesore: Tipi Bllok e Tipi me Oborr.

## TIPI BLLOK (Kompakt)

Tipi bllok është i karakterizuar nga një volum kompakt dhe me shpërndarje organizative të brendshme mjaft të thjeshtë. Një karakteristikë e dytë e rëndësishme e këtij tipi, është hapësira e madhe e unike për shoqërizimin (holli, shkallët) e cila çon direkt drejt mjediseve didaktike ( klasave, laboratorëve, punishteve etj.). Ky tip me konfigurimet e tij të ndryshme (me një atrium qendror ose me korridorin linear 'rrugën e mësimit') tenton të minimizojë hapësirat e qarkullimit dhe të japi një shpërndarje fleksibël për te ato didaktike. Në thelb të këtij varianti është se "vlefshmëria e këtij tipi është e bazuar në kushtin që hapësira kryesore e shoqërizimit është e banuar plotësisht nga studentët: nëse kjo hapësirë nuk do të ofronte mundësi fleksible e të shumëfishta për aktivitete të ndryshme atëherë kjo do të ishte thjesht një hapësirë qarkullimi e do shërbente si një ' hapësirë shërbimi'." (Rigolon, 2010)

Tipi Bllok (kompakt) ka dy nëntipa kryesore që kanë gjetur terren për tu përhapur në vendin tonë:

Tipi bllok me holl qendror  E mira e kësaj tipologjie është se gjithë mësimi edhe hapësirat e shërbimeve janë te grupuara rreth një holli të madh që është zemra e shkollës. Ky tip ka qenë shumë i përdorur te shkollat fillore ndoshta për madhësinë modeste që ato kanë si dhe gjithashtu paraqiten më miqësore karshi nxënësve duke rikujtuar skemat e kopshteve e nukleve të mbledhura. (Figura 223)




Figura 223. *Skema e tipit Bllok me holl qendror. Skema shkollash fillore me 2 klasa ose 4 klasa me tipin bllok me holl qendror.*

Varianti Bllok- Linear, ku korridori gjatësor bën shpërndarjen nëpër mjediset kryesore didaktike e ndihmëse. "Rruga e mësimit" është një hapësirë vibruese, veçanërisht kur nxënësit lëvizin nga një klasë në tjetrën". (Hertzbergerer, 2008) Varianti i shkollës Bllok-linear ndoshta është varianti më i përhapur i shkollave në Shqipëri e kjo ndoshta për disa arsye te cilat na shfaqen në dy nëntipat e bllokut.

- Nëse preokupohemi për **densitetin e ndërtimit** kërkimet tregojnë se tipologjitë bllok janë më të favorshme në zona urbane, për shkak të gjurmës së tyre kompakte. E sepse ato mund te vendosen edhe ne vende jo shumë të favorshme, afër me infrastruktura ekzistuese për shkak të stilit të tyre diskret e të thjeshtë.
- **Optimizmi i sipërfaqes së dobishme neto**[7] është një vlerësim thelbësor duke pasur parasysh buxhetin e ngushtë që kane ndërtimet e shkollave. Variantet e tipit bllok janë gjithmonë më të lira për sa u takon kostove. Duke qenë se në variantet bllok linear, korridori funksionon për shpërndarje , rekreacion, grumbullim etj., d.m.th. hapësira me qëllime të caktuara sesa vetëm atë të kalimit kursehet mjaft sipërfaqe në metra katrore.
- Në lidhje me **nivelin e edukimit**, tipi bllok është më i favorshëm për shkollat shqiptare duke qene se kurrikulat tona zhvillohen kryesisht në klasa, dhe rrallë në laboratorë e mjedise të tjera. Duke qenë se shkollat në pjesën e pushimit kanë vetëm 5 minuta kohë

[7] Siperfaqja ne $m^2$ didaktike përmbi sipërfaqen totale në $m^2$.

një skemë tjetër do të ishte e papërshtatshme për shpërndarjen e nxënësve. Gjithashtu grupet e nxënësve që përdorin një sërë sallash e hapësirash gjatë ditës, në momente të ndryshme duhet të lëvizi nga një mjedis në tjetrin kështu që sipërfaqet e përbashkëta janë plot me jetë. (Figura 224)



Figura 224. *Skema shkollash Bllok- Lineare.*

TIPI ME OBORR

Tipi me oborr është një tipologji nga më të përdorurat në të shkuarën në Evropë, dhe është përsëri i favorizuar për shkollat të cilat konsiderojnë hapësirat e jashtme mjaft të rëndësishme. Megjithëse ka variacione, karakteristika kryesore e këtij standardi është mbrojta e një hapësire të jashtme e cila kontrollohet lehtësisht dhe është më ruajtëse nëpërmjet vetë godinës së ndërtesës. "Ky tip ka dy efekte kryesore: së pari kontribuon në mënyre domethënëse me krijimin e një ndjenje pronësie brenda komunitetit të shkollës; së dyti, jep një fokus viziv për hapësirat e brendshme: ndjesia e të qenit brenda një hapësire të mbyllur, me kënde të ndryshme hapjeje, shpesh të jep një ndjesi e impresion të mirë." (Rigolon, 2010)

Dy nëntipa janë identifikuar gjatë kërkimeve: me një oborr të mbyllur, ose me oborr të hapur. Volumet e tyre zakonisht ndjekin një model linear, dhe formojnë një ose me shumë kate. Zgjedhja për të lënë të hapur apo për të mbyllur hapësirën e jashtme, duke formuar kështu një mikrokozmos, varej shumë nga vendndodhja. Ndryshe nga vendet e tjera në Evropë të cilat zgjedhin të përdorin tipin me Oborr të mbyllur në zona me dendësi urbane dhe ato me oborr të hapur në periferi pasi në zona rurale, panorama përbën një element të rëndësishëm, në Shqipëri ka ndodhur e kundërta.

Ledia Mezini

Në zona rurale e kryesisht në shkollat 8-vjeçare të fshatit me 12 klasa është përdorur tipi me oborr të mbyllur, Tipi i vitit 1974. Ndërkohë aty ku kërkohen më shumë "sheshe të mbrojtura", në zona urbane përdoren tipi në formë L ose U që lejon hapjen e oborrit. Duke qenë se kati përdhes është hapësira kryesore ku ndodh lëvizja e shoqërizimi hapësirat e përbashkëta janë të projektuara si hapësira qarkullimi: shumica e ndërtesave ndjekin një shpërndarjen tradicionale me një korridor që i jep ekses klasave. Hapja e shkollës drejt oborrit bëhen nëpërmjet dy daljeve te vogla në korridor si dhe nëpërmjet një pasazhi të ngushtë qe kalon afër nyjeve Sanitare. (Figura 225)

Kjo shkollë e planifikuar vetëm për 380 nxënës kishte një kosto relativisht të madhe duke e krahasuar atë me normativën e Optimizmit të sipërfaqes neto, pasi në Tipet me oborre humbasin shumë sipërfaqe qarkullimi pasi ato janë të tipit tradicional me korridor të ngushta e klasa.

Gjithashtu Densiteti i ndërtimit në tipin me oborr, është i lartë, pasi kërkojnë një sipërfaqe më të madhe të truallit e ndoshta kjo ka qenë arsye pse është planifikuar në periferi.

Ndërkaq shkollat me oborr të hapur në Shqipëri janë të formave te U-së në plan (Figura 226) ose edhe të L-së. (Figura 227) Pavarësisht se oborri ne këto shkolla paraqitet i vogël edhe shpesh edhe i pa trajtuar, thjesht si një hapësirë grumbullimi, paraqet interes fakti se gjithmonë kishte dalje të drejtpërdrejta në pjesën e oborrit.



Figura 225. *Tipi i shkollës me oborr të mbyllur. Varianti për shkollë 8-vjecare Fshati, Viti 1974. Arkitekte Valentina Pistoli*



Figura 226. *Skema shkollash 8-vjeçare me oborr të hapur në formë U-je.*

Mjaft interesante paraqiten edhe variantet e kërkimit mes territorit të jashtëm, ndërtesës se shkollës për orientimin më të favorshëm, dhe asaj të palestrës në shkollën 7 vjeçare tip të vitit 1948/1949, ku kërkohet pikërisht marrëdhënia që krijohet mes këtyre modelesh dizajni. (Figura 228)




Figura 227. *Skema shkollash të mesme me oborr të hapur në formë L-je.*



Figura 228. *Plan vendosje të shkollës tip, 7 vjeçare të vitit 1948/1949. Burimi AQTN*

Tipet Bllok kanë aspekte të kushtëzuara pasi volumet nuk japin mundësi për të pasur eksterierë të pranishme. Ndërkohë që tipi me oborr e përforcon idenë e hapësirave të jashtme duke e pasur qëllim më vete si nga pozicioni arkitektonik ashtu edhe ai pedagogjik.

Duke qenë se shkolla si ndërtesë ishte Tip, vetëm terreni i jashtëm lihej të sistemohej sipas vendit ku do të ndërtohej shkolla. Pavarësisht edhe këtu udhëzimet jepeshin mbi madhësinë e organizimin e parcelës.

Për sa i takon madhësisë së parcelës ajo shkon kryesisht te 1 Ha., por gjithmonë varej nga vendi ku do të ndërtohej. Në organizimin e sipërfaqeve e territoreve të jashtme, shkollat 8 vjeçare projektoheshin me këto mjedise: 1- Ndërtesa e shkollës. 2-Vend lojërash, 3- Hapësirë gjimnastikore, 4- Vend Perimesh, 5- W.C. e jashtme. Në projekt ide specifikohej që shkolla duhej të orientohej nga jugu ose nga lindja, e klasat të kishin mundësi diellëzimi natyral. (Figura 229)




Figura 229. *Parcela të shkollave 7 vjeçare tip frontale me 1 dhe me 2 kate , viti 1955. Ark. V.Pistoli*

Më poshtë jepet e plotë skema e tipologjive të arsimit të ndara sipas organizimit të strukturës, sipas vendit e pozitës gjeografike, sipas madhësisë së shkollës si dhe sipas arkitekturës dhe zhvillimit morfologjik. (Figura 230)




Figura 230. *Skema e plotë tipologjive të ndërtesave të arsimit*

Nëse do i gruponim këto objekte edhe sipas moshës së ndërtesave do të vinim re që shumica prej tyre janë relativisht të vjetra e një numër i madh ende nuk dihet se kur është ndërtuar ekzaktësisht. Mosha e ndërtesës është një faktor i rëndësishëm në efektet që sjell në mësimmarrje e mësimdhënie. Ndërtesat e shkollave të ndërtuara rreth periudhës së "vrullit" arsimor përbëjnë grupin më të madh të ndërtimeve arsimore ekzistuese në Shqipëri. (Figura 231)

| Viti ndërtimit | Para 1945 | 1945-1954 | 1955-1964 | 1965-1974 | 1975-1984 | 1985-1990 | 1991-2000 | 2001-2010 | 2011-2015 | ND |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri objekteve | 43 | 103 | 220 | 563 | 633 | 453 | 363 | 409 | 86 | 367 |




Figura 231. *Numri i objekteve arsimore sipas viteve të ndërtimit.*

# PËRFUNDIME 4

Në kapitullin e katërt i cili trajton arkitekturën e tipologjitë e ndërtimeve arsimore në periudhën 1945-1990 e që përbën bazën e kërkimit, studimi ndahet në tre pjesë. Pjesa e parë shikon ndërtimet arsimore në vazhdën historike e godinat kryesore përfaqësuese të kësaj faze. Pjesa e dytë trajton normativat shqiptare për shkollat duke u mbështetur te krahasimi i këtyre normativave në lidhje me standardet e caktuara. Pjesa e tretë grupon, sqaron, e pasqyron tipologjitë e këtij grupi ndërtimor, strukturat, materialet, format morfologjike e karakteristika të tjera të arkitekturës së tyre.

Ky kapitull nis fillimisht me analizën arkitekturore nën vazhdën e trysnisë politike, pikërisht të ndryshimeve kryesore dhe çështjeve të cilat kanë influencuar ose jo drejtpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte ndërtesat arsimore të projektuara në vitet 1945-1990 si periudha ku u ndërtua numri më i madh i ndërtimeve arsimore në Shqipëri. Arkitektët që kanë ndërtuar gjatë kësaj faze, shkollat e para, fasadat, pamja e tyre, modelet morfologjike shfaqen në këtë pjesë nën titullin: Arkitektura e shkollave nën influencën politike. Me ardhjen e Partisë Komuniste në pushtet mbas vitit 1945, "stereotipat në arkitekturë e klasicizmit arkaik që mbizotëruan në Bashkimin Sovjetik (B.S.) u imponuan edhe në vendin tonë." (Bego, 2009, f. 5)

Në shkollat e kësaj periudhe të viteve 1945-1950 vihet re se ndërtesat kanë përsëri ri-sjellje të elementë të arkitekturës së banesave, kishave, xhamive, me arkada, kolona e dekorime, ose

edhe dritareve e të kanateve të grilave, me arkitekturën e medreseve e mejtepeve e të banesave tipike popullore.

Në objektet e ndërtuara në Shqipëri si ato të banimit ashtu edhe ato shoqërore, e kryesisht në shkollat 11-vjecare u reflektuan gjatë këtij 10 vjeçar-i të parë, arkitektura e fryrë e butaforisë eklektike me elementë dekorues e të panevojshëm në fasadat e shkollave.

Më pas me prishjen me B.S. filluan tendenca të reja ku arkitektët shqiptare po kërkonin arkitekturën moderne të shkollave nëpër Evropë, me dritare më të mëdha, pastërti, thjeshtësi, e forma që të ndiqnin funksionin. “Po perëndonte një periudhë dhjetëvjeçare projektimi të gabuar.” (Kolevica, 2004, p. 74)

Gjithashtu edhe me ndryshimet në strukturat organizuese të arsimit të cilat kalonin sistemin 7-vjeçar në atë 8 vjeçar si dhe 11-vjeçarin në 12-vjeçar, e një ballafaqim të arkitekteve me projektimin e gabuar të mëparshëm u dukën disa tendenca drejt një arkitekture më moderne në ndërtesat arsimore, tendenca që u fshinë e u zhdukën shpejt nën trysninë politike të tipizimit, standardizimit si dhe shtrydhjes ekonomike.

Arkitektura e periudhës së viteve 1963-1975 u karakterizua nga zhvillime Tip, të njëllojta kudo e kurdo, derivate të të njëjtës tipologji me mangësi të mëdha në origjinalitet e në krijimtari, të bllokuara në një sasi të kufizuar fondi e kostoje ekonomike.

“Sistemi edukativ dhe trendi arkitektonik në përgjithësi përfshinte tendencën e fabrikës, bazuar në ndërtimin e shpejtë dhe ekonomik të shkollave pa pasur parasysh uniken, dhe përshtatjen me procesin e mësimit. Aspektet kulturore, gjeografike, shoqërore, dhe ideologjike nuk ishin prioritet të krahasuara me interesin për të krijuan një unifikim. Falë mungesës së buxhetit ekonomik për ndërtimin e shkollave, interesi dhe fokusi në infrastrukturën e shkollave ishte i pakët në fushën e pedagogjisë, organizimit shoqëror, hapësirës së brendshme, dhe elementeve të tjerë fizikë.” (Pasalar, 2003)

“Arti i Realizmit Socialist u dallua për mungesën e origjinalitetit dhe varfërisë të shprehjes artistike”.(Velo, 2013) Kjo shprehje na ballafaqon më së miri me situatën e krijuar ndoshta edhe prej imponimit të regjimit i cili nuk linte të dilje nga tipi, ose edhe nga mungesa e madhe ekonomike, duke sjellë që në shkollat e kësaj periudhe të vihet re një varfëri mendimi në projektimin e shkollave. Krahas ndërtimit në masë të shkollave u has fenomeni i standardizimit, i cili solli monotoninë në qytetet e fshatrat e vendit. Dy tipet kryesore të shkollave: simetrike dhe asimetrike, shkuan drejt varfërisë, lënien pas të sipërfaqeve e zbrazjes së saj nga çdo hapësirë e lirë e kreative.

Parulla që ia zuri frymën ekonomisë së vendit e sidomos ndërtimit ishte: “Kursim, kursim dhe vetëm kursim, kudo dhe në çdo gjë, aq shpesh të përsëritur me klithma të shfrenuara.” (Kolevica, 2004, p. 154)

Në pjesën e dytë të kapitullit përforcohet më fortë ideja se këto shkolla kanë një arkitekturë të papërshtatshme për kryerjen e procesit mësimor. Pikërisht në këtë pjesë trajtohen parametrat e dizajnit, sipërfaqet, raportet, e hapësirave, numri i nxënësve e të dhëna të tjera të cilat mbështeten mbi principet e dizajnit që duhet të kihen parasysh në projektimin e shkollave. Këto parametra janë të shumtë dhe literatura na tregon se janë të lidhur me faktorë që ndikojnë direkt

ose në mënyrë të tërthortë në projektim e ndërtesave arsimore e që sjellin efekte pozitive ose negative në procesin e mësimit. Analiza dhe sintetizimi i këtyre principeve të dizajnit në shkollat e ndërtuara në vitet 1945-1990, krijon një ballafaqim të çështjeve kryesore që lidhen me shkollat, shfaq një bazë të gjerë konteksti dhe njohjeje me këtë grup strukturash si dhe evidenton gjendjen e këtij stoku të madh ndërtimesh duke dhënë mundësi reflektimi për atë që ka qenë është e do të jetë e ardhmja e ndërtimeve arsimore në Shqipëri.

Të projektuara për 40 nxënës në klasë, me një raport 1 $m^2$ për nxënës shkollat shqiptare largohen shumë nga arkitektura e shkollave Evropiane, si në mendim, pedagogji, kurrikula e struktura duke krijuar sipërfaqe minimale për rekreacion të brendshëm, duke i kthyer korridoret vetëm si kalime shpërndarëse, duke pakësuar të gjitha mjediset e lira dhe zvogëluar "pseudo-laboratorët" në 45-55 m2 e duke shfaqur parametra të dizajnit të papërshtatshme, të ngurta e jo fleksible në shkollat Shqiptare të periudhës së viteve 1945-1990. Në këtë pjesë studiohen klasat, madhësitë, format, mobilimet, hapësirat e laboratorëve, e të palestrave, normativat e sipërfaqet e parcelave, korridoret, hapësirat administrative, ndihmëse etj., duke i krahasuar e duke i analizuar për të parë rritjet, zvogëlimet e tendencat nëpër të cilat kanë lëvizur.

Në fund të kapitullit të katërt studimi bën një kategorizim të tipologjive kryesore të shkollave duke i ndarë ato sipas grupeve kryesore. Analiza bëhet duke parë tipologjitë kryesore të ndërtimeve arsimore, ndryshimet që kanë hasur gjatë vazhdës së historisë e kush kanë qenë disa prej këtyre influencave të cilat kanë modeluar ndërtesat edukative dhe problemet që kanë sjellë e që mbartin deri në ditët tona.

Janë studiuar një numër i madh planimetrish e janë grupuar e ndarë sipas atyre faktorëve më të rëndësishëm qe studimi ka evidentuar, siç kanë qenë ndarja e shkollave sipas organizimit të strukturës, ne shkolla të ciklit të ulët, 7/8 vjeçare, e të mesme të përgjithshme, ndarja sipas vendit të ndërtimit e pozicioneve gjeografikë, në shkolla rurale dhe qyteti, ndarja sipas madhësisë së shkollës, numri i klasave e në fund sipas formave morfologjike më shumë të përdorura, të tipit kompakt e atyre me oborr. Varianti i shkollës Bllok-linear ndoshta është varianti më i përhapur i shkollave në Shqipëri e kjo ndoshta për disa arsye te cilat na shfaqen në dy nëntipat e bllokut: Blloku me atrium e blloku linear.

- Nëse preokupohemi për densitetin e ndërtimit kërkimet tregojnë se tipologjitë bllok janë më të favorshme në zona urbane, për shkak të gjurmës së tyre kompakte. E sepse ato mund te vendosen edhe në vende jo shumë të favorshme, afër me infrastruktura ekzistuese për shkak të stilit të tyre diskret e të thjeshtë. Ndoshta kjo ka qenë një arsye e përdorimit të bllokut në masë.
- Optimizmi i sipërfaqes së dobishme neto (Sipërfaqja në $m^2$ didaktike përmbi sipërfaqen totale në m2), është një vlerësim thelbësor duke pasur parasysh buxhetin e ngushtë që kanë ndërtimet e shkollave. Variantet e tipit bllok janë gjithmonë më të lira për sa u takon kostove. Duke qenë se në variantet bllok linear, korridori funksionon për shpërndarje, rekreacion, grumbullim etj., d.m.th. hapësira me qëllime të caktuara sesa vetëm atë të kalimit kursehet mjaft sipërfaqe në metra katrore.
- Në lidhje me nivelin e edukimit, tipi bllok është më i favorshëm për shkollat shqiptare duke qenë se kurrikulat tona zhvillohen kryesisht në klasa, dhe më pak në laboratorë e mjedise të tjera të shkollës, ose jashtë në hapësira të hapura, për shembull. Duke qenë

Ledia Meziri

se nxënësit në pjesën e pushimit kanë vetëm 5 minuta kohë në dispozicion, një skemë tjetër do të ishte e papërshtatshme për shpërndarjen e nxënësve nga një mjedis në tjetrin pasi do kërkonte më shumë kohë. Gjithashtu grupet e nxënësve që përdorin një sërë sallash e hapësirash gjatë ditës, në momente të ndryshme duhet të lëvizin nga një mjedis në tjetrin kështu që sipërfaqet e përbashkëta janë plot me jetë.

Periudha e viteve 1945-1990 në arkitekturën e arsimit ashtu si edhe në fusha të tjera të ndërtimit u karakterizua nga Standardizimi e Tipizimi: normativat mbi ndriçimin, përmasat e dritës në klasë, ajrimit, ventilimit sipërfaqes së klasës, korridorit, laboratorit etj., e rregulla të tjera të kësaj periudhe u aplikuan në numrin më të madh të shkollave të cilat shumë prej këtyre janë te pranishme edhe në ditët e sotme. Këto parametra të projektuara në kohën e tyre vendosën rregulla të qarta mbi çdo hapësirë dhe normativë që i takonte shkollës, por duhet pasur parasysh se "standardizimi duhet bërë por varet nga koha, vendi, paratë, kërkesat edukative e çështje te tjera të rëndësishme. Një princip mund të jetë universal por aplikimet e tij janë të veçanta dhe specifike" (Mills, 1915, p. 333)

Ky ishte ndoshta gabimi më i madh në shkollat shqiptare ku ekonomizimi, kursimi në materiale, ndrydhja e lirisë së arkitektit, çoi në ndërtesa arsimore të njëllojta, uniforme, standarde për të gjithë grup-moshat e fëmijëve duke i trajtuar ata si të njëllojtë, pedagogjinë e mësuesit si të barabartë, ndryshimet e ngjarjet në kohë si mos-ekzistente, dhe vazhduan të ndërtojnë në masë shkolla jo të veçanta, jo unike, e të njëjta pa reflektuar asgjë nga ndryshimet globale.

Ledita Mezini

# DISKUTIME E PËRFUNDIME

*"Duhet të kuptohet se çdo arkitekturë është e lidhur pazgjidhshmërisht me epokën e saj dhe që ajo mund ta shprehë veten, vetëm me format e kohës dhe vetëm me gjuhën e kohës".*
*(Kolevica, Arkitektura dhe diktatura, 2004, p. 262)*

Tema studimore tenton të kuptojë arkitekturën e shkollave Shqiptare si një pjesë e pa trajtuar më parë në analizën e ndërtimeve në Shqipëri. Për të kuptuar fillimisht epokën, historinë, ngjarjet, faktorët, influencat, arsyet që kanë sjellë këto forma, këtë fasadë e paraqitje estetike, është grumbulluar një numër i madh planimetrish, dokumentesh, literature e është analizuar baza teorike. Kërkimi ngrihet pikërisht mbi enigmën se si është zhvilluar kjo lloj arkitekture në Shqipëri, dhe pasojë e kujt faktorëve, influencave, e ndikimeve janë format e trashëguara sot?

Asnjë godinë nuk lidhet aq fortë e nuk ndikon aq shumë sa ndërtesat e shkollave. Ato jetojnë më shumë se 100 vjet, mbledhin me detyrim breza të tërë fëmijësh për orë të zgjatura brenda mureve të tyre, e në mënyrë të pandërgjegjshme edhe prindërit e tyre. Me hapësirat që ofrojnë, mbledhin komunitetin e banorët përreth dhe me pamjen e tyre bëhen shpesh simbol i lagjes, i fshatit a zonës urbane si ndërtesa më e rëndësishme. Pikërisht rëndësia që ka ndërtesa e shkollës dhe numri i madh i strukturave shkollore që ekzistojnë e që kërkojnë të ndërtohen në të ardhmen, lind nevojën që të njohim, të kuptojmë e të arsyetojmë mbi evoluimin, historikun e tipologjitë e tyre në mënyrë që mos përsërisim gabimet e të shkuarës në të ardhmen.

Pikërisht tema studimore kërkon të reflektojë, të kuptojë, të paraqesë, grupojë e qartësojë zhvillimet arkitekturore të kulturës arsimore në periudhën '45-'90. Të gjitha këto ndarje, grupime, parametra e zhvillime të arkitekturës e historisë së ndërtimeve arsimore japin një panoramë të plotë të këtij grupi të madh strukturash dhe na ballafaqojnë me gjendjen që trashëgojnë ndërtesat arsimore në Shqipëri. Tema studimore kalon e prek disa faza të zhvillimeve arsimore duke trajtuar historikun, pedagogjinë, arkitekturën si dhe faktorët së bashku me parametrat e të dhënat sasiore e cilësore.

Historiku i ndërtesave të arsimit në vendin tonë tregon se ato kanë një arkitekturë të lidhur ngushtë me luftërat që ka kaluar vendi, pushtimet e huaja, influencat, ndryshimet politike, sociale, kulturore etj. Studimi e ndan zhvillimin e shkollave në Shqipëri në 5 etapa kryesore, të cilat formohen nga faktorë të ndryshëm dhe karakterizohen nga tipare të veçanta të ndërtesave arsimore. Këto etapa janë:

**Etapa e parë**: Prej fillimit deri në Pavarësi. Kjo etapë karakterizohet nga ndikimi i madh që pati feja e ndërtimi i shkollave të para shqiptare dhe korrespondon me një arkitekturë të lidhur ngushtë me besimet fetare, si nëpër manastire ose nëpër medrese. Por përsëri mund të pohojmë se kjo arkitekturë shkon paralel me zhvillimet nëpër botë deri në shekullin e XIX të këtyre infrastrukturave.

**Etapa e dytë:** prej Pavarësisë deri në Mbretëri. Shumica e ndërtesave të para shkollore ishin shtëpi të thjeshta, depo, hambarë, etj., kryesisht ato në të cilat flitej shqip e që ishin për fëmijët

e varfër. Vihet re një ndërtim më i kompletuar në strukturat e sponsorizuara nga fondet e Austro-Hungarisë ose vendeve të tjera si Italia, Franca e Amerika. Vetëm pas pushtimit Austro-Hungarez e më pas atij Italian mund të themi se nisi të kuptohej se çfarë përfaqësonte "Shkolla", si një vend për të mësuar e për t'u informuar e gjithashtu si një ndërtesë e mirëfilltë.

Pikërisht rreth kësaj periudhe 1912-1925 u dalluan në ndërtesat shkollore përkrahja nga vendet perëndimore dhe tendenca për të futur parimet e shkollave Amerikane e teoritë e John Dewey-t "*learning by doing"*, (të mësosh duke e bërë). Ndërtesa do të ishte më shumë se një godinë mësimi. Ato përkrahnin pedagogji të reja dhe po përpiqeshin të kapnin me hapa të vogla e të ngadalta "arkitekturën e shkollave të së nesërmes."

**Etapa e tretë:** Shkollat nën influencën Italiane. Por e gjendur mes luftërave të vazhdueshme, arkitektura e ndërtesave shkollore u përfshi nën influencën italiane e cila në vitet 1925- 1939 që përkon me periudhën e mbretërimit të Ahmet Zogut e më pas në vitet 1939-1944, me pushtimin italian, është një krijim total i arkitekteve Italianë të cilët të ardhur në Shqipëri patën mundësi të projektonin e të krijonin duke u bazuar te arkitektura racionale fashiste por duke futur edhe elemente të arkitekturës tradicionale Shqiptare. Për sa i përket shkollave të periudhës së viteve 1939-1944 kemi një arkitekturë shumë të ndryshme në formë e tipologji e të karakterizuar nga variacione të ndërtesave të shkollave në plan me format simetrike ose lineare ashtu edhe në fasadë. Ky diapazon i madh variacionesh që nis i ngjashëm me arkitekturën e monumentalitetin e '900, vazhdon me arkitekturën fashiste, merr elemente të arkitekturës së banesave Shqiptare, e gjithashtu përqafon parime moderne të arkitekturës së shkollave '*open air'*, bën që strukturat edukative të kësaj periudhe të përbëjnë një shumëllojshmëri arkitekturash e stilesh. Arkitektet italiane patën mundësinë te eksploronin, të kërkonin veten e tyre në fushën e arkitekturës duke provuar të rikthenin elemente të arkitekturës italiane në një kontekst tjetër jashtë vendit të tyre e të fusnin një identitet e arkitekturë moderne.

**Etapa e katërt.** Arkitektura nën influencën politike. Fillimisht arkitektura e ndërtesave arsimore kishte ngjashmëri me atë të B.S. dhe këto ishin plotësisht jo në kohezion me ndërtimet arsimore në vendet e tjera Evropiane ku me kohë e kishin lënë pas arkitekturën butaforike të '900. Fatmirësisht kjo periudhë nuk zgjati shumë për disa arsye: duke qenë se numri i gjimnazeve të ndërtuara ishte i ulët, përdorimi i kësaj arkitekture ishte i kufizuar, edhe për shkak të anës ekonomike pasi kjo arkitekturë kërkonte një kosto edhe më të madhe me përdorimin e mermerit, basorelieve, kolona e korniza dekorative. Dëshira për të ndërtuar si në B.S. ekzistonte, por mungesa e fondeve sillte thjeshtime të projekteve në fasadat anësore, e bërjen e disa varianteve të fasadës kryesore në mënyrë që të gjenin atë që do të ishte më e lira po njëkohësisht e ngjashme me ato të simotrave Ruse.

Më pas me prishjen me B.S. "po perëndonte një periudhë dhjetëvjeçare projektimi të gabuar." (Kolevica, 2004, p. 74), filluan tendenca të reja ku arkitektët shqiptare po kërkonin arkitekturën moderne të shkollave nëpër Evropë, me dritare më të mëdha, pastërti, thjeshtësi, e forma që të ndiqnin funksionin. Por kjo fazë nuk zgjati e arkitektura e periudhës së viteve 1965-1979 u karakterizua nga zhvillime të projekteve Tip, të njëllojta kudo e kurdo, derivate të të njëjtës tipologji me mangësi të mëdha në origjinalitet e në krijimtari, të bllokuara në një sasi të kufizuar fondi e kostoje ekonomike.

Izolimi politik e ekonomik i Shqipërisë, gjendja e rëndë ekonomike, së bashku me parullat për kursim si dhe luftës kundër influencave të huaja, çuan në zbrazjen totale të shkollës nga elementët arkitektonik, në rritjen e numrit të kateve për të kursyer maksimalisht, në shtimin e klasave por të asnjë parametri tjetër normativ, në zvogëlimin e dritareve e dyerve të cilat duhet të ishin standarde me madhësinë që ndërtonte fabrika dhe në krijimin e shkollave uniforme, monotone e të njëllojta në të gjithë vendin.

Periudha e viteve 1945-1990 në arkitekturën e arsimit ashtu si edhe në fusha të tjera të ndërtimit u karakterizua nga Standardizimi e Tipizimi, vendosja e normativave minimale mbi çdo hapësirë dhe parametër që i takonte ndërtimit të shkollave. Por duhet pasur parasysh se "standardizimi duhet bërë por varet nga koha, vendi, paratë, kërkesat edukative e çështje të tjera të rëndësishme. Një princip mund të jetë universal por aplikimet e tij janë të veçanta dhe specifike" (Mills, 1915, f. 333) Ky ishte ndoshta gabimi më i madh në shkollat shqiptare ku ekonomizimi, kursimi në materiale, ndrydhja e lirisë së arkitektit, çoi në ndërtesa arsimore të njëllojta, uniforme, standarde për të gjithë grup-moshat e fëmijëve duke i trajtuar ata si të njëllojtë, pedagogjinë e mësuesit si të barabartë, ndryshimet e ngjarjet në kohë si mos-ekzistente, dhe vazhduan të ndërtojnë në masë shkolla jo të veçanta, jo unike, e të njëjta pa reflektuar asgjë nga ndryshimet globale.

**Etapa e Pestë:** Etapa e fundit, në arkitekturën e shkollave u karakterizua nga reforma të vazhdueshme, nga përshtatje, rikonstruksione, shtesa, e zvogëlime të strukturave, ndryshimeve të vrullshme në kurrikula, struktura e politika administrative mbi arsimin të cilat çuan në braktisje ose mbipopullim. Ndërtesa inovative arsimore me teknologji të reja, struktura moderne por që mbartnin problemet e pedagogjive të vjetruara ose edhe shkolla të ndërtuara së fundmi të cilat përkrahën normativat e vjetra, dhe standardet e 5 dekadave më parë, ishin veçantitë e kësaj faze mjaft kaotike.

Nëse reflektojmë e qartësojmë mendimet mbi kulturën e shkollave shqiptare, ne mund të nxjerrim mësimet, të mirat, të këqiajt e kësaj arkitekture duke u përpjekur të ndryshojmë aq sa mundemi nëpërmjet projektimit, të ardhmen e fëmijve. Të dizenjuara për 40 nxënës në klasë, me një raport 1 $m^2$ për nxënës shkollat shqiptare largohen shumë nga arkitektura e shkollave Evropiane, si në mendim, pedagogji, kurrikula e struktura, duke u shtypur nga influencat politike, fillimisht nga Bashkimi Sovjetik e më pas nga Kinezët, duke krijuar sipërfaqe minimale për rekreacion të brendshëm, duke i kthyer korridoret vetëm si kalime shpërndarëse, duke pakësuar të gjitha mjediset e lira dhe zvogëluar "pseudo-laboratorët" në 45-55 m2 e duke shfaqur parametra të dizajnit të papërshtatshme, të ngurta e jo fleksible në shkollat Shqiptare të periudhës së viteve 1945-1990.

Pavarësisht kësaj, kompaktësia e bllokut linear, masivisht të përdorur në Shqipëri, favorizon densitetin e ndërtimit në zona urbane për shkak të gjurmës kompakte, optimizimin e sipërfaqes së dobishme neto që është thelbësor duke pasur parasysh buxhetin e ngushtë që kanë ndërtimet arsimore, shpërndarjen më të thjeshtë të nxënësve si rrjedhoje e kurrikulës e nivelit të edukimit, si dhe më pak probleme sociale mes fëmijëve të cilët ndihen më mirë e më produktivë në shkollat e vogla e kompakte se sa në shkollat e mëdha e komplekse.

Ndërtesat e shkollave duhet të stimulojnë mësimin dhe format e këtyre ndërtesave duhet të lidhen me funksionin që ato kanë. “Forma ndjek funksionin” por funksioni i shkollës është në një lëvizje e transformim të vazhdueshëm. Duke qenë se modele të reja shkollash kanë dalë dhe bota po përkrah ide të reja në procesin e mësimit atëherë edhe objektet e shkollave duhet të përkrahin këto modele. Ndërtesat e reja për metodat pedagogjike të reja duhet të jenë shumë ndryshe nga ndërtesat e së shkuarës e mjaft fleksible.

E si do të zhvillohet në të ardhmen ambienti i procesit të edukimit, dhe cilat do jenë problemet ose çështjet që do shfaqen? Disa prej parashikimeve për të ardhmen përfshijnë: ‘skuta të fshehta’, qendra komuniteti, mobilime fleksible e ergonometrike, mësime në distancë, klasa të lëvizshme, celularet si mjetet e të mësuarit, biblioteka pa libra, etj. Por a është me të vërtetë kjo e ardhmja e shkollave pasi historia ka treguar se jo të gjitha risitë teknologjike vijnë si zgjidhje por mbartin e një serë problemesh duke u përpjekur të zgjidhin disa te tjera. Dëshira për ndërtime arsimore në masë, sa më ekonomike, duke përdorur Tipet për te kursyer kohë, e para e duke i parafabrikuar e standardizuar për të shprehur teknologjinë e “përparimet e kohës” ka sjellë sot një stok prej 3400 ndërtesash arsimore në Shqipëri që reflektojnë papërshtatshmëri, mungesë fleksibiliteti, kosto e mundim për mirëmbajte, përshtatje e adaptim.

Pavarësisht se në pjesën më të madhe këto ndërtesa na shfaqen të papërshtatshme me risitë e reja të projektimit e tendencat e arsimit në botë, ne e kemi tashmë, këtë stok të madh ndërtimor të cilin e trashëgojmë nga një periudhë e gjatë, e mundimshme dhe e vështirë dhe duhet ta studiojmë, ta njohim e ta përdorim sa më mirë për të ardhmen.

Kërkimi lë të hapur vazhdimësinë e studimit për periudhën pas viteve 1990 e cila mund të na japi sugjerimet e veta mbi projektimin e shkollave.

Askush nuk do të projektojë “keq” e sidomos për fëmijët , dhe arkitektura e shkollave në Shqipëri shpreh mendësinë, botëkuptimin, zhvillimet ekonomike, kulturore, sociale ato ndërtimore e arkitektonike pikërisht të asaj kohe. Megjithëse mund të argumentohet se investigimi i këtyre ndërtesave nuk na jep një zgjidhje të vetme në dizajnin e shkollave, ka sugjerime te forta e aspekte të procesit të projektimit të ndërtimit e të përdorimit te tyre që mund të reflektojnë problemet, çështjet, variacionet, influencat në arsim, e të bëhen modele dizajni për të ardhmen e projektimit e shkollave.

## REFERENCA

Akkinsanmi, Bukky. 2008. *The Optimal Learning Environment: Learning Theories.* Dallas TX: LEED AP, SHW Group.

Anne-Marie Chatelet, Marta Gutman. 2004. "School Buildings and architecture." Në *Encyclopedia of children and childhood in history and society*, nga Paula S. Fass (editor), 726-728. New York: Macmillan reference, USA.

Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit. 2015. "Fletë Projektesh, shkollash." Shë*nime Teknike.* Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit.

Baballëku, Markel. 2014. *Vlerësim i Ndërtimeve Strukturore në Ndërtesat Tip të Sistemit Arsimor.* Tiranë: Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Temë doktorate.

Baker, Linday. 2012. *A history of School design and its Indooor Environmental Standards, 1900 to today.* National Institute of Building Sciences, Washington D.C.: National Clearinghouse for Educational Facilities.

Bakiu, Gazmend. 1998. *Qyteti i Tiranës*. Tiranë.

Bego, Mauricio. 2009. *Skeda Arkitekture 1965-2004 në kronikën e një jete të dallgëzuar. Monografi, çështja e Strehimit në periudhën e Realizmit Socialist.* Tiranë: DEA, Sh.P.K.

Beqja, Hamit. 1974. *Politika arsimore marksiste- leniniste e PPSH dhe zbatimi i saj në jetë.* Tiranë: Revista pedagogjike, Nr. 5.

Bertman, Kathryn. 2012. *The cultural architecture of schools: a study of the relationship between school design, the learning environemt, and learning communities in new schools.* Teze doktorature, University of Wollongong. Australi

2009. "Building Intelligence", *Building Intelligence for Education Segment.* Schneider Electric, Dhjetor.

CABE/RIBA. 2004. "21st Century Schools". *Learning environments of the future.* Marrë më 7 Shtator 2014. http://www.buildingfutures.org.uk.

Catherine Burke & Ian Grosvenor. 2008. *School.* London, UK: Reaktion Books Ltd.

Ceka, Neritan. 2003. "Edukata dhe arsimi ne lashtësi". Vëll. i 1, në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, 13-23. Tirana: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Châtelet, Anne-Marie, Lerch, Dominique and Luc, Jean-Noël. 2003. *L'école de plein air. Une expérience pédagogique et architecturale dans l'Europe du XXe siècle*. Paris: Éditions Recherches.

Clay, Felix. 1902. *Modern School Buildings Elementary and Secondary*. Londër.

Copa, G. H. 2000. *Impact of new designs for the comprehensive high school.* Berkeley, CA: National Center for Research në Vocational Education, (ED 438 419).

Crowley, Ralph H. 1933. "The mental Health of the Child". *Federation Education Committees Conference.* Londër.

Dedej, Sule. 2003. "Arsimi dhe mendimi pedagogjik në mesjetë". Vëll. i 1, në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i Studimeve pedagogjike, 43-88. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Dedja, Bedri. 2003. "Mendimi Pedagogjik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare". Në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, 224-261. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Dedja, Bedri. 2003. "Vazhdimësia Iliro-Shqiptare në fushën e edukatës dhe arsimit". Në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, 24-41. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Ledita Mezini

Dept. for Education and Skills, Great Britain. 2006. *Design of Sustainable Schools: Case Studies, Schools for the future.* Londër: The Stationery Office.

Dishnica, Dhimiter. 1997. *Motrat Qiriazi (monografi).* Tiranë: Botimet: Enciklopedike.

Dudek, Mark. 2000. *Architecture of Schools*. Architectural Press.

Earthman, G. 1998. "The Impact of School Building Condition and Student Achievement and Behavior". Në *European Investment Bank*, *Luksemburg: Organization for Economic Coordination and Development International Conference.*

Education. 1954. *Education (Project Innovation)* 658.

Ensor, Beatrice. 1925. "School of tomorrow", *New Era*, 81-88.

Erebara, Gjergj. 2012. "Historia e Shqipërisë (1912-2012)." *Shqip,* 28 Nëntor.

Faja, Enver. 2004. "Rebeli i arkitekturës uniforme." *Albania*, janar 20.

Faja, Enver. 2008. *Kush e drejton urbanistikën Shqiptare? Përmbledhje artikujsh kritikë 1991-2008.* Tiranë: UFO Press.

Fielding, Michael. 2006. "Leadership, Personalization and High Performance Schooling: Naming the New Totalitarianism". *School Leadership and Management* 26 (4): 350.

Fischer, Kenn. 2005. "Linking pedagogy and space". *Knowledge & Skills Building a Future.* Victoria: Department of Education and Training, 16 Mars.

Forty, Adrian. 1986. *Objects of Desire*. London: Thames and Hudson.

Foster, Norman. 2003. *http://www.fosterandpartners.com/projects/capital-city-academy/.*

Franklin, Geraint. 2012. "Built-in Variety: David and Mary Medd and the Child Centered Primary School, 1944-80." *Architectural History* (SAHGB Publications Limited) 55: 321-367.

Gardner, Howard. 2005. *Educazione e sviluppo della mente. Intelligenze multiple e aprendimento.* Trento: Erickson.

Gecaj, Murat. (2008). *Nëpër udhët e shkollës Shqipe.* Tiranë: Botimet "Erik".

Gogaj, Iliaz. 2003. "Arsimi në periudhën 1925-1939". Në *Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, 425-542. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sportit.

González, Marko Kuuskorpi & Nuria Cabellos. 2011. *The future of the physical learning environment: school facilities that support the user.* CELE Exchange 2011/11, Organisation for Economic Co-Operation and Development.

Hecker, Zvi. 2000. *http://www.arcspace.com/features/zvi-hecker/the-heinz-galinski-school/.* Nëntor 15. http://www.arcspace.com/features/zvi-hecker/the-heinz-galinski-school/.

Hertzberger, Herman. 2008. *Space and Learning: Lessons in Architecture 3*. Rotterdam: 010 Publishers.

Hille, Thomas. 2011. *Modern Schools: A Century of Design for Education.* John Wiley & Sons.

Hoxha, Enver. 1968. "Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë." *Arsimi Popullor 1*, mars 7: 11.

Ledita Mezini

Hubner, Peter. 2005. *Kinder Bauen ihren Schule (Children makes their school):* Evangelische Gesamtschule Gelsenkirchen. Stutgard/Londër: Edition Axel Menges Gmbh.

Imeri, Xhemal. 2003. *Perla e Lungarës*. Tiranë: Mokra.

J.Lackney. 1999. "The Relationship Between Environmental Quality of School Facilities and Student Performance". *U.S. House of Representatives Committee on Science*. Missisipi State University.

Jamieson, Taylor, Fisher, Trevitt & Gilding. 2000. "Place and Space in the Design of New Learning Environments". Higher Education Research & Development.

John D. Bransford, Ann L. Brown, & Rodney R. Cocking. 1999. *The Design of Learning Environment.* National Research Council.

Johnson, Philip. 2012. "1954 August: School at Hunstanton, Norfolk, by Alison and Peter Smithson". *The Architectural Riview.*

Kashari, Qazim. 2003. "Arsimi kombëtar në shtetin e pavarur Shqiptar". Në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i studimeve pedagogjike, 262-319. Tirana: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Kazazi, Njazi. 2014. *Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër*. Shkodër: Rozafa.

Kazazi, Njazi. 1997. "Vështrim për historinë e arsimit në trevën e Shkodrës". *Revista Pedagogjike*, Nr. 4, 114.

Kolevica, Petraq. 2004. *Arkitektura dhe diktatura*. Tiranë: Logoreci.

Kolevica, Petraq. 1966. "Një vështrim kritik ndërtimeve tona." *Zëri i Popullit*, janar 28.

Koliqi, Hajrullah. 2002. *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar.* Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Filozofik, Libri Shkollor.

Kumar, C. Rajendra. 2008. *Research Methodology.* New Dehli, India: S.B. Nangia.

Lawton, Millicent. 1999. "School Design Can Say a Lot about Teaching and Learning". *Harvard Education Publishing Group* (Harward Education Publishing Group) Vol 15: 1.

Leaman, A & Bordass, B. 2001. "Assessing building performance in use 4: the Probe occupant surveys and their implications." *Building Research and Information.* Volumi 29, Nr. 2 129-143.

Lyons, John B. 2001. *Do School Facilities Really Impact a Child's Education?* Institute of Education and Science.

MAS. 2014. *Ministria e Arsimit dhe Sportit.* 15 Mars.

MASH. 2009. *Buletini para-universitar.* Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Maxine Wolfe & Leanne G.Rivlin. 1987. "The Institutions in Children's Lives". Në *Spaces for Children: The Built Environment and Child Development*, nga T.G. David & C.S. Weinstein. New York: Plenium Press.

Meksi, Sofokli. 2008. *Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar.* Tiranë: Jehona.

Leonita Meziri

Mills, Wilbur T. 1915. *American School Building Standards.* Columbus, Ohio: Franklin Educational Publishing Company.

Moore, D. 1998. *Where Children Learn: The Effect of Facilities on Student Achievement.* Council of Education Facility Planners International.

Morgan, L. 2000. *Where Children Learn: Facilities Conditions and Student Test Performance in Milwaukee Public Schools.* Council of Educational Facility Planners International.

Muzeu Historik Kombëtar. 2016. "Shkollat Amerikane në Shqipëri." *Ekspozitë*. Tiranë, mars 7.

Myziri, Hysni. 2003. "Zhvillimi i arsimit ne fund te shekullit XIX dhe fillim te shekullit XX", në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*. Tirana: Instituti i studimeve pedagogjike. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Nathan, J., & Febey, K. 2001. *Smaller, safer, saner, successful schools.* Minneapolis: University of Minnesota, Center for School Change,Humphrey Institute.

Osmani, Shefik. 2003. "Arsimi dhe mendimi pedagogjik gjatë viteve 1914-1920." Në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Instituti i studimeve Pedagogjike, 320-376. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Osmani, Shefik. 1994. "Kompleksi mësimor-kulturor i Pashallëkut të Shkodrës", *Shkodra në shekuj.* Shkodër: Muzeu Historik i Shkodrës.

Pasalar, Celen. 2003. *The Effects of Spatial Layouts on Students' Interactions in Middle Schools: Multiple Case Analysis.* North Carolina: Faculty of North Carolina State University.

Pasko, Lejla, intervista nga Ledita Mezini. 2016. *Mbi Ndërtesat e Shkollave* (10 Mars).

Pearson, Eric. 1972. *Trends in School Design.* Londër: Macmillan.

Rama, Fatmira. 2005. *Dukuri arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*. Tiranë: Argenta-LMG.

Repishti, Xhevat, Qazim Kashari, dhe Shefik Osmani. 2003. "Perpjekjet per demokratizimin dhe laicizimin e shkolles shqipe, ne vitet 1914-1920". Në *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik Shqiptar*, nga Insituti i studimeve pedagogjike, 377-424. Tirane: Ministria e Arsimit dhe Shkences.

Rigolon, Alessandro. 2010. "European design types for 21st century schools: an overview." *www.oecd.org/publishing.* 03. Accessed 04 22, 2016.

Ristani, Alma, intervistë nga Ledita Mezini. 2013. Bashkia Tiranë (04 15).

Robson, Edward Robert. 1972. *School Architecture.* New York: Leicester University Press.

Sahatçiu, Kostaq. 1964. "Recension për projektin Tip të Shkollave 8-vjeçare." *Shkresa mbi Projektin Tip.* Tiranë: Vendimi Nr. 93 i Këshillit Teknik të Ministrisë së Ndërtimit, 3 Nëntor.

Sanoof, H, C Pasalar, and M Hashas. 2001. "School Building Assessment Methods." *National Clearinghouse for Educational Facilities.*

Saunders, Keith. 2012. "Effective teaching: Evidence and practice-by Daniel Muijs & David Reynolds." *British Journal of Educational Technology.* doi:10.1111/j.1467-8535.2011.01274_5.x.

Ledita Mezini

Schank, Roger. 1999. “Classrooms are out! No more classrooms! Don’t build them”. *www.designshare.com.* Maj. http://www.designshare.com/Research/Schank/Schank1.html.

Schapiro, B. 1998. "National Survey of Public School Teachers." *The Carpet and Rug Institute and The International Interior Design Association Foundation*.

Seaborne, M. 1971. *The English School: Its architecture and organization* Vol.1 : 1370-1870. Routledge&Kegan Paul.

Smith, H. n.d. "*Interactive Whiteboards*."

Stamps, David. 1998. “Learning Ecologies”. *Training,* Vol.35 Nr. 1 32-38.

Stigliano, Marco. 2012. "Tirana, ndërtimi i një kryeqyteti". Në *Arkitektura moderne Italiane për qytetet e Shqipërisë*, nga Frida Pashako, Marco Stigliano Anna Bruna Menghini, 255. Bari, Itali: Botimet Dudaj, Collana Archinauti 40.

Stratton, Lloyd. 2005. "And today's lesson is..." *www.building.co.uk.* Maj 04. http://www.building.co.uk/and-todays-lesson-is-/3050310.article.

Tani, Arta, intervistë nga Ledita Mezini. 2014. Inxhiniere në MAS (03 15).

Tanner, C. Kenneth. 2008. “Explaining Relationship Among Student Outcomes and the School's Physical Environment”. *Journal of Advanced Academics*, 444-471.

Velaj, Besnik. 2004. "Tragjasi i diturisë dhe arsimit." *55*, Shkurt 11: 12.

Velo, Maks. 2013. *Betonizimi i demokracisë*. Tiranë: UET Press.

Velo, Maks. 2004. “Rikonstruksioni i shkollave në Tiranë.” *Gazeta 55*, 11 janar.

Vokshi, Armand. 2014. *Tracce dell'architettura Italiana in Albania 1925-1943*. Firenze: DNA Editrice.

Washor, Elliot. 2003. *Innovative Pedagogy and School Facilities*. www.designshare.com.

Whitehouse, Kellee Frith & Denise. 2009. “Designing Learning Spaces that Work: A Case for the Importance of History”. *History of Education Review*, Vol. 38, Nr. 2, 94-108.

Woolner, Pamela. 2010. *The design of learning spaces.* New York: Continuum International Publishing Group.

Young, Ed, Harry A. Green, Lynnisse Roehrich-Patrick, Linda Joseph, & Teresa Gibson. 2003. *Do K-12 School Facilities Affect Education Outcomes? Staff Information Report.* Tennessee Advisory Commission on Intergovernmental Relations. http://www.state.tn.us/tacir/PDF_FILES/Education/SchFac.pdf.

Zini, Massimo. 2005. "Children in Europe." *Making Space: Architecture and design for young children.* Edinburgh, United Kingdom: OECD. 22-23.

Zotaj, Elda. 2014. *Tranzicioni politik dhe roli i tij në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Evropian.* Tiranë: Instituti i Studimeve Evropiane, disertacion.

Ledita Mezini

**SHTOJCA A-** Tabela e normativave Shqiptare (deri në vitin 1973) krahasuar me normativat e kohës të vendeve të tjera.

| Nr. | Të dhënat Kryesore | Tipi i Shkollës | Literatura Jonë | | | Literatura e huaj | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Normat e reja 1974 | Normat e vjetra 1958 | Normat 1959-1973 | NEUFERT | SOVJETIKE Normativa te Pravila1954 | KINEZE, normativa te ndryshme 1964 | ITALIANE, Karbonara vol. III 1958 | RUMUNE, Arkitektura 3- 1963 | BULLGARE Arkitektura 5- 1960 |
| 1 | Numri i klasave | 8-Vjecare Qyteti | 16 dhe 24 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 16 klasa | | 7_8 | 6-12 (FILLORET) KLASA | | 4-8 fillore | 8-16-24 KLASA |
| | | Te mesme te pergjithshme | 16 dhe 24 klasa | | 15-16 klasa (Për 12 vjecaret) | | 10-11-20-22 | 12_18_24 KLASA | | 8-12-16-20 | 12-24-36 KLASA |
| | | 8-Vjecare Fshati | 8 dhe 12 klasa | 1 deri ne 7 klasa | 7 klasa (Për 7 vjecaret) | | | | | 4-8 fillore | 8-16-24 KLASA |
| 2 | Madhësia e Parcelës | 8-Vjecare Qyteti, 16 klasa | 0.75 Ha 11.7 m2/nxënës | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | | 20-25 M2/ NXENES | 1.00-1.5 Ha<br>0.75-1.0 Ha | 1.5-3.0 M2/ NXENES,<br>2-3.5 M2/ NXENES,<br>1.5- 3.0 M2/ NXENES | | | 2.0-4.0 M2/ NXENES |
| | | 8-Vjecare Qyteti, 24 klasa | 1 Ha 10.4 m2/nxënës | | | | | | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme, 16 klasa | 0.75 Ha 11.7 m2/nxënës | | | | | | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme, 24 klasa | 1 Ha 10.4 m2/nxënës | | | | | | | | |
| | | 8-Vjecare Fshati, 8 klasa | 0.5 Ha 15.6 Ha/nxënës | | | | | | | | |
| | | 8-Vjecare Fshati, 12 klasa | 0.75 Ha 15 m2/nxënës | 7 vjecare 7 klasa, 100 Ha | | | | | | | |
| 3 | Sipërfaqe klase M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | 1 | 7 vjecare, 1 m2 | 1 | 1.2 M2-1.5 M2-2 M2/NXENES PER TE VEGJEL 100 M2 | 1.25 m2/ nx. | 1-1.2 FILLORE | 1.33 STUTGARD | 1.4 te 1967 | 1.2-1.25 M2/NX |
| | | Te mesme te pergjithshme | 1.05 | | 1 | | | 1.1-1.4 E MESME | 1.55 ZVICER | 1.2 te vjetra | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 1 | 7 vjecare, 1 m2 | 1 | | | 1-1.2 FILLORE | 2.1 USA/ 1.9 ANGLI | | |
| 4 | Sipërfaqe laborator M2/ Nxënës | 8-Vjecare Qyteti | 1.37 | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | | 1.8 M2 PER VIZATIM 2-2.5 M2/NXENES | 1.5 m2/ nx. | | | 1.87 te 1967 | 1.5 M2/ NX |
| | | Te mesme te pergjithshme | 1.5 | | 1.3-1.9 (53-67 M2) | | | | | 1.62 te vjetra | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 1.37 | 7 vjecare, 1.37-1.43 m2 | 1.06 | | | | | | |
| 5 | Sipërfaqe rekreacioni (jashtë korridorit)M2/ | 8-Vjecare Qyteti | 0.2-0.3 | | | | 0.55-0.60 | | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | 0.2-0.3 | | 0.21-0.3 | | | | | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 0.16-0.25 | | | | | | | | |
| 6 | Gjerësi Korridori në ml | 8-Vjecare Qyteti | 2.20 l dyanshëm | 2.2 | 2.14 | >> 300 l dyanshem | | >> 2.1 l dyanshem | | | |
| | | Te mesme te pergjithshme | 1.80 l njëanshëm | | 2.14 | >> 250 l njeanshem | | >> 1.71 l njeanshem | | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 1.8-2.0 l dyanshëm/1.6-1.8 l njëanshëm | 2.2 | 2.2 l dyanshëm/ 2.2 l njëanshëm | | | | | | |
| 7 | Lartësia e katit në ml | 8-Vjecare Qyteti | 3.3 dysheme/dysheme | 3.3 dysheme/dysheme | 3.4 | 3.2-3.5 m neto | 3.5 neto | 3.4-3.6 m neto | | | 3.5-3.6 m neto |
| | | Te mesme te pergjithshme | 3.3 dysheme/dysheme | | 3.4 | | | | | | |
| | | 8-Vjecare Fshati | 3.15 dysheme/dysheme | 3.3 dysheme/dysheme | | | | | | | |
| 8 | Salla e gjimnastikës | 8-Vjecare Qyteti | 9*18*4.5 h neto | | | | 8*16 m, h neto 4.5 m | | | | 12*24 m, h=5.5 -6 m |
| | | Te mesme te pergjithshme | 10*20*5 h neto | | 8.6*17.6*4.3 h neto/8.5*19.4.3 h neto | | 9*18 m, h neto 6 m | | | 28*15 m | 12*24 m, h=5.5 |
| | | 8-Vjecare Fshati | | | | | 13*25 m, h neto 6 m | | | | 8*19 m, h< 6 m |
| 9 | Raporti I Ndricimit | Per klasat e laboratoret | 1:5-1:7 | 7 vjecare, 1:0-1:8 | 1:5-1:6 | 1:5-1:2 | 1:4-1:6 per klasa e laboratore | 1:4-1:6 per klasa e laboratore | | | |
| | | Per fshat ose klime te ftohte | 1:7-1:9 | | 1:5-1:6 | | | | | | |
| | | Per ambjentet e tjera | 1:6-1:9 | 7 vjecare, 1:7-1:9 | 1:08 | | | | | | |
| 10 | Nyjet sanitare | Per gjithe tipat | 1 W.C. dhe 0.4 Pisuar per 40 djem | 1 W.C. dhe Pisuar per 40 djem | 1 W.C. per 30-52 nxenws | 1 W.C. + 0.5 pisuar per 40 djem | 1 W.C. + 0.4 pisuar per 40 djem | 3 W.C. + 0.4 pisuar per 40 djem | | | |
| | | | 1 W.C. per 30 vajza | 1 W.C. per 30 vajza | | 1 W.C. per 25 vajza | 1 W.C. per 30 vajza | 3 W.C. per 30 vajza | | | |
| | | | 1 lavaman per 60 nxenes | 1 lavaman per 1 W.C. | 1 lavaman per 80 nxenes | | 1 lavaman per 60 nxenes | 1 lavaman per 80 | | | |

## **SHTOJCA B-** Legjendat ndihmëse.







## **SHTOJCA C-** Shpërndarja e shkollave në rrethet e Shqipërisë. (Tabela)

| Nr | Emertimi | Godina viti 2012 | | | Investime te kryera Viti 2005-2012 Buxheti+d | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Godina | dhoma | Nxenes | Investimet 2005 2012 Buxhet + Donator | Numri I objekteve arsimore qe kane perfituar | Nuri I nxenesve qe kane perfituar | Investime për nxenes në 000/leke |
| | Qarku Berat | 249 | 1762 | 31180 | | | | |
| | Qarku Diber | 295 | 1817 | 35568 | | | | |
| | Qarku Durres | 183 | 1626 | 59449 | | | | |
| | Qarku Elbasan | 483 | 2458 | 67325 | | | | |
| | Qarku Fier | 345 | 2906 | 63468 | | | | |
| | Qarku Gjirokaster | 200 | 1347 | 15512 | | | | |
| | Qarku Korce | 327 | 2449 | 45442 | | | | |
| | Qarku Kukes | 198 | 1425 | 26502 | | | | |
| | Qarku Lezhe | 176 | 1616 | 34758 | | | | |
| | Qarku Shkoder | 304 | 2356 | 47408 | | | | |
| | Qarku Tirane | 309 | 2550 | 63482 | | | | |
| | Qyteti Tirane | 124 | 2038 | 79003 | | | | |
| | Qarku Vlore | 195 | 1808 | 35840 | | | | |
| | | 3388 | 26158 | 604937 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Leida Mezini

**SHTOJCA D-** Shpërndarja e shkollave në rrethet e Shqipërisë (Harta)

